



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË



DISERTACION

Paraqitur nga Maklena Çabej
(për mbrojtjen e gradës “Doktor”)

FJALËT E PËRNGJITURA DHE LOKUCIONET NË
FJALORIN E GJUHËS SHQIPE, 2006

Specialiteti: Morfologji (Gjuhësi)

Udhëheqës shkencor: Akad. Ethem LIKAJ

Mbrohet më, dt. _____._____.2014 përpara jurisë së përbërë nga:

- | | |
|----------|---------|
| 1. _____ | Kryetar |
| 2. _____ | Anëtar |
| 3. _____ | Anëtar |
| 4. _____ | Anëtar |
| 5. _____ | Anëtar |

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE

ABSTRACT

PARATHËNIE

HYRJE - Rrugët e pasurimit të fjalësit të gjuhës shqipe

METODOLOGJIA

PJESA 1

KREU I	KONCEPTI MBI FJALËN.....	5
I.1	Fjala fonetikofonologjike.....	9
I.2	Fjala drejtshkrimore.....	11
I.3	Fjala morfologjike.....	12
I.4	Fjala leksikore.....	13
I.5	Fjala sintaksore.....	15
KREU II	STRUKTURA E FJALËS.....	17
II. 1.	Llojet e strukturës së fjalës.....	21
II.1.1.	Llojet e strukturave sintetike.....	22
	- Të parme.....	22
	- Të prejardhura.....	23
	- Të përngjitura.....	24
	- Të përbëra.....	26

II.1.2. Llojet e strukturave analitike.....	27
- Me nyja.....	28
- Të përziera.....	29

PJESA 2

KREU III KRITERET E PËRCAKTIMIT TË FJALËVE TË PËRNGJITURA.....31

III.1. Vendi i fjalëformimit në gjuhësi	
III.2. Fjalët e përngjitura dhe llojet e tjera të fjalëve.....	37
III.2.1. Dallimi nga fjalët e përbëra.....	37
III.2.2. Dallimi nga fjalët e prejardhura.....	40
III.2.3. Dallimi nga lokucionet.....	43

KREU IV FJALËT E PËRNGJITURA NË FJALORIN E GJUHËS SHQIPE 2006

Struktura e fjalëve të përngjitura.....	44
IV.1. Llojet e fjalëve të përngjitura.....	45
IV.2. Përbërësit e fjalëve të përngjitura.....	58
IV.3. Statistika.....	81
IV.4. Vërejtje fonetikodrejtskrimore.....	84
IV.5. Semantika e fjalëve të përngjitura.....	87
IV.5.1. Lloji semantik i fjalëve të përngjitura.....	88
IV.6 Përgjithësim modelesh.....	155
IV.7 Prirje.....	156

PJESA 3

KREU V KRITERET E PËRCAKTIMIT TË LOKUCIONEVE.....101

KREU VI	LOKUCIONET NË FJALORIN E GJUHËS SHQIPE 2006	
	Struktura e lokucioneve.....	104
VI.1.	Llojet e lokucioneve.....	105
VI.2.	Përbërësit e lokucioneve.....	119
VI.3.	Statistika.....	144
VI.4.	Semantika e lokucioneve.....	146
VI.4.1.	Lloji semantik i lokucioneve.....	146
VI.5.	Përgjithësim modelesh.....	155
VI.6.	Prirje.....	156
PJESA 4		
KREU VII	PËRNGJITJET DHE LOKUCIONET.....	158
VII.1.	Raportet.....	158
VII.2.	Vërejtje.....	160
KREU VIII	PËRCAKTIME DHE PËRGJITHËSIME.....	162
KREU IX	REKOMANDIME.....	168
BIBLIOGRAFI.....		170
SHTOJCË		
- FJALORTH.....		176

PËRMBLEDHJE

Objekti kryesor i këtij punimi është njohja dhe analiza e strukturës së fjalëve të përngjitura dhe të lokucioneve, si dy procese të rëndësishme të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe dhe sidomos prirjet e zhvillimeve të tyre.

Njohja e konceptit mbi fjalën dhe e statusit të saj në kontekste të caktuara, nëpërmjet këndvështrimeve dhe rrafshve të ndryshme gjuhësore na ndihmon të analizojmë drejt strukturën e fjalës. Njohja me llojet dhe me pjesët përbërëse të strukturës së fjalës në përgjithësi na ndihmon të njohim dhe të analizojmë strukturën e fjalëve të veçanta dhe mënyrën e ndërtimit të tyre.

Për të dalluar fjalët e përngjitura dhe lokucionet në gjuhën shqipe e për të përcaktuar kufijtë që i ndan ato nga llojet e tjera të fjalëve e të ndërtimeve të ngjashme jemi përpjekur të përcaktojmë disa kritere kryesore, nëpërmjet të cilave mendojmë se kemi bërë një analizë të gjerë, por joshteruese për këto dy forma fjalësh.

Duke përdorur si lëndë bazë Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006, për të nxjerrë në pah veçoritë e fjalëve të përngjitura dhe të lokucioneve jemi përqendruar: a) në analizën e strukturës formale të tyre, sipas llojeve të ndara sipas të gjitha pjesëve të ligjëratës, ku veprojnë këto mënyra fjalëformimi; b) në lidhjet fjalëformuese; c) në analizën e strukturës semantike. Analiza e secilit prej këtyre aspekteve nuk është parë krejt e shkëputur nga njëri-tjetri, prandaj ka ndodhur që, gjatë analizës së një aspekti, është dashur ndërhyrja analizuese e aspektit tjetër.

Fjalë kyçe: Fjalë e përngjitur, lokucion, semantika e fjalës, struktura e fjalës.

ABSTRACT

The objective of this study is to analyze the structure of agglutinative words and word phrases, as two important processes in word formation in the Albanian language, as well as trends in their continuing development.

Knowing the concepts about the word and its status in different contexts, analyzed from different grammatical viewpoints, helps in analyzing the word-structure. Knowing the different kinds of word structures in general helps in analyzing specific words' structure and their formation process.

In order to distinguish agglutinative words and word phrases in Albanian and to determine the borders that separate them from other word types, this study uses some principal criteria that help in deeply analyzing them, but not exhaustively.

Using the 2006 Albanian Dictionary as the basic source for finding and analyzing agglutinative words and word phrases, the study is concentrated in: a) the analysis of their formal structure, categorized according to different parts of the speech where they are used; b) word forming links; and c) analysis of semantic structure. The analysis of each of these aspects is done in conjugation with each-other, therefore during the analysis of one aspect often is analyzed the other, too.

Key words: agglutinated words, word phrases, word semantics, word-structure.

PARATHËNIE

Si në çdo fushë të dijes, ashtu edhe në gjuhësi bazën e çdo studimi e përbën materiali (E.Çabej, Studime gjuhësore I, Prishtinë 1976 :10).

Jemi përpjekur që, para se të nisnim të mendonim praktikisht e të shkruanim këtë studim, të grumbullonim sa më shumë material, që mbledhja e tij të mos ishte e metë. Për të gjetur ato që janë thënë e shkruar mbi fjalët e përngjitura e lokucionet në gjuhën shqipe kemi qëmtuar në gramatikat e hershme, në fjalorë, në shkrime e në studime të kryera posaçërisht ose jo për to nga studiues shqiptarë e albanologë të huaj. Para Kongresit të Drejtshkrimit është folur pak për këto struktura fjalësh, ndonjëherë edhe në mënyrë joshkencore. Megjithatë, përfshirja dhe përmendja e tyre në disa studime të Xhuvanit, të Çabejt, të Agalliut, në gramatikat e Sheperit, të Xanonit e të Cipos ishin një fushë rekomandimesh për studime të plota e të thelluara. Kështu, më pas studimi i tyre u pa si një vlerësim që i bëhej pasurimit të mëtejshëm të fjalësit të gjuhës shqipe. Studimet e posaçme të Kostallarit, të E.Angonit, të M.Çelikut, M.Domit, të Z.Dacit etj., dhe së fundi monografia mbi fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe e L.Buxhelit pohuan dhe përforcuan rolin e rëndësishëm të këtyre formimeve fjalësh, edhe pse jo prodhimtare, në gjuhën shqipe.

Në këtë linjë, edhe punimi ynë ka si qëllim të nxjerrë në pah veçoritë e fjalëve të përngjitura e lokucioneve, nëpërmjet rivlerësimit që u është bërë në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006, për të arritur këto synime kryesore:

- 1. Klasifikimin strukturor e semantik të fjalëve të përngjitura dhe të lokucioneve*
- 2. Përgjithësimin e modeleve strukturore*
- 3. Përcaktimin e kufijve midis fjalëve të përngjitura dhe lokucioneve*

*Pjesa tjetër me rëndësi e mbledhjes së materialit është pikërisht vjelja e tyre nga ky Fjalor, që përmban fjalësin më të plotë krahasur me gjithë fjalorët e mëparshëm, ku janë përfshirë fjalë nga gjuha popullore e nga gjuha letrare. E, në të vërtetë, **ky material një burim ka, gjuhën shqipe në tërësinë e saj të pandarë. Veçse për ta përfshirë këtë shtesë më mirë edhe në hollësi, është mirë ta shikojmë nga ana e dy burimeve, nga të cilat ajo kryesisht ka rrjedhur: nga gjuha letrare e nga gjuha popullore** (E.Çabej, po aty.).*

HYRJE

- Rrugët e pasurimit të fjalësit të gjuhës shqipe

Gjuha ekziston vetëm për shkak se ajo në të vërtetë përdoret: e folur dhe e dëgjuar, e shkruar dhe e lexuar.¹ Ajo është rezultat i rrethanave shoqërore, kulturore, ekonomike, politike etj., që zhvillohen në kohë dhe në hapësirë. Ajo gjuhë, që pasqyron gjendjen e qenësishme të një komuniteti gjuhësor, nuk mund të jetë asnjëherë e brishtë; por është, mbi të gjitha, imazhi i shoqërisë, ku faktorë të ndryshëm socialë (kulturorë, ideologjikë, ekonomikë, institucionalë, politikë, por edhe psikologjikë) luajnë rol mbizotërues në ekzistencën e gjuhës.

Ndër burimet kryesore që ushqejnë një gjuhë, në mënyrë që ajo të zhvillohet vazhdimisht, të jetë e qëndrueshme, e veçantë, e ndryshme, por edhe e lidhur me gjuhë të tjera e faktorë jashtëgjuhësorë, është fjalësi i saj. Fjalësi ndodhet gjithmonë në evolucion të përhershëm. Në të hyjnë e vihen në përdorim fjalë të reja, dalin fjalë të vjetruara e të tjera fjalë ndryshojnë kuptimin e formën. Pasuria dhe larmia e leksikut është tregues i drejtpërdrejtë i pasurisë dhe i zhvillimit të gjuhës. Gjuha pa leksik as mund të mendohet.²

Në këtë evolucion është përfshirë edhe fjalësi i gjuhës shqipe. *Kur flasim për fjalësin e shqipes, nuk kemi kufizim kohor e truallsor... Ai përfshin të gjitha fjalët që janë përdorur nga shqiptarët në të gjitha periudhat e jetës së popullit tonë.*³

Në krahasim me të kaluarën, kur në gjuhën e shkrimit shihej një pasqyrim i kufizuar i fjalësit të shqipes, tani ky i fundit paraqitet shumë më i pasur dhe i larmishëm,

¹ E.Sepir, Hyrje në shkencën e ligjërit, 177.

² A.Xhuvani, *Çështja e "Fjalorit të gjuhës shqipe"*, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, 1972 : 115.

³ Shih: J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, 2002 : 22-24.

për shkak se edhe kërkimet për njohjen sa më të plotë të tij që më parë pothuaj mungonin ose ishin amatore, u bënë të organizuara, sistematike dhe shkencore. Kështu, u njohën më mirë, u bënë më të qarta dhe u zgjeruan më shumë burimet apo rrugët e pasurimit të fjalësit të gjuhës shqipe. Megjithatë, në çdo kohë, ndër rrugët kryesore të pasurimit të fjalësit të gjuhës shqipe mbetet *gjuha e folur e popullit*, ku përfshihet kryesisht fjalësi krahinor, dialektor. Këtu hyjnë e do të hyjnë fjalë me kuptim konkret, të lidhura me natyrën e me jetesën e popullit, me bujqësinë, blegtorinë e sferat e ndryshme të prodhimit, një sasi jo e vogël leksiku abstrakt, frazeologjia e pasur në kuptimin më të gjerë e sidomos një mori frazeologjizmesh që janë ekuivalente fjalësh.⁴ Prof.Çabej, duke nxjerrë në pah rëndësinë që ka mbledhja e visarit të gjuhës së gjallë të popullit për shtimin e mëtejshëm të fjalësit të shqipes, thekson se dialektet janë një gurrë e gjallë fjalësh dhe pothuajse e pashteruar.⁵ Prej tyre kanë hyrë dhe mund të hyjnë në gjuhë fjalë të rralla, të reja e të panjohura, të cilat ose mbeten gjithmonë aty, për shkak të asimilimit të mirë dhe përdorimit të gjerë prej folësve të shqipes, ose përdoren për një kohë të caktuar, duke iu përshtatur rrethanave historike, kulturore e shoqërore, dhe dalin sërish. Kjo rrugë e pasurimit të fjalësit të shqipe, nga pikëpamja e gurrës, e së kaluarës, mund të ketë herë-herë karakter krahinor, por nga pikëpamja kombëtare, e së ardhmes, mund të shihet si një fond *letrar potencial*.⁶

Por rruga kryesore e pasurimit të fjalësit të shqipes mbetet *formimi i fjalëve të reja* mbi bazën e fjalëve ekzistuese.⁷ Edhe kësaj çështjeje Çabej i ka kushtuar vëmendje të veçantë duke vlerësuar se jo të gjitha fjalët që janë me burim vendi, janë medoemos të lashta e medoemos të gurrës indoevropiane direkte. *Si çdo tjetër gjuhë, edhe shqipja ka krijuar në mënyrë spontane, për nevojat e reja, përherë fjalë të reja, sidomos nga burimet vetiake të saj, dhe ajo vazhdon në këtë rrugë, duke pasuruar kështu përherë visarin e leksikut të saj.*⁸ Këtu hyjnë formime fjalësh të cilat janë zhvilluar në periudhën postetnike

⁴ A.Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, në: Studime mbi leksikun... II, 1972 : 15.

⁵ E.Çabej, *Gjendja e sotme dhe detyrat e etimologjisë së gjuhës shqipe*, në Studime gjuhësore, Prishtinë 1976 : 17-18.

⁶ A. Kostallari, po aty, 16.

⁷ Shih: A.Kostallari, po aty, 15.

⁸ E.Çabej, po aty, 7-11.

të gjuhës (fjalë të prejardhura, kompozita, fjalë të përngjitura, të krijuara në ngërthim të fjalisë, por edhe fjalë onomatopeike ose formime leksikore elementare). Rëndësinë e këtij burimi e trajton edhe Xh.Lloshi, i cili shpjegon sesi ndryshoi koncepti mbi rrugët e pasurimit të fjalësit të shqipes.⁹ Tashmë *fjalëformimit* po i kushtohet gjithnjë e më shumë një vend i posaçëm në gjuhësinë shqiptare, si një nga faktorët kryesorë të pasurimit të fjalësit të gjuhës sonë. Kjo është e lidhur edhe me studimet që janë bërë dhe që bëhen mbi strukturën e fjalës dhe me rëndësinë që po i jepet asaj në gramatikat e sotme, sepse studimi i analizës strukturore është i lidhur me studimin e analizës semantike të fjalëve.

Huazimet janë një tjetër burim që pasuron fjalësin e shqipes. Huazimet mund të jenë të vjetra e të reja. Huazimet e vjetra kanë hyrë në shqipe në periudha të hershme të historisë së saj në veçanti dhe të historisë së popullit në përgjithësi. Ato janë gjurmë e ndikimit që kanë lënë gjuhët e popujve fqinj, si dhe të atyre popujve që kanë sunduar në Shqipëri në epoka të ndryshme të historisë së saj. Shqipja ka marrë fjalë nga greqishtja e vjetër dhe e re, nga latinishtja e më vonë nga italishtja, nga spanjishtja, frëngjishtja, dalmatishtja, rumanishtja, nga sllavishtja e Ballkanit e nga turqishtja e osmanishtja¹⁰. Huazimet e reja hyjnë herëpashere në gjuhë, në varësi të rrethanave, të zhvillimit të vendit në të gjitha aspektet, të lëvizjes dhe të marrëdhënieve të drejtpërdrejta me popuj e me gjuhë të tjera, fqinje ose jo. Fjala e huazuar, kur hyn në shqipe, u përshtatet rregullave gjuhësore të saj. Kështu, edhe në fushën e huazimeve duket që shqipja është mjaft prodhimtare. Ajo merr fjalën bazë prej gjuhës së huaj dhe, me anë të përzierjes me elemente të vendit ose me të tjera të huaja, me mjete të ndryshme të fjalëformimit, me marrje e zhbartje ose këmbime prefiksesh e sufiksesh, me zberthim fjalësh me anë të terminologjisë popullore etj., përftohen forma të reja fjalësh, emërtimi i të cilave si huazime ka vetëm një vlerë relative.¹¹

⁹ Xh.Lloshi, *Mbi rezultatet kryesore në studimin e leksikut dhe të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe pas çlirimit*, në: Studime mbi leksikon... I, 1972 : 479-481.

¹⁰ Shih: E.Çabej, *Gjendja e sotme dhe detyrat e etimologjisë së gjuhës shqipe*, në: Studime gjuhësore I, Prishtinë 1976 : 5-7.

¹¹ E.Çabej, *po aty*.

Çdo gjuhë ka leksikon karakteristik për një kohë të caktuar historike.¹² Ky fjalës pasqyrohet edhe në *veprat letrare* qysh në periudhat e hershme të shkrimit, ose prej veprave letrare mund të vilen fjalë që mund të bëhen pjesë e fjalësit të shqipes. Këto fjalë mund të jenë edhe pjesë e *fjalësit vetiak të shkrimtarit*. Prandaj, Çabej, në punën për pasurimin e fjalësit të shqipes, ka theksuar si faktor të rëndësishëm edhe *vjeljen sistematike të veprave të vjetra letrare*. Në të vërtetë, një pjesë e mirë e këtyre fjalëve tashmë janë zhdukur dhe tani vlejnë vetëm për t'u studiuar nga ana gjuhësore. Gjithashtu, periudha e Rilindjes u dallua sidomos për krijimin e *neologjizmave*, të cilat u pasqyruan në veprat letrare-historike të asaj kohe. Neologjizmat janë një burim i mirë i pasurimit të fjalësit të shqipes (pavarësisht se gjatë Rilindjes edhe më pas u teprua me purizmin e gjuhës)¹³, por nocioni tepër i zgjeruar për to nuk mund të mbulonte gjithë rrugët e tjera të pasurimit, siç ishte fjalëformimi.¹⁴ Edhe veprat letrare të sotme janë pasuruar me një fjalës, që mund të jetë edhe fjalës vetiak i shkrimtarit (kështu, i njohur është ndikimi i fjalësit vetiak të Kadaresë në pasurimin e gjuhës letrare), i cili është shprehje e gjithë zhvillimeve gjuhësore, teknologjike, kulturore, shkencore etj. të kohës sonë.

Terminologjia është një rrugë tjetër që çon në pasurimin e fjalësit të shqipes. Ajo sjell gjithnjë prurje të reja, sepse ecën dhe zhvillohet krahas zhvillimeve më të fundit të botës sonë (siç është p.sh. terminologjia e teknologjisë së informacionit).

Duke iu dhënë rëndësia e duhur, duke i vështruar dhe analizuar njësoj të gjitha rrugët e pasurimit të fjalësit të gjuhës shqipe, ky i fundit ka arritur të pasqyrohet në nivele të kënaqshme edhe në fjalorin e fundit normativ të gjuhës shqipe, të vitit 2006.

¹² P.Geci, *Pasuria e leksikut të shqipes dhe fjalori i gjuhës shqipe*, në: Studime mbi leksikon... II, 1972 : 157.

¹³ Për këtë shih: Xh.Lloshi, *Purizmi i dështuar*, në: Shqipja, gjuhë e hapur dhe dinamike, 2011.

¹⁴ Shih: Xh.Lloshi, *Mbi rezultatet kryesore në studimin e leksikut dhe të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe pas çlirimit*, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, 1972 : 480

METODOLOGJIA

Për realizimin e këtij punimi, në përpjekje për të trajtuar strukturën e fjalës në dy procese të rëndësishme të formimit të fjalëve në shqipe, siç janë përngjitja dhe lokucionet, janë zbatuar disa metoda. Metoda kryesore që përshkon punimin, është *metoda analitike*, e cila na ndihmon që, nëpërmjet analizave të hollësishme, të paraqesim hap mbas hapi të gjitha dukuritë që shoqërojnë ndërtimin e strukturës së fjalëve të përngjitura dhe të lokucioneve. Metoda të tjera të përdorura janë *metodat përqasëse, statistikore dhe krahasuese*. Këto metoda janë zbatuar kryesisht duke përqasur dhe krahasuar me njëra-tjetrën këto dy lloje të formimit të fjalëve (fjalët e përngjitura dhe lokucionet), si dhe duke i përqasur e krahasuar ato edhe me llojet e tjera të formimit të fjalëve në shqipe. Gjithashtu, si burim për realizimin e metodës statistikore kanë shërbyer tre fjalorë të gjuhës shqipe, fjalori i vitit 1954, fjalori i vitit 1980 dhe Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006, i cili është edhe lënda bazë e ndërtimit të këtij punimi, duke menduar se në të është përfshirë një fjalës i larmishëm, i përmirësuar dhe i pasuruar. Këto metoda, të ndërthura me metodën kryesore, japin një pasqyrë të gjerë të zhvillimit dhe të rolit të fjalëve të përngjitura dhe të lokucioneve në zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe.

PJESA 1

I. Koncepti mbi fjalën

Gramatikanë, leksikologë e studiues të tjerë të gjuhësisë tradicionale e moderne janë përpjekur ta përkufizojnë fjalën sipas këndvështrimit të tyre, por asnjë përkufizim nuk mund të quhet plotësisht shterues, sepse nuk ka kritere të përcaktuara qartë, në bazë të të cilave të mund të mbështetemi për ta zgjidhur përfundimisht këtë çështje.

Për përdoruesit e thjeshtë të gjuhës duket sikur "fjala" është nocioni më i kuptueshëm në gjuhësi. Kjo vlen sidomos për folësit e gjuhëve që kanë një sistem drejtshkrimor. Sipas këtij këndvështrimi, fjala përkufizohet si një bashkim shkronjash apo fonemash, që nuk ndahen me hapësira. Kështu, në frazën *Këtu bën shumë ftohtë*, folësi i shqipes, në mënyrë të pavetëdijshme, dallon katër fjalë. Por në një rast tjetër, kur themi *do të studioj më shumë*, folësi e ka të vështirë të dallojë fjalët ose folës të ndryshëm mund të dallojnë një numër të ndryshëm fjalësh. Disa mund të mendojnë se këtu kemi pesë fjalë, të tjerë mund të mendojnë se kemi vetëm dy fjalë *studioj* dhe *shumë* etj. I njëjti problem haset edhe në gjuhë të tjera, si në anglishte *I like it*. Edhe në këtë rast është e vështirë të dallojmë kufijtë e fjalëve. Çështja e dallimit të kufijve të fjalëve varet shumë edhe nga specifikat e gjuhëve të ndryshme, prandaj puna ndërlikohet edhe më.

Po si mund të përcaktohen kufijtë e një fjale dhe si mund të përkufizohet fjala?

Shumica e studiuesve të gjuhësisë bashkëkohore i referohen konceptit klasik të Blumfildit mbi fjalën, sepse ai ishte i pari që dha një përkufizim të përgjithshëm e të zbatueshëm. Sipas Blumfildit, fjala është "*forma e lirë më e vogël*". Kjo do të thotë që fjala, duke qenë formë e lirë, nuk mund të ndahet në njësi të tjera më të vogla me kuptim. Gert Boiji (Geert Booij), profesor i gjuhësisë në Universitetin e Leidenit, Holandë, në *The*

Grammar of Words e sqaron kështu këtë koncept: Në frazën *What are we going to eat today?* "Çfarë do të hamë sot?" - *Lasagna* "Lazanja", fjala *lasanja* është një formë e lirë, sepse mund të qëndrojë më vete dhe nuk ndahet më tej në njësi me kuptim. Por nuk mund t'i përgjigjemi njësoj, me një fjalë të vetme pyetjes *What is that?* "Çfarë është kjo?" - *Apple* "Mollë". Për arsye sintaksore duhet të përgjigjemi *An apple* "Një mollë". Dhe kështu, nga pikëpamja gramatikore do të kishim dy fjalë, njëjën joshquese *an* dhe emrin *apple*, por *an* nuk mund të qëndrojë e pavarur, pra nuk mund të jetë formë e lirë¹⁵. Prandaj, sipas Xhon Lajënsit, përkufizimi i Blumfildit *nëse përgjithësisht është i zbatueshëm, më shumë u përshtatet fjalëve fonologjike sesa fjalëve gramatikore. Blumfildi nuk ka bërë dallimin e qartë midis këtyre të dyjave*¹⁶. Nga ana tjetër, Lajënsi, pasi analizon përkufizimin semantik që i ka bërë fjalës *Antuan Meje*, në të cilin "*Fjala mund të përkufizohet si lidhja e një kuptimi të caktuar me një kompleks tingullor të caktuar, i cili mund të përdoret gramatikisht*", i quan të parëndësishme konsideratat semantike për përkufizimin e fjalës, ndërsa kriterin fonologjik e sheh thjesht si një dukuri shoqëruese. Sipas Mejesë, fjala duhet të shihet në tri rrafshë njëherësh: në rrafshin semantik, fonologjik dhe gramatikor. Dhe mund të jetë vërtet kështu, sepse në rrafshin semantik fjala është njësi me funksion emërtues, që mund të qëndrojë e pavarur dhe mund të kryejë rolin e gjymtyrëve të ndryshme në fjali, në rrafshin fonologjik është një kompleks tingullor dhe në rrafshin gramatikor kryen një funksion të caktuar në fjali. Pikërisht këtu qëndron problemi i përkufizimit të Mejesë, sepse nuk është fjala e vetmja njësi që përmbush këto tri kushte, por ka edhe njësi të tjera më të mëdha, si sintagma. Prandaj, Lajënsi, duke përjashtuar kriterin semantik dhe fonologjik si kushte për përkufizimin e fjalës, e sheh atë vetëm si njësi gramatikore. Po nëse do ta trajtonim fjalën vetëm si njësi gramatikore, atëherë do të përjashtonim një nga anët më të rëndësishme të saj: kuptimin leksikor, që është *lidhja midis një sendi të caktuar dhe veshjes tingullore të fjalës*¹⁷. Kështu që edhe nga këndvështrimi i Lajënsit nuk mund të bëjmë një interpretim teorik të plotë për të dalluar kufijtë e fjalës dhe për ta përkufizuar atë.

Ndërkohë, Metjusi, në veprën e tij *Morphology, an introduction to the theory of*

¹⁵ Geert Booij, *The grammar of words*, 2010: 282.

¹⁶ John Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike* 2001: 192.

¹⁷ F. Agalliu etj., *Hyrje në gjuhësi*, 1970 : 38.

word-structure, i dallon fjalët duke u nisur nga tri nivele gjuhësore: fjala në fonologji ose në drejtshkrim (fjalëforma), fjala në gramatikë (vetë fjala) dhe fjala në leksikon (leksema)¹⁸. Sipas tij, nga pikëpamja fonologjike, fjala dallohet nga njësi më të vogla, që janë fonemat dhe rrokjet, ndërsa nga pikëpamja gramatikore fjala dallohet nga njësi më të mëdha, siç janë frazat dhe nga njësi më të vogla, siç janë morfemat. Por në disa gjuhë është e vështirë të dallojmë të njëjtën fjalë duke u nisur njëkohësisht si nga kriteri fonologjik ashtu edhe nga ai gramatikor. Kështu, në frëngjishte, në fjalinë *Je ne la connais point* “Nuk e njoh fare”, nga këndvështrimi gramatikor mund të themi se, të paktën, *connais* dhe *point* janë fjalë në kuptimin më të gjerë, ndërsa nga këndvështrimi fonologjik e gjithë fraza është fjalë. Prandaj, Metjusi, duke parë se fjalët nga pikëpamja fonologjike dhe nga pikëpamja gramatikore nuk mund të kenë të njëjtën shtrirje, përdor termat *fjalë fonologjike* dhe *fjalë gramatikore*. Gjithashtu, ai dallon mospërputhje, edhe kur bëhet fjalë për leksemën, sepse ndryshe trajtohet nga këndvështrimi gramatikor dhe ndryshe nga këndvështrimi leksikor. Metjusi i sqaron kështu këto koncepte: Në togfjalëshin *a block of ice* “mollok” ose copë akulli”, fjala *ice* “akull” i përket leksemës ICE, dhe në togfjalëshin *a jug of cream* “një poce me ajkë”, fjala *cream* “ajkë” i përket leksemës CREAM. Por ç’do të thoshim për *ice-cream* “akullorë” në *I want some ice-cream* “Dua akullorë”? Nga pikëpamja e vendosjes së theksit, ky shembull është i njëjtë me një ndërtim të tipit mbiemër + emër, si: *I want some fresh cream* “Dua ca ajkë të freskët”. Por lidhjet semantike janë të ndryshme. Në *some fresh cream* si mbiemri ashtu edhe emri mund të qëndrojnë më vete dhe mund të zëvendësohen me leksema të tjera, p.sh: *some thick cream* “ajkë e trashë” ose *some fresh milk* “qumësht i freskët” etj. Por në *some ice-cream* nuk mund të bëjmë të tilla zëvendësime dhe këto dy leksema nuk mund të qëndrojnë më vete, sepse ndryshe do të humbiste kuptimi i fjalës. Prandaj, nga këndvështrimi semantik ose leksikografik mund të themi se *ice-cream* është një njësi më vete, që ndryshe mund ta quajmë *leksemë e përbërë*, e krijuar gjatë procesit të kompozimit prej leksemave të thjeshta ICE dhe CREAM.

Siç shihet nga shembujt dhe nga analiza që u bëhet, Metjusi përpiqet të bëjë dallimin midis vetë fjalës, fjalëformës dhe leksemës, duke u nisur nga këndvështrime të ndryshme

¹⁸ P.H.Matthews, *Morphology, an introduction to the theory of word-structure*, 1974 : 31-32.

(fonologjik, gramatikor dhe semantik). Gjithashtu, ashtu si Lajënsi, ai përdor termat fjalë fonologjike dhe fjalë gramatikore, por nuk na jep një përkufizim të qartë, nga i cili mund të nisemi për të dalluar një fjalë.

Gert Boiji në *The Grammar of Words* bën një interpretim teorik të nocionit “fjalë”, duke na parashtruar disa dallime teorike dhe hipoteza. Elementet që ai përdor për të bërë një përcaktim të përshtatshëm e të mjaftueshëm të këtij nocioni janë dallimet midis leksemës dhe fjalëformës, midis fjalës dhe njësisë leksikore ose listemës, si dhe dallimi mes fjalës morfosintaksore, fonologjike dhe drejtshkrimore.

Hapi i parë është të dallojmë leksemën nga fjalëforma. Kur dikush kërkon të gjejë sa fjalë kemi në një tekst të caktuar, së pari duhet të dijë ç’janë “leksemat e ndryshme” dhe “fjalëformat e ndryshme”. *Dallimi midis këtyre dy nocioneve të fjalës lidhet me nocionin e eptimit dhe me atë që fjalëformat me tregues eptimorë të ndryshëm mund të jenë shfaqje të së njëjtës leksemë.*¹⁹ (Geert Booij, *The grammar of words*, 2010: 282).

Hapi i dytë është të dallojmë fjalën nga njësia leksikore (listema). Thuhet se një njësi gjuhësore që përbën një zë të veçantë në fjalor, është fjalë. Por duket se ky përkufizim është i gabuar, sepse njësitë gjuhësore mund të paraqiten edhe si shprehje, të përbëra nga më shumë se një fjalë. Prandaj përdoret termi listemë ose njësi leksikore. Pra, listema është një njësi gjuhësore (një fjalë ose më shumë se një fjalë) që ka një zë të caktuar në fjalor ose që është renditur në fjalor. Kjo do të thotë që përdoruesit e gjuhës mund të depozitojnë në kujtesën e tyre leksikore, përveç fjalëve, togje fjalësh të tipit *red tape*, *yellow fever*, “procedurë burokratike, ethe e verdhë” etj., ose shprehje frazeologjike apo edhe proverba. Megjithatë, kjo nuk na tregon ende asgjë për statusin e fjalës. Vëmë re se në shembujt e mësipërm, në anglishte, kemi kombinime të tipit mbiemër + emër (Mb+E). Pyetja është nëse këto kombinime, pra Mb+E, do të quhen fjalë të përbëra (pra që nga pikëpamja leksikore do të paraqiten si një njësi) apo fraza. Për t’iu përgjigjur kësaj

¹⁹ *Leksema* lidhet me nocionin “fjalë” në kuptimin abstrakt të saj, kurse *fjalëforma* lidhet me nocionin “fjalë” në kuptimin e fjalës konkrete që përdoret në një fjali të caktuar. Kështu, çdo fjalë e eptueshme që paraqitet si zë më vete në fjalorë është leksemë (*punoj, dal, mbyll* etj.). Format konkrete të saj, që mund të paraqiten ose jo në fjalorë (*punon, punojmë, punonte, punova, punuam* etj.) dhe që kanë tregues eptimorë të ndryshëm nga leksema quhen fjalëforma të leksemës së dhënë (*punon, punojmë, punonte, punova, punuam janë fjalëforma të leksemës punoj*).

pyetjeje, Boiji merr disa shembuj në gjuhë të ndryshme.

Në holandishte, *hard disk* përkthehet *harde schijf*, ndërsa në gjermanishte *Festplatte*. Në të dy rastet shprehjet janë formuar sipas ndërtimit të tipit Mb+E. Por në holandishte mbiemri *harde* eptohet, pra *-e* është flektiv, ndërsa në gjermanishte mbiemri *fest* është ngurosur dhe nuk ndryshon. Nga kjo vërejtje mund të themi se *harde schijf* është frazë, kurse *Festplatte* fjalë e përbërë. Por kur një tog fjalësh do të quhet fjalë e përbërë dhe kur frazë? Në frëngjishte shprehja *pomme de terre* “patate” quhet listemë, pra është një njësi leksikore. Ajo ka formën e një fraze në frëngjishte të tipit *emër + parafjalë + emër* (E+P+E), që u përshtatet rregullave sintaksore të kësaj gjuhe. Po ndryshe nga rregullat e zakonshme sintaksore të frëngjishtes ku, në ndërtime të tilla, E+P+E, emri i dytë mund të marrë një përpara ose të ndiqet nga ndonjë mbiemër, këtu, emri *terre* “tokë” është ngurtësuar. Pra, nuk mund të themi, p.sh., *une pomme de terre noire* “patate e zezë”, sepse do të humbiste kuptimi dhe, fjalë për fjalë, do të përkthehej “një mollë e tokës së zezë”. E njëjta gjë ndodh edhe me rastin e shprehjes në anglishte, *yellow fever* “ethe e verdhë”. Këtu, ky mbiemër e ka humbur aftësinë për t’u përdorur në shkallë të ndryshme, siç ndodh rëndom në ndërtime të këtij tipi, pra nuk mund të themi *very yellow fever* “ethe shumë e verdhë”, gjë që e vëmë re edhe në përkthimin në shqipe.

Siç shihet, ka disa shprehje të cilat paraqiten si fjalë sintaksore, që do të thotë se kanë statusin formal të një njësie sintaksore, por që, për nga mënyra e funksionimit, janë të ngjashme me fjalën në pikëpamje morfologjike.

Prandaj, për të bërë një përkufizim sa më të saktë të fjalës, për të dalluar qartë statusin e saj në kontekste të caktuara, është e nevojshme t’i përkufizojmë e t’i dallojmë ato nga këndvështrime të ndryshme gjuhësore, si: nga këndvështrimi fonetikofonologjik, drejtshkrimor, gramatikor (morfologjik e sintaksor) e leksikor.

I.1 Fjala fonetikofonologjike

Përgjithësisht, për të bërë një përkufizim sa më të pranueshëm të fjalës, mbështetemi fillimisht në kriterin fonetikofonologjik. Fjalët janë subjekt i disa rregullave të caktuara fonetike të cilat shpesh përcaktojnë se ku fillon njëra fjalë e ku mbaron tjetra. Një pjesë e mirë e gjuhëtarëve e dallojnë fjalën fonetikofonologjike pothuajse në të njëjtën mënyrë. Për Lajënsin, *një fjalë fonologjike nuk është përbërë nga tinguj, por nga elemente të shprehjes*, ku te elemente të shprehjes përfshin tingullin dhe shkronjën. Kështu, [t], [e] etj. shenjojnë tinguj; kurse *t*, *e* etj. – shkronja. Kur themi që [t] dhe [e] përkrijnë përkatësisht me *t* dhe *e*, atëherë këto mund t'i quajmë elemente të shprehjes. Në qoftë se me /l/ do të shenjonim një element shprehjeje të përcaktuar, si më sipër, atëherë do të thoshim se ai mund të sendërtohet në substancë fonike me tingullin [t] dhe në substancë grafike me shkronjën *t*, e kështu me radhë.²⁰ Pra, sipas Lajënsit, fjala fonologjike formohet nga elemente të shprehjes. Por një fjalë fonologjike nuk përkon gjithmonë me një fjalë gramatikore, pra *mes tyre nuk vendoset detyrimisht izomorfi*. Kështu, fjalës fonologjike *down* “poshtë”, i përgjigjen dy fjalë gramatikore: *down the hill* “poshtë kodrës” dhe *the soft down on his cheek* “pushi i lehtë i fytyrës së tij”.

Mark Aronofi e përkufizon fjalën fonologjike si një varg tingujsh që sillen si një njësi e vetme gjatë procesit fonetik të theksimit. Përgjithësisht, nuk ka dallim mes fjalëve fonologjike dhe fjalëve gramatikore. Në anglisht, për shembull, ka të paktën një rrokje të theksuar në çdo fjalë fonologjike, por një fjalë gramatikore mund të mos ketë një të tillë. Kështu, në fjalinë “*the dogs ran*”, fjala *the* nuk është e theksuar (shqiptohet dhë) ndërsa në fjalinë “Did you meet *the* Elvis Presley himself?”, ajo është e theksuar (shqiptohet dhi’). Në rastin e dytë ajo është një fjalë fonologjike, në të parin jo²¹.

Sipas Boijit, fjala fonetikofonologjike është *një njësi gjuhësore që paraqit karakteristikat prozodike të fjalëve dhe frazave (si theksi dhe rrokjezimi)*.²² Për ta

²⁰ John Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike* 2001: 70.

²¹ Mark Aronoff and Kirsten Fudeman, *What is Morphology?* 2005: 39.

²² Geert Booij, *The grammar of words*, 2010: 287.

shpjeguar këtë duhet të bëjmë dallimin mes fjalës morfosintaksore dhe fjalës fonetikofonologjike dhe, përveç kësaj, duhet të kuptojmë që këto dy njësi nuk janë izomorfe. Kështu, Booiji tregon se në holandishte një kompozitë është një fjalë morfosintaksore, por që përbëhet nga më shumë se një fjalë fonetikofonologjike. Madje, disa afikse, që nga këndvështrimi morfosintaksor janë morfema kufi, formojnë fjalë fonetikofonologjike.

Në anglishte, disa fjalë të përbëra shkruhen me hapësirë në mes, pra përbëhen, të paktën, prej dy fjalëve drejtshkrimore. Por ka edhe fjalë të përbëra që shkruhen pa hapësirë ose me vizë lidhëse. Boiji e sqaron këtë me fjalën *tax payer* “taksapagues”. Në anglishte këtë fjalë e hasim të shkruar në tri mënyra: *tax payer*, *taxpayer* dhe *tax-payer*. Shkruarit e anglishtes shpesh nuk e dinë se cila është forma e duhur e kësaj fjale. E shkruar me vizë në mes (*tax-payer*), i përmbledh të dyja, pra që kjo fjalë përbëhet nga dy njësi fonetikofonologjike, që formojnë një fjalë morfosintaksore. Gjithashtu, në anglishte, disa prefikse, ndryshe nga sufikset, shkruhen me vizë lidhëse (*anti-social*, *co-pilot* etj.), gjë që tregon se këto prefikse janë fjalë fonetikofonologjike.

Duke u nisur nga shpjegimet dhe shembujt e mësipërm, mund të themi se për të dalluar fjalën fonetikofonologjike duhet të njohim mirë strukturën drejtshkrimore dhe prozodike të saj.

I.2 Fjala drejtshkrimore

Në krye të kapitullit, kur nisëm të zbërthejmë konceptin mbi fjalën, thamë se fjala përkufizohet si një bashkim shkronjash apo fonemash, që nuk ndahen me hapësira, gjë që nuk ishte aspak e mjaftueshme për një përkufizim të plotë e shkencor të fjalës, por, gjithsesi, ishte një pikënisje. Në të vërtetë, ky përkufizim vlen për fjalën drejtshkrimore, të cilën janë në gjendje ta dallojnë të gjithë përdoruesit e gjuhës, pavarësisht nga arsimimi. Nga studimet që bëri në fushën e gjuhëve të indianëve të Amerikës, Sepiri tregon se *indiani naiv, fare i pamësuar me konceptin e fjalës së shkruar, megjithatë, nuk*

has në vështirësi serioze kur i dikton tekstin fjalë për fjalë studiuesit të gjuhës. Natyrisht që ai ndalet, duke i lënë të kuptojë se ç' dëshirohet prej tij, dhe mund t'i veçojë fjalët duke i përsëritur si njësi. Nga ana tjetër, ai, zakonisht, nuk do ta veçojë elementin rrënjor ose gramatikor, duke thënë se "s'ka kuptim".²³ Xhon Lajënsi flet për kriterin e "pushimeve të mundshme" që segmenton shprehje në njësi, të cilat mund t'i vështronim si fjalë, por që, pasi kemi analizuar se ç' do të quajmë fjalë, duke u nisur nga disa këndvështrime gjuhësore, ky kriter vlen vetëm për të dalluar fjalët drejtshkrimore. Ndërkohë duhet kuptuar se jo çdo fjalë drejtshkrimore është fjalë nga këndvështrimi gjuhësor. Kështu, në gjermanishte ka disa folje me parashtesa (ose pjesëza), të cilat shfaqen si një fjalë drejtshkrimore, por që nga këndvështrimi morfologjik nuk është e njëjta gjë, si: *aufsietzen* "hipi". Këtu kemi një fjalë drejtshkrimore, por jo një fjalë morfologjike, sepse ajo mund të ndahet në: *sietzen* "rri" dhe *auf* "në". Këtë gjë mund ta shohim edhe në shqipe në ndërtime të tilla, si: *parapërgatit*, *mbivendos* etj., ndërkohë që në anglishte ndodh ndryshe. Te folja *look up* "shoh lart" pjesëza *up* shkruhet e ndarë nga folja. Pra, në këtë rast, kemi dy fjalë drejtshkrimore.

Në përfundim mund të themi se jo gjithçka që përdoruesit e gjuhës e quajnë fjalë, është fjalë nga këndvështrimi gjuhësor.

I.3 Fjala morfologjike

Pavarësisht se është e vështirë të jepet një përkufizim shterues për fjalën, përsëri përdoruesit e gjuhës, të arsimuar apo të paarsimuar qofshin, arrijnë t'i dallojnë fjalët në mënyrë të pavetëdijshme. Madje, qysh kur mësojnë të shkruajnë, fëmijët janë në gjendje të ndajnë fjalët nga njëra-tjetra. Nisur nga kjo, përdoruesit e thjeshtë të gjuhës mund të mendojnë se *gur* dhe *gurë* janë e njëjta fjalë. Por, në të vërtetë, ato duhen parë si dy fjalë të ndryshme gramatikore. E para përdoret kur flasim për një send të një lloji të caktuar, ndërsa e dyta, kur flasim për disa të tillë. Elementi që bën dallimin midis këtyre dy

²³ Eduard Sepir, Hyrje në studimin e ligjëritimit, 46.

fjalëve, flektivi -ë, është element gramatikor (morfologjik), sepse është përdorur për të treguar kundërvënien njëjës-shumës. Edhe në fjalitë: *Deti kishte dallgë të mëdha* dhe *Dallgët e detit ishin të mëdha*, *deti* dhe (e) *detit* paraqiten si dy fjalë të ndryshme nga pikëpamja morfologjike. *Si njësi formale gramatikore fjalët mund të shihen si formime plotësisht abstrakte...*²⁴. Kjo lidhet me karakterin abstrakt të gramatikës. *Abstraksioni gramatikor dallohet në pikëpamje cilësore prej abstraksionit leksikor, prandaj fenomenet e leksikut janë konkrete në krahasim me faktet e gramatikës.*²⁵ Kështu, për gramatikën nuk është e rëndësishme fjala konkrete, pra ajo që lidhet me një send apo me një dukuri të caktuar të realitetit dhe që përbën kuptimin leksikor të saj, por fjala në të gjitha format e saj. Kjo do të thotë që për leksikologjinë, p.sh., fjalët *mur* dhe *det* janë dy fjalë të ndryshme, sepse kanë kuptime të ndryshme, ndërsa për morfologjinë janë e njëjta gjë: janë dy emra të gjinisë mashkullore që gjatë lakimit marrin të njëjtat mbaresa, madje edhe shumësin e formojnë me të njëjtin flektiv, -e. Pra, për morfologjinë janë të rëndësishme të gjitha format e fjalës dhe jo vetëm leksema. Këto njësi nga të cilat nis analiza morfologjike, quhen fjalë morfologjike. Në fjalinë *Deti kishte dallgë të mëdha*, janë fjalë morfologjike të gjitha format e leksemës *det* (*deti, detit, dete, detet* etj.), të leksemës *kam* (*ke, ka, kanë, kisha, pata, do të kem* etj), të leksemës *dallgë* (*dallga, dallgës, dallgët, dallgëve* etj.) dhe të leksemës *i madh* (*të madh, e madhe, së madhe, më i madh* etj.). Po fjalë morfologjike nuk duhen quajtur vetëm fjalëformat, pra format e ndryshme që marrin gjatë eptimit pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, por edhe fjalët që nuk ndryshojnë formë ose që kanë vetëm një formë, si: *dhe, jashtë* etj.

I.4 Fjala leksikore

Nëse përdoruesve të thjeshtë të gjuhës do t'u kërkohej të shpjegonin, sipas njohurive të tyre, se ç'është fjala, atyre do t'u shkonte mendja menjëherë te një njësi që ka kuptim.

²⁴ John Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike* 2001: 77.

²⁵ F.Agalliu, *Hyrje në gjuhësi*, 1970: 126.

Pra, për ta kuptimi i fjalës, ose më saktë kuptimi leksikor i fjalës, është një gjë e pandarë nga fjala. Por shpesh gjuhëtarët që janë marrë me konceptin e fjalës dhe me karakteristikat e saj, e vënë theksin te dallimet që ekzistojnë mes fjalës fonologjike, fjalës gramatikore (morfosintaksore) dhe leksemës. Sipas Aronofit, një leksemë është e barabartë me një fjalë. Kështu, në shqipe fjala *verë* nga pikëpamja fonologjike është e njëjta fjalë, por ndryshon për nga kuptimi leksikor (*stinë e vitit* dhe *pije alkoolike*). Prandaj mund të themi se kemi dy leksema, pavarësisht se fjalët kanë veshje tingullore të njëjtë.

Në rastin e foljes *punoj*, në disa forma të shfaqjes së saj:

(1) *punoj*

punon

punuam

kishin punuar

mund të themi se fjalët nuk kanë të njëjtën veshje tingullore. Po kështu, nga ana morfologjike, nuk kemi të bëjmë me të njëjtën fjalë, përderisa shprehin kuptime të ndryshme gramatikore, që i dallojnë nga njëra-tjetra. Ndërkohë që për nga kuptimi leksikor janë e njëjta gjë. Për këtë arsye, edhe në fjalor nuk është e nevojshme që secila prej tyre të ketë një zë të veçantë, mjafton vetëm forma përfaqësuese. Pra, këtu na paraqitet një leksemë (që është forma e foljes *punoj*, si formë përfaqësuese, në të tashmen e dëftores, veta e parë, njëjës) dhe të gjitha të tjerat janë forma të ndryshme të shfaqjes së saj. Meqë thamë se një leksemë është e barabartë me një fjalë, atëherë leksemën mund ta quajmë edhe fjalë leksikore. Pra, çdo njësi gjuhësore që ka kuptim leksikor të pavarur, quhet fjalë leksikore. Te fjalët leksikore përfshihen pjesët e ndryshueshme të ligjëratës dhe ndajfolja, e cila, megjithëse përfshihet te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, është e vetmja syresh që ka kuptim leksikor të pavarur. Por një fjalë leksikore nuk përputhet gjithmonë me një fjalë duke u nisur nga këndvështrimet e tjera gjuhësore. Ndodh që një fjalë leksikore të përbëhet nga dy ose më shumë fjalë drejtshkrimore, fonologjike e

gramatikore, si në rastin e listemave. Kështu, listema *pomme de terre* “patate” përbëhet nga tri fjalë drejtshkrimore *pomme, de* dhe *terre*, si dhe nga dy fjalë fonologjike, nëse do të niseshim nga numri i rrokjeve të theksuara dhe nga tri fjalë morfologjike. Ndërsa nga pikëpamja leksikore kjo listemë na paraqitet si një njësi gjuhësore, sepse, nëse do të ndahej, do të humbiste kuptimin fillestar. Gjithashtu ajo është përdorur si zë i veçantë në fjalor. Pra, fjalë leksikore mund të quhet çdo njësi gjuhësore që ka një kuptim leksikor të caktuar.

I.5 Fjala sintaksore

Përdorimi i togut “fjalë sintaksore” na çon tek objekti i studimit të dy pjesëve kryesore të gramatikës: morfologjisë dhe sintaksës. Përgjithësisht, në gramatikën tradicionale morfologjia merret me studimin e strukturës së fjalës, kurse sintaksa me rregullat e bashkimit të fjalëve në fjali. Këtu qëndron edhe dallimi thelbësor mes morfologjisë dhe sintaksës: morfologjia merret me formën, sintaksa me funksionin. Pra, në varësi të funksionit që kryejnë fjalët në fjali (funksioni i kryefjalës, kallëzuesit, plotësit etj), i cili shpjegohet me anë të rregullave sintaksore, ato (fjalët) marrin forma të ndryshme që trajtohen në morfologji. Me fjalë të tjera, që fjalët të marrin forma të ndryshme, duhet të përdoren në kontekste të caktuara sintaksore²⁶.

Nisur nga lidhja që kanë dy pjesët kryesore të gramatikës, gramatikanët shpesh përdorin termin *fjalë gramatikore* ose *fjalë morfosintaksore* për ta dalluar më lehtë nga fjalët fonologjike apo fjalët leksikore. Megjithatë, përderisa morfologjia e sintaksa kanë objekte të ndryshme studimi, brenda termit fjalë morfosintaksore mund të dallojmë termin *fjalë morfologjike* dhe *fjalë sintaksore*. Fjala morfologjike nuk përputhet gjithnjë

²⁶ Në fjalinë “I kujt është ky laps?”, duke marrë parasysh se fjalët kanë aftësi të qëndrojnë më vete, mund të përgjigjeshim –*Im*. Por kjo njësi, e përdorur në këtë formë dhe në këtë kontekst nuk qëndron dot më vete. Kjo gjë ka të bëjë më shumë me sintaksën sesa me morfologjinë, sepse *im* është përemër pronor i cili shoqërohet gjithmonë nga një emër. Atëherë ose do përgjigjeshim *lapsi im*, ose, më mirë, do të emërzonim përemrin, *imi*, që nga pikëpamja morfologjike është një formë e leksemës *im*.

me fjalën sintaksore.

Në fjalinë *Era shkon në shkollë çdo mëngjes*, dallojmë gjashtë fjalë morfologjike: *Era*, *shkon*, *në*, *shkollë*, *çdo* dhe *mëngjes*. Por, po të nisemi nga funksioni, dallojmë katër gjymtyrë fjalie: *Era* (kryefjala), *shkon* (kallëzuesi), *në shkollë* (rrethanor vendi), *çdo mëngjes* (rrethanor kohe). Meqë gjymtyra e fjalisë është një njësi funksionale, atëherë çdo njësi që kryen funksionin e gjymtyrës së fjalisë, do ta quajmë *fjalë sintaksore*. Si rrjedhojë, këtu kemi katër fjalë sintaksore. Dy të parat, pra kryefjala dhe kallëzuesi (*Era* dhe *shkon*) përputhen me fjalën morfologjike, ndërsa dy rrethanorët përmbajnë më shumë se një fjalë morfologjike.

II. Struktura e fjalës

Fjalët mund të ndahen në njësi më të vogla. Nisur nga këndvështrimi fonologjik fjalët ndahen në rrokje ose në segmente dhe segmentet në veçoritë përbërëse fonologjike. Nga këndvështrimi morfologjik fjalët mund të përbëhen nga më shumë se një njësi të cilat nuk mund të ndahen më tej në njësi me kuptim (leksikor ose gramatikor). Këto njësi janë quajtur morfema. Morfemat, që në morfologji janë quajtur ndryshe dhe si atome të fjalës, ashtu siç janë atomet në kimi, janë të llojeve të ndryshme, prandaj për analizën morfologjike është shumë i rëndësishëm klasifikimi i tyre. Një klasifikim i mirë është një instrument i fortë analitik për të njohur dhe për të kuptuar strukturën dhe formimin e fjalëve²⁷.

Koncepti që kishin strukturalistët amerikanë mbi strukturën e fjalës nuk dallon shumë

²⁷ Fjala *morfemë* është një nga termat themelore, por edhe të diskutueshëm në gjuhësi. Ky term u përdor për herë të parë nga gjuhëtari polak, dë Kurtëne (Jan Baudouin de Courtenay), në vitin 1880. Duke qenë se ai njihej si krijues i neologjizmave, e përdori këtë fjalë të re për të cilësuar njësinë më të vogël të fjalës që nuk mund të ndahet më tej, duke u bazuar në fjalën fonemë, që tashmë përdorej për të cilësuar njësinë më të vogël të analizës tingullore (për të krijuar fjalën *morfemë*, Kurtëneja u nis nga greqishtja *morphe* – formë + afiksin –*eme*, si te fonemë). Sipas Kurtënesë, *morfema është pjesë e fjalës, e pajisur me mëvetësi psikologjike dhe, për këtë arsye, nuk mund të ndahet më tej. Prandaj, ajo përfshin koncepte të tilla, si: rrënja (radix), të gjitha afikset e mundshme (prefikse dhe sufikse) dhe mbaresat, që janë tregues të lidhjeve sintaksore.* (Shih: Stephen R. Anderson, *The morpheme: Its nature and use*, the Oxford handbook of inflection, 2013). Kështu, fjala shqipe *rivlerëso* është e përbërë nga tri morfema: *ri-*, *vlerë*, *-so*, nga të cilat morfema *vlerë* është edhe rrënja e fjalës, ndërsa dy morfemat e tjera janë afikse.

Edhe pse i përdorur shumë herët, duket sikur koncepti i Kurtënesë për morfemën qëndron më pranë konceptit të sotëm të klasifikimit të saj. Më pas termin morfemë e përdorin gjerësisht edhe strukturalistët amerikanë. Për shembull, për Blumfildin duket se morfema ka një përmbajtje të përcaktuar fonologjike dhe si e tillë nuk lë shteg për përdorimet e mëvonshme të termave morf dhe alomorf.

Gjuhëtarë të tjerë, si Harris, në vitin 1942, Bloch, më 1947-ën, Hockett, më 1947-ën, Nida më 1948-ën, e studiuuan konceptin e morfemës duke e parë përgjatë vijës së zhvillimit të kuptimit strukturalist të konceptit të fonemës. Kështu, fonemat shihen si elemente abstrakte që realizohen prej një vargu segmentesh fonetike (alofonet). Atëherë, nisur nga ky këndvështrim, morfemat shihen si elemente strukturore abstrakte, që realizohen nga një varg formash konkrete fonologjike (alomorfet). Pra, në gjuhësinë strukturaliste, që mbizotëroi në këtë periudhë, por edhe më pas, morfema shihej thjesht si njësi me kuptim gramatikor pa shprehjen e saj materiale.

nga koncepti i strukturalistëve evropianë. Megjithatë, Martineja dallonte morfemën si njësi me kuptim gramatikor nga leksema si njësi me kuptim leksikor. Dhe të dyja si morfemën ashtu edhe leksemën i përfshinte në klasën e monemave. Sipas tij, edhe pse mes dy tipave të monemës ka një ndryshim në llojin e kuptimit që ato mbartin, përsëri ato janë njësi që qëndrojnë midis përbërësve të formës fonologjike dhe përbërësve të kuptimit.

Hjelmslevi e kufizoi më tej përdorimin e morfemës. Ai e quajti si një njësi me përmbajtje (jo formë) që lidhet vetëm me fleksionin dhe jo me elemente të tjera kuptimore.

Në praktikë, dallimi mes gjuhëtarëve amerikanë dhe atyre evropianë lidhur me konceptin e strukturës së fjalës qëndronte në rolin që i jepnin kuptimit. Amerikanët mendonin se morfemat, përveç formës, kishin edhe lidhje kuptimore, por që kuptimi, në vetvete, nuk ishte i nevojshëm për studimin e tyre. Kurse gjuhëtarët evropianë i kushtuan më shumë vëmendje semantikës përshkruese, gjë që pati rëndësi për studimet e tyre të mëvonshme në fushën e morfologjisë.

Meqë thuhet se morfemat janë pjesë përbërëse të fjalës dhe se nëpërmjet bashkëlidhjes së tyre ndërtohen forma fjalësh dhe fjalë të reja, që janë themelore për analizën morfologjike, mendojmë se është e rëndësishme të shihen edhe qëndrimet e ndryshme që janë mbajtur prej gjuhëtarëve për trajtimin e saj, pas viteve '60 të shekullit XX (pas strukturalizmit) e deri sot. Një trajtim më i gjerë i konceptit të morfemës ndihmon në një trajtim më të plotë dhe, në ndonjë rast, ndryshe, të analizës strukturore dhe fjalëformuese. Endrju Karsteirs-Mekarti (Andrew Carstairs-Mccarthy), profesor në Universitetin e Kentërbërit, Zelandë e Re, dallon tri qëndrime lidhur me trajtimin e termit morfemë:

- (a) Termi “morfemë” vazhdon të përdoret edhe sot e kësaj dite, por disa ose, më mirë, asnjë morfemë nuk mund të shihet kurrsesi si shenjë sosyriane.
- (b) Termi “morfemë” vazhdon të përdoret si term i përshtatshëm për të nënkuptuar rrënjën dhe afikset, por pa ndonjë peshë të madhe teorike.

(c) Termi “morfemë” nuk përdoret shumë ose nuk përdoret fare. (Andrew Carstairs-Mccarthy, Basic terminology, Handbook of word-formation 2005: 20).²⁸

Por, megjithë qëndrimet që kanë mbajtur dhe që mbajnë gjuhëtarë të ndryshëm, ne, në këtë punim, nuk do të merremi me interpretimin e mëtejshëm dhe shpjegimin e nocionit *morfemë*, sepse na intereson më shumë lloji dhe mënyra e lidhjes së elementeve (morfemave) të caktuara për të prodhuar fjalë.

Ndryshimi i formave të fjalës apo formimi i fjalëve të reja varet nga mënyra sesi lidhen morfemat me njëra-tjetrën ose sesi bashkëveprojnë ato, në përputhje me rregullat gramatikore të gjuhës dhe me rregullat e fjalëformimit. Morfemat shprehin kuptime të caktuara. Disa prej tyre shprehin kuptime leksikore, disa të tjera kanë thjesht kuptime gramatikore.

Meqë morfemat, që janë njësia themelore e analizës morfologjike, shprehin kuptime të ndryshme, vetë morfologjia ndahet në dy fusha studimi: një që lidhet me procesin e eptimit dhe që quhet morfologji eptimore dhe tjetra që lidhet me procesin e fjalëformimit e që quhet morfologji leksikore.²⁹ Kështu, nga këndvështrimi i morfologjisë eptimore, forma *nxito* e fjalës *nxitojnë* është rrënjë e leksemës *nxitoj*. Përgjithësisht,

²⁸ Versioni (a) mbrohet prej Aronofit, i cili u kushtoi më shumë vëmendje elementeve morfofonologjike që dalin në pah nga latinizimi i disa foljeve dhe emrave të formuar prej tyre, si: *assume/assumption* “marr/marrje” dhe *deceive/deception* “mashtroj/mashttrim”. Vihet re se foljeve që përmbajnë elementin –*sume*, si: *assume*, *presume*, *resume*, *consume*, u korrespondojnë emrat me –*sumption*. Sipas tij, kjo nuk është rastësi. –*Sume* nuk mund të shihet si shenjë sosyriane, sepse nuk ka kuptim (signifié) të njëjtësueshëm. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për elementin –*ceive* të foljet *deceive*, *conceive*, *perceive*, *receive*, përballë të cilit qëndron elementi –*ception* tek emrat përkatës. Aronofi mendon se elementet –*sume* dhe –*ceive* (ashtu si edhe prefikset që kombinohen me to) janë morfema, por morfemat nuk janë gjithmonë shenja.

Versioni (b) mbrohet nga Halle (1973), Mekarti (1981), Liber (1992). Përmbledhtas, mendimi i tyre është se morfemat janë thjesht rrënjë dhe afikse, të cilat kombinohet sipas rregullave të fjalëformimit për të prodhuar fjalë.

Mbrojtësit e versionit (c), Anderson, Stump dhe Karsteirs-Mekarti i japin rëndësi dallimit mes dukurisë *concatenate* (tema dhe afikset) dhe *nonconcatenate* (ndryshimi i tingujve, lëvizja e theksit). Sipas kësaj teorie, tema dhe afikset duhet të kenë një kuptim të dallueshëm. Te kuptimi përfshihen si të dhënat fonologjike dhe morfologjike, ashtu edhe ato semantike e sintaksore. Pra, është një teori që shfrytëzon shenjë sosyriane dhe i trajton afikset dhe temat (jo fjalën) si shenja, por pa përdorur nocionin *morfemë*.

²⁹ Për morfologjinë eptimore dhe leksikore, shih P.H.Matthews *Morphology – An introduction to the theory of word-structure*, 1974: 37-58.

rrënja nuk ndryshon formë gjatë eptimit të fjalës (emrat *lis*, *shtëpi*, *derë* etj. e ruajnë të pandryshuar rrënjën gjatë lakimit, si në njëjës ashtu edhe në shumë. Po kështu, foljet *hap*, *mbyll*, *qesh* etj., nuk e ndryshojnë rrënjën gjatë zgjedhimit në të gjitha mënyrat, kohët, vetat dhe numrat). Pra, rrënja është bërthama që ndërton strukturën e një fjale.

Meqë shqyrtoam fjalën *nxitojnë*, mund të shohim edhe fjalën *nxitim*, në një nga format e paradigmës së saj, në emërore të shquar njëjës *nxitimi*. Në rastin e foljes *nxitojnë*, *nxito* mund të quhet rrënjë e thjeshtë, ndërsa tek emri *nxitimi*, *nxitim* mund të quhet rrënjë e përbërë, e formuar me prejardhje nga baza *nxit(o)* me elementin *-im*. Por shumë gjuhëtarë mendojnë të mos e përdorin termin *rrënjë* në këto raste, përderisa rrënja është e paanalizueshme jo vetëm nga pikëpamja eptimore, por edhe nga pikëpamja e prejardhjes apo e kompozimit. Prandaj, është pranuar që, në vend të termit rrënjë e përbërë, të përdoret termi *temë*. Tema e fjalës është pjesa e fjalës pa flektivë. Kështu, tema e fjalës *përpunova* është *përpuno* (pa flektivin *-va*), ose tema e fjalës *lisat* është *lis* (pa flektivin e pandryshueshëm *-a* dhe pa flektivin e ndryshueshëm *-t*). Njohja me konceptet e rrënjës dhe të temës së fjalës do të na ndihmojë për të vështuar më mirë e më saktë në strukturën e fjalës.

II.1 Llojet e strukturës së fjalës

- Struktura sintetike
- Struktura analitike

Strukturat e fjalëve janë të larmishme. Një fjalë mund të përbëhet vetëm nga një morfemë, e cila është edhe morfemë rrënjore (*punë*, *vajzë*, *hap*, *bukur* etj.), por mund të përbëhet edhe nga më shumë se një morfemë (*punë-tor-ë*, *vajzë-ri-a*, *mbyll-i*, *i-bukur*). Për të ndërtuar struktura me më shumë se një morfemë, ndodhin disa procese morfologjike. Kështu, për të ndërtuar një strukturë të re prej rrënjës *punë*, është i nevojshëm elementi *-tor*, që lidhet me procesin e prejardhjes, konkretisht, me atë të

sufiksimit dhe për t'i dhënë kësaj strukture kuptimin e numrit shumëës është i nevojshëm elementi –ë, që ndryshe quhet flektiv i shumësit. Në të njëjtën mënyrë, për të ndërtuar strukturën *i mbyllur*, që është mbiemër, prej rrënjës *mbyllur* që paraqitet si ndajfolje, është i nevojshëm procesi i nyjëzimit. Mënyrat e bashkimit dhe të lidhjes së morfemave për të formuar forma fjalësh apo fjalë të reja, si dhe shprehjet e kuptimeve të tyre përcaktojnë llojin e strukturës së fjalës. Nëse kuptimet e reja leksikore apo gramatikore shprehen brenda fjalës, thënë ndryshe, nëse proceset morfologjike që shoqërohen me ndryshim të strukturës së fjalës, ndodhin brenda fjalës, atëherë fjala ka *strukturë sintetike* ose strukturë të mbyllur. Kështu, fjala *punëtorë* ka strukturë sintetike. Kur kuptimet e reja leksikore apo gramatikore shprehen jashtë fjalës, atëherë kemi të bëjmë me *strukturë analitike* ose strukturë të hapur. (Fjala *i mbyllur* ka strukturë të hapur, sepse kuptimi i ri që mbart mbiemri *i mbyllur* është shprehur jashtë kufijve të temës *mbyllur*, nëpërmjet nyjës *i*).

II.1.1 Llojet e strukturave sintetike

Fjalët që kanë strukturë sintetike, përbëjnë edhe numrin më të madh të fjalëve në shqipe. Meqë kjo strukturë është mbizotëruese, gjuha jonë njihet, përgjithësisht, si gjuhë sintetike. Në shqipe strukturat sintetike të fjalëve mund të jenë:

- **Të parme**

Këto lloj strukturash përbëhen vetëm prej një morfeme, e cila përkon me morfemën rrënjore. Si të tilla, ato nuk mund të zërthehen më tej dhe janë të pamotivueshme semantikisht. Kjo do të thotë që ato nuk janë të formuara prej ndonjë strukture tjetër (prej fjalësh të tjera).³⁰

³⁰ Shih: Gramatika e gjuhës shqipe, I, 2002: 51, 55.

Por jo çdo fjalë që ka në përbërjen e saj strukturore vetëm morfemën rrënjore dhe nuk përmban asnjë afiks, ka strukturë të parme. Kështu folja *ndryshk* është formuar prej emrit *ndryshk* ose emri *hap* është formuar nga folja *hap* etj. Pra, këto janë vërtet struktura fjalësh të pazbërthyeshme, por semantikisht janë të motivueshme. Kësisoj, nuk mund të quhen të parme.

• Të prejardhura

Shumë gjuhëtarë që janë marrë me studimin e ndërtimit të strukturës së fjalës, sidomos në gjuhët që i përdorin ndajshitesat, mendojnë se, që të njohim mirë strukturat e prejardhura, duhet të kuptojmë dallimin mes tyre dhe strukturave eptimore, ose mes fleksionit (eptimit) dhe derivacionit (prejardhjes). Me anë të fleksionit ndërtohen vetëm struktura gramatikore (njëjësi-shumësi, mashkullore-femërore, e tashme-e pakryer... etj.). Përdorni i formave të reja gramatikore varet, përgjithësisht, nga konteksti sintaksor. Pra, fleksioni, si shprehje e karakteristikave morfosintaksore të fjalës, shërben për të ndërtuar forma të ndryshme të së njëjtës leksemë, kurse derivacioni merret kryesisht me krijimin e fjalëve të reja. Kjo do të thotë se, nëpërmjet derivacionit, ndryshon kuptimi leksikor i një fjale të veçantë, por mund të ndryshojë edhe kategoria leksiko-gramatikore e saj, gjë që nuk mund të ndodhë nëpërmjet fleksionit, p.sh. nga folja *lexo(j)*, nëpërmjet procesit të derivacionit (me anë të sufiksit *-im*) formohet emri *lexim*. Siç vihet re, përveç kuptimit leksikor, ka ndryshuar edhe kategoria leksiko-gramatikore e leksemës *lexo(j)*. Ndërsa nga leksema *lexo(j)* për të ndërtuar të kryerën e thjeshtë, për shembull, na nevojitet flektivi i ndryshueshëm *-va*, i cili, përveç formës, nuk ndryshon asgjë në kuptimin e leksemës *lexo(j)*. Por Boiji, kur përpiket të gjejë dallimet mes derivacionit dhe fleksionit, shkon edhe më tej, duke thënë se *një kriter tjetër i rëndësishëm që dallon këto dy procese morfologjike është se derivacioni mund ta ushqejë fleksionin, por nuk mund të ndodhë e kundërta*³¹. Kjo do të thotë se, që të krijojmë struktura të prejardhura, pra, fjalë të reja, na duhen temat e fjalëve pa flektivë. Nëse këtyre temave u shtojmë ndajshitesa, atëherë krijojmë tema të reja, te të cilat mund të zbatohet rregullat e fleksionit. Kështu, temës

³¹ Geert Booij, *The grammar of words*, 2010 : 114.

vend, e cila, siç shihet, është pa flektivë, mund t'i shtojmë ndajshtesën *-os*, që të përftojmë një temë të re, *vendos*. Kjo temë e re është një folje të cilën, duke zbatuar rregullat e fleksionit, mund ta përdorim në mënyra, në kohë e në veta të ndryshme, p.sh. me anë të flektivit *-im*, ndërtohet veta I shumës e së tashmes së dëftores, *vendosim*, ose me anë të flektivëve *-sh* dhe *-a* ndërtohet veta I njëjës e së tashmes së dëshirores, *vendossha* etj. Pra, nëse arrijmë të dallojmë derivacionin nga fleksioni, kjo do të na ndihmonte të njihnim dhe të dallonim edhe llojin e ndajshtesave dhe mënyrën e lidhjes së tyre me temën e fjalës.

Kështu, strukturat e reja të prejardhura, që ndryshe mund t'i quajmë edhe derivate, ndërtohen nëpërmjet bashkimit të afikseve (ndajshtesave), që janë morfema fjalëformuese, me tema fjalësh ose me fjalë, p.sh.: fjalët *qytetar* e *tregtar* janë struktura sintetike të prejardhura, të ndërtuara duke u shtuar përkatësisht afikset *-ar* dhe *-tar* temave *qytet* dhe *treg*. Po kështu, strukturat e prejardhura *rimarr* e *përdor* janë ndërtuar duke u shtuar përkatësisht afikset *ri-* dhe *për-* temave *marr* dhe *dorë*. Në shqipe, strukturat sintetike të prejardhura ndërtohen duke i bashkëngjitur temës së fjalës ose fjalës:

a) *prefikse* (parashtesa), si: *stër-gjysh*, *për-hap*, *zh-bëj*, *mos-zbatim*, *ri-ndërtoj*, *jo-shkencor*, *anti-kombëtar*, *de-formim*, etj.;

b) *sufikse* (prapashtesa), si: *pun-o*, *vend-os*, *punë-tor*, *dal-je*, *miqësi-sht*, *or-ar*, *social-izëm*, *kapital-ist* etj.

Te këto struktura, pra që janë ndërtuar me prefikse ose me sufikse, duhet dalluar qartë elementi fjalëformues, prefiksi ose sufiksi, sepse ka fjalë që për nga struktura dhe modeli i ndërtimit janë të ngjashme me to, por që ndryshojnë prej tyre sepse elementi fjalëformues del në formën e një morfeme të lirë, kurse prefikset dhe sufikset janë morfema të lidhura. Kështu, në struktura të tilla, si: *parandiej*, *prapavendos*, *filoshqiptar*, *shumëfish* etj., elementet *para-*, *prapa-*, *filo-* dhe *-fish* janë morfema të lira, pra janë pjesë përbërëse të kompozitave, që quhen kompozita afiksoide, ndërsa vetë këto elemente, që bëhen mjaft produktive për ndërtimin e këtyre lloj kompozitave, quhen përkatësisht

prefiksoide dhe *sufiksoide*.³² E njëjta gjë ndodh edhe në anglishte, ku është vështirë të dallohen prefikset nga disa elemente që shërbëjnë si pjesë e parë e disa kompozitave. Elemente, si: *agri-*, *eco-*, *Euro-*, *psycho-*, *techno-* etj. në struktura të tilla, si: *agriculture*, *ecosystem*, *Eurocentric*, *psychogenic*, *technology*, sillen si pjesë përbërëse të kompozitave.³³ Ndryshe, këto janë quajtur *kompozita (fjalë të përbëra) neoklasike*.³⁴

c) *circumfikse* (prefikse dhe sufikse njëkohësisht), si: *sh-fryt-zo*, *për-fytyr-o*, *z-bukur-o* etj. Në këto ndërtime, temave *fryt*, *fytyrë* dhe *bukur* u janë shtuar njëkohësisht prefikset *sh-*, *për-*, *z-* dhe sufikset *-zo*, *-o*. Mendoj se edhe këto struktura duhet të dallohen nga disa të ngjashme me to, si: *nëpunës*, *mëkëmbës*, *përshpirtje* etj., për të cilat ka mendime të ndryshme. Prof.Sh.Demiraj i përfshin këto lloj formimesh në grupin e fjalëve të prejardhura të formuara me parashtesë dhe prapashtesë njëkohësisht. Këto fjalë kanë dalë nga një tog fjalësh me shtimin e ndonjë prapashtese... Elementi i parë i togfjalëshit luan rolin e parashtesës.³⁵ Kështu, fjalët *nëpunës*, *mëkëmbës* dhe *përshpirtje* janë krijuar prej togfjalëshave *në punë*, *më këmbë* dhe *për shpirt* me prapashtesat përkatëse. Në Gramatikën e gjuhës shqipe 1, thuhet se *formimet parashteso-prapashtesore duhen dalluar nga formimet e përfutuara me anë të prapashtesimit të një togu parafjalë + emër, si: ...nëpunës (në punë+s), mëditje (më ditë+je)* etj.³⁶ Për nga struktura, këto ndërtime janë të ngjashme me ato me *circumfikse*, por modeli i ndërtimit dhe motivimi i tyre nuk është i njëjtë, prandaj mund t'i përfshijmë te grupi i strukturave sintetike me përngjitje+prapashtesim.

● Të përngjitura:

Përgjithësisht, një pjesë e gjuhëtarëve të sotëm nuk i ndajnë strukturat e përngjitura dhe strukturat e përbëra, por i përfshijnë në një proces të vetëm të ndërtimit

³² Shih: E.Likaj, M.Çabej, *Morfologji e shqipes standarde*, 2010 : 28-29.

³³ Shih: Rochelle Lieber, *English word-formation process*, në: Handbook of word-formation, 2005 : 390-391.

³⁴ Shih: Geert Booij, *The grammar of words*, 2010 : 85-88.

³⁵ Sh.Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1971 : 16.

³⁶ Gramatika e gjuhës shqipe 1, 2002 : 68.

dhe të krijimit të fjalëve, në atë të kompozimit. Në të vërtetë, brenda këtij procesi, gjatë analizave më të hollësishme morfologjike, ata dallojnë modelin e ndërtimit të strukturave të përngjitura nga ai i strukturave të përbëra. Kështu, në frëngjishte, fjalët *toujours* (tous les jours) “gjithmonë” dhe *demi-jour* (demi + jour) “përgjysmë ose, fjalë për fjalë, gjysmë + ditë” quhen *mots composés* “fjalë të përbëra”, por, nga pikëpamja e strukturës, nuk ndjekin të njëjtin model ndërtimi për krijimin e fjalës së re. Strukturat e përngjitura, siç është *toujours*, ndërtohen nga përngjitja e dy a më shumë fjalëve të një tog fjalësh, të cilat nga përdorimi i gjatë dhe i dendur me kohë janë shkrirë në një fjalë të vetme, ku ruajnë po atë renditje, që kishin në togfjalëshin e dhënë.³⁷ Edhe në shqipe, gjatë ndërtimit, struktura të tilla fjalësh, si *gjithmonë* (gjithë + motnë), *kushdo* (kush + do), *atëherë* (atë + herë), e kanë ruajtur kuptimin e tyre dhe rendin e elementeve përbërëse, që kishin para se të përngjiteshin.

Strukturat e përngjitura mund t’i quajmë ndryshe edhe *struktura aglutinuase*. Në fjalorë të ndryshëm kuptimi i termit *aglutinim* shpesh përputhet me kuptimin e termit *përngjitje*, siç e përdorim në shqipe. Kështu, A.S.Hornbi e përkufizon aglutinimin si *kombinim fjalësh të thjeshta pa ndryshuar formën dhe kuptimin*. (A.S. Hornby, Oxford advanced learner’s dictionary of current english, 1974 : 18). Në Petit Larousse aglutinimi përkufizohet kështu: *Formimi i një fjalë nga bashkimi i dy ose më shumë fjalëve, që dallohen nga fjala bazë ose e origjinës*. (Petit Larousse, 1979 : 21). Por në gramatika apo në libra ku flitet për fjalëformimin apo për strukturën e fjalës, termin aglutinim e hasim më shpesh kur bëhet fjalë për gjuhët aglutinuase. Në këto raste, aglutinim quhet procesi morfologjik, ku temës së fjalës i shtohen një ose më shumë afikse. Prandaj, përgjithësisht, për të analizuar strukturat e përngjitura duhet parë dhe analizuar kompozimi apo përbërja (compounding).

- **Të përbëra**

Përgjithësisht, strukturat e përbëra të fjalëve janë binare, pra përbëhen nga dy tema që bashkohen dhe formojnë një strukturë të vetme, si në anglishte *ëaterman* “barkëtar”, në italishte *pellierossa* “lëkurëkuq”, në gjermanishte *schlafzimmer* “dhomë

³⁷ Sh.Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1971 : 21.

fjetjeje” etj. Në shumë gjuhë evropiane, përbërja është mënyra më prodhimtare për formimin e fjalëve të reja. Në shqipe, në strukturën e fjalës së përbërë *neutralizohen marrëdhëniet gramatikore që ekzistojnë midis komponentëve në togfjalëshin përkatës, ku këto marrëdhënie gjejnë shprehjen e tyre formale.*³⁸ Duke analizuar fjalën *vendbanim*, Kostallari shpjegon se kjo fjalë buron nga togfjalëshi *vend banimi*. Në rastin e togfjalëshit marrëdhëniet gramatikore shprehen me anë të flektivit të rrjedhës –i, ndërsa në rastin e fjalës së përbërë ky element bie. Rënia e fleksionit neutralizon marrëdhëniet gramatikore në fjalën e përbërë dhe bën që ajo të dallohet përfundimisht nga togfjalëshi. Temat, prej të cilave ndërtohet një strukturë e përbërë *ruajnë pak a shumë në mënyrë të qartë kuptimet e tyre materiale, leksikore dhe kjo u jep mundësinë atyre të hyjnë në lidhje të caktuara e shumë të ndryshme semantiko-sintaktike në bazë të mundësive ligjësore sintaktike që ekzistojnë në gjuhën tonë për lidhjen e kategorive të caktuara leksikore.*³⁹ Në shqipe, strukturat e fjalëve *hekurudhë, shitblerje, fatbardhë, zemërmirë, duarartë, djegagur* etj. përbëhen nga dy tema që kanë mes tyre marrëdhënie të ndryshme, prej të cilave krijohet një fjalë e re.

Duke qenë se kanë në përbërje të tyre dy ose më shumë elemente motivuese, strukturat e përbëra të fjalëve, për gjuhë që i njohin dhe i shfrytëzojnë këto ndërtime, krijohen më shpesh dhe më lehtë, por gjithmonë në përputhje me modelet që ekzistojnë tashmë në gjuhën përkatëse. Në shqipe modelet e kompozitave janë gjallëruar e gjallërohen kryesisht mbi bazën e shqipes së folur.⁴⁰

II.1.2 Llojet e strukturave analitike

Fjalët e krijuara sipas modeleve të ndërtimit të strukturave analitike i ndeshim më shpesh në gjuhët analitike, të cilat përdorin forma e mjete jashtë fjalës për të ndërtuar

³⁸ A.Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, 1972 : 84.

³⁹ A.Kostallari, *po aty* : 83.

⁴⁰ Shih më tej: A.Kostallari, *po aty* : 89.

struktura fjalësh të reja. Edhe në shqipe, që njihet si gjuhë sintetiko-analitike, dallohen fjalë që kanë strukturë të hapur ose analitike. Këto struktura janë ndërtuar:

- **Me nyja**

Në këto ndërtime fjalët kanë në përbërje të tyre një nyjë të paravendosur. Nga pikëpamja etimologjike nyjat e përparme janë një me nyjat e prapme, por ndryshojnë për nga funksioni (shërbimi) që kryejnë.⁴¹ Në shqipe, modeli i ndërtimit të fjalëve të reja me nyja nuk zinte ndonjë vend të veçantë në gramatika, ndoshta ngaqë është më pak prodhimtar se modelet e tjera, si prefiksimi, sufiksimi apo kompozimi. Prof.Sh. Demiraj në kapitullin për strukturën e fjalës, në *Morfologjinë e gjuhës së sotme shqipe*, flet vetëm për strukturat me parashtesa, prapashtesa, parashtesa e prapashtesa njëkohësisht, si dhe për strukturat e përngjitura e të përbëra, kurse ndërtimet me paranyjëzim i trajton disi kur flet për nyjat e përparme, sidomos për formimin e mbiemrave të nyjshëm nga pjesoret e foljeve me anë të nyjës së përparme.⁴² Kur trajton disa çështje të fjalëformimit në shqipe, E.Hysa shprehet se: *Janë gjallëruar sidomos mënyra, tipa e mjete që çojnë në krijimin e njësive sintetike, krahas mënyrave që çojnë në krijimin e njësive analitike.*⁴³ Më tej trajton mënyrat sintetike të formimit të fjalëve. Në gramatikën e botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe në *Morfologjinë e shqipes standarde*, në kapitullin e fjalëformimit, nyjëzimi ose prejardhja me nyjë zë vend të veçantë, ashtu si mënyrat dhe tipat e tjerë të fjalëformimit.⁴⁴

Në gjuhën e sotme modeli i ndërtimit të strukturave analitike me nyja është mjaft prodhimtar. Strukturë analitike kanë të gjithë mbiemrat e nyjshëm, të formuar prej ndajfoljeve dhe prej pjesoreve të foljeve (*i mirë, i bukur, i shkruar, i ardhur* etj.). Gjithashtu, ka edhe disa emra që kanë strukturë të hapur, e cila është ndërtuar me paravendosjen e një nyjeje, si emrat e ditëve të javës, disa emra farefisnie (*i ati, e bija*

⁴¹ Shih: Sh.Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë 1967 : 57-59.

⁴² Po ai, po aty.

⁴³ E.Hysa, *Dukuri e prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare*, në: *Gjuha jonë*, 1985/1 : 111.

⁴⁴ Gramatika e gjuhës shqipe 1, 2002 : 69 dhe E. Likaj, M.Çabej, *Morfologji e shqipes standarde*, 2010 : 24.

etj.) emrat asnjanes (*të ecurit, të ftohtët* etj.), si edhe disa emra të gjinisë femërore që shprehin nocione abstrakte (*e ardhmja, e shkuara, e drejta*) dhe emra femërorë pluralia tantum (*të ardhurat, të lashtat* etj.) Sot në shqipen e shkruar e të folur vihet re një denduri më e madhe përdorimit të emrave asnjanes që ndërtohen prej pjesoreve të foljeve, por që nuk kanë për bazë modelin e ndërtimit të strukturës së shqipes, por janë një përkthim fjalë për fjalë nga gjuha e huaj, sidomos nga anglishtja. Kështu, thuhet *të pasurit punë* nga “having job” etj.

Edhe në gjuhë të tjera, sidomos në gjuhët neolatine, shumë fjalë kanë strukturë analitike, të formuar me anë të nyjës së përparme (në frëngjishte: *le livre* “libri”, *la table* “tryeza” etj.) Po kështu, në gjermanishte, me anë të nyjës ndërtohen struktura të hapura fjalësh (*das Leben* “jetë”, *der Vater* “babai” etj.) etj.

● Në mënyra të përziera

Strukturat analitike të përziera përbëhen nga më shumë se dy morfema, ku një prej tyre është gjithmonë morfema nyjë. Këto morfema *nuk mund të veçohen, nuk mund të zgjidhen nga ajo (struktura), prandaj edhe skema e përbërësve të drejtpërdrejtë, sipas drurit të degëzuar, është së paku treshe*⁴⁵. Kështu, në fjalën *i ndershëm*, temës *nder* i është shtuar njëkohësisht morfema nyjë *i* dhe sufiksi *-shëm*. Në këto lloj ndërtimesh nyja shërben për formimin e mbiemrave të nyjshëm nga kategori të tjera leksiko-gramatikore me sufikse, me cirkumfikse etj.

Këto struktura fjalësh ndahen sipas përbërësve në:

a) struktura të ndërtuara me *paranyjëzim* dhe sufikse

Këto formime janë ndër më prodhimtaret në shqipe. Përgjithësisht formohen mbiemra prej temash emërore, foljore e ndajfoljore me anë të sufikseve *-shëm, -(ë)m, -t(ë)* etj. (*i mundshëm, i artë*, etj.).

⁴⁵ E.Likaj, M.Çabej, *Morfologji e shqipes standarde*, 2010 : 30.

b) struktura të ndërtuara me *paranyjëzim* dhe cirkumfikse

Edhe prej këtij modeli strukturor formohen mbiemra (*i përbotshëm*, *i përpiktë* etj.).

c) struktura të ndërtuara me *paranyjëzim* dhe përngjitje

Përsëri, edhe me anë të këtij modeli formohen mbiemra, por në këtë rast mbiemrat dalin nga paranyjëzimi i një togu parafjalor, si: *i papunë* etj.

d) struktura të ndërtuara me *paranyjëzim* dhe përngjitje e sufikse

Mbiemrat e formuar sipas këtij modeli kanë dalë nga paranyjëzimi i një togu parafjalor (kryesisht me parafjalën *për*) me sufiksin *-shëm* (*i përjavshëm* etj.).⁴⁶

Modeli strukturor i këtyre formimeve në shqipe është më pak prodhimtar se modelet e tjera, si p.sh. ai me sufikse, me prefikse, me përbërje etj.

⁴⁶ Për mënyrat e përziera të formimit të fjalëve në shqipe, shih: Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 78-79.

PJESA 2

III. Kriteret e përcaktimit të fjalëve të përngjitura

Krijimi i fjalëve të përngjitura realizohet nëpërmjet procesit të përngjitjes së fjalëve, që është një prej nënndarjeve të kompozimit.⁴⁷ Në shumë gjuhë *kompozimi është një mënyrë shumë prodhimore e formimit të fjalëve të reja, për shkak të qartësisë dhe të larmisë semantike*⁴⁸. Por në gjuhë të ndryshme dhe, brenda një gjuhe, në varësi të natyrës së lidhjes së elementeve dhe të tipit të fjalëve që përbëjnë një kompozitë, studiues të ndryshëm nuk i grupojnë njësoj fjalët gjatë këtij procesi. Kështu, Liber dallon për anglishten dy forma të kompozitave: kompozita sintetike dhe kompozita rrënjore⁴⁹, kurse Turnie, një prej të rrallëve gjuhëtarë francezë që është marrë me studimin e leksikologjisë

⁴⁷ Disa studiues që janë marrë me fjalëformimin, përngjitjen e studiojnë si një mënyrë të veçantë të formimit të fjalëve në sistemin e fjalëformimit, krahas prejardhjes, kompozimit (përbërjes), nyjzimit, konversionit dhe mënyrave të përziera. Kështu trajtohet përngjitja në Gramatikën e Akademisë së Shkencave, ku, së bashku me konversionin, shihen si mënyra fjalëformimi jomorfologjike, që do të thotë se fjalët e përngjitura dhe ato me konversion krijohej pa ndonjë mjet morfologjik. (Gramatika e gjuhës shqipe 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002 : 59-60).

Gjuhëtarë të tjerë e shohin përngjitjen si nënndarje të kompozimit, krahas përbërjes. I këtij mendimi ka qenë fillimisht A.Kostallari, i cili dallon disa tipare të përbashkëta që i afrojnë fjalët e përngjitura me fjalët e përbëra. *Në radhë të parë ato kanë lidhje gjenetike*. Duke iu referuar përfaqësuesve të njohur të gjuhësisë historike të krahasur, ai nënvizon se *gjenetiksht kompozitat e kanë burimin të togfjalëshat të cilët në procesin e zhvillimit të gjuhës kanë pësuar ndryshime të shumëllojshme fonetiko-morfologjike dhe semantike*. Gjithashtu, Kostallari dallon edhe një tipar tjetër për shqipen që i afrojnë këto dy nënndarje: *procesin e kalimit nga bashkëngjitja në kompozim* (përbërje). (A.Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, në Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, 1972 : 80-81, botuar për herë të parë në BUSHT 3, 1961. Ky qëndrim ndiqet më pas edhe nga Sh.Demiraj në Morfologji e gjuhës së sotme shqipe (1967), nga E. Likaj në Morfologji e shqipes standarde (2010), i cili të mënyra e kompozimit dallon dy nënndarje: kompozimin me fjalë të mëvetësishme dhe kompozimin me përngjitje).

Duke pasur parasysh këto argumente, edhe ne, gjatë punimit, do t'i trajtojmë fjalët e përngjitura si nënndarje të kompozimit.

⁴⁸ Geert Booij, *The grammar of words*, 2010 : 75.

⁴⁹ Rochelle Lieber, *English word-formation process*, në Handbook of word-formation, 2005 : 375-376.

bashkëkohore angleze, dallon brenda kompozimit, përveç fjalëve të përbëra (që përsëri i quan kompozita) edhe disa fjalë të përngjitura (juxtaposition) dhe amalgamet⁵⁰.

Për të vendosur kriteret që përcaktojnë fjalët e përngjitura, mund të vështrojmë edhe mbi fjalëformimin në përgjithësi.

III.1. Vendi i fjalëformimit në gjuhësi

Në gramatikat klasike greke e latine, por edhe në gramatikat e gjuhëve më të reja, të cilat mbështeten në parime klasike, fjalëformimi shihej si një prej tri pjesëve kryesore të gramatikës, mes eptimit dhe sintaksës, por që, krahasuar me to, zinte një vend shumë të vogël. Xhon Lajënsi e cilëson *trajtimin e fjalëformimit si një gjest të ngathët dhe torikisht jokonsekuent, që merr parasysh njohjen e faktit se disa fjalë mund të zbërthehen më tej në përbërës, edhe në qoftë se rregullat në pjesët kryesore të gramatikës nuk thonë asgjë për funksionin apo distribucionin e këtyre përbërësve*. (John Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, 2002 : 187, *origjinali është botuar më 1968*). Studiuësit perëndimorë i kushtuan vëmendje të posaçme fjalëformimit kur përfaqësuesit e gjuhësisë krahasuese, pas studimeve gramatikore që ishin bërë për sanskritishten, nisën të interesoheshin edhe për fjalëformimin nga këndvështrimi historik.⁵¹ Studime *diakronike* mbi fjalëformimin u kryen nga disa studiuës, si prej Koziolit (1937), Jespersenit (1942) e shumë të tjerë. Më pas studimet u thelluan dhe morën tjetër drejtim me teorinë e Hans Marhandit (Hans Marchand) mbi fjalëformimin (në vitet 1960), që njihet ndryshe si Marhandizëm, e cila ishte *sinkronike*⁵² dhe prej së cilës u ndikuan një sërë studiuësish (Hansen, Brekle, Lipka, Kastovsky etj.). Ndërkohë në gjuhësinë evropiane perëndimore studiuës të shumtë e trajtonin fjalëformimin si pjesë të gramatikës, si pjesë të leksikologjisë ose si pjesë të morfologjisë e leksikologjisë së bashku, madje në shumë gjuhë vazhdon të trajtohet

⁵⁰ Jean Tournier, *Precis de lexicologie anglaise*, 1988 : 63.

⁵¹ Shih: John Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, 2002 : 188.

⁵² Dieter Kastovsky, *Hans Marchand and the Marchandians*, në: *Handbook of word-formation*, 2005 : 100-101.

kështu, si në shqipe ku fjalëformimi trajtohet brenda morfologjisë. Por ka gjuhëtarë që e studiojnë fjalëformimin brenda sintaksës, si Spencer e të tjerë, që e trajtojnë këtë çështje duke marrë parasysh lidhjen mes fjalëformimit dhe frazëformimit (sintaksës)⁵³. Në Evropën Lindore dhe Qendrore, paralelisht me Marhandin, Dokulilli (Miloš Dokulil), gjuhëtar çek, paraqit *teorinë* e tij *onomasiologjike* mbi fjalëformimin, i cili, veç të tjerash, e sheh fjalëformimin si një *komponent të pavarur* jashtë sistemit gjuhësor, por njëkohësisht studion lidhjet e dallimet mes analizës morfologjike e asaj fjalëformuese, formën e brendshme të fjalës, nocionin e tipit fjalëformues etj. Edhe një prej pasuesve të kësaj teorie, Štekauer (Pavol Štekauer) e trajton fjalëformimin si një komponent të pavarur gjuhësor.⁵⁴

Në të vërtetë, duke parë lidhjet e përhershme dhe të padiskutueshme mes fjalëformimit dhe disiplinave të ndryshme gjuhësore, si dhe mundësitë e realizimit të studimeve më shkencore e më të sakta në disa këndvështrime njëherësh, ai (fjalëformimi) mund të trajtohet edhe si fushë më vete në sistemin gjuhësor dhe jo si pjesë e njërës prej disiplinave. Ky koncept është përhapur së fundmi në gjuhësinë gjermane, ruse, çeke, polake, sllovae, serbe, sllovene etj. Fjalëformimi mund të studiohet si disiplinë më vete, sepse:

- *Ka anën morfologjike, anën semantike dhe anën sintaksore, pra ngërthen tri aspekte dhe ky trajtim ka copëzuar dhe ka shpërndarë problemin në tri fusha. Trajtimi i tij në një fushë të veçantë do të rrokte që të tri aspektet dhe do të trajtohej si sistem. Në këtë mënyrë, pos të tjerash do të ndihmohej edhe të kuptuarit më të lehtë të problemit të tij...*
- *Tashmë në fushën e fjalëformimit është zhvilluar e standardizuar edhe terminologjia e saj. Terminologjia e stabilizuar është bazë e mirë për një fushë që pretendon të jetë disiplinë më vete⁵⁵.*

⁵³ Shih: Andrew Spencer: Word-formation and syntax, në: Handbook of word-formation, 2005.

⁵⁴ Shih: Pavol Štekauer, *Onomasiological approach to word-formation*, në: Handbook of word-formation, 2005.

⁵⁵ Sh. Islamaj, *Fjalëformimi në gjuhësinë shqiptare*, kumtesë e mbajtur në Seminarin XXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Prishtinë 2010.

Këto dy arsye, mes disa të tjerash, mbështesin propozimin e Sh.Islamajt që edhe në gjuhësinë shqiptare fjalëformimi mund të trajtohet si disiplinë e sistemit gjuhësor.

Trajtimi i fjalëformimit në të gjitha këto aspekte do të çonte në trajtimin në të njëjtën mënyrë të çdo procesi të këtij sistemi. Kështu, procesi i përngjitjes së fjalëve në shqipe mund të trajtohet duke pasur parasysh të gjitha kriteret që dallojnë edhe vetë fjalëformimin si proces.

Prandaj, kriteret kryesore të përcaktimit të fjalëve të përngjitura në shqipe janë:

a) Kriteri leksikor

Përngjitja e fjalëve shihet si një tip *leksikosintaksor* i fjalëformimit, prandaj kriteri leksikor në përcaktimin e tyre luan rol të rëndësishëm. Fjala e përngjitur është një njësi leksikore që shpreh një nocion të caktuar. Kjo do të thotë që ajo ka kuptim leksikor të mëvetësishëm, i cili korrespondon me një nocion që është i barabartë me shumën e kuptimeve të gjymtyrëve që përbëjnë fjalën e përngjitur. Kështu, fjala e përngjitur *gjithmonë* ka kuptim të mëvetësishëm dhe kuptimi i saj është i barbartë me shumën e kuptimeve të secilës prej gjymtyrëve përbërëse *gjithë* + *motnë*. Gjithashtu, kuptimi leksikor i fjalëve të përngjitura ka *karakter tërësor*, që i dallon ato nga njësitë e tjera motivuese, si togfjalëshat, togjet parafjalore, grupet e fjalëve e fjalitë. Kjo do të thotë që, pavarësisht nga numri i gjymtyrëve që përbëjnë fjalën e përngjitur ajo shpreh një *nocion të vetëm* dhe jo marrëdhënie nocionesh, siç ndodh me njësitë e tjera motivuese.⁵⁶

b) Kriteri sintaksor

Fjalët e përngjitura formohen nga njëfjalëzimi (leksikalizimi) i një grupi fjalësh. Kur ky grup fjalësh shkrihet, edhe në fjalën e re të formuar *ruhet rendi sintaksor* i fjalëve

⁵⁶ Shih: L.Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009 : 70.

përbërëse të grupit. Kështu, fjala e përngjitur *matanë* është formuar nga njëfjalëzimi i grupit të fjalëve *më + atë + anë*. Pjesët përbërëse të fjalës së re *matanë* kanë po të njëjtën renditje sintaksore me fjalët e grupit nga ka dalë. Përderisa ruhet rendi sintaksor, në fjalën e re të përngjitur ruhen, përgjithësisht, edhe lidhjet sintaksore të pjesëve përbërëse të saj. Këto lidhje sintaksore mund të jenë bashkërenditëse, si *gjëegjëzë* (gjë + e-gjëzë > gjëegjëzë), *thashethem* (thashë + e-them > thashethem) etj. ose nënrenditëse, si: *kushdo* (kush + do > kushdo), *falemnderit* (falem + nderit > falemnderit) etj. Por, megjithëse kriteri sintaksor është i rëndësishëm për përcaktimin e fjalëve të përngjitura, kjo nuk do të thotë që në formimin e tyre veprojnë gjithmonë rregullat e sintaksës.

c) Kriteri morfologjik

Për të përcaktuar drejt një fjalë të përngjitur e sidomos për ta dalluar nga mënyrat e tjera të formimit të fjalëve është kusht edhe njohja dhe zbatimi i kriterit morfologjik. Përveç kuptimit dhe rendit sintaksor, përgjithësisht gjymtyrët përbërëse të një fjale të përngjitur (nëse janë pjesë të ndryshueshme të ligjëratës) *ruajnë edhe format e tyre të eptimit*. Në fjalën e përngjitur *paradite*, e formuar prej parafjalës *para* dhe emrit *ditë*, ruhet fjalëforma e këtij emri në rasën rrjedhore *dit-e*. Por, pasi përfundon formimi i fjalës së përngjitur, këto fjalëforma shfaqen në formë të ngurosur, pra flektivët nuk kryejnë më funksionet e tyre gramatikore dhe fjala e krijuar në këtë mënyrë është e re edhe nga pikëpamja fonetiko-morfologjike. Kështu, në fjalën e përngjitur *gjithmonë* (*gjithë + motnë*) ka rënë zanorja e patheksuar *ë*, dukuri e cila haset shpesh edhe në formimin e fjalëve të tjera të përngjitura (*matanë, anëmbanë* etj.).

ç) Kriteri theksor

Edhe ky kriter është i qëndrueshëm dhe *vepron njësoj, pa ndonjë dallim, te të gjitha*

*pjesët e ligjëratës të formuara me përngjitje*⁵⁷. Pra, përgjithësisht, fjalët e përngjitura janë të theksuara dhe dallohen se kanë një theks të vetëm, për shkak të strukturës së mbyllur, si *kushdo, ngandonjëherë, secili, tridhjetë* etj. Por ka syresh që mund të kenë edhe një theks dytësor, përveç theksit kryesor, si: *luledielli, sidoqoftë* etj, që nuk janë të theksuara, siç është përemri i pacaktuar *çdo*, ose që kanë theksim mjaft të dobët, si: *pasi, sikur, posi* etj.⁵⁸ Në formimet me përngjitje theksi bie, përgjithësisht, në fjalën e fundit, por mund të jetë *fundor* ose *jofundor* (këtu, kryesisht është parafundor). Kështu, fjalë të përngjitura me theks fundor janë: *askund, asnjë, bardhezi, diku, kushdo, sepse* etj. Fjalë të përngjitura me theks jofundor janë: *asnjëri, ndonjëherë, gjithmonë, meqenëse*, etj. Të pakta janë rastet kur theksi nuk bie në fjalën e fundit të formimeve me përngjitje, si *sonte, sot, meqenëse, megjithëse*.

d) Kriteri drejtshkrimor

Duke pasur parasysh procesin e formimit të fjalëve të përngjitura (shkriren ose ngjitjen e dy ose më shumë fjalëve të një grupi fjalësh, për shkak të përdorimit të gjatë dhe të dendur pranë njëra-tjetrës), kriteri grafik është më i dallueshmi e më i thjeshti për përcaktimin e tyre, por njëkohësisht edhe më i dobëti. Fjalët e përngjitura shkruhen gjithmonë njësh, por kjo nuk do të thotë që çdo fjalë komplekse që shkruhet njësh, është e përngjitur. Kështu fjalët *përfaqëso-j* (për + faqe + so) dhe *udhëkryq* (*udhë* + *kryq*), edhe pse janë formuar nga dy ose më shumë përbërës, nuk janë të përngjitura, për shkak se nuk plotësojnë asnjë nga kriteret e tjera për të qenë të tilla.⁵⁹

⁵⁷ L.Buxheli, Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe, 2009 : 72.

⁵⁸ Sh.Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, 1967 : 21.

⁵⁹ Për përcaktimin më të saktë të kriterëve që dallojnë fjalët e përngjitura, jemi mbështetur edhe në disa monografi e botime të tjera: L.Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009 : 69-73; P.H.Matthews, *Morphology - An introduction to the theory of word-structure*, 1974 : 174-195; J. Tournier, *Precis de lexicologie anglaise*, 63-67.

Metjusi dhe Turnie kanë dalluar disa kriteret për përcaktimin e kompozitave në përgjithësi e sidomos atyre të gjuhës angleze.

III.2 Fjalët e përngjitura dhe llojet e tjera të fjalëve

III.2.1 Dallimi nga fjalët e përbëra

(1) Duke qenë se janë nëndarje të së njëjtës mënyrë fjalëformimi, fjalët e përbëra dhe fjalët e përngjitura kanë ngjashmëri si në strukturë, ashtu edhe nga pikëpamja e formimit. Nga një përkufizim krejt i thjeshtë i kompozitave e ndoshta edhe i pamjaftueshëm për të dhënë saktë konceptin e formimit të tyre, mund të thoshim se ato janë formime të reja fjalësh që kanë dalë nga bashkimi i dy ose më shumë fjalëve (ku me fjalë do të nënkuptojmë pjesët e ndryshueshme e të pandryshueshme të ligjëratës). Kështu, fjalët *bregdet* (fjalë e përbërë) dhe *përherë* (fjalë e përngjitur) janë formuar nga bashkimi i dy fjalëve.

Por në rrafshin sinkronik e diakronik, fjalë të tjera të ngjashme me këta dy tipa dhe me mënyrën sesi janë lidhur ato me njëra-tjerën tregojnë se mes tyre ka dallime.

Kështu:

a) Fjalët e përngjitura janë bashkime fjalësh të plota, kurse fjalët e përbëra janë formuar nga bashkimi i dy ose më shumë temave *pa elemente formuese paradigmatiche*. Elementet përbërëse të fjalës së përngjitur ruajnë të qarta lidhjet sintaksore që kanë në grupin e fjalëve nga kanë dalë (*luledielli* > *lule* + *dielli*, *qoftëlargu* > *qoftë* + *larg-u*, *megjithatë* > *me* + *gjithë* + *atë* etj.) Fjalët e përbëra, duke qenë se formohen prej temash që ruajnë, përgjithësisht qartë, kuptimet leksikore, *hyjnë në lidhje të caktuara e shumë të ndryshme semantiko-sintaktike në bazë të mundësive ligjësores sintaktike që ekzistojnë në gjuhën tonë për lidhjen e kategorive të caktuara leksikore* (A.Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, botuar në Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, 1972, I : 83).

b) Rendi i elementeve që përbëjnë fjalën e përngjitur nuk ndryshon nga rendi që

- kishin në grupin e fjalëve nga ka dalë (*lule dielli* > *luledielli*), kurse te fjalët e përbëra ky rend mund të ndryshojë (*gdhendës guri* > *gurgdhendës*).
- c) Kuptimi i fjalës së përngjitur është i barabartë me shumën e kuptimeve të elementeve përbërëse të grupit të fjalëve nga ka dalë, kurse kuptimi i fjalës së përbërë mund edhe të mos jetë i barabartë me shumën e kuptimeve të elementeve përbërëse të saj (p.sh. *veshmbathje*).
- d) Fjalët e përngjitura mund të përbëhen nga fjalë që janë vetëm pjesë të ndryshueshme të ligjëratës {*atëherë* > *atë* + *herë* (*përemër* + *emër*)}, që kanë në përbërje të tyre edhe pjesë të ndryshueshme edhe të pandryshueshme të ligjëratës {*pasdite* > *pas* + *dite* (*parafjalë* + *emër*)}, por edhe vetëm nga pjesë të pandryshueshme të ligjëratës {*meqë* > *me* + *që* (*parafjalë* + *lidhëz*). Ndërsa një fjalë e përbërë nuk mund të formohet vetëm nga pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.
- e) Fjalët e përngjitura mund të përbëhen nga më shumë se dy gjymtyrë (*me* + *qenë* + *se* > *meqenëse*), kurse fjalët e përbëra janë gjithmonë dygjymtyrëshe, edhe nëse përbëhen nga më shumë se dy tema fjalëformuese, sepse njëra prej dy gjymtyrëve është e përbërë (*atdhe* + *dashuri* > *atdhedashuri* – gjymtyra e para është e përbërë nga *at* + *dhe*).⁶⁰
- f) Përgjithësisht, fjalët e përngjitura formohen në *procesin e përdorimit të gjatë* pranë njëra-tjetrës, kurse fjalët e përbëra janë *akt krijimi*. Këto krijohen mbi bazën e modeleve që kanë lindur e janë zhvilluar në gjuhë gjatë procesit të fjalëformimit. Prandaj, përbërja është më prodhimtare në formimin e fjalëve të reja, sepse krijohet mbi bazën e modeleve, kurse përngjitja është *spontane*. Megjithatë, ka raste kur përngjitja mund të cilësohet si *akt krijimi*, atëherë kur, për analogji, krijohen formime të tjera me përngjitje (*kushdo*, *cilido*, *ngado*, *kudo*, *tekdo* etj.)⁶¹
- g) Përngjitjet, si rregull, nuk kanë *kokë* strukturore-semantike endocentrike⁶².

⁶⁰ A.Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, 1972 : 85.

⁶¹ Shih: Gramatika e gjuhës shqipe 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, 2002 : 76.

⁶² L.Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009 : 95.

Nocioni *kokë* është një nocion i rëndësishëm në sintaksë, por disa gjuhëtarë e shtrijnë edhe në fushën e morfologjisë. Në sintaksë, një grup fjalësh ose një frazë përbëhet të paktën nga një kokë, e cila përcakton edhe kategorinë leksiko-gramatikore të këtij grupi ose të kësaj fraze. Kështu, një frazë që ka si kokë një mbiemër, është një Frazë Mbiemër (FM), ose një frazë që ka si kokë një emër, është Frazë Emër (FE) etj., p.sh.: *shumë i mirë* është një FM, sepse ka si kokë mbiemrin *i mirë*, ose *punë e vështirë* është FE, sepse ka si kokë emrin *punë*.⁶³ Ndërsa në morfologji Uilliamsi (E. Williams) e lidh konceptin e *kokës* me afiksimin dhe kompozimin dhe e përkufizon atë (*kokën*) si anën e djathtë (right-hand) të një fjale të përbërë ose të një fjale komplekse.⁶⁴ Sipas këtij përkufizim, *kokë* mund të quhen edhe sufikset, p.sh. në fjalën *puno*, koka është sufiksi *-o*, sepse është ana e djathtë e një fjale jo të parme (komplekse). Por koncepti *kokë* është shumë i lidhur me fjalët e përbëra ose kompozitat. Në gjuhët gjermanike, elementi që ndodhet në anën e djathtë të një kompozite është edhe koka e saj (në gjermanishte, në fjalën *Vatersname* “emri i babait”, koka është *name* “emri”). Por koncepti i kokës, përveç anës formale, është i lidhur edhe me anën semantike, sepse ajo shpreh përkatësinë leksiko-gramatikore dhe kuptimin e fjalës së re. Po kështu, koncepti *kokë* lidhet edhe me zbatimin e rregullave të eptimit, sepse është ajo që përcakton treguesit eptimorë të gjithë kompozitës.⁶⁵ Megjithatë, në disa gjuhë, një pjesë e kompozitave e kanë elementin *kokë* në të majtë dhe disa në të djathtë të tyre, si në italishte *croce-rossa* “kryqi i kuq”, koka e kompozitës është *croce*, kurse te *gentil-uomo*, (koka është *uomo*).

Pas përcaktimit të konceptit *kokë* në përgjithësi, mund të themi se fjalët e përngjitura në shqipe, pavarësisht se janë fjalë jo të parme, nuk kanë kokë strukturore-semantike.

gj) Te fjalët e përngjitura roli i faktorit fonetik-theksor është më i madh se te fjalët e përbëra

⁶³ Shih: G. Booij, *The grammar of words*, 2005 : 54.

⁶⁴ E. Williams, *On the notions lexically related and head of word*, në: *Linguistic inquiry* 12-2, 1981 : 248.

⁶⁵ G. Booij, po aty, 77.

ku ky faktor shoqërohet edhe me faktorin shumë të rëndësishëm morfologjik.⁶⁶

III.2.2 Dallimi nga fjalët e prejardhura

Përngjitja dhe prejardhja janë mënyra fjalëformimi që afrojnë me njëra-tjetrën, sepse nëpërmjet këtyre proceseve formohen fjalë të reja si rezultat i *bashkëlidhjes* së dy a më shumë elementeve. Kështu, fjala e përngjitur *sikur* dhe fjalët e prejardhura me parashtesë apo me prapashtesë, *puno* dhe *moszbatim*, janë formuar nga bashkëlidhja e dy elementeve. Megjithatë, fjalët e përngjitura dhe fjalët e prejardhura dallojnë pikërisht nga mënyra sesi lidhen këto elemente për të formuar një njësi të re leksiko-gramatikore dhe nga mënyra e motivimit të fjalës. Përgjithësisht, më të ndërlikuara paraqiten lidhjet mes përngjitjes dhe parashtesimit, ku është vështirë të dallosh nëse në një rast kemi të bëjmë me fjalë të përngjitur apo me një parashtesë të mirëfilltë që i është bashkuar temës së fjalës.

- a) Fjalët e përngjitura formohen nga fjalë të plota, kurse fjalët e prejardhura formohen prej *morfemash* (ndajshtesat), të cilat lidhen me rrënjën ose me temën fjalëformuese.
- b) Fjalët e përngjitura ruajnë treguesit formalë që shërbejnë për shprehjen e marrëdhënieve sintaksore të njësive përbërëse në një grup fjalësh.
- c) Përgjithësisht, fjalët e përngjitura nuk janë akte krijimi, pra nuk formohen mbi bazën e modeleve fjalëformuese, kurse fjalët e prejardhura formohen mbi bazën e modeleve të caktuara, prandaj paraqiten mjaft prodhimtare në gjuhë. Kështu, në shqipe me anë të prapashtesës *-tar* formohen emra e mbiemra të tipit *gjahtar*, *mesdhetar*, *këngëtar*, *valltar* etj., ose me anë të parashtesës *mbi-* formohen emra që tregojnë shkallën më të lartë të asaj që emërton fjala motivuese, si *mbinxehje*, *mbilodhje*, *mbingarkesë* etj.

⁶⁶ A.Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, 1972 : 85.

- d) Parashtesimi është një mënyrë e formimit të fjalëve të reja që ka lidhje burimore me përngjitjen, prandaj, nga pikëpamja e përbërjes strukturore fjalët e përngjitura janë të ngjashme me fjalët me parashtesa, sepse duket sikur përbëhen nga të njëjtat elemente, megjithatë ato dallohen nga njëra-tjetra, sepse vlera e elementeve nuk është e njëjtë. Formimet parashtesore përbëhen prej një parashtese dhe një teme fjalëformuese emërore (*mbivendos*, *përpunoj*, etj), ndërsa ato me përngjitje janë krijuar mbi bazën e një togu parafjalor të tipit *parafjalë + emër (mbi + krah, për + ditë etj)*.⁶⁷
- e) Parashtesat nuk mund të bashkohen me emra në trajtën e një rase të zhdrejtë. Prandaj, në formime të tilla, si: *paradite, pasdreke, paradreke etj.*, elementet *para* dhe *pas* nuk paraqiten si parashtesa, përderisa janë lidhur me emra në rasën rrjedhore.
- f) Fjalët e përngjitura mund të shërbejnë si model për formime fjalësh të reja, sidomos kur parafjala kthehet në mjet fjalëformues, në parashtesë, p.sh. parafjala *për* në formime të tipit *përherë, përbrenda, përjashta etj.*

III.2.3 Dallimi nga lokucionet

Një çështje e rëndësishme në analizën e fjalëve të përngjitura është dallimi i tyre nga lokucionet. Në pamje të parë duket se dallimi është shumë i thjeshtë për shkak të strukturës së tyre (krh. fjalën e përngjitur *vërej* me lokucionin *vë re*). Por, duke ditur se fjalët e përngjitura janë formuar nga përngjitja e lokucioneve, problemi vështirësohet, sepse përveçse duhen dalluar qartë lokucionet nga njësitë e tjera frazeologjike, duhet përcaktuar mirë edhe shkalla e bashkëlidhjes ndërmjet fjalëve të përngjitura dhe lokucioneve. Nga shkalla e bashkëlidhjes mund të përcaktohet njëfarë kufiri ndarës midis këtyre fjalëve. Kur fjala e përngjitur është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, shkalla e bashkëlidhjes është më e dobët, kurse, kur fjala e përngjitur është pjesë e ndryshueshme e

⁶⁷ Shih: L.Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009 : 93.

ligjëratës, si folja *vërej*, shkalla e bashkëlidhjes është më e qëndrueshme, për shkak të treguesve gramatikorë (mbaresa –j), prandaj edhe kufijtë e dallimet mes lokucioneve dhe fjalëve të përngjitura janë më të qartë. Gjithashtu, një vështirësi tjetër që hasim në dallimin mes tyre është se, si fjalët e përngjitura dhe lokucionet, janë njësi gjuhësore që veprojnë njësoj si të tilla në sistemin gjuhësor. Këto dy njësi karakterizohen nga *atomiciteti sintaksor*⁶⁸, që do të thotë se edhe fjalët e përngjitura edhe lokucionet janë atome, brenda të cilave sintaksa nuk mund “të hyjë”, pra brenda tyre nuk mund të ndërfiten elemente të tjera dhe nuk mund të funksionojnë as rregullat e lëvizjes. Për fjalët e përngjitura kjo është e qartë, sepse elementet përbërëse të saj i janë nënshtruar fillimisht procesit të leksikalizimit, pastaj janë bashkuar për të formuar fjalën e re. Kështu, në fjalën e përngjitur *nëse* nuk mund të ndërfitim ndonjë fjalë apo ndonjë element tjetër dhe as nuk mund t’u ndërrojmë vendin elementeve të saj. E njëjta gjë vlen edhe për lokucionet, p.sh. në lokucionin lidhëzor *në qoftë se* nuk mund të ndërfitim ndonjë element dhe as të zbatojmë rregullat e lëvizjes së elementeve ekzistuese. Megjithëkëto, përderisa fjalët e përngjitura dhe lokucionet sillen si dy njësi gjuhësore të ndryshme, madje mund të shihen edhe si dy mënyra të ndryshme fjalëformimi (në gramatikat tona, edhe në atë akademike, lokucionet studiohen me vlerën e një pjese të ligjëratës dhe jo si mënyrë e veçantë e fjalëformimit) kanë edhe dallime mes tyre:

- a) Fjalët e përngjitura kanë strukturë të mbyllur (*anëmbanë, meqenëse, bardhezi, bëzaj* etj.), kurse lokucionet kanë strukturë të hapur (*në qoftë se, me qëllim që, në vend..., copë e çikë* etj.).
- b) Kuptimi leksikor i një fjale të përngjitur është i barabartë me shumën e kuptimeve të elementeve përbërëse të grupit të fjalëve nga ka dalë, kurse lokucionet, si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht, janë të barasvlershme me një fjalë të vetme, por jo të njëjta me të. Pra, elementet përbërëse të një lokucioni nuk e ruajnë mëvetësinë e tyre kuptimore e gramatikore.

Në shqipe ndodh që krahas fjalëve të përngjitura të përdoren edhe lokucionet prej të cilave kanë dalë këto fjalë, p.sh. *digjepiq, shkeleshko* etj. përdoren paralelisht me

⁶⁸ Shih: S.Scalise, *Morfologia*, 1994 : 89.

lokucionet *shkel e shko, digj e piq* etj. Në këto fjalë ku mungojnë treguesit gramatikorë, problemi qëndron nëse do të merren si lokucione apo si fjalë të përngjitura, pra nëse do të shkruhen njësh apo ndaras. Në Fjalorin e gjuhës shqipe të 2006-ës vihet re prirja që disa nga këto njësi të shkruhen bashkë, ndryshe nga ç'është pasqyruar në Fjalorin e 1980-ës dhe në Gramatikën e gjuhës shqipe I (1995).

IV. Fjalët e përngjitura në Fjalorin e gjuhës shqipe 2006

- Struktura e fjalëve të përngjitura

Fjalët e përngjitura, përgjithësisht, kanë strukturë *binare* ashtu siç është në përgjithësi struktura e fjalëve jo të parme. Sipas parimit të binaritetit, i njohur fillimisht në gjuhësinë gjermane dhe austriake, të gjitha lidhjet semiotike dhe gramatikore janë binare, si në rrafshin paradigmatic ashtu dhe në atë sintagmatik, madje edhe lidhjet terciare (treshe) zakonisht zbërthehen në dy lidhje binare. Në lidhjet sintagmatike një element i caktuar i bashkëngjitet një baze.⁶⁹ Kështu, në fjalë të prejardhura, të formuara me parashtesim ose me prapashtesim, prefiksi apo sufiksi i bashkëngjiten temës së fjalës (bazës)⁷⁰. E njëjta gjë ndodh edhe me kompozitat, pavarësisht nëse janë me lidhje bashkërenditëse apo nënrenditëse, kur nga bashkimi i dy temave ose i dy fjalëve formohet një fjalë e re. Kompozita *bregdet* ka strukturë binare, sepse elementi *breg* është bashkuar me bazën *det* për të formuar këtë fjalë të përbërë. Por kompozitat mund të përbëhen edhe nga tri ose më shumë elemente duke përfshirë edhe bazën. Në këtë rast, nëse lidhja është terciare, njëri element i kompozitës grupohet zakonisht në dy lidhje binare. Kështu, në kompozitën *[[[zë][vendës]][ministër]]*, fjala *zëvendës* formon një lidhje binare më vete, ku lidhja bazë është *zëvend*-ës. Edhe nëse kompozita është fjalë e përngjitur, e përbërë nga tri ose më shumë elemente, sërish struktura e saj është binare. Kështu, fjalët e përngjitura *përveçse* dhe *foleqesh* kanë strukturë binare. Fjala e parë, që është lidhëz, përbëhet nga baza *përveç* dhe elementi *se*, që i shtohet bazës, ndërkohë që edhe vetë baza ka strukturë binare, e përbërë nga elementet *për* + *veç*. Fjala *dokudo* është ndajfolje, e formuar nga elementi *do* + *kudo*, ku elementi i parë *do* i shtohet bazës (elementit të dytë *kudo*) për të krijuar binaritetin e ndajfoljes së përngjitur, ndërkohë që vetë elementi i dytë, baza, ka

⁶⁹ W.Dressler, *Word-formation in natural morphology* (Preference for binarity), në: Handbook of word-formation, 2005 : 276.

Ndryshe, baza e fjalës quhet temë e fjalës, që është pjesa e fjalës pa flektivë.

⁷⁰ Bazës (temës) së fjalës *punë* i bashkëngjitet sufiksi *-o* për të formuar një fjalë të re me strukturë binare.

strukturë binare *ku + do*.

IV.1 Llojet e fjalëve të përngjitura

Fjalët e përngjitura hyjnë te të gjitha pjesët e ligjëratës, të ndryshueshme e të pandryshueshme. Përgjithësisht, te pjesët e ndryshueshme të ligjëratës përngjitja është më pak e pranishme, sepse, përderisa aty fjalët ndryshojnë vazhdimisht formë, pra marrin tregues eptimorë të ndryshëm, është më e vështirë të ngurosen, prandaj qëndrojnë më shumë në formën e grupeve të fjalëve. Nga ana tjetër, te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës përngjitja është më prodhimtare dhe më vepruese, për shkak edhe të rolit të analogjisë, e cila, në mjaft raste, vepron edhe te përemrat e pacaktuar dhe te numërorët që janë pjesë të ndryshueshme të ligjëratës. Duke qenë se formohen *nga afrimi i dy ose më shumë fjalëve në procesin e përdorimit të tyre të gjatë*, ekzistenca e fjalëve të përngjitura dëshmohet qysh herët, pavarësisht sesi mund të jenë emërtuar nga studiues të ndryshëm. Në *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Çabej dallon fjalë të tilla qysh te Buzuku e te Bogdani. Edhe në *Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe* të Gustav Majerit (1891), që më vonë shërbeu si pikënisje për studimet etimologjike të Çabejt dhe për studime të tjera, dëshmohen disa fjalë të përngjitura, të cilat janë përfshirë edhe në fjalorët e sotëm të gjuhës shqipe. Fjalë të përngjitura gjejmë edhe te fjalorët e Gazullit (1941) e të Pano Tases (1941), që janë fjalorë dialektorë, i pari me fjalë të rralla të përdorura në Veri të Shqipërisë, kurse i dyti me fjalë dhe shprehje nga Jugu i Shqipërisë. Veçanësia e *Fjalorit dialektor* të Tases është se, përpos pjesës së parë që është mirëfilli fjalor, ka edhe një pjesë të dytë ku Tase është munduar të klasifikojë “me vesh” disa fjalëformime të shqipes. Këtu janë përfshirë edhe disa shprehje ndajfoljore me përsëritje (siç i quan ai), një pjesë e të cilave, pavarësisht se aty janë shkruar ndaras, sot në gramatikat e shqipes e në fjalorë paraqiten si fjalë të përngjitura (an’e mb’anë, drejt për drejt, rrall’e tek etj.)⁷¹.

⁷¹ Pano Tase, *Fjalor dialektor*, 2006 : 300-302.

Për vjetërsinë e tyre, me argumente shkencore, flet edhe Kostallari në studimin e tij “Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe”.

Nga këto studime e fjalorë është vjelë edhe një pjesë e lëndës që ka shërbyer më pas për hartimin e fjalorëve të shqipes, si për atë të '54-ës, të '80-ës dhe, së fundi, për *Fjalorin e gjuhës shqipe* të vitit 2006.

Sipas pjesëve të ligjëratës, ku përngjitja vepron gjerësisht, kemi 10 lloje fjalësh të përngjitura, të cilat do t'i trajtojmë më poshtë duke marrë si lëndë bazë *Fjalorin e gjuhës shqipe* të vitit 2006. Fillimisht, do të japim shpërndarjen e tyre në pjesët e ligjëratës me disa karakteristika, pastaj në kapitujt e tjerë veçoritë dhe përbërësit e tyre strukturorë, si dhe veçoritë dhe përbërësit e tyre semantikë.

IV.1.1 Emra të përngjitur

Përgjithësisht, në formimin e emrave të përngjitur duket se analogjia nuk vepron. Ata janë formuar sipas mënyrës klasike të formimit të fjalëve të përngjitura, duke u përdorur për një kohë të gjatë pranë njëra-tjetrës. Prandaj, emrat e përngjitur i gjejmë kryesisht në të folmen e popullit, në vargje e në këngë, në folklor për të shënuar emra figurash të ndryshme, por edhe në formën e eufemizmave.⁷² Janë, kryesisht, formime të hershme, të cilat janë pasqyruar gjerë në *Fjalorin e 2006-ës*, krahasuar me atë të '54-ës dhe të '80-ës. Megjithatë, ka edhe ndonjë rast kur mendohet se emri i përngjitur është formuar për shkak të analogjisë. Kështu, Kostallari, në studimin për kompozitat dëshirore e urdhërore të shqipes (këto të fundit janë të gjitha fjalë të përngjitura), veçon rastin e emrit *hajfurrare*, për të cilin mendon se është kompozitë e zbërthyer dhe e interpretuar

⁷² Shënim: Pjesa më e madhe e lëndës së Fjalorit të Tases është vjelë nga këngët isopolifonike të Shqipërisë së Jugut, pra nga forma e kënduar. Në këto lloje këngësh, për shkak të natyrës së tyre, popullit i është dashur të ekonomizojë gjuhën vetvetiu, duke krijuar kështu fjalë të reja, të prejardhura e të përngjitura. Në pjesën më të madhe, fjalët e përngjitura janë emra ose onomatope, të cilat në përshtatje me sistemin fonetik e gramatikor të gjuhës në fjalor dalin si emra (dërvëre-ja etj.) (Shih.: *Parathënie e Fjalorit dialektor nga L.Shamku-Shkreli*).

nga vetë populli si urdhërore në analogji me *hajujk*. Emri i përngjitur *hajujk* (djalli), që përdoret si eufemizëm, shihet si përngjitje urdhërore e mirëfilltë (*haje ujk!*), gjë që është e vështirë të thuhet për emrin *hajfurrare* (*haje furrare!*). Prandaj mendohet se në analogji me kompozitën me strukturë të qartë urdhërore të tipit *hajujk*, interpretohet edhe kompozita *hajfurrare* (ai që ha një furrare bukë).⁷³

Në Fjalor nuk paraqiten emërtimet e përveçme të përngjitura, ku hyjnë edhe toponimet mjaft interesante, që dëfton se kategoria e emrave të përngjitur në shqipe është edhe më e pasur. Fjalët *buzagaz*, *donkishot*, *donzhuan* e *gurkali* që, në disa fjalorë (1954) e në ndonjë studim i trajtojmë fillimisht si mbiemra, në Fjalorin e 2006-ës paraqiten së pari si emra, pastaj jepet përdorimi i tyre edhe si mbiemra. E njëjta gjë ndodh me fjalët *paradite*, *paradreke*, *pasdarke*, *pasdite*, *pasdreke*, të cilat fillimisht duhen vështruar si emra, pastaj me anë të konversionit kalojnë në klasën e ndajfoljeve, ku gjejnë përdorim edhe më të shpeshtë.

Kemi veçuar si emra të përngjitur edhe fjalët *nënbarkëz*, *nënbisht*, *nënçati*, *nëndore*, *nënlëkurë*, *nëntokë*. Për nga struktura, duket sikur këta janë emra të prejardhur të formuar me parashtesën *nën*. Këtë e dëshmojnë edhe Xhuvani-Çabej, kur përmendin fjalët *nënbarkëz*, *nëntokë* etj. si emra të formuar me parashtesën *nën*-.⁷⁴ *Sipas tyre, kjo parashtesë tregon tek emrat një objekt që gjendet nën një tjetër*. Studiuesja L.Buxheli mendon se këta emra mund të quhen se janë formuar me përngjitje, me ndihmën e parafjalës *nën*-, sepse në këto fjalë *nën*- nuk tregon një objekt që gjendet nën një tjetër. Kështu, në fjalorin e 2006-ës, fjala *nënbarkëz* është një rrip i gjerë që kalon nën barkun e kafshëve të ngarkesës...etj., ose fjala *nënçati* nuk tregon diçka që ndodhet nën çati, por pjesën e brendshme të një çatie etj.⁷⁵ Të njëjtën gjë mund të themi për emrat *mbibisht*, *mbifushë*, *mbisup*..., *ndajnatë*, *padije*, *pafuqi*..., *përgojë*, *përshitës*...etj.

Prej Fjalorit kemi nxjerrë edhe emrat *kacabu*, *kacadre*, *kacafik*, *kacagjel*, *kacamic*, *kacarra*, *kacarrum*, *kaladredhë*, *kalavesh*. Këta emra kanë si përbërës të parë

⁷³ A.Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, 1972: 182-183.

⁷⁴ A.Xhuvani-E.Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, në A.Xhuvani, *Vepra I*, 1980 : 390.

⁷⁵ Shih: L.Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009 : 135-138.

elementet *kaca-* dhe *kala-*. Këto dy elemente Xhuvani-Çabej i paraqesin si parashtesa dhe fjalët e formuara prej tyre si fjalë jo të parme të formuara me parashtesa.

Sipas tyre, këta emra janë formuar me parashtesën *kaca-*. Këtu kjo parashtesë *regon një përgjasim të zvogëluar me primitivin*.⁷⁶ Kjo parashtesë vendoset edhe përpara foljeve⁷⁷ e përpara ndajfoljes *kacagjelthi*. Në shqipe sot kjo parashtesë nuk është më prodhimtare. Edhe vetë Xhuvani-Çabej pohojnë se ky formant dikur ka pasur përhapje më të madhe në gjuhën shqipe. Meqë kjo parashtesë nuk shërben më për formime fjalësh të reja, gjë që është karakteristike për formimet e prejardhura, atëherë fjalët e formuara prej saj mund të trajtohen si të përngjitura.⁷⁸ Të njëjtën gjë mund të themi edhe për parashtesën *kala-*, megjithëse kuptimi i saj nuk del i qartë në çdo rast.⁷⁹

Si fjalë të përngjitura, në fjalorin e 2006-ës kemi vjelë edhe disa forma onopatopeike, të cilat janë emëruar në përshtatje me rregullat drejtshkrimore e gramatikore, si: *bëzbëze, çakaçuke, gërgëre, raketake, taketuke, tiktak*.⁸⁰

Emra të përngjitur në Fjalorin e 2006-ës⁸¹:

Besëtytni, bëzbëze, brezëmbrek, bukëvale, buzagaz, çakaçuke, çapejak, deleduk, digjepiq, donkishot, donzhuan, drekëherë, ecejak, farefis, gërgëre, gugufu, gurali, gjëgjëzë, hajujk, hamendje, herdhagjel, herdhaqen, hiqepiq, imzot, jashtënesh(i), kacabu, kacadre, kacafik, kacagjel, kacamic, kacarra, kacarrum, kaladredhë, kalavesh, kashelashë, këmbëdele, kryeshëndoshë, kukamë, kukumjaçkë, kukuvajkë, kukuvriq, lagaterë, lamtumirë, largkëtej(i), largnesh(i), largqoft/ë(i), lotzonjë, lulegojë, mbibisht, mbifushë,

⁷⁶ Në Fjalorin e 2006-ës, fjala *kacadre* është një lloj buburreci i madh, me dy brirë si antena në kokë, kurse *kacagjel* është një lloj milingone e madhe me trup në ngjyrë të kuqe të errët etj. Ndërsa për fjalën *kacabu*, Xhuvani-Çabej mendojnë se është formuar për analogji me *kacadre*.

⁷⁷ Në Fjalor kemi gjetur foljet *kacafyt* e *kacambyt*.

⁷⁸ Shënim: Këtu hyjnë edhe variantet e kësaj parashtese: *kaci-* dhe *kaca-*. (A.Xhuvani-E.Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, në: A.Xhuvani, Vepra I, 1980 : 374-375.

⁷⁹ Rreth këtyre parashtesave, shih: A.Xhuvani-E.Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, në: A.Xhuvani, Vepra I, 1980 : 374-375 dhe 375-376.

⁸⁰ E.Angoni këta emra me prejardhje onomatopeike i quan të përngjitur me prapashtesën *-e* (E.Angoni, *Onomatopetë dhe mundësitë e tyre fjalëformuese*, në: Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II, 1975 : 253-254.

⁸¹ Fjalët e përngjitura i kemi vjelë nga Fjalori duke pasur parasysh kriteret për përcaktimin e tyre, si edhe njohuritë që kemi nga gramatika të ndryshme.

mbikrah, mbipetk, mbisup, mbivetull, melekuqe, mëgojëz, mëkresë, mëngojë, mëzëmër, mirëseardhje, mishmash, mollatartë, motmot, ndajgjethëz, ndajnatë, ndeshetrashë, ndjesëpast/ë(i), ndore, nëdorës, nënbarkëz, nënbishte, nënçati, nëndore, nënlëkurë, nëntokë, ninananë, nusebukur, njëenjëzë, njëzenjëzë, padije, padjallëzi, padurim, pafuqi, pamiradije, panxharsheqer, paradite, paradreke, pasdarke, pasdite, pasdreke, pasmesnatë, pasqafe, pavetëdije, përderës, përgojë, përmjet, përshitës, picingul, plotfuqi, prapamalas, punëdore, qepëdosë, qoftëlarg(u), ruajnazot(i), rraketaqe, rrasëpetë, rrushqyqe, sanataditë, sapunqyqe, shëmëhill, shëmitër, shënëndre, shqepadru, shtatëpëllëmbëmjekër, shtojzorreshta, shtojzovalle, shtrojerë, taketuke, tambël, tamtam, tëlyen, tëmbël, tëmotje, tiktak, togfjalësh, thashetheme, theribujkë, therimi, therpelë, thithëlopë, udhembarë(a), vadhëviçe, vajgur, valëbuke, vapëherë, vëmendje, xhuxhmaxhuxh, zëmërherë, zigzag, zomotër.

IV.1.2 Mbiemra të përngjitur

Mbiemrat e përngjitur janë më të paktë, krahasuar me emrat. Në këtë pjesë ligjërate, përngjitja nuk është mënyrë prodhimtare fjalëformimi. Ka prej tyre formime të hershme, por edhe formime të mëvonshme, si: *kuqezi, bardhezi*⁸², *bardheblu* etj. Duket se në këto formimet e fundit luan rol edhe analogjia, por nuk mund të themi se ka ndonjë model të caktuar për formimin e tyre, siç ndodh te mbiemrat e formuar me prejardhje, ku kjo mënyrë fjalëformimi është mjaft e gjallë dhe vepruese. Gjithashtu, dy mbiemra të përngjitur janë kalkime: (lule) *mosmëharro* prej gjermanishte “Vergissmeinnicht” dhe (lule) *mosmëprek* prej latinishtes “noli me tangere”⁸³.

⁸² Në Fjalorin e gjuhës shqipe, 2006, fjala *bardhezi* paraqitet vetëm si ndajfolje, ndërkohë që fjala *kuqezi*, që për nga struktura dhe pjesët *përbërëse* është e njëjtë me *bardhezi* (mbiemër+lidhëz bashkërenditëse+mbiemër) paraqitet si mbiemër. Në fjalorët e shqipes të 1954-ës dhe 1980-ës, fjala *bardhezi* paraqitet si mbiemër. Si mbiemër i përngjitur del kjo fjalë edhe në Gramatikën e gjuhës shqip I, të Akademisë së Shkencave.

⁸³ Shih: A.Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, në: Studime mbi leksikon... I, 1972 : 184.

Mbiemra të përngjitur në Fjalorin e 2006-ës

*Besëtytë*⁸⁴, *foleqesh*, *kuqezi*, *majëkrahut*, *mosmëharro*, *mosmëprek*, *ndërhundsh*, *ngjyrëvishnje*.

IV.1.3 Numërorë të përngjitur

Numërorët e përngjitur janë 9, nga njëmbëdhjetë deri në nëntëmbëdhjetë. Ata janë formuar nga leksikalizimi i njësive përbërëse të lokucioneve, duke qëndruar për një kohë të gjatë pranë njëra-tjetrës. Për formimin e këtyre numërorëve mund të ketë vepruar edhe analogjia, pra mundet që jo të gjithë numërorët të jenë formuar nga leksikalizimi i lokucioneve.

IV.1.4 Përemra të përngjitur

Pjesa më e madhe e përemrave të përngjitur janë përemra të pacaktuar. Me përngjitje janë formuar edhe pak përemra pyetës (*çfarë*, *çka*) e dëftorë (*asisoj*, *asodore*, *kësisoj*, *kësodore*). Përderisa përemrat e përngjitur janë të shumtë në numër, duket se kjo mënyrë fjalëformimi është mjaft vepruese në këtë pjesë ligjërata. Përveç leksikalizimit të njësive përbërëse të grupit të fjalëve, për shkak të përdorimit të gjatë pranë njëra-tjetrës, këtu analogjia ka luajtur rol të konsiderueshëm, pra jo të gjithë përemrat janë krijuar si rezultat i përdorimit të gjatë pranë njëra-tjetrës të pjesëve përbërëse të tyre (*askurrfarë*, *askurrgjë*, *askurrkush*, *askush ose gjithfarë*, *gjithfarëlloj*, *gjithfarësoj* etj.).

Si përemra të formuar me përngjitje kemi trajtuar edhe përemrat e pacaktuar që kanë si pjesë të parë elementin *akë-*. Xhuvani-Çabej e paraqesin këtë element si

⁸⁴ Shënim: *Besëtytë* është formim prapavajtës nga *besëtytni*.

parashtesë që u vihet përpara disa përemrave të pakufishëm dhe disa ndajfoljeve përemërore.⁸⁵ Në këtë mënyrë, përemrat e pacaktuar që kanë si pjesë të parë elementin *akë-* shihen si përemra jo të parmë të formuar me parashtesë. Edhe në fjalorët e '80-ës e të 2006-ës, *akë-* trajtohet si element fjalëformues. Por ky element, në të vërtetë, duket se është i ngurosur dhe nuk përdoret si fjalë e mëvetësishme jashtë fjalës së përngjitur. Gjithashtu nuk mund të përdoret për të krijuar gjedhe strukturore. Edhe në Gramatikën e Akademisë së Shkencave përemrat e pacaktuar të formuar me elementin *akë-* merren si të përngjitur⁸⁶. Si të përngjitur i trajton këta përemra edhe Sh. Demiraj⁸⁷. Përgjithësisht, një nga elementet e përemrave të pacaktuar të përngjitur është i lakueshëm, kurse tjetri i ngursosur, por mund të jenë edhe të dy të ngurosur. Prandaj, shpesh përemrat e pacaktuar ndahen në tipa duke marrë për bazë elementin e ngurosur⁸⁸.

Përemra të përngjitur në Fjalorin e 2006-ës:

Akëcili, akëku, akëkush, akëqysh, akësecili, akësekush, asfarëgjë, asgjë, asgjëkafshë, asgjësend, askurrfarë, askurrgjë, askurrkush, askush, asndonjë, asndonjëri, asnjeri, asnjë, asnjëfarë, asnjëfarëlloj, asnjëri, asodore, cilido, çdo, çdofarë, çdogjë, çdoherë, çdokush, çdolloj, çdonjëri, çdota, çfarë, çfarëdo, çfarëdolloj, çfarëmos, çka, çkado, çkamos, çmos, çnuk, çoç, çdokush, çosa, diç, diçka, dikush, disa, dokushdo, farëgjëje, farësendi, gjëkafshë, gjësend(i), gjithçka, gjithçmos, gjithfarë, gjithfarëlloj, gjithfarësoj, gjithkush, gjithmbarë, gjithsecili, gjithsekush, hiçasgjë, hiçgjë, hiçgjëkafshë, hiçgjësend(i), hiçmosgjë, kësisoj, kësodore, kurrfarë, kurrjë, kurrkush, kushdo, moskush, mosnjeri, ndokush, ndonjë, ndonjëri, njëfarë, pakkush, secili, secilido, sedo, sekush, sikush, shumçka, shumëkush, tjetërkush.

⁸⁵ A.Xhuvani - E.Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, në A.Xhuvani, Vepra I, 1980 : 366.

⁸⁶ Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 250.

⁸⁷ Sh.Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë 1971 : 141-143.

⁸⁸ Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 250.

IV.1.5 Folje të përngjitura

Në shqipen standarde të pakta janë foljet që janë formuar nga përngjitja e një togfjalëshi. Studiuesit kanë vërejtur se kuptimi i foljeve *bëzaj, shtozoj* e *vërej* ka dalë mirëfilli nga kuptimi i togfjalëshave, prej të cilëve janë formuar. Pas formimit, këto folje kanë marrë edhe tregues eptimorë të ndryshëm nga ato të lokucionit foljor. (krh. *vë re* dhe *vërej*).

Përveç këtyre, në kategorinë e foljeve të përngjitura, të vjela në Fjalorin e 2006-ës, kemi përfshirë edhe disa syresh, që janë formuar nga përngjitja e një togu parafjalor pa ndajshitesë⁸⁹ (*mëkëmb, ngarend, ngush, përsysh, përtym, përudh* etj.). Këto folje janë interpretuar edhe si të formuara me anë të një parashtese ose prapashtese ose me të dyja njëkohësisht. Parafjalët që marrin pjesë në këto lloj përngjitjesh janë: *nga, më, ndër, në, nëpër* dhe *për*. Foljet e përngjitura të formuara nga përngjitja e togut parafjalor, me parafjalën *për* + emër në kallëzore, dallohen për prodhimtari më të madhe.

Si folje të përngjitura kemi trajtuar edhe disa forma onomatopeike, të cilat janë foljëzuar, duke iu përshtatur rregullave gramatikore të gjuhës.

Folje të përngjitura në Fjalorin e 2006-ës:

Bërbëlit, bëzaj, fërfëllij, fëshfërin, kacafyt, kacambyt, kalamend, kalavar, kukuris, mbudh, mbuz, mëkeq, mëkëmb, mërkëmb, mërmërit, murmërij, murmurit, murmuroj, ndërsyj, ndorem, nëpërkëmb, ngarend, ngush, pajambaj, përdyt, përfytem, përhedh, përkëmb, përkrah, përqurr, përsëdyt, përsysh, përshtëndosh, përtop, përtym, përudh, përshtëpërit, shtozoj, shushurin, takeq.

⁸⁹ Po aty, 355.

IV.1.6 Ndajfolje të përngjitura

Ndër pjesët e ligjëratës, të formuara me përngjitje, ndajfoljet zënë vendin kryesor. Ato janë formuar nga përngjitja e një grupi fjalësh, ku një ndër elementet përbërëse, përgjithësisht, është përemër. Ka ndër to formime të hershme që dëshmohen qysh te Buzuku, te Bardhi e te Bogdani, për etimologjinë e të cilave kanë shkruar edhe albanologë të shquar, si Pedersen, Jokli e Majeri⁹⁰. Megjithëse janë të hershme, për formimin e tyre si fjalë të përngjitura është folur relativisht vonë. Kështu, në një studim të veçantë e të gjerë për ndajfoljet (1949), Xhuvani flet edhe për formimin e tyre. Ai i paraqit ndajfoljet të formuara prej rasash të ndryshme të emrit, prej mbiemrash, me prapashtesa e lokucione, por nuk përmend ndajfolje të formuara me anë të përngjitjes ose të kompozimit, siç e quan ndryshe.⁹¹ Në gramatikat e sotme të shqipes, formimit të ndajfoljeve, ku përfshihen edhe ndajfoljet e përngjitura, u kushtohet një vend i vecantë.

Për formimin e ndajfoljeve të përngjitura ka luajtur rol edhe analogjia. Një pjesë e ndajfoljeve të këtij grupi, që kanë nga një element të përbashkët në përbërje të tyre (ky element mund të jetë pjesë e parë ose e dytë e fjalës së përngjitur), ndoshta nuk janë formuar të gjitha prej përngjitjes së një togu fjalësh për shkak të përdorimit të gjatë pranë njëra-tjetrës të pjesëve përbërëse të tij (*gjithherë, gjithkah, gjithkund, gjithmonë* etj. ose *ngado, kudo, tekdo* etj.). Në këto raste është vështirë të shpjegohet nëse kemi të bëjmë me përngjitje klasike (që janë formuar me kohë) apo me përngjitje prej analogjisë.

Edhe te ndajfoljet, ashtu si te të gjitha pjesët e tjera të ligjëratës të formuara me përngjitje nuk ka një modël të përcaktuar për formimin e tyre.

Ndajfolje të përngjitura në Fjalorin e 2006-ës:

⁹⁰ Shih: E. Çabej, *Studime gjuhësore I, II*, Prishtinë 1976 dhe G.Meyer, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, 2007.

⁹¹ A.Xhuvani, *Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqipet*, në *Vepra I*, 1980.

Afërmendsh, akëku⁹², akëseku, anamend (anamendas), anaprapthi, andej, andejpari, anekënd, anembanë, anepërçark, anëpëranë, asajane, asfare, asgjetiu, asgjëkund(i), askund(i), askurrë, askurrkah, askurrkund, asndonjëherë, asnjëherë, asohere, asokohe, aspak, assesi, atëbotë, atëherë, atëkohë, atypari, ballaballë (ballaballas), ballafaqe (ballafaqas), barabar, batbat, brendapërbrenda, bythakrej, caherë, capak, cekapreka, cinglapjekthi, çakaçukthi, çdogjë, çdoherë, çelemyll, çoku, dalëngadalë, denbabaden, diku, dikur, diqysh, disi, doemos, dokudo, dokurdo, domosdo, dorëmenjë, dosido, drejtpërsëdrejti, dymëzaj, fshehalogas, fytafyty, guraçokthi, gurangrehas, gurapeç, gurashenjash, gurmakash, gurmacthi, gurtopthi, gurthimurthi, gjëkund, gjithandej, gjithaq, gjithashtu, gjithherë, gjithkah, gjithkund, gjithmonë, gjithnduer, gjithnduersh, gjithnjë, gjithqysh, gjithsej, gjithsesi, gjithunji, hapadollapa, hapagojas, hapakrah, hapashalas, hapashalthi, herëdokur, hënabrenda, hënajashtë, hënakeq, hënaprapë, hëpërhë, hiçgjëkund(i), hopakalas, hopangop, kacagjelthi, kaheerë, kahmos, kaladibrance, kaladredhas, kalagjunjas, kalakiç, kalakryq, kalangërç, kalavigjas⁹³, kalehtas, kalehtë, kalëshalë, kaliqafë, kamot, këmbëcingthi, këmbëkithi, këtejpari, këtupari, kryekreje, kryepari, kryepicingul, kudo, kukafshehtas, kukafshehthi, kumos, kurdo, kurdoherë, kurrkah, kurrkund, kurnjëherë, kurrqysh, kurrsesi, kushedi, lesheli, logetrog, majakrethi, marramendth, matanë, mbanë, mbandaj, mbyllasyzash, menatë, menjëherë, mepërmes, mëdyshas, mëdyzaj, mëngjunjas (mëgjunjazi), mënjane, mënjëzaj, mirëfilli, moskurrë, mosnjëherë, mostjetër, ndajnatëherë, ndanë, ndërdysh, ndërdyzash, ndërkaq, ndërkohë, ndërmet, ndërsjelltas, ndoca, ndokund, ndonjëherë, ndopak, ndoresh, nëpërmes, ngaditë, ngado, ngaherë, ngandonjëherë, nganjëherë, ngrykë, nisesos, njaçkaditë, njëditëzaj, njëfarëlloj, njëfarësoj, njëherë, njëherësh, njëlloj, njëmendthi, njëmenjë, njëmëzaj, njënatëzaj, njënjë, njëpërnjë, njësoj, njëtash, njëzëri, padashka, pakmos, paksa, paksëpaku, pakujtimas, papritmas (papritmazi), parasysh, pardje, parmbrëmë, parvjet, paskëtaj, pasnesër, patjetër, pasagurthi, përballë, përbrenda, përbri, përditë, përdhe, përfaqe, përfund(i), përgjatë, përgjithmonë, përgjithnjë, përgjumësh, përherë, përjashta, përjetë, përkarshi, përkëtej, përmatanë, përmbas,

⁹² Për formimin e ndajfoljeve që kanë si pjesë të parë elementin akë-, shih këtu, Përemra të përngjitur.

⁹³ Edhe për formimin e ndajfoljeve që kanë si pjesë të parë elementet kaca- dhe kala-, shih këtu, Emra të përngjitur.

përmbipardje, përmbipasnesër, përmbirapa, përmbendsh, përmbes, përmbatë, përmbdryshe, përmbgaherë, përmbgut, përmbjëherë, përmbjëmend, përmbposhtë, përmbqark, përmbreth, përmbse, përmbseri, përmbsipër, përmbëshqit, përmbshat, përmbtejt, përmbtokë, përmbimajthi, përmbingulthi, përmbëgjallë, përmbëpesë, përmbësëpari, përmbgojas, përmbpërplot, përmborsa, përmbosa, përmbpothuj, përmbpothujse, përmbpranë, përmbprapëseprapë, përmbprore, përmbpulaqorrthi, përmbqëherthi, përmbqëkur(i), përmbqëlshati, përmbqëmoti, përmbqënatje, përmbqëparë, përmbqëparthi, përmbqiteprit, përmbrrallëherë, përmbrrallëkund, përmbrrëshqanë, përmbrruazapalcas, përmbrado, përmbradokudo, përmbradopak, përmbsakaq, përmbsakaqherë, përmbsaora, përmbsapo, përmbsepse, përmbsesi, përmbsidu, përmbsidokudo, përmbsidozot, përmbsipër, përmbsivjet, përmbsonte, përmbsymbyllas (symbyllazi), përmbsyplasas, përmbsytokas, përmbshpeshherë, përmbshumëkund, përmbtejefund, përmbtejjetanë, përmbtejjetanë, përmbtejjetej, përmbtejjetmatanë, përmbtejjetnesër, përmbtejjetpardje, përmbtejjetparvjet, përmbtejjetpasnesër, përmbtejjetpërtej, përmbtekandej, përmbtekdo, përmbtekefundit, përmbtekembramja, përmbtekëndej, përmbteposhtë, përmbtërësej, përmbtjetërkah, përmbtjetërkund, përmbtjetërmendas, përmbtjetërpardje, përmbtjetërpasnesër, përmbtjetërparvjet, përmbtjetërqysh, përmbtopahipas (topahipthi), përmbtopgropti, përmbtheqafas (theqafazi), përmbveçan, përmbveçmas, përmbvetvetiu, përmbxheku.

IV.1.7 Parafjalë të përngjitura

Në studimin për parafjalët (1964), që është një analizë e gjithanshme morfologjike, semantike e sintaksore e kësaj pjese ligjrate, A.Xhuvani, ndryshe nga ndajfoljet, flet për parafjalë të përngjitura.⁹⁴ Si të tilla ai dallon parafjalët nëpër e përmbi, bashkë me trajtat e tyre, përkatësisht *ndërpër, ndëpër* dhe *ënbii a përënbii, mbi, mi, përmi*. Parafjalën *nëpër* e gjejmë në trajtën *ndërpër* qysh te Buzuku, kurse trajta tjetër *ndëpër* është përdorur prej Budit, Bogdanit e Argjirokastritit etj. Po kështu, parafjala *përmbi* me trajta e saj është përdorur prej shkrimtarëve të lashtë të Veriut e të Jugut.⁹⁵ Përdorimi i hershëm i këtyre parafjalëve tregon se ato duhet të jenë formuar nga përngjitja e pjesëve përbërëse të grupit të fjalëve si rezultat i përdorimit për një kohë të gjatë pranë njëra-tjetrës.

Për parafjalën *nëpërmjet*, Xhuvani mendon se ka ardhur prej ndajfoljesh, pra nuk

⁹⁴ A.Xhuvani, *Parafjalët*, në *Vepra I*, 1980 : 267.

⁹⁵ Po aty, 290 dhe 320.

e përfshin në grupin e parafjalëve të përngjitura. Në fjalorët e '54-ës, të '80-ës e të 2006-ës kjo fjalë del vetëm si *parafjalë*.

Në Fjalorin e 2006-ës kemi gjetur si parafjalë të përngjitura fjalët: *nëpër*, *nëpërmjet*, *përgjatë*, *përmbi*, *përpos*, *përveç* dhe *sipas*. Në Gramatikën e gjuhës shqipe (2002) si parafjalë e përngjitur jepet edhe fjala *ndërmjet*, ndërkohë që nuk është dhënë fjala *përpos*. Në Fjalorin e 2006-ës, fjala *ndërmjet* jepet si ndajfolje, pastaj me konversion kalon në klasën e parafjalëve. Katër nga shtatë parafjalët e përngjitura kanë si pjesë të parë elementin *për-*, gjë që nuk mohon veprimin e analogjisë edhe në këtë pjesë ligjërata.⁹⁶

IV.1.8 Lidhëza të përngjitura

Ashtu si te çdo pjesë tjetër ligjërata, edhe te lidhëzat përngjitja nuk është rruga kryesore e formimit të tyre, megjithatë ajo zë një vend jo të paktë, duke pasur parasysh se për nga struktura lidhëzat i kemi vetëm të parme, të përngjitura e lokucione. Pjesa më e madhe e tyre kanë patjetër në përbërje një lidhëz, që përgjithësisht është element i dytë. Ka raste kur edhe elementi i parë është lidhëz.

Lidhëzat e përngjitura janë formuar nga leksikalizimi i pjesëve përbërëse të një grupi fjalësh në procesin e përdorimit të gjatë e të vazhdueshëm pranë njëra-tjetrës. Kryesisht janë formime të hershme, por ka edhe formime më të reja. Në Fjalorin e 2006-ës ka edhe ndonjë përdorim krahinor, si *anipse*, të papërfshirë në fjalorët e mëparshëm të shqipes, në atë të '54-ës e të '80-ës.

Lidhëza të përngjitura në Fjalorin e 2006-ës:

Andaj, anipse, apo, asgjëmangut, derisa, domethënë, gjersa, gjithasaherë, jomë, josemë, kurse, megjithatë, megjithëkëtë, megjithëqë, megjithëse, meqenëqë, meqenëse, meqë,

⁹⁶ Shënim: Te parafjalët e përngjitura nuk kemi përfshirë ato që kanë ardhur me konversion prej ndajfoljesh të përngjitura, por vetëm ato fjalë që në Fjalor dalin mirëfilli si parafjalë.

mësa, mirëpo, ndërsa, ndo, ndonëse, nëse, ngaqë, ngase, paçka, pasi, përderisa, përveçqë, përveçse, porse, porsì, posaqë, posi, posikur, prandaj, qëkurse, sadomos, sadoqë, saqë, sesa, siç, sikundër, sikundërqë, sikundërse, sikur, sikurse, tekqë, teksa, veçse.

IV.1.9 Pjesëza të përngjitura

Përgjithësisht, pjesëzat nuk janë trajtuar si pjesë ligjërata më vete nëpër gramatika të shqipes. Ato, ose nuk janë përmendur fare, ose kanë qenë të shpërndara nëpër pjesë të tjera të ligjëratës, si te ndajfoljet, te lidhëzat ose te pasthirrmat. Edhe në rastet kur janë trajtuar si pjesë ligjërata, pra si kategori leksiko-gramatikore më vete, kur flitet për strukturën e për formimin e tyre, nuk përmenden pjesëzat e formuara me përngjitje. Kështu, Sh.Demiraj i trajton pjesëzat si kategori leksiko-gramatikore më vete, por, nga pikëpamja e prejardhjes, flet vetëm për pjesëza *që kanë dalë prej kategorish të ndryshme leksiko-gramatikore, si prej foljesh, prej ndajfoljesh, prej parafrjalësh, prej lidhëzash etj.*⁹⁷ Në Gramatikën e gjuhës shqipe I, kur flitet për strukturën e pjesëzave, dallohen mes pjesëzave të thjeshta e lokucione edhe pjesëzat e përngjitura.

Numri i pjesëzave të përngjitura është mjaft i kufizuar. Në Fjalorin e 2006-s kemi gjetur vetëm 6 të tilla: *Çne, pale, përkundër, sidomos, sidoqoftë, thujse*. Ato janë formuar nga leksikalizimi i pjesëve përbërëse të një grupi fjalësh në procesin e përdorimit të gjatë e të vazhdueshëm pranë njëra-tjetrës. Analogjia nuk vepron në këtë pjesë ligjërata. Në gramatika të ndryshme, por edhe në ndonjë studim (*Shih: E.Angoni, Pjesëzat, në Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, 1972 : 314*), si pjesëza të përngjitura janë trajtuar edhe fjalët *kushedi* e *pothujse*.⁹⁸ Në Fjalorin e 2006-ës këto fjalë dalin fillimisht si ndajfolje, por mund të përdoren edhe si pjesëza, që do të thotë se kanë ardhur me konversion prej ndajfoljeve. Edhe Çabej fjalën *pothujse* e

⁹⁷ Sh.Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, 1967 : 273-274.

⁹⁸ Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 415 dhe E.Angoni, *Pjesëzat në Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme*, 1972 :

trajton si *adverb*, një nga ato fjalë që kanë dalë prej një fjalie.⁹⁹

IV.1.10 Pashirrma të përngjitura

Pashirrat e përngjitura janë formuar si rezultat i përdorimit të vazhdueshëm e për një kohë të gjatë pranë njëra-tjetrës të pjesëve përbërëse të një togu fjalësh. Ka prej tyre formime të hershme (*faqemender*, *hajmedet*, *vajmedet*, *tumirëmbeç*, *tungjatjeta* etj.), por edhe të mëvonshme (*gatitu*, *prapakthehu* etj.).

Në grupin e pashirrmave të përngjitura, përveç atyre që janë formuar nga njëfjalëzime fjalësh, me përngjitje të gjymtyrëve të një fjalie, të plotë a mungesore, për shkak të përdorimit të gjatë e të vazhdueshëm si formula stereotipe urimi a përsëritjeje¹⁰⁰ dhe që përbëjnë shumicën, ka edhe disa pashirrma që përdoren të përsëritura dhe që, në disa raste, kjo përsëritje është përfutur nga përngjitja (*obobo*, *ububu*). Në Fjalorin e 2006-ës gjejmë edhe pashirrat *kuku* e *pupu*, të cilat i hasim edhe në fjalorët e mëparshëm. Sipas Buxhelit, këto formime dallohen nga pashirrat e përngjitura, si një tip i veçantë formimi me përsëritje.¹⁰¹ Ndërsa në Gramatikën e gjuhës shqipe I, merren si pashirrma të përngjitura edhe ato që përbëhen nga një tingull zanor ose që përbëhen nga dy a më shumë tinguj, siç mund të jetë rasti i mësipërm.

Pashirrma të përngjitura në Fjalorin e 2006-ës:

Faleminderit, *falëmeshëndet*, *faqemender*, *gatitu*, *hajmedet*, *kuku*, *mirëdita*, *mirëmbrëma*, *mirëmëngjes(i)*, *mirësevjen*, *mirupafshim*, *mirupjekshim*, *obobo*, *oburrani*, *prapakthehu*, *pupu*, *tumirëmbeç*, *tungjatjeta*, *ububu*, *vajmedet*.

⁹⁹ E.Çabej, *Studime gjuhësore II*, Prishtinë, 1976 : 46.

¹⁰⁰ Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 431.

¹⁰¹ L.Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009 : 283.

IV.2 Përbërësit e fjalëve të përngjitura

Veçoritë e fjalëve të përngjitura përcaktohen më qartë dhe dalin më në pah pas një analize të strukturës formale të tyre, të lidhjeve fjalëformuese dhe të analizës së strukturës semantike. Analiza e secilit prej këtyre aspekteve nuk mund të bëhet krejt e shkëputur nga njëri-tjetri, prandaj mund të ndodhë që, gjatë analizës së një aspekti, të duhet ndërhyrja analizuese e aspektit tjetër.

Nga pikëpamja strukturore fjalët e përngjitura përgjithësisht përbëhen nga dy ose më shumë morfema rrënjore. Ka fjalë të përngjitura që, përveç morfemave rrënjore, mund të përbëhen edhe nga morfema ndajshtesore formëformuese, siç mund të jetë mbaresa e rrjedhorjes së pashquar (para+dit+e). Këto morfema rrënjore, nga pikëpamja leksikore trajtohen si fjalë. Kështu, një fjalë e përngjitur mund të ketë në përbërje të saj:

- a) vetëm fjalë kuptimplota
- b) fjalë kuptimplota dhe fjalë jokuptimplota
- c) vetëm fjalë jokuptimplota.

Lloji dhe natyra e këtyre përbërësve varet edhe nga pjesa e ligjëratës, së cilës i përket fjala e përngjitur. Në strukturën e fjalëve të përngjitura bëjnë pjesë fjalë që u përkasin të gjitha pjesëve të ligjëratës. Këta përbërës e ruajnë rendin që kanë pasur kur ishin në gjendje të lirë, pra kur kishin formën e një grupi fjalësh. Gjithashtu, kur bëhen pjesë e një fjale të përngjitur, e humbasin kuptimin e tyre fillestar si fjalë të veçanta të pavarura dhe, në trup të fjalës së përngjitur, ngurosen, duke i dhënë kështu fjalës së re të krijuar nga përngjitja e tyre jo vetëm një kuptim të ri leksikor, por edhe kuptim të ri morfologjik.

Në varësi të pjesës së ligjëratës që krijohet prej përngjitjes, përbërësit strukturorë të fjalëve të përngjitura janë të ndryshëm në pjesë të ndryshme të ligjëratës. Edhe brenda një

pjesë ligjërate, fjalët e përngjitura kanë në përbërje të tyre elemente të ndryshme strukturore.

IV.2.1 Përbërësit e emrave të përngjitur

Në strukturën e emrave të përngjitur në gjuhën shqipe, nisur nga kategoria leksiko-gramatikore, marrin pjesë këta përbërës¹⁰²:

- emër + emër (*bukëvale, gurkali, punëdore, valëbuke etj.*)

Në këto struktura, përbërësi i parë është *emër i pashquar*, kurse përbërësi i dytë është, përngjithësisht, *emër në rrjedhore të pashquar njëjës* (*bukë-val-e*).¹⁰³

Në këtë tip hyn edhe emri *togfjalësh* që përbëhet nga një *emër i pashquar* + *emër në rrjedhore të pashquar shumës*.

Gjithashtu në tipin strukturor të fjalëve të përngjitura *emër + emër* mund të përfshihet edhe emri *zomotër* (vajza e kunatit në lidhje me nusen e shtëpisë)¹⁰⁴, ku kemi

¹⁰² Për përcaktimin e përbërësve të fjalëve të përngjitura, në këtë rast të emrave të përngjitur, kemi marrë për bazë vetëm emrat e përngjitur që kemi vjelë nga Fjalori i 2006-ës. Këtu nuk përfshihen p.sh., emra të përngjitur që kanë në përbërje të tyre një emër antroponimik.

¹⁰³ Disa emra të tipit strukturor emër + emër, në Fjalorin e 2006-ës kanë këtë përbërje grafike: *fendëdosë, fendujkë, lulegojë, nuselalë, panxharsheqer, rrushqyqe, vajgur*, ndërkohë që këta emra i gjejmë edhe në trajtat e tyre më të hershme: *fundujke, fëndëdose* (në Fjalorin dialektor të P.Tases *fendë-dose*, 2006 : 82), *lulegoje* (në Fjalorin dialektor të P.Tases, *lule-goje* 2006 : 126), *nuselale, panxharsheqeri, rrushiqyqes* (që për nga struktura është *emër i pashquar + emër në gjinore*), *vajguri* etj. Në këto trajta këta emra shihen si të përngjitur të tipit *emër i pashquar + emër në rrjedhore*, në një rast edhe *emër i pashquar + emër në gjinore*. Këta lloj emrash përdoren me të njëjtën trajtë si në njëjës in e pashquar (në gjithë rasat), ashtu edhe në emërore të shquar njëjës, gjë që është e paprunueshme për strukturën morfologjike të shqipes (Shih edhe Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 76). Për këtë arsye, këta emra janë prirur ta humbasin mbaresën e rrjedhore, përkatësisht *e* dhe *i* dhe mbaresën e gjinore së shquar *-es*, të cilat e kanë humbur funksionin e tyre gramatikor. Duke e humbur këtë mbaresë këta emra mund të trajtohen edhe si emra të përbërë, pra, në këtë rast, mund të kemi një kalim të përngjitjes në kompozim. Në tipin strukturor të fjalëve të përngjitura *emër + emër* nuk kemi përmendur fjalën *luledielli*, që përgjithësisht trajtohet si e përngjitur, sepse në Fjalorin e 2006-ës del vetëm në formën e lokucionit *lule dielli*.

¹⁰⁴ Fjalor i gjuhës shqipe, 2006 : 1235.

një ndryshim fonetik, rënien e rrokjes së dytë ose fundore të përbërësit të parë, si edhe emrat *drekëherë*, *vapëherë* dhe *zëmërherë*, që kanë si përbërës të dytë emrin *herë*.

- emër + mbiemër i nyjshëm {(*melekuqe*, *mollatartë*¹⁰⁵, *nusebukur*, *udhembarë(a)*}
- mbiemër i panyjshëm + emër (*shëmëhill*, *shëmitër*, *shënëndre*)

Në këto ndërtime përbërësi i parë i fjalës së përngjitur është fjala *shën* (*shë*, *shënë*), që historikisht lidhet me mbiemrin *shën*. Me këtë mbiemër formohen disa emra të përngjitur toponimikë, por edhe emra të përngjitur të përgjithshëm, që shënojnë muaj të vitit. Në përbërje të fjalës së përngjitur ky mbiemër mund të pësojë edhe ndryshime fonetike.

- mbiemër + mbiemër (*bardhëkuqe*). Të dy mbiemrat që janë pjesë përbërëse e kësaj strukture, janë mbiemra të nyjshëm që, duke u përngjitur, kanë pësuar ndryshime fonetike, rënien e nyjës së përparme.

- përemër + emër (*gjithëfuqi*, *imzot*)

Një pjesë e emrave të përngjitur kanë kuptim dëshiror. Këta emra kanë në strukturën e tyre ose një folje në dëshirore ose janë formuar nga përngjitja e fjalive dëshirore. Këta të fundit nuk përmbajnë në strukturë ndonjë folje në dëshirore, por kuptimi dëshiror shprehet nëpërmjet intonacionit dhe mjeteve të tjera sintaksore.

Emrat e përngjitur që kanë në strukturën e tyre një folje në dëshirore, janë formuar (përveç foljes) nga këta përbërës:

- emër + folje në dëshirore (*ndjesëpastë(i)*)
- folje në dëshirore + ndajfolje ose ndajfolje + folje në dëshirore [*qoftëlarg(u)*, *ndeshetrashë(a)*, *largqoftë(i)*]

Emrat e përngjitur që janë formuar si rezultat i përngjitjes dhe i substantivimit të *fjalive dëshirore eliptike*¹⁰⁶, përbëhen nga:

¹⁰⁵ Emri i përngjitur *mollatartë* ka ardhur nga përkthimi fjalë për fjalë nga italishtja i fjalës *pomodoro*.

- emër + ndajfolje (*kryeshëndoshë*)
- parafjalë + ndajfolje *{(largkëtej(i))}*
- parafjalë + përemër në rrjedhore *{(largnesh(i))}*

Duke u nisur nga struktura formale, ka edhe disa emra të përngjitur që janë formuar nga përngjitja e fjalive urdhërore. Fjalët e krijuara në këtë mënyrë si në shqipe ashtu edhe në gjuhë të tjera quhen kompozita urdhërore ose imperative. Në shqipe kompozitat urdhërore janë vetëm fjalë të përngjitura.

Përbërësit e këtyre emrave janë:

- folje në urdhërore + emër, që del në trajtën e një thirrori (*hajujk, ruajnazot*)
- folje në urdhërore + emër në kallëzore (*hamendje, tundubishje, theribujkë, therimi, therpelë, thithëlopë, vëmendje*)
- folje në urdhërore + emër (thirror) + emër në kallëzore. Në këtë rast kemi një ndërthurje të përbërësve të emrave të përngjitur të dy rasteve të para, ku e përbashkët është folja në urdhërore (*shtojzovalle, shtojzorreshtat*), pra këta emra të përngjitur përbëhen nga tri elemente, edhe pse janë dygjymtyrësh. Këtu kanë ndodhur edhe ndryshime fonetike, siç është rënia e *-t-së* te përbërësi i dytë *-zot-*.
- folje në urdhërore + zanoren lidhëse *e* + folje në urdhërore (*deleduk, digjepiq, ecejak, çapejak, hiqepiq*). Në këto ndërtime, dy foljet në urdhërore janë gjymtyrë homogjene që lidhen mes tyre me anë të zanores lidhëse *e*.

Emrat e përngjitur mund të përbëhen edhe nga:

- ndajfolje + emër (*plotfuqi*)

¹⁰⁶ A. Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, 1972 : 168.

- folje + ndajfolje (*lamtumirë*)¹⁰⁷
- parafjalë + emër

Në këtë tip strukturor përbërësi i dytë i fjalës së përngjitur, që është një emër, mund të jetë:

- në rasën kallëzore; në këtë rast përbërësit e fjalës së përngjitur do të jenë:
parafjalë + emër në kallëzore të pashquar

Parafjalët që përbëjnë këtë nëntip strukturor janë: *mbi* (mbibisht, mbipetk etj.), *më* (mëkresë, mëngojë etj.), *nën* (nënbarkëz, nëndore etj.), *pa* (padije, pafuqi etj.) dhe *për* (përshitës, përmjet etj.).

- në rasën rrjedhore; përbërësit do të jenë:

parafjalë + emër në rrjedhore të pashquar

Parafjalët që përbëjnë këtë nëntip strukturor janë: *para* (paradite, paradreke etj.), *pas* (pasdite, pasqafe etj.).

- pjesëz + emër (*donkishot, donzhuan, tambël, tëbutë, tëlyen, tëmbël*).

Në këto ndërtime përbërësi i parë i fjalës së përngjitur është:

- pjesëza *don*, që përdoret në disa mbiemrave të përveçëm të huaj.

- pjesëza *të*, që është pjesë e një pjesoreje të emëruar (*tëlyen*), pra e një emri asnjës.

Elementin *të*- Xhuvani-Çabej fillimisht e marrin si parashtesë me funksion të paqartë, ku përfshijnë edhe emrat *tambël* dhe *tëmbël*. Më pas shpjegojnë se kjo parashtesë ka pasur funksion intensiv, pastaj ka kaluar në formim fjalësh me analogji. Ky formant,

¹⁰⁷ A.Dodi e shpjegon fjalën *lamtumirë* si të përngjitur prej foljes *lamë* (trajtë dialektore e foljes *lë*, në të tashmen, veta I shumë) me fjalën *tumirë* që, në këtë rast, është përdorur si ndajfolje në kuptimin *shëndoshë e mirë, mirë e bukur*. (A.Dodi, Fjala *lamtumirë*, përdorimi dhe formimi i saj, në Gjuha jonë, 1985/3 : 98-99. Vetë fjalën *tumirë*, Xhuvani – Çabej e shpjegojnë të formuar prej fjalës *mirë* me parashtesën *tu-*, që është një variant i parashtesës të-. (Xhuvani-Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, në A.Xhuvani, Vepra I, 1980 : 411.

sidomos tek emra e mbiemra nuk është gjë tjetër tjetër veçse nyja e parme, që i është përngjitur fjalës ndjekëse dhe është shkrirë e është bërë njësh me të¹⁰⁸.

Emrat e përngjitur mund të kenë në strukturën e tyre edhe tre përbërës:

- emër i pashquar + parafjalë + emër (*brezëmbrek*), ku parafjala *më* ka pësuar ndryshime fonetike duke u shkrirë me emrin që e ndjek dhe që është në rasën kallëzore.
- përemër + emër + emër (*sanataditë*)
- numëror + emër + emër (*shtatëpëllëmbëmjekër*)

Një prej tri elementeve përbërëse të fjalëve të përngjitura mund të jetë edhe zanorja lidhëse *-e*¹⁰⁹, të cilën e hasëm më parë në strukturat e përngjitura, të përbëra prej dy foljesh në urdhërore.

- emër + zanore lidhëse *e* + emër (*farefis, gjëgjëzë*)
- folje + zanore lidhëse *e* + folje (*thashethem, kashelashë*).

Në këto ndërtime foljet mund të jenë të dyja në dëftore (*thashethem*), ose t'u përkasin kohëve të së shkuarës (*kashelashë*).

- numëror + zanore lidhëse *e* + numëror (*njënjëzë, njëzenjëzë*)
- Rrallë ndodh që emrat e përngjitur të përftohen nga përsëritja e të njëjtit emër, si: *motmot*.

¹⁰⁸ A.Xhuvani – E.Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, në A.Xhuvani, *Vepra I*, 1980 : 409-410.

Edhe F.Agalliu emrat e tipit *tëmbël* e *tlyen* i merr si formime me përngjitje ku është ruajtur nyja, sepse në përbërje të fjalëve të përngjitura hyjnë edhe fjalë shërbyese, si edhe ruhen format e fjalëve ashtu si janë në lidhjet sintagmatike nga kanë dalë (F.Agalliu, *Sinkroni apo diakroni*, në *Çëshje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, 1988 : 94.).

¹⁰⁹ Sipas Kostallarit, do të ishte më e drejtë që në kompozitat këpujore të tipit *ecejak, çapejak* etj., por edhe të tipave të tjerë të ngjashëm këpujorë (*thashetheme, farefis*) të flitej jo më për *lidhëzën e*, por për *zanoren lidhëse e*, e cila kryen funksione të njëjta me ato zanore lidhëse në fjalët e përbëra dhe ndryshon prej tyre vetëm sepse bashkëlidhet gjenetiksht me lidhëzën homonime *e* dhe jo me ndonjë zanore tematike. (A.Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, në *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, 1972 : 182.

- Disa emra të përngjitur janë formuar nga emërzime formash të përngjitura onomatopeike (*çakaçuke, gërgëre, kukamë, kukumjaçkë, kukuvajkë, kukuvriq*¹¹⁰, *ninananë, rraketake, taketuke, tiktak.*).

IV.2.2 Përbërësit e mbiemrave të përngjitur

Duke qenë se mbiemrat e përngjitur janë të paktë, në strukturën e tyre nuk dallohen shumë përbërës. Ata janë:

- emër + emër në rrjedhore

Në këtë tip strukturor kemi gjetur vetëm mbiemrin *ngjyrëvishnje*. Për nga struktura, ky mbiemër është i ngjashëm me mbiemrat e përbërë që kanë si element të parë përbërës emrin *ngjyrë* (*ngjyrëportokall, ngjyrëvjollcë etj.*). Por në këto struktura, elementi i dytë është një *emër me përdorim mbiemëror* dhe përbërësit e tyre do të ishin *emër + mbiemër*. Nëse mbiemri *ngjyrëvishnje* do të ndiqte modelin e formimit të mbiemrave të tjerë, atëherë, nga pikëpamja drejtshkrimore, do të kishim *ngjyrëvishnjë*, ku forma *vishnjë* mund të përdoret edhe si mbiemër, ndërkohë që forma *vishnje* përdoret vetëm si emër.

Në këtë tip Buxheli përfshin edhe mbiemra të tillë si *gushëpëllumbi* ose *gushëgjeraqine*. Në Fjalorin e 2006-ës këta mbiemra paraqiten pa mbaresën e ngurosor të rrjedhores, gjë që tregon se kanë kaluar drejt përbërjes, ku elementi i dytë *pëllumb* dhe *gjeraqinë* mund të përdoren edhe si mbiemra.¹¹¹

- folje + lidhëz + folje (*foleqesh*)
- mbiemër + lidhëz + mbiemër (*kuqezi*).

¹¹⁰ Xhuvani –Çabej (Po aty, 381) flasin për ekzistencën e parashtesës *kuku-*, si një formë e përsëritur e parashtesës *ku-*, në fjalë si; *kukumare* (mare), *kukulafshë* (lafshë) etj. Por në formimin e fjalëve *kukuvajë* e *kukumaçe* që me trajta të ndryshme gjenden edhe në gjuhë të tjera të Ballkanit e në dialektet italiane, mendojnë se ka ndikuar thirrma “*kuku*”. Prandaj, mund të mendojmë se fjalët e mësipërme janë emërzime formash të përngjitura onomatopeike.

¹¹¹ Shih: L.Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009 : 153-155.

Mbiemrat e përngjitur janë gjithmonë të panyjshëm, sepse edhe përbërësit e tyre, edhe në qofshin të dy të nyjshëmë kur marrin pjesë në strukturën e fjalës së përngjitur, përdoren pa nyjën e përparme.

- pjesëz + folje {*mosmëharro (mosharro), mosmëprek (mosprek)*}.
- parafjalë + emër në rrjedhore të pashquar shumës.

Në këtë tip kemi ndeshur vetëm mbiemrin *ndërhundsh*. Te ky mbiemër dallohet qartë mbareza *-sh* e rrjedhore, e cila, në disa struktura të tjera të tipit *numëror/përemër i pacaktuar + emër në rrjedhore të pashquar shumës*, që kanë kaluar nga përngjitja në përbërje, është interpretuar si prapashtesë fjalëformuese (*dyngjyrësh, disamuajsh etj.*). Mbiemrat e formuar në këtë mënyrë, pra me prapashtesën fjalëformuese *-sh*, shërbejnë si model formimi, ndërkohë që tipi strukturor *parafjalë + emër në rrjedhore të pashquar shumës*, nuk përbën ndonjë tip të hapur formimi për mbiemra të tjerë.

- parafjalë + emër në rrjedhore të shquar njëjës (*majëkrahut*)

IV.2.3 Përbërësit e numërorëve të përngjitur

Numërorët e përngjitur kanë të njëjtët përbërës strukturorë:

- numëror + parafjalë + numëror (*njëmbëdhjetë etj.*).

Te numërorët e përngjitur përbërësi i dytë është gjithmonë numërori *dhjetë*, kurse parafjala *mbë* është një variant i parafjalës *mbi*.

IV.2.4 Përbërësit e përemrave të përngjitur

Struktura e përemrave të përngjitur përbëhet nga këto elemente:

- emër + emër (*farëgjëje, farësendi, gjëkafshë, gjësendi etj.*)

Përbërësi i dytë që është një emër, përgjithësisht është në rasën rrjedhore.

- përemër + emër (*çfarë, njëfarë, gjithfarë etj.*)

Në këtë tip strukturor përemri, që është përbërësi i parë i fjalës së përngjitur, mund të jetë *pyetës* (*çfarë*) ose *i pacaktuar* (*njëfarë, gjithfarë*).

Zakonisht, kur përemrat e përngjitur kanë përbërës një përemër, ky mund të jetë *pyetës* ose *i pacaktuar*.

- ndajfolje + emër (*kurr gjë*)
- lidhëz + emër (*asgjë, asnjëri etj.*)
- përemër + përemër (*çdokush, gjithçka, gjithsecili etj.*)
- përemër + folje (*cilido, çdo, kushdo etj.*)
- folje + përemër (*diçka, dikush, disa etj.*)

Në tipat strukturorë ku si përbërës i parë ose i dytë është një folje dhe tjetri përemër, ky i fundit mund të jetë *pyetës* ose *i pacaktuar*, kurse folja është ngurosur.

- ndajfolje + përemër (*kurrkush*)
- lidhëz + përemër (*askush, asnjë, asnjëri, secili etj.*)

Edhe në këtë tip strukturor përemri, që është përbërësi i dytë i fjalës së përngjitur, mund të jetë *pyetës* ose *i pacaktuar*.

- përemër + pjesëz (*çmos*)
- lidhëz + folje (*ndo*)

Në më të shumtën e rasteve, një nga elementet përbërëse të përemrave të përngjitur është përemër.

Përgjithësisht, te përemrat e përngjitur një nga përbërësit ruan treguesin eptimor, i cili bëhet pjesë e gjithë fjalës së përngjitur. Këta lloj përemrash janë të lakueshëm. Të tjerët janë të palakueshëm. Një pjesë e vogël e tyre lakohen jo sipas përbërësve (*diçka*).

IV.2.5 Përbërësit e foljeve të përngjitura

Përgjithësisht, te foljet e përngjitura një prej përbërësve është fjalë emërtuese. Foljet e përngjitura përbëhen nga këto elemente:

- folje + emër (*bëzaj, ngarend, vërej, shtozoj*).

Në këto struktura folja mund të jetë në të tashmen, shoqëruar me ndryshime fonetike, ose në urdhërore (*shtozoj*).

Sipas Çabejt, foljet *bëzaj, ngarend* e *vërej* kanë dalë nga univërbimi i lidhjes *folje + emër*. Në një vështrim më të gjerë, ato janë formuar në ngërthim të fjalisë.¹¹²

- parafjalë + emër

Në këtë tip strukturor përbërësi i dytë i fjalës së përngjitur, që është një emër, mund të jetë:

- në rasën kallëzore
- në rasën rrjedhore

Foljet që kanë si element përbërës një emër në rasën kallëzore përbëjnë edhe numrin më të madh të foljeve të përngjitura. Parafjalët më të përdorshme të rasës kallëzore, që shërbejnë si përbërës i parë i foljeve të përngjitura, janë:

- më (*mbudh, mbuz, mëkëmb* etj.)
- në (*ndorem, ngush* etj.)

¹¹² E.Çabej, *Studime gjuhësore II*, Prishtinë 1976 : 304.

- nëpër (*nëpërkëmb*)
- ndër (*ndërsy*)
- për (*përfytem, përkëmb, përkrah* etj.)

Të vetmet parafjalë që përdoren në rasën rrjedhore janë *më* dhe *për* në foljet e përngjitura *mësysh* dhe *përsysh*. Në këto raste dallohet qartë tek përbërësi i dytë mbaresa *-sh* e rrjedhores.

- parafjalë + numëror (*përdyt*)

Ky tip strukturor është shumë i rrallë.

- parafjalë + ndajfolje (*përshtëndosh*)
- folja *përsëdyt* duket se është formuar nga përngjitja e lokucionit ndajfoljor *për së dyti* duke marrë kështu vlerën e një fjale të vetme, të një foljeje të përngjitur.¹¹³
- Disa folje të përngjitura janë formuar nga foljëzime formash të përngjitura onomatopeike (*bërbëlit, përshpërit* etj.).

tukeq

IV.2.6 Përbërësit e ndajfoljeve të përngjitura

Në pjesën më të madhe, një nga përbërësit e ndajfoljeve të përngjitura është përemër. Ndajfoljet mund të grupohen edhe sipas një përbërësi që është i përbashkët për disa prej tyre. Kështu, ka ndajfolje që kanë të përbashkët përemrin e pacaktuar *gjithë, një* etj., ose emrin *herë* apo foljen *do* etj. Sipas elementeve përbërëse, dallohen disa tipa strukturorë ndajfoljesh të përngjitura.

¹¹³ Për foljen *mëkeq* studiuesja L.Buxheli mendon se nuk është formimi me përngjitje i tipit *mëkëmb*, por një formim me konversion nga ndajfolja *më keq* në shkallën krahasore (L.Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009 : 199).

Një tip strukturor e përbëjnë ndajfoljet që kanë si përbërës të parë një *përemër*, kurse si përbërës të dytë mund të kenë një emër, një ndajfolje përemërore a një pjesë tjetër të ligjëratës. Përemri mund të jetë *përemër i pacaktuar* ose *përemër dëftor*. Përemrat e pacaktuar që marrin pjesë në këto struktura janë: *gjithë, një, njëfarë, tjetër, tërë, ca*. Me përemrin e pacaktuar *gjithë* si përbërës të parë të ndajfoljeve të përngjitura, ndërtohen këto struktura:

- përemri i pacaktuar **gjithë** + emër në rasën kallëzore (*gjithherë, gjithmonë*)
- përemri i pacaktuar **gjithë** + përemër i pacaktuar (*gjithnjë, gjithsej*)
- përemri i pacaktuar **gjithë** + ndajfolje (*gjithandej, gjithashtu, gjithkah*)
- përemri i pacaktuar **gjithë** + sintagmë parafjalore (*gjithnduer, gjithnduersh*)

Me përemrin e pacaktuar **një** si përbërës të parë të ndajfoljeve të përngjitura, ndërtohen këto struktura:

- përemri i pacaktuar **një** + emër (*njëherë, njëmendthi, njëzëri*)
- përemri i pacaktuar **një** + përemër i pacaktuar (*njëlloj, njësoj*)
- përemri i pacaktuar **një** + ndajfolje (*njëtash*)

Me përemrin e pacaktuar **njëfarë** si përbërës të parë të ndajfoljeve të përngjitura, ndërtohen këto struktura:

- përemri i pacaktuar **njëfarë** + përemër i pacaktuar (*njëfarëlloj, njëfarësoj*)

Me përemrin e pacaktuar **ca** si përbërës të parë të ndajfoljeve të përngjitura, ndërtohen këto struktura:

- përemri i pacaktuar **ca** + emër (*caherë*)

- përemri i pacaktuar **ca** + përemër i pacaktuar (*capak*)

Me përemrin e pacaktuar **tjetër** si përbërës të parë të ndajfoljeve të përngjitura, ndërtohen këto struktura:

- përemri i pacaktuar **tjetër** + ndajfolje (*tjetërkah, tjetërkund, tjetërmendas, tjetërpardje, tjetërpasnesër, tjetërparvjet, tjetërqysh*)

Me përemrin e pacaktuar **tërë** si përbërës të parë të ndajfoljeve të përngjitura, ndërtohet kjo strukturë:

- përemri i pacaktuar **tërë** + përemër i pacaktuar (*tërësej*)

Kur përbërësi i parë i ndajfoljes së përngjitur është përemri dëftor **ai** ose **ky**, strukturat do të jenë:

- përemër dëftor (ai, ky) në rasën rrjedhore + emër (*asajane, asohere, asokohe, kësodore*)
- përemër dëftor (ai, ky) në rasën kallëzore + emër (*atëbotë, atëherë, atëkohë, kësisoj*)

Një tip strukturor përbëjnë edhe ndajfoljet e përngjitura që kanë si përbërës të përbashkët të strukturave të tyre foljen **do**, e cila del në formë të ngurosur. Në këto raste përbërësi i përbashkët **do** është element i dytë i ndajfoljes së përngjitur, kurse si element i parë është një nga ndajfoljet përemërore: *kur, ku, nga, sa, si, tek*¹¹⁴. Kështu struktura e këtyre ndajfoljeve do të ishte:

¹¹⁴ Sh.Sinani, në monografinë “Ndajfoljet përemërore në gjuhën shqipe”, këto ndajfolje i cilëson si ndajfolje të përngjitura me gjedhe njëfjalësimi një fjali pohore kryesore mungesore (pa kryefjalë) plus një

- ndajfolje përemërore + folja **do** (*kurdo, kudo, ngado, sido, sado, tekdo*)

Po në këtë tip hyjnë edhe ndajfoljet e përngjitura që kanë si përbërës të përbashkët foljen **di** në formën pyetëse të vetës së parë njëjës.¹¹⁵ Në këtë rast, folja është element i parë, kurse element i dytë është një ndajfolje përemërore.

- folja **di** + ndajfolje përemërore (*diku, dikur, disi*)

Ndajfolje të përngjitura që kanë si përbërës të përbashkët emrin **herë**, i cili del në formë të ngurosur. Në këto struktura emri *herë* është element i dytë i fjalës së përngjitur, kurse si element i parë mund të jetë një *parafjalë*, një *ndajfolje*, një *përemër*, një *folje* ose një *pjesëz*.

- parafjalë + emri **herë** (*ngaherë, përherë*)
- ndajfolje + emri **herë** (*rrallëherë, shpeshherë, kurdoherë*)
- përemër + emri **herë** (*atëherë, ndonjëherë, njëherë*). Përemri që merr pjesë në ndërtimin e këtyre strukturave mund të jetë dëftor ose i pacaktuar.
- folje + emri **herë** (*kaherë*)

Në ndonjë rast emri **herë** del si përbërës i parë i ndajfoljes së përngjitur:

- emri **herë** + folja **do** + ndajfolje përemërore (*herëdokur*)

Një tip tjetër strukturor e përbëjnë ndajfoljet e përngjitura që kanë si përbërës të përbashkët ndajfoljen përemëror **kund** dhe **kundi**¹¹⁶. Ndajfolja *kund* (*kundi*) del si

fjali të nënrenditur rrethore, formimi i të cilave ndjek të njëjtën rrugë si përemrat *kushdo, cilido*. (Tiranë 203 : 173).

¹¹⁵ Shih: E.Çabej, *Studime gjuhësore I*, Prishtinë 1976 : 125.

Edhe këto ndajfolje (që kanë si pjesë përbërëse foljen *di*), Sh.Sinani i cilëson si ndajfolje të përngjitura me strukturë fjalie të formuara prej një fjalie pohore kryesore pa kryefjalë ose me kryefjalë të munguar, plus një fjali pyetëse të nënrenditur mungesore. (Po aty.).

¹¹⁶ Në formë të thjeshtë, *kund(i)*, kjo ndajfolje del vetëm në gegërisht, ndërsa në formë të përngjitur del në mbarë gjuhën. Çabej shpjegon se kjo ndajfolje është formë e ndajfoljes *ku*, me *d* fundore sekundare, zhvilluar me rrugë thjesht fonetike (E.Çabej, *Studime gjuhësore I*, Prishtinë 1976 : 299).

element i dytë i përngjitjes, kurse si element i parë mund të jetë një *përemër*, një *ndajfolje* apo një *pjesëz*.

- përemër + ndajfolja përemërore **kund** (kundi) { *gjëkundi, tjetërkund* }
- ndajfolje + ndajfolja përemërore **kund** (kundi) { *kurrkund, shumëkund* }
- pjesëz + ndajfolja përemërore **kund** (kundi) { *askund* }

Përveç ndajfoljeve të përngjitura që kanë përbërës të përbashkët, ka edhe mjaft tipa të tjerë strukturorë, përbërësit e të cilëve u përkasin pothuajse të gjitha pjesëve të ligjëratës.

- parafjalë + emër

Ky tip përbën numrin më të madh të ndajfoljeve që kanë si përbërës të parë një parafjalë, kurse përbërësi i dytë, emri, është gjithmonë në trajtën e pashquar. Emri mund të jetë në rasën:

- kallëzore
- rrjedhore
- emërore

Kështu, përbërësit strukturë të këtij tipi do të ishin:

- parafjalë + emër në kallëzore (*mbanë, menatë, ndanë, ndërkohë, ndërmjet, nëpërmes, ngrykë, përballë, përbri, përditë, përdhe, përfaqe, përfund, përjetë, përmes, përnatë, përngut, përqark, pranë*).
- parafjalë + emër në rrjedhore (*afërmendsh, parasysh, përfundi, përgjumësh, përmendsh, prore*)¹¹⁷
- parafjalë + emër në emërore (*ngaditë*)

¹¹⁷ Fjalët *paradite, mbasdite, paradarke, paradreke, pasdarke, pasdreke etj.*, që në disa raste përfshihen te ndajfoljet, në Fjalorin e 2006-ës dalin si emra dhe me konversion kalojnë në klasën e ndajfoljeve.

Studiuesja Buxheli vëren edhe një nëntip tjetër strukturor *parafjalë + emër në emërore të shquar (tekefundit, tekembramja)*, ku si përbërës i parë përdoret parafjala *tek*, kurse si përbërës i dytë një mbiemër i emërzuar.

- parafjalë + ndajfolje (*mbasandaj, mëgjunjas, ndërkaq, pardje, parmbrëmë, parvjet, pasnesër, përkarshi, përkëtej, përmatanë, përmbas, përmbipardje, përmbipasnesër, përmbropa, përndryshe, tekëndeje, tekëndeje, teposhtë, etj.*)
- parafjalë + përemër (*paskëtaj, patjetër, përse*)
- Disa ndajfolje të përngjitura formohen mbi bazën e përsëritjes së të njëjtës fjalë ose të fjalëve që kanë kuptim të përafërt (*kryekreje, motmot, tejmatanë*).

Këto ndajfolje mund të formohen edhe mbi bazën e një lokucioni ndajfoljor (*dorëmenjë, paksëpaku, pikësëpari*).

Tipi tjetër strukturor është ai i ndajfoljeve të përngjitura, pjesët përbërëse të të cilave lidhen me anë të një mjeti lidhës, që mund të jetë parafjalë, lidhëz (zanore lidhëse) ose pjesëz. Përbërësit e këtyre strukturave mund të jenë fjalë që përsëriten, por edhe fjalë të tjera.

Kështu, kur mjeti lidhës është **parafjalë**, ndërtohen këto struktura:

- ndajfolje + parafjalë + ndajfolje (*brendapërbrenda, dalëngadalë, drejtpërsëdrejti, plotpërplot, tejpërtej* – këto janë fjalë që përsëriten),
- emër + parafjalë + emër (*anëpëranë, mespërmes*)
- përemër + parafjalë + përemër (*njëmenjë, njëpërnjë*)

Kur mjeti lidhëz është **lidhëz** ose **zanore lidhëse** ndërtohen këto struktura:

- emër + lidhëz + emër (*lesheli*)

- ndajfolje + lidhëz + ndajfolje (*prapëseprapë, tejetej, tejëmbanë, tejëndanë*)
- folje + lidhëz + folje {(*dokudo, dokurdo, dosido* – këto janë fjalë që përsëriten), *çelembyll, nisesos, qiteprit*}.
- emër + lidhëz + ndajfolje (*anekënd, anëmbanë, anëpërqark*)
- ndajfolje + lidhëz + emër (*tejefund*)
- përemër + lidhëz + folje (*kushedi*)

Kur mjeti lidhëz është **pjesëz**, fjalët që përsëriten mund të jenë folje:

- folje + pjesëz + folje (*domosdo*)

Ndajfolje të përngjitura që një prej përbërësve e kanë *lidhëz*. Në këto lloje strukturash, pjesën më të madhe e përbëjnë ndajfoljet që kanë si përbërës të parë lidhëzën **as**, ndërsa si përbërës të dytë kryesisht një ndajfolje, në ndërtime të tilla:

- lidhëz + ndajfolje (*asfare, asgjetiu, asgjëkund(i), askurrë, askurrkah, askurrkund, asndonjëherë, asnjëherë, aspak*). Në këtë nëntip përfshihen edhe ndajfolje *sesi, sivjet, ndokund, ndopak*)
- pjesëz + folje + lidhëz (pothuajse)

Ndajfolje të përngjitura që një prej përbërësve e kanë *pjesëz*. Pjesëzat që marrin pjesë në këto ndërtime janë *ço, mos, që, qysh*.

- pjesëz + ndajfolje (*çoku, moskurrë, mosnjëherë, qëherthi, qëkur(i), qëlashti, qëparë, qëparthi, xheku*). Ndajfoljet mund të jenë vendi dhe kohe.
- ndajfolje + pjesëz (*kahmos, kumos, pakmos, posa, sapo*)
- pjesëz + përeër dhe anasjelltas (*mostjetër, tjetërqysh, çmos*)
- pjesëz + folje (*pothuaj*)

Të tjera:

- ndajfolje + ndajfolje (*këtejpari, këtupari, paksa, sakaq*)
- ndajfolje + emër (saora, veçan)
- emër + ndajfolje (*hë nabrenda, hë najashtë, hë nakeq*)
- përemër (vetvetor) + ndajfolje (*vetvetiu*)
- përemër + parafjalë (*sipër*)¹¹⁸

Për ndajfoljen *tepër*, të cilën nuk e kemi përfshirë në ndonjë tip strukturor, Xhuvani mendon se është formuar me mjetet e brendshme të gjuhës në ngërthim të fjalisë nga përdorimi i neutrit *tepër*, duke e zërthyer fjalën në *t'epër*, duke gjetur pra në të mbiemrin *epër* me *t-*.¹¹⁹ Kështu, krahasimi që Majeri bën për formimin e ndajfoljes *sipër* me formimin e kësaj ndajfoljeje nuk qëndron.

IV.2.7 Përbërësit e parafjalëve të përngjitura

Përbërësit e parafjalëve të përngjitura janë lehtësisht të dallueshëm krahasuar me një pjesë të ndajfoljeve. Një tip strukturor e përbëjnë ato parafjalë që kanë si përbërës parafjalën *për*, e cila mund të jetë përbërës i parë ose i dytë i strukturës së përngjitur. Ky tip përbëhet ka këto elemente:

- parafjalë + parafjalë (*nëpër, përgjatë, përmbi, përpos, përveç*).

Përbërësi i dytë i këtij tipi strukturor mund të jetë i formuar me konversion nga ndajfoljet, si *përgjatë, përpos dhe përveç*.

¹¹⁸ Këtë ndajfolje Majeri dhe Pedersen e shohin si një përngjitje të formës *si-* të dëftorit indoevropian me parafjalën *-për.*, duke e krahasur edhe me ndajfoljen *tepër*. (G.Meyer, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, 2007 : 450 dhe E.Çabej, *Studime gjuhësore II*, Prishtinë 1976 : 110.

¹¹⁹ Shih: E. Çabej, *Studime gjuhësore II*, Prishtinë 1976 : 171.

Fjalët *përveç* dhe *përgjatë* në Fjalorin e 2006-ës dalin fillimisht si parafjalë, prandaj i kemi përfshirë në këtë kategori leksiko-gramatikore. Xhuvani këto parafjalë i trajton si të prejardhura, të formuara me konversion, përkatësisht nga ndajfolja dhe mbiemri.¹²⁰

- parafjalë + emër në kallëzore (*nëpërmjet*).

Fjala *nëpërmjet* përdoret mirëfilli si parafjalë dhe nuk gjen përdorim si ndajfolje. Ndërkohë Xhuvani e trajton si të prejardhur me konversion prej ndajfoljes. Ka të ngjarë që ajo të jetë formuar nga parafjala e thjeshtë *në* + emrin *përmjet* me kuptimin *mes*, që del si zë më vete edhe në fjalor.

- lidhëz + parafjalë (*sipas*).

Edhe këtë strukturë përbërësi i dytë, parafjala, është formuar me konversion prej ndajfoljes.

IV.2.8 Përbërësit e lidhëzave të përngjitura

Përgjithësisht, pjesa më e madhe e lidhëzave të përngjitura një prej përbërësve e kanë lidhëz. Zakonisht lidhëz është përbërësi i dytë, por ka edhe raste kur edhe përbërësi i parë është lidhëz. Pak janë lidhëzat e përngjitura që nuk kanë asnjë prej përbërësve lidhëz. Kur një ose të dy përbërësit e lidhëzave të përngjitura janë lidhëza, formohen këto struktura:

- lidhëz + lidhëz (*kurse, nëse, porsa, porse, porsi sesa, teksa etj.*)

Në këtë tip strukturor një prej përbërësve mund të jetë edhe lidhëz e përngjitur (*sikurse, qëkurse etj.*). Kjo lidhëz e përngjitur mund të jetë element i parë ose i dytë i fjalës së përngjitur.

- parafjalë + lidhëz (*meqë, mësa, ndërsa, ngaqë, tekqë, teksa etj.*)

¹²⁰ A.Xhuvani, Vepra I, 1980 : 328-329.

- pjesëz + lidhëz (*apo, derisa, gjersa*)
- ndajfolje + lidhëz (*mësa, mirëpo, veçse*)
- parafjalë + përemër + lidhëz (*megjithëse, megjithëqë etj.*)
- formë foljore + lidhëz (*meqenëse*)
- lidhëz + përemër (*siç*)
- lidhëz + formë foljore (*ndo*)
- lidhëz + pjesëz (*sadomos*)
- lidhëz + ndajfolje (*sikundër*)
- lidhëz + ndajfolje + lidhëz (*sikundërqë, sikundërse*)

Lidhëzat e përngjitura që nuk kanë asnjë prej përbërësve lidhëz, janë formuar sipas këtyre strukturave:

- parafjalë + përemër i pacaktuar + përemër dëftor (*megjithatë, megjithëkëtë*)
- përemër i pacaktuar + përemër pyetës + emër (*gjithsaherë*)
- pjesëz + ndajfolje (*jomë*)
- pjesëz + pjesëz (*as*)¹²¹
- formë foljore + formë foljore (*domethënë*)
- përemër + ndajfolje (*asgjëmangut*)

¹²¹ Në gramatikat e sotme, lidhëza *as* merret si lidhëz e thjeshtë, por Çabej e sheh si një nga ato fjalë që kanë dalë nga bashkimi i dy pjesëzave në ngërthim të fjalisë, më shumë në fjali pyetëse.

IV.2.9 Përbërësit e pjesëzave të përngjitura

Përgjithësisht, një prej përbërësve të pjesëzave të përngjitura është pjesëz ose lidhëz. Numri i tyre është mjaft i kufizuar, kështu që edhe llojet e strukturave dhe të përbërësve që formojnë ato, janë të kufizuara.

- pjesëz + folje (*pale*)
- folje + lidhëz (*thuajse*)
- ndajfolje + pjesëz (*sidomos*)

Ka ndonjë rast kur asnjë prej përbërësve të pjesëzave të përngjitura nuk është lidhëz apo pjesëz:

- ndajfolje + formë foljore (*sidoqoftë*)
- parafjalë + ndajfolje (*përkundër*)¹²²

IV.2.10 Përbërësit e pasthirmave të përngjitura

Karakteristikë e pasthirmave, ndryshe nga pjesët e tjera të ligjëratës të formuara me përngjitje, është se, përgjithësisht, janë formuar nga njëfjalëzime fjalësh, me *përngjitje të gjymtyrëve të një fjalie*, të plotë a mungesore. Në shumë raste këto pasthirma kanë pësuar edhe ndryshime fonetike. Këto dalin më në pah te tipi strukturor me përbërës:

- mbiemër + emër (*mirëdita, mirëmbërëma, mirëmëngjes*).

¹²² E.Angoni që është marrë me studimin e pjesëzave, trajton si pjesëz të përngjitur edhe pjesëzën *nja*, të formuar prej numërorit *një* e lidhëzës *a* (E.Angoni, *Pjesëzat*, në Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, 1972 : 314), por në Gramatikën e gjuhës shqipe I 2002 : 414, kjo pjesëz trajtohet si e thjeshtë nga pikëpamja e gjuhës së sotme, kurse etimologjikisht nuk është e tillë.

Në këtë tip, përbërësi i parë i fjalës së përngjitur është një mbiemër i nyjshëm, por që, pas procesit të leksikalizimit, kjo nyjë ka rënë. Këto lloj pasthirmash të përngjitura përdoren në fjali si formula stereotipe përshëndetjeje.

Një tip strukturor më vete e përbëjnë pasthirrat:

- që kanë dalë nga përngjitja e një fjalie të paplotë, njëkryegjymtyrëshe, me kryegjymtyrë një folje (*faleminderit, falëmeshëndet, mirësevjen, mirupafshim, mirupjekshim, tumirëmbec*). Në disa nga këto pasthirra folja shfaqet në formë dëshirore.
- E vetmja pasthirmë që ka dalë nga përngjitja e një fjalie të plotë me dy gjymtyrë kryesore, është *tungjatjeta*, e cila, duke pasur strukturë të ndryshme nga të tjerat, mund të përbëjë një tip më vete.
- Tip strukturor i veçantë është ai që është formuar nga përsëritja e dy pasthirmave të njëjta ose e dy pasthirmave të ndryshme (*hajmedet, obobo, oburrani, ububu, pupu, kuku, vajmedet*¹²³).
- Pasthirrat *gatitu* dhe *prapakthehu* janë krijuar relativisht vonë. E para përbëhet prej ndajfoljes *gati* dhe pjesëzës thirrmore *këtu*¹²⁴, që shoqërohet me rënie të rrokjes së parë. Pasthirra tjetër, *prapakthehu*, përbëhet prej ndajfoljes si përbërës i parë dhe prej një foljeje në urdhërore, që i jep fjalës intonacion thirrmos.

¹²³ Edhe pasthirra *vajmedet* është e formuar prej dy pasthirmash (*vaj+medet*) që, për nga kuptimi, janë të njëjta. Fillimisht fjala *vaj* del si pasthirmë e prej saj është formuar emri *vaj* "të qarët...". Këtë shpjegim e gjejmë te Majeri (Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe, 2007 : 523) e më pas, më të zgjeruar te Çabej (*Studime gjuhësore II*, Prishtinë, 1976: 260).

¹²⁴ Bëhet fjalë për ndajfoljen *këtu*, e cila, me konversion, është bërë pjesëz thirrmore, që përdoret në fjali thirrmore si mjet karakteristik strukturor e që në të folur dallohet nga intonacioni i veçantë. Në këtë rast, kjo pjesëz shërben për të përforcuar thirrjen.

(Për pjesëzat thirrmore ose eksklamative, shih: J.Kole, *Pjesëzat si kategori leksiko-semantike në shqipen e sotme*, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, 1972 : 339.

IV. 3 Statistika

Një prej synimeve të hartimit të fjalorëve shpjegues normativë të një gjuhe është edhe pasurimi i fondit të tyre leksikor, duke pasur parasysh specifikat e gjuhës përkatëse dhe duke iu përmbajtur parametrave të hartimit të këtyre lloj fjalorëve.

Në fjalorin e 2006-ës, krahasuar me fjalorët e mëparshëm të gjuhës shqipe, atë të 1954-ës dhe atë të 1980-ës, kjo prirje është e dukshme. Këta fjalorë e pasqyrojnë leksikun e shqipes, në mënyrë, diku më shumë e diku më pak, të kufizuar, ndonjëherë asimetrike dhe të njëanshme në ndonjë aspekt. *Fjalori i gjuhës shqipe, i '54-ës*, përmban 25.000 fjalë, kurse *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, i '80-ës*, përmban rreth 41.000 fjalë. *Fjalori i gjuhës shqipe, i 2006-ës*, duke pasur si tipar themelor dhe kërkesë për hartimin e tij prirjen për t'i dhënë më shumë hapësirë korpusit leksikor, përmban rreth 48.000 fjalë. Kështu, duke pasur parasysh lidhjen e ngushtë mes strukturës leksikore të shqipes letrare dhe strukturës fjalëformuese, është rritur natyrshëm, krahasuar me dy fjalorët e mëparshëm shpjegues të shqipes, edhe numri i njësive leksikore të formuara nëpërmjet mënyrave të ndryshme të fjalëformimit. Në këtë fushë (të fjalëformimit), veçoria themelore dalluese është prodhimtaria dhe gjallëria e madhe e mënyrave që sjellin formimin e njësive të reja leksikore sintetike¹²⁵.

Në shqipe, përngjitja, edhe pse nuk shquhet si ndonjë mënyrë aq prodhimtare në formimin e fjalëve të reja, siç mund të jetë prejardhja apo përbërja, vepron në gjuhë dhe ka kontributin e saj në pasurimin e strukturës leksikore të një fjalori. Kështu, në *Fjalorin e gjuhës shqipe të 2006-ës* gjenden rreth 600 fjalë të përngjitura. Në monografinë "*Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*", L.Buxheli shpjegon se në gjuhën e sotme janë krijuar me

¹²⁵ Shih: A.Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, 1972 : 10.

anë të përngjitjes rreth 400 fjalë, pa përfshirë variantet, toponimet dhe emrat e përveçëm.¹²⁶

Duke iu dhënë gjithnjë e më shumë rëndësi rezultateve të fjalëformimit në gjuhën e sotme shqipe, në fjalorin e 2006-ës, krahas rritjes së numrit të njësive të reja leksikore, ka një rritje të numrit të njësive leksikore të përngjitura. Në këtë pjesë të fjalëformimit ka një përfshirje më të gjerë të fjalëve nga gjuha e folur e popullit, nga leksiku krahinor e dialektor, që nuk janë pasqyruar në botimet e mëparshme ose që shfaqen shumë rrallë në mënyrë të paqëndrueshme, por që sjellin elemente të reja leksikore-semanticke ose stilistikore. Gjithashtu, ka një përfshirje të konsiderueshme të fjalëve të përngjitura të vjela prej leksikut letrar dhe neologjizma të këtyre dy dhjetëvjeçarëve të fundit.

Nga ana tjetër, duke qenë se përngjitja është një mënyrë fjalëformimi ku faktori kohë luan rolin kryesor, me kalimin e kohës, pra, prej '80-ës e këtej, ka fjalë që janë krijuar si rezultat i ngjitjes së pjesëve përbërëse të një grupi fjalësh gjatë përdorimit të gjatë e të shpeshtë pranë njëra-tjetrës (kalimi i lokucioneve në fjalë të përngjitura), ashtu siç ka edhe rrjedhje fjalësh prej kësaj mënyre fjalëformimi (kalime prej përngjitjes në përbërje).

Shpërndarja e fjalëve të përngjitura nëpër pjesë ligjërata në fjalorin e 2006-ës është pothuaj në përpjesëtim të drejtë me fjalorët e mëparshëm.

- Vihet re një *sasi e konsiderueshme e emrave të përngjitur, rreth 140*. L.Buxheli dallon në leksikun e shqipes së sotme rreth 50 emra jo të parmë, të formuar me anë të përngjitjes. Në këtë numër është përfshirë edhe ndonjë emër që nuk gjendet në asnjë prej fjalorëve shpjegues të mëparshëm të shqipes (të '54-ës e të '80-ës), por që haset në fjalorët e Gazullit, të Tases etj.¹²⁷

- Përsa u përket *mbiemrave të përngjitur*, numri i tyre është mjaft i kufizuar. Në *Fjalorin e 2006-ës* janë përfshirë 9 të tillë. Pak a shumë e njëjta shpërndarje është edhe në fjalorët e mëparshëm.

¹²⁶ L.Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009 : 287.

¹²⁷ Për statistika prej fjalorëve të '54-ës e të '80-ës dhe të tjera do të mbështetemi në monografinë e L.Buxhelit, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009.

- Ka gjithashtu një shtim të numrit të *përemrave të përngjitur*, rreth 85 në *Fjalorin e 2006-ës*, kundrejt 53 të tillë në dy fjalorët e tjerë.

- Edhe numri i *foljeve të përngjitura* është relativisht i kufizuar, megjithatë, sipas interpretimeve që u kemi bërë mënyrës së formimit të disa prej tyre, në *Fjalorin e 2006-ës* dalin rreth 40 të tilla. Ndërkohë që në *Fjalorin e '54-ës* ky numër është mjaft i kufizuar, dallohen vetëm 4 të tilla, që zgjerohen disi në *Fjalorin e '80-ës* me foljet *bëzaj*, *vërej* etj., të cilat nuk ishin përfshirë më parë në grupin e fjalëve të përngjitura.

- Duke qenë se mes të gjitha pjesëve të ligjëratës, të ndryshueshme e të pandryshueshme, *ndajfoljet* kanë numrin më të madh të fjalëve të përngjitura, në *Fjalorin e 2006-ës* dallohen rreth 300 të tilla, përkundrejt 103 dhe 180 në fjalorët e '54-ës dhe të '80-ës.

- Te *parafjalët e përngjitura* në *Fjalorin e 2006-ës* duket se ndodh një përmbysje, krahasur me numrin e tyre në fjalorët e mëparshëm. Kemi gjetur 7 të tilla, kurse në *Fjalorin e '80-ës* dallohen 10 parafjalë. Por në këtë numër ne kemi përfshirë vetëm ato fjalë të përngjitura që në fjalor dalin mirëfilli si parafjalë dhe që nuk janë formuar me konversion prej pjesësh të tjera ligjërata.

- *Lidhëzat* dalin më shumë në formë lokucionesh, të përngjitura janë më të pakta, rreth 50 në *Fjalorin e 2006-ës*, përkundrejt 27 dhe 40 në dy fjalorët e tjera.

- *Pjesëzat* zënë vend shumë të vogël mes fjalëve të përngjitura. Vetëm një pjesëz dallohet në *Fjalorin e 54-ës*, kurse në dy të tjerët numri është po ai, 6. Veçse në *Fjalorin e 2006-ës*, në vend të pjesëzave *posi*, *sadomos* e *pothuajse*¹²⁸, të nxjerra nga *Fjalori i '80-ës*, janë pjesëzat *çne*, *përkundër* e *sidoqoftë*.

- Me ndonjë rritje të vogël nga botimet e mëparshme, numri i *pasthirrmave të përngjitura* në *Fjalorin e 2006-ës* është 20.

¹²⁸ Në *Fjalorin e gjuhës shqipe të 2006-ës*, këto fjalë dalin fillimisht si pjesë të tjera ligjërata dhe, pastaj, me konversion, kalojnë në kategorinë e pjesëzave.

IV. 4 Vërejtje fonetikodrejtshkrimore

Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe shkruhen gjithmonë njësh. Kanë një theks të vetëm. Kanë strukturë të mbyllur. Karakterizohen, përgjithësisht, nga zbehja e kuptimit të elementeve përbërëse. Nëse një fjalë përmbush qartë këto kritere, atëherë dallohet lehtë si fjalë e përngjitur. Ka raste kur një prej kritereve nuk është i qartë ose nuk përmbushet dhe, për të dalluar nëse një fjalë është e përngjitur, duhet të përqendrohemi te kriteret e tjera. Kështu, nëse një fjale duhet t'i japim vlerën e një fjale të përngjitur, ndërkohë që nga pikëpamja drejtshkrimore paraqet probleme (shkruhet herë njësh e herë ndaras), atëherë duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje kuptimit të fjalës etj. Në shqipe një sërë fjalësh të përngjitura paraqesin probleme të karakterit drejtshkrimor. Kjo ndodh, përgjithësisht, kur krahas fjalës së përngjitur ka ekzistuar ose, sidomos, kur ekziston lokucioni apo togfjalëshi i lirë prej nga është formuar kjo fjalë e përngjitur. Këto probleme nuk i ndeshim në të gjitha pjesët e ligjëratës. Përgjithësisht, më të dukshme janë tek emrat, mbiemrat, ndajfoljet dhe lidhëzat, ndonjëherë edhe te disa pasthirma.

♦ Ka raste, kur fjala e përngjitur dhe lokucioni apo togfjalëshi i lirë e i qëndrueshëm, që kanë të njëjtin kuptim leksikor, përdoren njëkohësisht, në vend të njëri-tjetrit, pa përcaktuar konkretisht se ç'qëndrim duhet mbajtur nga pikëpamja drejtshkrimore. Kjo dukuri vërehet kryesisht te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, ku mungojnë treguesit gramatikorë (mbaresat), të cilët janë shenjë e mbylljes së strukturës dhe njëfjalësimi.¹²⁹ Kjo do të thotë se është vështirë të dallohet kufiri që ndan fjalën e përngjitur nga lokucioni apo togfjalëshi, sepse, në shumicën e rasteve, këta të fundit ndodhen në procesin e leksikalizimit. Kështu, disa njësi i hasim herë-herë të shkruara njësh si një fjalë e vetme e herë-herë të shkruara ndaras. Prof. Sh.Demiraj grupet e fjalëve *për herë, për së dyti, me gjithë këtë, me qenë që, me qenë se, me që, nga që, sikundër që,*

¹²⁹ Për këtë shih edhe L.Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009 : 235.

o burra i paraqet si lokucione¹³⁰. Në gramatikat e mëvonshme e në fjalorë (në *Gramatikën e gjuhës shqipe I* dhe në *Fjalorin e '80-ës*), përveç lokucioneve *për së dyti e sikundër që*, të gjitha grupet e tjera të fjalëve shkruhen njësh, si fjalë të përngjitura. Ndërkohë, prof.Sh. Demiraj i jep të shkruara njësh lidhëzat *sadoqë e sidoqë*¹³¹, të cilat, në *Gramatikën e gjuhës shqipe I*, jepen në formën e lokucioneve lidhëzore, por në *Fjalorin e 2006-ës* paraqiten si të përngjitura.

Gjithashtu, në *Gramatikën e gjuhës shqipe I*, njësitë gjuhësore *çel e mbyll, shkel e shko, mes për mes, që kur, posa që, sado që, sido që, për së dyti*¹³² jepen të shkruara ndaras, në formën e një lokucioni. Kurse në *Fjalorin e gjuhës shqipe 2006*, këto njësi shkruhen njësh, si një fjalë e vetme, duke marrë vlerën e një fjale të përngjitur. Kjo gjë tregon se, përgjithësisht, në shqipe, ka një prirje për kalimin e lokucioneve në përngjitje.

Qëndrimet e dyzuara që shfaqen në shkrimin e këtyre njësive gjuhësore dhe prirja për kalimin nga lokucioni në përngjitje, lidhet me prirjen e vazhdueshme për sintetizimin e mjeteve të shprehjes, duke mënjeluar strukturat analitike. Në disa raste, procesi i kalimit nga lokucioni në përngjitje ka përfunduar plotësisht (*meqenëse, meqenëqë, ngaqë* etj.), në raste të tjera procesi është në faza kalimtare dhe ndihet ende i papërfunduar. Kështu, mund të vazhdojnë të trajtohen si lokucione ato struktura analitike, te të cilat, sot për sot, elementet përbërëse nuk e kanë humbur plotësisht mëvetësinë kuptimore e gramatikore.

♦ Mund të ndodhë, gjithashtu, që, përveç përdorimit në formë lokucioni, të jetë i pranueshëm edhe përdorimi si fjalë e përngjitur, por, në këto raste, duhet pasur kuptimi leksikor që përçojnë këto njësi, i cili, në kontekste të ndryshme është i ndryshëm. Kështu ndodh me ndajfoljen *njëherë* dhe lokucionin ndajfoljor *një herë*. Në kontekstin *na ishte njëherë...*, nuk mund të përdorim lokucionin *një herë*, sepse elementet përbërëse të tij e ruajnë ende karakterin e tyre prej fjalësh të veçanta, si në kontekstin *fol edhe një herë...*¹³³

¹³⁰ Shih: Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë 1971 : 266, 268, 271, 282.

¹³¹ Po aty, 272.

¹³² Shih: Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 378, 384, 401.

¹³³ Shih edhe L.Buxheli, *Fjalët e përngjitur në gjuhën shqipe*, 2009 : 228-229.

Të njëjtën gjë mund të themi për ndajfoljen pyetëse *përse* (*përse qesh?*) dhe togun *për se* (*nuk e mora vesh për se më fole*), ku përemri pyetës *se* zëvendëson përemrin pyetës *çfarë* dhe përdoret vetëm i shoqëruar me parafjalë.¹³⁴ Po kështu ndodh me ndajfolje *papritur* (*erdhi papritur*) dhe me formën e pashtjelluar të foljes *pres*, *pa pritur* (*pa pritur e pa kujtuar*).

Probleme ndeshim edhe në drejtshkrimin e disa lokucioneve ndajfoljore të tipit *parafjala pa + emër*. Në gjuhën e shkruar, sidomos në media e në letërsi artistike, grupe të tilla fjalësh, *pa dyshim*, *pa dashje*, *pa ndërprerje*, *pa fund*, *pa masë* i gjejmë shpesh të shkruara njësh, pra dalin në formë të përngjitur. Edhe në këtë rast duket prirja për kalimin nga lokucioni në përngjitje, por ky proces ndihet ende i papërfunduar, sepse pjesët përbërëse të lokucionit vazhdojnë t'i ruajnë karakteristikat e tyre si fjalë të veçanta. Ndërkohë që grupe të tjera fjalësh të këtij tipi shfaqen edhe më të qëndrueshme (*pa përjashtim*, *pa numër*, *pa pushim*). Në drejtshkrimin e tyre gabohet më rrallë, përgjithësisht i ndeshim të shkruara në formë lokucioni.

♦ Një vërejtje fonetikodrejtshkrimore mund të jetë kur kemi të bëjmë me procesin e kalimit nga përngjitja në përbërje. Historikisht, kompozimi (përbërja) ka dalë nga përngjitja¹³⁵, prandaj ky proces është i zakonshëm. Por te disa fjalë, të cilat fillimisht janë formuar prej përngjitjes së grupeve të fjalëve, të tipit *emër + emër në rrjedhore njëjës* shfaqen lëkundje të karakterit drejtshkrimor. Fjalët *vajguri*, *qymyrguri*, *gurkali*, *panxharsheqeri* etj., të shkruara në këtë formë, marrin vlerën e fjalëve të përngjitura. Në këto struktura, i-ja fundore e ka humbur kuptimin gramatikor të rrjedhores së pashquar, sepse këta emra, në këtë formë, përdoren në të gjitha rasat e së pashquarës njëjës dhe në emërore të shquar njëjës, gjë që bie në kundërshtim me strukturën morfologjike të shqipes. Për këtë arsye vihet re prirja për rënien e i-së fundore, gjë që do të realizonte përfundimin e procesit të kalimit nga përngjitja në përbërje¹³⁶. Kështu, në fjalorë, këta emra dalin në trajtën e emrave të përbërë, pa i-në fundore. Kohë më parë, prof.Kostallari i trajton emrat e këtij tipi, së pari, për të shpjeguar përfundimin e procesit të kalimit nga

¹³⁴ Shih: Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 245.

¹³⁵ Po aty, 76.

¹³⁶ Po aty.

lokucioni në përngjitje, duke i parë tashmë, përgjithësisht, si njësi të vetme leksiko-gramatikore. Pas kësaj, ai vëren se tek emrat e këtij tipi ruhen trajtat e lidhjes që ekzistonte në togfjalëshin *emër në emërore ose kallëzore + emër në rrjedhore njëjës*, pra ruhet mbaresa e rasore e përbërësit të dytë të strukturës së fjalës. Por njëkohësisht shpjegon se këta emra përdoren edhe në trajtat *vajgur, qymyrgur* etj., pa i-në fundore të rrjedhores, megjithëse këto raste takohen më rrallë dhe nuk kanë fituar qëndrueshmëri. Dhe, kësisoj, duket se kemi të bëjmë me një proces të pambaruar kalimi nga përngjitja në përbërje¹³⁷. Në të vërtetë, edhe sot, në ligjërimin bisedor dhe në gjuhën e shkruar shpesh vihet re përdorimi i këtyre emrave në formë të përngjitur, që do të thotë se, nga pikëpamja shkencore, problemi mund të quhet i zgjidhur, por zbatimi i tij kërkon kohë.

IV. 5 Semantika e fjalëve të përngjitura

Analiza e veçorive semantike të fjalëve të përngjitura, krahas analizës strukturore, dhe ndërthurja e tyre, ndihmojnë në zbërthimin e drejtë të përmbajtjes së tyre kuptimore dhe e bën më të larmishme pasqyrën e tipave dhe të nëntipave.

Nga pikëpamja semantike, kuptimi i fjalës së përngjitur është i barabartë me shumën e kuptimeve të përbërësve të grupit të fjalëve prej nga ka dalë. Por kjo rregull nuk përfaqëson të gjitha fjalët e përngjitura, sepse përbërësit e disa prej tyre e kanë zbehur më shumë kuptimin, pra janë çsemantizuar më shumë, kurse te disa të tjerë prirja për çsemantizim është më e zbehtë. Kështu, në fjalën e përngjitur *pasdite*, përbërësit strukturorë janë çsemantizuar deri në atë masë sa kuptimi i fjalës së re të përngjitur është lehtësisht i dallueshëm. Ndërsa në fjalën e përngjitur *theribujkë*, përbërësit e kanë zbehur aq shumë kuptimin, saqë është vështirë që, nga shuma e kuptimeve të tyre, të nxjerrësh kuptimin e fjalës së re. Pavarësisht nga numri i elementeve që bëjnë pjesë në strukturën e fjalës së përngjitur, në fund të fundit, ato *shprehin një nocion të vetëm dhe jo*

¹³⁷ Shih: A.Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, 1972 : 81.

marrëdhënie nocionesh, siç ndodh, përgjithësisht, me grupet e fjalëve. Për të njohur dhe për të interpretuar këtë nocion, që përbën thelbin kuptimor të fjalës së përngjitur, është e rëndësishme analiza në përbërës semantikë të kësaj të fundit.

IV.5.1 Lloji semantik i emrave të përngjitur

Larmia e madhe e tipave strukturorë dhe fakti se elementet përbërëse të emrave të përngjitur janë, kryesisht, fjalë kuptimplota, flasin për një larmi të madhe semantike. Ashtu si gjithë emrat në përgjithësi, që emërtojnë qenie e sende konkrete, lëndë e nocione abstrakte etj., edhe emrat e përngjitur shprehin kuptime që janë pjesë e gjithë klasës leksiko-gramatikore të emrave.

Nga pikëpamja semantike, emrat e përngjitur ndahen në:

- emra që emërtojnë qenie (veta ose frymorë).

Në këtë tip semantik përfshihen:

- emra qeniesh, të cilat, në mënyra të ndryshme e në shkallë të ndryshme, shprehin një dëshirë (*largnesh(i)*¹³⁸, *ndjesëpastë(i)*, *qoftëlarg(u)*, *haju(jk)(u)*, *ruajnazot*, *shtojzovalle*, *shtojzorreshtat*, *kacamic* etj.). Për shprehjen e kësaj dëshire vjen në ndihmë struktura e fjalës, që ka si përbërës një folje në formë të ngurosur në dëshirore ose në urdhërore (*edhe pse folja është në urdhërore, semantika e këtyre emrave, në përgjithësi, nuk ka vlerë urdhërore*). Pra, ndërthurja e anës semantike dhe asaj strukturorë mund të japë në mënyrë më të qartë e më të plotë kuptimin e fjalës së përngjitur.

Përgjithësisht, emrat me semantikë të tillë janë pjesë e folklorit e më pas janë bërë edhe pjesë e krijimtarisë artistike. Duke ndjerë nevojën për emërtimin e këtyre qenive, populli ka zgjedhur një tipar të tyre të dallueshëm, i cili *përmbledhet në dëshirën që qenia*

¹³⁸ Ky emër i përngjitur nuk ka në strukturën e tij asnjë folje në urdhërore apo në dëshirore, por kuptimi i tij shprehet me mjete intonacionore.

të kryejë një veprim ose t'i nënshtrohet një veprimi. Ky tipar, që e ka zanafillën në faza të hershme të një botkuptimi shoqëror të caktuar, përbën thelbin për të zbërthyer e për të kuptuar semantikën e këtyre emrave. Edhe pse kjo semantikë, diku më shumë e diku më pak, është zbehur mjaft, ajo mund të zbulohet duke studiuar historinë, mënyrën dhe rrethanat e krijimit të këtyre fjalëve të përngjitura, si edhe lidhjet strukturoresemantike që i karakterizojnë ato.¹³⁹

- emra të përgjithshëm që emërtojnë njerëz, të cilët përfaqësojnë dhe shprehin të njëjtat tipare karakteristike si heronjtë, me të njëjtin emër, të disa veprave letrare (*donkishot, donzhuan*).

- emra shpendësh dhe kafshësh {*guguftu, kacabu, kacadre, kukumjaçkë, kukuvajkë, tundubishtje (zog i vogël, bishtatundës), thithëlopë*}. Kuptimi i këtyre emrave nuk është i barabartë me shumën e kuptimeve të përbërësve strukturorë të tyre, sepse ana semantike e këtyre të fundit është errësuar mjaft dhe fjala e re e përngjitur merr një kuptim të ri.

● emra bimësh {*bardhëkuqe (lloj kërpudhe), bythëqyqe (bimë e egër), fendëdosë, fendujkë (sinonim me fendëdosë, lloj kërpudhe), këmbëdele (radhiqe), melekuqe (barishte), mollatartë (domate), ndajgjethëz (fletëz e një bime), qepëdosë (barishte), rrushqyqe (barishte), sapunqyqe (shkumëz), theribujkë (ferrënuse), therpelë (rrushkull)*}.

Edhe tek emrat e përngjitur që emërtojnë bimë, është e vështirë të nxjerrësh kuptimin prej shumës mekanike të kuptimeve të përbërësve strukturorë. Semantika e tyre e ka burimin në krijimtarinë folklorike. Ajo mund të zbulohet duke studiuar historinë, lidhjen semantikestrukturore të përbërësve, si dhe tipare të veçanta të tyre, që mund të përçohen në mënyrë të figurishme të fjala e përngjitur.

¹³⁹ Shih A.Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, 1972.

- emra sendesh { *brezëmbrek (ushkur), çakaçuke (çoku i portës), gërgëre (lodër druri), mëgojëz (ngojëz), mbipetk, mbisup (rrip veshjesh), mëkresë (gur varri), nëngrykëz (copë pëlhure që lidh thesin), nënbarkëz (rrip për kafshët), ngojëz (nyja e frerit të kafshët), rrocketake, taketuke.*

Në këtë tip semantik, përveç formimeve të reja që kanë forma onomatopeike, përgjithësisht, gjithë të tjerët që duket se janë formime të hershme, emërtojnë një send në formën e rripit që përdoret te njerëzit ose te kafshët në pjesë të ndryshme të kokës ose të trupit.

- emra lëndësh { *bukëvale, gurali, mëngojë (ushqim sa për të mbajtur veten gjallë), tambël, tëlyen, tëmotje, valëbuke* }.

Këta emra, ndryshe nga emrat e bimëve, përdoren shpesh në ligjërimin bisedor, prandaj, edhe pse kuptimi i tyre mund të mos dalë drejtpërdrejt nga shuma e përbërësve strukturë, është i njohur dhe, përgjithësisht, nuk është e nevojshme të studiohen në aspektin historik e në rrethanat e krijimit.

- emra abstraktë. Në këtë tip semantik përfshihen:

- emra, që, nga pikëpamja strukturore, kanë dy përbërës që lidhen me zanoren lidhëse *e* dhe që, nga pikëpamja semantike, kanë kuptime që plotësojnë e përforcojnë njëri-tjetrin ose kuptime të kundërta. Këta emra kanë karakter tërësisht të figurshëm, metaforik (*deleduk, digjepiq, hiqepiq ecejak, çapejak, gjëgjëzë, kashelashë, thashetheme*).

- emra, kuptimi i të cilëve, në njëfarë mase, është i barabartë me shumën e kuptimeve të përbërësve strukturorë (*besëtytni, bëzbëze, padije, padjallëzi, padurim, pafuqi, plotfuqi, hamendje, vëmendje, togfjalësh, nëndore, punëdore etj.*).

- emra, që emërtojnë pjesë të ndryshme të trupit të njeriut ose të kafshës (*mbibisht, mbikrah, mbivetull, nënlëkurë, pasqafe, përmjet*).

Duke i trajtuar më herët këta emra si të formuar me përngjitje, me përbërës të parë një parafjalë, atëherë kuptimi i tyre nuk del në mënyrë të drejtpërdrejtë.¹⁴⁰

- emra që emërtojnë intervale kohore (*paradite, paradreke, pasdarke, pasdite, pasdarke, sanataditë, shëmëhill, shëmitër, shënëdre*, etj.).

IV.5.2 Lloji semantik i mbiemrave të përngjitur

Përgjithësisht, semantika e mbiemrave të përngjitur është më e qartë. Mbiemrat emërtojnë një tipar të sendit. Ashtu si të gjithë mbiemrat, edhe mbiemrat e përngjitur ndahen në grupe semantike, në varësi të llojit të tiparit që emërtojnë. Kështu, dallohen këto grupe ose këto lloje semantike:

- mbiemrat që tregojnë cilësi (*foleqesh, kuqezi, ngjyrëvishnje, ndërhundsh*).

Kuptimi i këtyre mbiemrave del nga shuma e kuptimeve të përbërësve strukturorë. Mbiemri *foleqesh*, nga pikëpamja strukturorë, por edhe nga pikëpamja semantike ngjan me emrat e të njëjtit tip (*digjepiq, ecejak etj.*). Pra, përbërësit lidhen me zanoren lidhëse *e* dhe kanë kuptime që përforcojnë njëri-tjetrin.

- mbiemra që tregojnë marrëdhënie {*majëkrahut (me njërin krah të ngritur lart), mosmëharro, mosmëprek*¹⁴¹}. Në të vërtetë, edhe këta mbiemra tregojnë cilësinë e sendeve, por në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet lidhjeve të sendit të cilësuar me një send tjetër apo me një rrethanë a veprim.

¹⁴⁰ Në rast se këta emra do të trajtoheshin si emra të formuar me parashtesë, atëherë kuptimi i tyre do të ishte i drejtpërdrejtë dhe do t'u humbiste kuptimi real.

¹⁴¹ Mbiemrat *mosmëharro* dhe *mosmëprek*, siç edhe e kemi shpjeguar, janë kalkime prej gjermanishtes dhe latinishtes, prandaj edhe kuptimet e tyre janë të njëjta si në këto gjuhë.

IV.5.3 Lloji semantik i numërorëve të përngjitur

Numërorët themelorë, ku bëjnë pjesë edhe numërorët e përngjitur, tregojnë numra abstraktë ose sasi të caktuara sendesh e frymorësh të një fare.

Përgjithësisht, në ligjërimin bisedor, këta numërorë përdoren të shoqëruar me emra. Në këto raste, numërorët e përngjitur shërbejnë për të përcaktuar me saktësi kuptimin e numrit shumës të emrave që shoqërojnë.¹⁴² Duke pararendosur numrin më të vogël para dhjetës, kuptimi i tyre është i barabartë me kuptimin e grupit të fjalëve prej nga kanë dalë.

IV.5.4 Lloji semantik i përemrave të përngjitur

Përemrat e përngjitur, ashtu si të gjithë përemrat, nuk shprehin nocione, por vetëm tregojnë frymorë, sende, tipare ose sasi të pacaktuar frymorësh a sendesh.

Nga pikëpamja semantike, përngjithësisht, kuptimi i përemrave të përngjitur është i kushtëzuar nga rrethanat e përdorimit të tij. Ata mund të kenë kuptim të pacaktuar dhe, si nga kuptimi, ashtu edhe nga funksioni, ngjajnë me numërorët, por mund të përdoren për të pyetur për sende, frymorë, tipare të tyre etj.

● Përemra të përngjitur me kuptim të pacaktuar

Nga pikëpamja semantike, këta përemra ndryshojnë shumë mes tyre, por kanë një karakteristikë të përgjithshme të përbashkët: *kuptimin e pacaktuar*, që përdoret për të

¹⁴² Shih: Sh.Demiraj, Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, Prishtinë 1971 : 86.

treguar frymorë, sende etj. ose sasi në mënyrë të pacaktuar. Në këtë tip semantik dallohen këta nëntipa:

- përmra të përngjitur me kuptim të pacaktuar që *tregojnë ose përjashtojnë* frymorë ose sende në mënyrë të pacaktuar (*akëcili, akësecili, akësekush, askush, asnjë, dikush, secili etj.*). Te ky nëntip semantik, një prej përbërësve e ruan më qartë kuptimin leksikor, kurse përbërësi tjetër ka kuptim të zbehur. Këta përemra të përngjitur mund të tregojnë me kuptim pohor, por mund të tregojnë edhe me kuptim mohor, pra mund të kenë *kuptim përjashtimi*.¹⁴³

Kur kanë *kuptim përjashtimi*, ata ndahen në:

a) përemra që *tregojnë vetëm frymorë* në mënyrë të pacaktuar (*askush, asnjëri, asndonjë, asnjëri, kurrkush, moskush etj.*)

b) përemra që *tregojnë vetëm sende* në mënyrë të pacaktuar (*asgjë, asgjëkafshë, asgjësend, askurrfarë, askurrgjë, asnjëfarë, hiçgjë, hiçmosgjë, kurrfarë, mosgjë etj.*)

c) përemra që *tregojnë frymorë ose sende* në mënyrë të pacaktuar (*asnjë, asndonjë etj.*).

Këta lloj përemrash kanë gjithmonë si përbërës të parë fjalët *as, hiç* dhe *kurrë*.

Kur *tregojnë në mënyrë pohuese*, ndahen në:

a) përemra që *tregojnë vetëm frymorë* në mënyrë të pacaktuar (*çdokush, çdonjëri, dikush, gjithkush, gjithsekush, kushdo, ndokush, rrallëkush, sekush, tjetërkush etj.*)

b) përemra që *tregojnë vetëm sende* në mënyrë të pacaktuar (*diç, diçka, gjëkafshë, gjësendi, çmos etj.*)

¹⁴³ Shih: Sh.Demiraj, Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, Prishtinë 1971 : 139 dhe L.Buxheli, Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe, 2009 : 168 -171.

- c) përemra që tregojnë frymorë ose sende në mënyrë të pacaktuar (*cilido, çdo, çfarëdo, disa, gjithfarë, gjithfarëlloj, njëfarë, ndonjë, ndonjëri, secili etj.*).

Gjithashtu, në grupin e përemrave të përngjitur që tregojnë frymorë ose sende në mënyrë të pacaktuar, dallohen përemra që tregojnë frymorë a sende të një fare, por që merren veç nga e tëra (*cilindo, cilitdo, çdo, secili etj.*)¹⁴⁴ Përsëri brenda këtij grupi hyjnë edhe përemrat që tregojnë lloje të ndryshme (*çfarëdo, gjithfarë, gjithfarëlloj*).

Një tip tjetër semantik të përemrave të përngjitur përbëjnë:

- **Përemra e përngjitur që përdoren për të pyetur**

Këta janë përemrat *çfarë* dhe *çka*. Zakonisht përdoren në fjali pyetëse ku kërkohet përcaktimi i një frymori, i një sendi, ose i tipareve të tyre.¹⁴⁵

- **Përemra të përngjitur që shërbejnë për të treguar tipare sendesh a frymorësh që janë afër ose larg folësit.**

Këta janë përemrat dëftorë *asisoj, kësisoj*. Këta mund të shoqërohen me emra, por mund të përdoren edhe më vete. Gjithsesi, përdorimi i tyre është i kufizuar. I hasim më shpesh në ligjërimin bisedor.

¹⁴⁴ Për semantikën e përemrave të pacaktuar, shih Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 251 – 258.

¹⁴⁵ Po aty, 244.

IV.5.5 Lloji semantik i foljeve të përngjitura

Përgjithësisht, kuptimi i foljeve të përngjitura del nga kuptimi i grupit të fjalëve, prej të cilit janë formuar. Janë të gjitha folje me kuptim të plotë leksikor.

Në shumicën e rasteve foljet e përngjitura përfaqësojnë vetëm një tip semantik.

Ato emërtojnë procese që, në disa raste, kryhen edhe nëpërmjet formave onomatopeike.

IV.5.6 Lloji semantik i ndajfoljeve të përngjitura

Ashtu si gjithë ndajfoljet, edhe ndajfoljet e përngjitura, duke qenë fjalë emërtuese, shprehin nocione, që do të thotë se kanë kuptim të pavarur. Në gjuhën e sotme shqipe vërehet një lidhje e ngushtë e kuptimit dhe funksionit të ndajfoljeve me mënyrën e tyre të formimit.¹⁴⁶ Kështu, *ndajfoljet e përngjitura*, përgjithësisht, emërtojnë rrethanat në të cilat kryhet një veprim, gjë që do të thotë se, përngjithësisht, janë ndajfolje rrethimore. Sipas kuptimeve rrethimore që shprehin, ndajfoljet e përngjitura emërtojnë:

- *rrethanë kohore*, pra kohën kur kryhet ose sa zgjat veprimi a gjendja e shprehur nga folja a nga një emër foljor, që tregon një veprim abstrakt.¹⁴⁷ Ndajfoljet e përngjitura që emërtojnë rrethanë kohore, mund të tregojnë:¹⁴⁸

- kohën e saktë të kryerjes së një veprimi lidhur me çastin e ligjëritimit (*pardje, parmbrëmë, parvjet, pasnesër, përmbipardje, sivjet, sonte etj.*)

- kohë të papërcaktuar me saktësi (*atëherë, atëkohë, dikur, njëherë, kaherë, qëkur etj.*)

¹⁴⁶ L. Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009 : 211.

¹⁴⁷ Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë 1971 : 246.

¹⁴⁸ Për këtë shih: Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 363-364.

- kohën e zgjatjes së një veprimi a të një gjendjeje ose dëndurinë e tyre (*çdoherë, gjithmonë, gjithherë, herëdokur, kurdoherë, ndonjëherë, ngaditë, ngaherë, ngandonjëherë, përjetë, rrallëherë etj.*) Në këtë nëntip semantik hyn edhe ndajfolja *nisesos* (*gjithnjë*), që, për nga struktura dhe pjesërisht nga kuptimi¹⁴⁹, është e ngashme me emrat e tipit *çapejak, ecejak, digjepiq* apo me mbiemrin *foleqesh*.

- një veprim të çastit (*menjëherë, përnjëherë, sakaq, saora etj.*)

Disa ndajfolje të përngjitura që emërtojnë rrethanë kohore dhe që kanë si element përbërës të strukturës së tyre një prej fjalëve: *as, mos, kurrë* (*asnjëherë, askurrë, asndonjëherë, moskurrë, mosnjëherë etj.*) zakonisht përdoren në fjali mohuese si pjesë të dyta të mohimit krahas pjesëzave *nuk, s', mos, pa*, për të mohuar më me forcë mendimin e shprehur.¹⁵⁰

● *rrethanë vendore*, pra vendin ku kryhet një veprim a ku ndodh diçka. Këto lloj ndajfoljesh mund të tregojnë:

- vendin ku kryhet një veprim a ku ndodh diçka, duke u nisur nga një pikë referimi (*anepërçark, asajane, atypari, matanë etj.*)

- vendin ku kryhet një veprim a ndodh diçka në mënyrë të papërcaktuar (*akëku, akëseku, anekënd, anembanë, diku, gjëkund, gjithkund, kudo, ngado, tekdo etj.*)

Edhe disa ndajfolje të përngjitura që emërtojnë rrethanë vendore, ashtu si disa ndajfolje kohe dhe që kanë si element përbërës të strukturës së tyre fjalët *as* dhe *kurrë* (*asgjetiu, asgjëkund(i), askund, askurrkah, kurrkund etj.*) përdoren krahas pjesëzave mohuese në fjali mohuese si pjesë e dytë përforcuese e mohimit.

¹⁴⁹ Fjalët e përngjitura me strukturë të tillë (folje + zanore lidhëse + folje), përveç kuptimit kryesor (në rastin e ndajfoljes *nisesos* kuptimi kryesor është ai i shprehjes së rrethanës kohore) brendapërbrenda strukturës së tyre mund të shprehin edhe kuptime përforcuese, të afërta apo të kundërta.

¹⁵⁰ Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 364.

- *rrethanë shkakore*. Në këtë tip semantik, përse i përket ndajfoljeve të përngjitura, hyn vetëm ndajfolja *përse*, e cila përdoret për të treguar a për të pyetur për shkakun e kryerjes së veprimit.

Megjithëse pjesa më e madhe e ndajfoljeve të përngjitura *emërtojnë rrethanat* në të cilat kryhet një veprim, ka edhe ndajfolje të tjera të përngjitura që *emërtojnë*:

- *tiparin e një veprimi ose që përcaktojnë ecurinë e procesit të veprimit*.¹⁵¹ (*afërmendsh, anamend, dalëngadalë, diqysh, disi, mespërmes, nëpërmes, pakujtimas, papritmas, pikëgjallë etj.*).¹⁵² Në këtë tip semantik bëjnë pjesë, gjithashtu, të gjitha ndajfoljet që *emërtojnë lojëra fëmijësh*, që tregojnë mënyra të luajturi (*guraçokthi, gurmacash, gurapec, gurthimurthi, çelemyll, qiteprit etj.*).

- *shkallën e intesitetit të veprimit ose shkallën e cilësisë së rrethanës*¹⁵³ (*aspak, barabar, capak, ndopak, paksa, plotpërplot, sadopak etj.*)¹⁵⁴. Pjesa më e madhe e këtyre ndajfoljeve të përngjitura kanë si element përbërës ndajfoljen *pak* që përdoret me kuptim dobësues.

IV.5.7 Lloji semantik i parafjalëve të përngjitura

Meqenëse janë fjalë shërbyese, mund të thuhet se, nga pikëpamja semantike, ato nuk mund të qëndrojnë më vete dhe, kështu, janë të zhveshura nga kuptimi leksikor. Por, përderisa tregojnë marrëdhënie ose lidhje mes gjymtyrëve të fjalisë, atëherë kanë edhe njëfarë vlere semantike, e cila përcaktohet, përgjithësisht, prej kuptimit të fjalëve që ato lidhin, në një kontekst të dhënë.¹⁵⁵ Kështu, secila prej 7 parafjalëve të përngjitura që

¹⁵¹ Shih: Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 360.

¹⁵² Ndajfoljet *dalëngadalë, pakujtimas, papritmas*, në kontekste të caktura, mund të përdoren edhe për të treguar kohë apo sasi.

¹⁵³ Shih: Sh.Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë 1971 : 245.

¹⁵⁴ Ndajfoljet *barabar* e *plotpërplot* në kontekste të tjera mund të përdoren edhe për të treguar mënyrën e kryerjes së veprimit.

¹⁵⁵ Shih: A.Xhuvani, *Parafjalët*, në *Vepra I*, 1980 : 266.

kemi gjetur në Fjalorin e 2006-ës, ka një vlerë të vetën semantike, të ndryshme nga të tjerat. Përgjithësisht, këtë vlerë e mbart njëri prej përbërësve të fjalës së përngjitur, kurse elementi tjetër luan më shumë rol përforcues. Një tip semantik të parafjalët e përngjitura e përbëjnë ato që shprehin:

- kuptim vendor (*nëpër, përgjatë, përmbi*). Kuptimi i përgjithshëm i këtyre tri parafjalëve mund të jetë vendor, por secila prej tyre ka specifikat e veta, në varësi edhe të lidhjeve që krijon me fjalë të tjera në fjali. Kështu:

- parafjala *nëpër* përdoret, kryesisht, për të treguar vendin nëpër të cilin ose përmes të cilit bëhet një lëvizje. Këtu mund të përfshijmë edhe parafjalën *nëpërmjet*, e cila nuk shërben për të treguar vendin, por *mjetin*, përmes të cilit bëhet një lëvizje ose me anë të të cilit bëhet a ndodhet dikush a diçka.

- Parafjala *përmbi* tregon vendin mbi të cilin gjendet dikush a diçka a ndodh një veprim

- Parafjala *përgjatë* tregon drejtimin e lëvizjes në gjatësi pranë një vendi¹⁵⁶

- kuptim përjashtimi. Në këtë tip semantik hyjnë parafjalët *përpos* e *përveç*, të cilat janë sinonime. Shënojnë dikë a diçka që mbetet jashtë një pune, një veprimi etj.¹⁵⁷

Parafjala *sipas* mund të tregojë mënyrë ose kufizim.¹⁵⁸

IV.5.8 Lloji semantik i lidhëzave të përngjitura

Lidhëzat e përngjitura ashtu si të gjitha lidhëzat nuk kanë kuptim leksikor. Ato janë fjalë marrëdhënieje ashtu si parafjalët. Në Gramatikën e gjuhës shqipe 1 flitet për *lidhëza*

¹⁵⁶ Fjalori i gjuhës shqipe, 2006 : 788.

¹⁵⁷ Po aty, 807.

¹⁵⁸ Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 395.

semantike, të cilat, përveç marrëdhënieve sintaksore, shprehin edhe marrëdhënie të caktuara kuptimore ndërmjet gjymtyrëve ose fjalëve që lidhin. Të gjitha lidhëzat e përngjitura, përveç lidhëzës *nëse*, kur përdoret si fthilluese, janë lidhëza semantike.

IV.5.9 Lloji semantik i pjesëzave të përngjitura

Nga pikëpamja semantike, kuptimi i pjesëzave në përgjithësi, ashtu edhe kuptimi i pjesëzave të përngjitura, është i kushtëzuar. Ky kuptim del nga konteksti. Në përkufizimin që u bëhet, përveç të tjerave, thuhet se pjesëzat shprehin ngjyime kuptimore plotësuese të një fjale, të një togfjalëshi etj., ndryshe nga pjesët e tjera të pandryshueshme të ligjëratës. Prandaj ato mund t'i klasifikojmë sipas kuptimit që kanë¹⁵⁹. Edhe pse të pakta në shqipe, secila prej pjesëzave të përngjitura ka një kuptim. Ato mund të ndahen sipas këtyre tipave semantikë:

- pjesëza që shprehin kuptime përforcuese-veçuese a kufizuese (*sidomos, sidoqoftë*), që përforcojnë, por edhe veçojnë a kufizojnë kuptimin e fjalës, togfjalëshit a fjalisë.
- pjesëza që shprehin kuptime përfruese (*thujajse*). Kuptimi i kësaj pjesëze është i përfaqësues dhe nuk shprehet me saktësi.
- pjesëza që shprehin kuptime mohuese (*përkundër*).
- pjesëza që shprehin kuptime emocionale-shprehëse (*çne, pale*).

IV.5.10 Lloji semantik i pasthirmave të përngjitura

¹⁵⁹ E.Angoni në studimin mbi pjesëzat, në *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme*, 1972, bën një klasifikim të pjesëzave sipas kuptimit. Sh.Demiraj, në *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, i klasifikon pjesëzat sipas funksioneve, kurse më vonë, si në *Gramatikën e gjuhës shqipe I* etj., ato klasifikohen sipas domethënies.

Në shqipe, pjesët e ligjëratës ndahen në fjalë emërtuese dhe fjalë shërbyese. E veçanta e pasthirmave është se nuk klasifikohen në asnjë grup, nuk hyjnë as në grupin e fjalëve emërtuese, as në grupin e fjalëve shërbyese. Ato nuk shprehin nocione, por vetëm ndjenjat e vullnetin e folësit. Përmbajtja e këtyre ndjenjave dhe e vullnetit të folësit kushtëzohet nga kuptimi, me të cilin përdoren pasthirrat në kontekste të dhëna, si dhe nga rrethanat e përdorimit të saj.¹⁶⁰ Kështu, pasthirrat karakterizohen nga *shumëkumtimshmëria*, e cila shprehet me ndihmën e kontekstit dhe të intonacionit. Të gjitha këto veçori semantike të pasthirmave në përgjithësi, janë karakteristike edhe për pasthirrat e përngjitura.

Pasthirrat e përngjitura (ashtu si të gjitha pasthirrat) klasifikohen në dy tipa semantikë: *pasthirra emocionuese* dhe *pasthirra nxitëse*. Pjesa më e madhe e pasthirmave të përngjitura bëjnë pjesë në tipin e dytë semantik.

- pasthirrat emocionuese shprehin ndjenja të folësit.

Pasthirrat e përngjitura që shprehin ndjenja të folësit, kanë *kuptim të qëndrueshëm e të përcaktuar*, që nuk është edhe aq i kushtëzuar nga konteksti dhe intonacioni. Ato shprehin frikë, dëshpërimi, hidhërim (*kuku, obobo, pupu, ububu*).

- pasthirrat nxitëse shprehin dëshirën a vullnetin e folësit. Një nëntip semantik të këtyre pasthirmave të përngjitura e përbëjnë ato që shprehin

- urdhër (*gatitu, oburrani, prapakthehu*)

Nëntipin tjetër semantik e përbëjnë pasthirrat e përngjitura që shprehin

- përsëndetje të ndryshme, mirënjohje etj. (*faleminderit, falëmeshëndet, faqemender, mirëdita etj.*).¹⁶¹

¹⁶⁰ Sh.Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1971 : 279.

¹⁶¹ Për klasifikimin e pasthirmave sipas domethënies, shih: Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 431- 435.

IV.6 Përgjithësim modelesh

Tipat semantikostrukturorë të fjalëve të përngjitura janë aq të larmishëm (si te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, ku është thënë se përngjitja ka vepruar më shumë, ashtu edhe te pjesët e ndryshueshme të ligjëratës) sa është e vështirë të përcaktosh se cili prej tyre është më i përdoruri.

Mund të themi se te të gjitha pjesët e ligjëratës të përngjitura, përveç pjesëzës, emri është një prej elementeve përbërëse i të paktën një prej tipave semantikostrukturorë që dallohen në to [te lidhëzat dallohet vetëm një tip semantikostrukturorë ku një prej përbërësve është emër (gjithsaherë)]. Përgjithësisht, ai del në formë të ngurosur. Po ashtu, ndajfolja merr pjesë në përbërjen e shumë tipave semantikostrukturorë. Duke qenë se emri dhe ndajfolja janë fjalë kuptimplota, tipat semantikë bëhen më të larmishëm.

Te përngjitja pak mund të flasim për modele, megjithatë është vështirë të përcaktohet se kemi të bëjmë vërtet me një model të caktuar, në bazë të të cilit janë ndërtuar edhe fjalë të tjera apo kemi të bëjmë me krijime analogjike.

IV.7 Prirje

Te *fjalët e përngjitura* ekziston prirja e kalimit të tyre në fjalë të përbëra. Kjo ndodh pasi përbërsit e tyre e zbehin mjaft kuptimin dhe e humbasin vlerën si njësi strukturore. Prirjen për kalimin e përngjitjes në përbërje e vëmë re në disa raste. Kështu, në Fjalorin e 2006-ës disa emra, që kanë funksionuar si emra të përngjitur, paraqiten si të përbërë (*vajgur, qymyrgur, panxharsheqer, fendëdosë, fendujkë, nuselalë, lulegojë* etj.). Po në këtë gjendje grafike paraqiten edhe disa mbiemra, si: *gushëgjeraqinë, gushëpëllumb* etj. Në formë të përngjitur këto fjalë në elementin e dytë të strukturës së tyre, këto dalin me mbaresë të rrjedhore së pashquar (*vajguri, qymyrguri, panxharsheqeri, fendëdose, fendujke, nuselale, lulegoje, gushëgjeraqine* etj.) dhe

përdoren me të njëjtën trajtë si në njëjësin e pashquar (në gjithë rasat), ashtu edhe në emërore të shquar njëjës, gjë që është e papranueshme për strukturën morfologjike të shqipes (*Shih edhe Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 76*). Për këtë arsye, ato janë prirur ta humbasin mbaresën e rrjedhore, përkatësisht *e* dhe *i*, e cila e ka humbur funksionin e saj gramatikor. Duke e humbur këtë mbaresë këto fjalë mund të trajtohen edhe si të përbëra. Por, përderisa ato vazhdojnë të përdoren në të shkruar e të folur edhe si fjalë të përngjitura, mund të themi se procesi i kalimit nga përngjitja në përbërje nuk ka përfundur, prandaj mbetet një prirje.

V. KRITERET E PËRCAKTIMIT TË LOKUCIONEVE

Përkufizimi, përdorimi dhe trajtimi i termit *lokucion* dhe i lokucioneve në përgjithësi, në gjuhë që e përdorin kështu, shpeshherë ka ngjallur diskutime ndër gjuhëtarë: morfologë, leksikologë, leksikografë etj.¹⁶² Përgjithësisht, lokucionet trajtohen si grupe fjalësh, të përbëra prej dy a më shumë fjalësh, që kanë karakteristikat gramatikore dhe leksikore të një fjale të vetme dhe që shprehin një koncept të vetëm. Këto grupe fjalësh mund të jenë të ngurosurat ose me fleksion në një prej elementeve përbërëse, që do të thotë se një prej tyre mund të jetë fjalë emërtuese. Problemi qëndron në dallimin e kufijve që ndan këto njësi gjuhësore (lokucionet) me të tjera njësi, të ngjashme me to në disa këndvështrime. Kështu, lokucionet ngatërrohen shpesh me togfjalëshat, me frazeologjizmat ose idiomat dhe me fjalët e përbëra. Edhe në gramatika të ndryshme të së njëjtës gjuhë ndodh që i njëjti grup fjalësh të paraqitet herë si lokucion, herë si togfjalësh, herë si idiomë etj. Kështu, në frëngjishte një sintagmë emërore, kur bëhet stereotipe, merr statusin e një lokucioni. Megjithatë, një sërë lokucioneve emërore stereotipe, si *pomme de terre* “patate”, *avant-guerre* “paraluftë” etj., më shumë trajtohen si sintagma sesa si lokucione, megjithatë kufiri mes tyre nuk është i përcaktuar. Po ashtu, Booij thekson se në shumë raste është vështirë të dallosh fjalën e përbërë nga lokucioni (compound and phrase¹⁶³)¹⁶⁴. Dhe ai e shpjegon këtë duke marrë shembuj krahasues nga disa gjuhë. Së pari, frazat (lokucionet) mund të kryejnë funksionin e një fjale të vetme. Së dyti, frazat dhe fjalët e

¹⁶² Në studimet e shqipes, kjo çështje është trajtuar gjerë nga M.Domi “Disa çështje të lokucioneve” në Studime filologjike, 1985, 1 dhe nga M.Samara “Mbi trajtimin leksikografik të lokucioneve në gjuhën e sotme shqipe” në Studime filologjike 1992, 1-4.

Më parë termi lokucion është përdorur nga Sheperi, por me një koncept shumë të gjerë, ku përfshin edhe frazeologjinë (Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, Vlorë 1927 : 139), pak nga Cipo (i cili flet për disa lokucione pavetore) në “Gramatika shqipe” dhe nga Xhuvani në “Mbi thjeshtësinë e gjuhës” (Vepra I, 1980 : 21) dhe në “Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqipet” (Vepra I, 1980 : 243-244). Kurse, kur flet për parafjalët në “Parafjalët” për të njëjtën njësi gjuhësore nuk përdor termin lokucion, por shprehje parafjalore. (Vepra I, 1980 : 330).

¹⁶³ Në anglishte, për termin *lokucion* përdoret termi *frazë*.

¹⁶⁴ G.Booij, *The grammar of words*, 2010 : 81-85.

përbëra duket sikur janë pothuaj e njëjta gjë, sepse përbërësit e fjalëve të përbëra kanë dalë historikisht prej kombinimeve të fjalëve që përbëjnë frazën. Kështu, në gjermanishte për të shprehur nocionin e frazës *red cabbage* (ang) “lakër e kuqe” përdoret fjala e përbërë *Rotkohl* (përbëhet nga mbiemri *rot* dhe nga emri *Kohl*, kurse në holandishte përdoret fraza *rode kool*. Booji shpjegon se *rode kool* është frazë, sepse mbiemri *rode* mund të marrë flektivë, *rod-e* (mbaresë), pra ndryshon duke marrë gjininë, numrin dhe rasën e emrit. Ky tip fleksioni në gjuhësi quhet *përkim* (agreement)¹⁶⁵. Në gjermanishte, mbiemri *rot* nuk ndryshon, pra nuk merr ndonjë tregues eptimor. *Përkimi* është një nga kriteret që dallon fjalët e përbëra nga frazat. Një kriter tjetër është *theksi*. Te frazat, theksi kryesor bie te përbërësi që ndodhet në të djathtë, kurse te fjalët e përbëra bie te përbërësi në të majtë. Gjithashtu, Booji thekson se nuk mund të themi *very red-cabbage* “lakër shumë e kuqe” ose *heel rode kool*, sepse këto fraza funksionojnë si një fjalë e vetme për të përcaktuar një lloj të veçantë lakre etj.¹⁶⁶

Edhe në shqipe lokucionet ngatërrohen me njësi të tjera gjuhësore të afërta, si me togfjalëshat e lirë, me shprehjet frazeologjike dhe me fjalët e përbëra e të përngjitura. Përcaktimi i disa kriterëve mund të dallojë, edhe pse jo në mënyrë të prerë, kufijtë mes tyre.

Lokucionet si kategori leksikogramatikore duhen njohur edhe si mënyrë e veçantë fjalëformimi.¹⁶⁷ Nëse shihen në këtë këndvështrim, kriteret që përcaktojnë vetë fjalëformimin si proces (që në i kemi trajtuar dhe për përcaktimin e fjalëve të përngjitura) mund të jenë të përshtatshëm edhe për përcaktimin e lokucioneve. Kështu, kriteret kryesore që përcaktojnë lokucionet si njësi gjuhësore, janë:

a) Kriteri semantik ose kriteri i kuptimit të përgjithshëm kategorial.

Sipas këtij kriteri, një njësi gjuhësore përcaktohet si lokucion, në qoftë se të gjithë përbërësit përfaqësojnë një njësi të vetme leksikore-funksionore; pra, të gjithë ata

¹⁶⁵ Shih: P.Qesku, *Fjalor Anglisht-Shqip*, Tiranë 2002 : 57.

¹⁶⁶ G.Booij, *The grammar of words*, 2010 : 81-85.

¹⁶⁷ Shih: M.Domi, *Disa çështje të lokucioneve*, në Studime filologjike, 1985, 1.

si një njësi përfshihen vetëm në një nga kuptimet e përgjithshme kategoriale.¹⁶⁸ Por vetëm ky kriter nuk mjafton për përcaktimin e lokucioneve, sepse, nga ana e kuptimit kategorial, të barazvlershme me fjalën paraqiten edhe shprehjet frazeologjike. Kuptimi i përgjithshëm kategorial i lokucioneve duhet të vështrohet në lidhje të ngushtë edhe me veçoritë gramatikore.

b) Përcaktimi i lokucioneve sipas ***kriterit morfologjik*** tregon se gjithë përbërësit, përgjithësisht, duhet të funksionojnë si një njësi e vetme gramatikore; pra, të gjithë ata si një njësi pranojnë tregues morfologjikë e sintaksorë vetëm të një pjese ligjërate¹⁶⁹. Edhe nëse në përbërje të lokucionit marrin pjesë dy fjalë të ndryshueshme nga pikëpamja e eptimit, vetëm njëra prej tyre ndryshon dhe lokucioni merr treguesit e saj morfologjikë, kurse tjetra është e ngurosur¹⁷⁰. Në rastin kur lokucioni u përket pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës dhe në stukturën e tij ka një element të ndryshueshëm nga pikëpamja eptimore, atëherë ky element i ka humbur të gjitha veçoritë morfologjike (në lokucionin ndajfoljor *me kujdes*, emri kujdes nuk ndryshon formë, sepse është ngurosur).

c) *Kriteri sintaksor*

Lokucionet karakterizohen nga *atomiciteti sintaksor*¹⁷¹, që do të thotë se janë atome, brenda të cilave sintaksa nuk mund “të hyjë”, pra brenda tyre, edhe pse kanë strukturë të hapur, nuk mund të ndërfiten njësi të tjera leksikore dhe nuk mund të funksionojnë as rregullat e lëvizjes (ndryshimi i rendit të fjalëve). Kjo karakteristikë i dallon lokucionet nga togfjalëshat e lirë, të cilët mund të hyjnë njësi të tjera leksikore pa e prishur kuptimin e togfjalëshit.

¹⁶⁸ E.Likaj, *Morfologji e shqipes standarde*, 2010 : 9.

¹⁶⁹ E. Likaj, Po aty.

¹⁷⁰ Lokucioni *marr vesh* merr treguesit morfologjikë vetëm të foljes *marr*, kurse emri *vesh* mbetet i ngurosur.

¹⁷¹ Shih: S.Scalise, *Morfologia*, 1994 : 89.

VI. Lokucionet në Fjalorin e gjuhës shqipe 2006

- Struktura e lokucioneve

Lokucionet kanë strukturë të hapur, që do të thotë se nga struktura ato përbëhen prej një grupi fjalësh, por nga funksioni kanë vlerën e një fjale të vetme. Përgjithësisht, lokucionet kanë në strukturën e tyre dy ose më shumë elemente përbërëse që kanë lidhje të qëndrueshme mes tyre. Ato nuk e ruajnë mëvetësinë e tyre kuptimore dhe gramatikore. Që të lidhen me fjale të tjera të fjalisë, duhet të funksionojnë si një e tërë dhe jo secila më vetë, siç ndodh me fjalët e togfjalëshave e togjeve të lira. Çështja e strukturës së lokucioneve (me përbërës kryesor një fjale emërtuese ose me të gjitha fjalët shërbyese) paraqit probleme në gjetjen e tyre në fjalorë. Zakonisht lokucionet, edhe kur u përkasin pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës edhe kur janë pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, kanë në përbërjen e tyre strukturore një ose dy fjale emërtuese, të cilat mund të jetë të ngurosurat (*lule maji* > lokucion emëror, *ngjyrë argjendi* > lokucion mbiemëror, *vë re* > lokucion ndajfoljor, me *kujdes* > lokucion ndajfoljor, në *vend* > lokucion parafjalor etj.). Kjo fjale emërtuese i jep kuptimin gjithë lokucionit dhe kështu, nga ana semantike, përbën edhe atë që mund ta quajmë *kokë* të lokucionit. Duke u nisur nga ky element kryesor mund të gjejmë lokucionin dhe të dallojmë strukturën e tij. Nga ana tjetër, nëse në strukturën e lokucionit nuk ka fjale emërtuese, por vetëm fjale shërbyese, si në rastin e disa lokucioneve lidhëzore, ato mund t'i dallojmë duke u nisur nga tipi strukturor, pra nga kuptimi i veçantë i gjymtyrës së parë.¹⁷²

¹⁷² Shih: M.Samara, *Mbi trajtimin leksikografik të lokucioneve në gjuhën e sotme shqipe*, në Studime filologjike, 1992-1-4.

VI.1. Llojet e lokucioneve

Në gjuhën shqipe, ashtu si edhe në gjuhë të tjera, ku përdoren dhe janë trajtuar gjerësisht, është vënë re se lokucionet shtrihen pothuaj në të gjitha pjesët e ligjëratës¹⁷³. Në pjesën më të madhe të gramatikave tona ato nuk janë studiuar më vetë si pjesë ligjërate, madje nuk janë përfshirë as në kapitullin e fjalëformimit, por janë përmendur si mënyrë fjalëformimi në pjesë të ndryshme të ligjëratës, kryesisht të pandryshueshme, si te ndajfoljet, parafjalët dhe lidhëzat. Sot, duke përcaktuar kritere më të sakta për përkufizimin e lokucioneve dhe kufij më të qartë mes tyre dhe njësive të tjera gjuhësore të ngjashme me to, është vënë re se kjo mënyrë formimi fjalësh vepron edhe në pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, mjafton që mes elementeve përbërëse të togut të fjalëve të ketë *shkrirje semantike, dobësim të kuptimit dhe bashkëngjitje nga ana gramatikore* në shkallë të ndryshme¹⁷⁴.

Sipas pjesëve të ligjëratës, në gjuhën shqipe dallojmë këto lloje lokucionesh:

VI.1.1. Lokucione emërore

Lokucionet emërore janë grupe fjalësh, të përbëra kryesisht prej dy fjalësh emërtuese, që funksionojnë si një emër i vetëm, që shprehin një koncept të vetëm dhe që e kanë humbur kuptimin e mëvetësishëm të tyre. Këto lloje lokucionesh në shqipe janë trajtuar pak si të tilla. Grupet e fjalëve *lule dhensh, gur kufiri, bukë gruri, ve pate, vaj ullish* etj.,

¹⁷³ M.Dobi përmend se në gramatikën rumune të Akademisë të vitit 1966 flitet për lokucione të barasvlershme me të gjitha pjesët e ligjëratës. Po ashtu, në *Dictionnaire de linguistique* të Dybuasë (Dubois), mes të tjerash, flitet edhe për lokucione foljore e emërore. Gjithashtu, gjuhëtari frëng M.Grevis në *Precis de grammaire française*, 1969, përmend lokucionet emërore, mbiemërore, përemërore, pasthirmore, etj. (M.Domi, *Disa çështje të lokucioneve*, në Studime filologjike, 1985/1).

¹⁷⁴ M.Domi, po aty, 211-212.

K.Cipo, ndoshta edhe nën ndikimin e pikëpamjeve të Vajgandit të shprehura më parë, i emërton si kompozita sui generis. Nga ana tjetër, Kostallari nuk e pranon këtë emërtim që u bën Cipoja këtyre grupe fjalësh, por vetë i quan thjesht togfjalësha¹⁷⁵. Gjithashtu në *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, grupet e fjalëve *bar blete*, *bar ethesh*, *bar gjaku*, *bar miu*, *lule sahati* etj., janë trajtuar si togfjalësha, gjymtyrët e të cilëve ruajnë pavarësinë morfologjike¹⁷⁶. Sipas kritereve që përcaktojnë lokucionet, emërtimet e mjaft luleve e bimëve të cilat kanë si përbërës të parë fjalën lule ose bar, disa emra lëndësh etj. përfshihen te lokucionet emërore. Duke pasur parasysh që lokucionet janë parashkalla e përngjitjes, thuhet se një pjesë e këtyre lokucioneve kanë kaluar në përngjitje dhe më pas është kapërcyer nga përngjitja në përbërje. Kështu mund të ketë ndodhur me lokucionin *vaj guri*, i cili është përngjitur në *vajguri* dhe tashmë në fjalorë e gjejmë në formë të përbërë, *vajgur*:

◀ vaj gur —————> vajguri —————> vajgur, -i

Megjithatë shumë grupe të tilla fjalësh i gjejmë dhe i përdorim në dy format, edhe si lokucione edhe si përngjitje ose përbërje, gjë që tregon se faza e kalimit nga lokucioni në përngjitje ende nuk ka përfunduar. Kështu, themi *lule deleje* dhe *luledele*, *lule bore* dhe *lulebore* (*luleborë*), *lule dielli* dhe *luledielli*, *gjel deti* dhe *gjeldet* etj. Megjithatë, në Fjalorin e gjuhës shqipe të 2006-ës, përgjithësisht, këto grupe fjalësh jepen në formën e lokucioneve.

Ndërkohë, jo çdo grup fjalësh i tillë mund të quhet lokucion. Kështu, togjet *bukë gruri*, *zog pule*, *vezë pate*, *vaj arre*, *vaj ulliri* etj., edhe pse shprehin një koncept të vetëm, nuk mund të quhen lokucione. Elementet përbërëse të tyre nuk e kanë humbur mëvetësinë kuptimore dhe, gjithashtu, nuk priren drejt kompozimit¹⁷⁷.

Lokucione emërore në Fjalorin e 2006-ës:

¹⁷⁵ A.Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në Studime mbi leksikon... I, 1972 : 80.

¹⁷⁶ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, 1973 : 129.

¹⁷⁷ M.Domi këta i quan togfjalësha përcaktorë. (M.Domi, *Disa çështje të lokucioneve*, në SF, 1985/1 : 216.

Arusha e Madhe, Arusha e Vogël, bar argjendi, bar balsami, bar beronje, bar blete, bar brengje, bar breshke, bar delli, bar djathi, bar dhëmballe, bar ethesh, bar guri, bar gjaku, bar hënëze, bar hikrraqi, bar hirre, bar hudhre, bari i jetës, bar jodi, bar lepuri, bar lunge, bar i lotzonjës, bar miu, bar mjalti, bar nepërke, bar ngjitës, bar pate, bar peshku, bar pezmi, bar përdhes, bar plasjeje, bar të preri, bar pushi, bar qelbës, bar qeni, bar qumështi, bar rresh, bar sahati, bar shëllire, bar shpirre, bar shpretke, bar tamblu, bar i trashë, bar thëllëze, bar thiu, bar uji, bar urithi, bar verdhëze, bar vese, bar veshi, bar zemre, bar zgjebeje, dallëndyshe deti, gështenjë kali, gështenjë deti, gruri i thneglave, gryka e Këlcyrës, gur gjaku (lëndë minerale), gur kali¹⁷⁸, gur liri, gur leshi, gur mëndafshi, gur pambuku, gur shkrepës (strall), Guri i Bardhë¹⁷⁹, hiri i hardhisë, shoku i jetës, Kashta e Kumtrit, lule akshami, lule akulli, lule alle, lule argjendi, lule balsami, lule blete, lule bore, lule breshke, lule bretku, lule bualli, lule deleje, lule dielli, lule dimri, lule djathi, lule dushku, lule dylli, lule dhensh, lule ethesh, lule fieri, lule floriri, lule fshese, lule gishti, lule gomari, lule gjarpri, lule gjize, lule kashte, lule këmbore, lule krehri, lule kungulli, lule lakre, lule lepuri, lule maji, lule mbrëmjeje, lule mëllage, lule mëngjesi, lule misri, lule mize, lule mosmëharro, lule mosmëprek, lule peshku, lule plepi, lule pranvere, lule preshi, lule qeni, lule qengji, lule qyqeje, lule rezhde, lule rruaze, lule sahati, lule sapuni, lule syri, lule sharre, lule shigjete, lule shpate, lule shqerre, lule shqiponje, lule thoi, lule vathi, lule vere, lule vizhe, lule vjeshte, lule ylli, lule zjarri, lule zogu, lule zonje, mish i huaj, mollë dheu, molla e Adamit, nuse deti, nusja e lalës¹⁸⁰, nuse pashke, nusja e syrit, peshku i kurrizit (bised), peshk guri, presh gjarpri, qafa e Buallit, qafa e Thanës, rrush arushë, rrush gjarpri, rrush mali, rrush pule, rrush qeni, rrushi i qyqes, rrush toke, rrush frëngu, rrush thëllëze, Shkalla e Tujanit, shkolla e jetës, xanë lepuri, zog bari, zog blete, zog drite, zogu i dhenve, zog miu, zogu i natës, zog nuseje, zoti i shtëpisë.

¹⁷⁸ Lokucionet *gur kali* dhe *gur gjaku* i gjejmë edhe si zë më vetë në Fjalor në formën e një emri të përngjitur, *gurkali* dhe të një emri të përbërë, *gurgjak*.

¹⁷⁹ Te grupet e fjalëve që kanë si element të parë të strukturës së tyre emrin *gur*, përfshihen edhe togjet *gur kufiri, guri shahu, gur varri* etj., të cilët nuk duhen ngatërruar me përdorimet e tyre në mënyrë të figurshme (në Fjalor, kur trajtohen si frazeologjizma, jepen pas yllthit (*).

¹⁸⁰ Edhe lokucioni *nusja e lalës* në Fjalor del si zë më vete në variantin e një fjale të përbërë, *nuselalë*.

VI.1.2. Lokucione mbiemërore

Për lokucionet mbiemërore nuk është folur në gramatikat tona. Por M.Domi në një analizë të thelluar dhe në vlerësimin që u bën lokucioneve, përmend edhe disa lokucione mbiemërore, që do të thotë se kjo mënyrë fjalëformimi ka vepruar edhe te mbiemrat. Por në më të shumtën e rasteve, te kjo pjesë ligjërate struktura e lokucionit del në një fazë kalimtare, të ndërmjetme mes grupit të fjalëve dhe fjalës së përbërë. Prandaj, krahasuar me pjesët e tjera të ligjëratës, lokucionet mbiemërore janë më të pakta, megjithatë ekzistojnë, sepse, ashtu si te të gjitha lokucionet, edhe në rastin e lokucioneve mbiemërore një nocion i caktuar jepet prej një grupi fjalësh me vlerën e një mbiemri të vetëm. *Zhvillimi i mëtejshëm i kohezimit strukturor të pjesëve të tij ka shpënë shpesh në formimin e fjalëve të përbëra, çka dëshmon edhe më shumë njësinë semantike e gramatikore të togut dhe e përligj edhe më shumë njohjen e tij si lokucion*¹⁸¹.

Në Fjalorin e 2006-ës ka disa lokucione mbiemërore që shënojnë ngjyrë, të cilat kanë si element të parë të strukturës së tyre emrat *ngjyrë* ose *bojë*. Këto nuk janë dhënë si zë më vete në Fjalor dhe as nën zërin e emrit *ngjyrë* apo *bojë* (përveç lokucionit *bojë argjendi* që del nën emrin *bojë*). Në zërin e emrit *ngjyrë* jepen veten formimet e përbëra të këtij tipi që kanë dalë prej lokucioneve përkatëse. Por këta lloj mbiemrash dalin në formë lokucioni nën zërin e gjymtyrës kryesore ose të kokës së lokucionit, e cila herë-herë del edhe e pavaruar pa u lidhur me emrin ngjyrë dhe në këto raste nuk kemi të bëjmë më as me lokucion dhe as me fjalë të përbërë¹⁸².

Lokucione mbiemërore në Fjalorin e 2006-ës:

Ngjyrë *argjendi*, *bojë argjendi*, *bojë dheu*, *ngjyrë dheu*, *ngjyrë hiri*, *bojë kafe*, *lara-lara*, *leskra-leskra*, *lule-lule*, *ngjyrë limon*, *njolla-njolla*, *ngjyrë portokalli*, *bojë qielli*, *shkallë-*

¹⁸¹ M.Domi, *Disa çështje të lokucioneve*, SF 1985/1 : 216.

¹⁸² Kështu, në Fjalor për të shënuar ngjyrën *vjollcë*, jepet vetëm mbiemri *vjollcë* nën këtë zë pa u shoqëruar me emrin *ngjyrë* (fustan *vjollcë*).

shkallë, ngjyrë *tjegulle*, ngjyrë *tulle*¹⁸³, *thekë-thekë*, *xixa-xixa*, *zhele-zhele*..

Prof.M. Domi flet edhe për ndonjë lokucion tjetër mbiemëror të tipit *i dalë mendsh*, por në Fjalor jepet si zë më vete në formë të përbërë: *i dalëmendsh*.

VI.1.3. Lokucione numërore

Klasifikimi i disa numërorëve themelorë si *lokucione* në gjuhën shqipe nuk është i panjohur, por ashtu si edhe për pjesë të tjera të ligjëratës për emërtimin e tyre nuk është mbajtur një qëndrim. Kështu në Gramatikën e gjuhës shqipe 1 të Akademisë së Shkencave për njësi gjuhësore: *njëzet e një*, *tridhjetë e tre*, *njëqind e pesëdhjetë* etj., përdoret termi shprehje dhe jo lokucion. Po ashtu, në Drejtshkrimin e gjuhës shqipe (1973) flitet për lokucione ndajfoljore, parafjalore e lidhëzore, por për numërorët e formuar në të njëjtën mënyrë nuk cilësohet se ç'janë nga pikëpamja e strukturës dhe e formimit. M.Domi në studimin e tij mbi lokucionet i përmend edhe lokucionet numërore. Po ashtu, Sh.Demiraj në kapitullin e numërorit bën një klasifikim të tyre, ku, përveç numërorëve *fjalë të para dhe të përngjitura*, përmend edhe *lokucionet*.¹⁸⁴

Te numërorët themelorë ka shumë raste kur numri shprehet prej dy ose më shumë fjalësh, të cilat përbëjnë një njësi të pandashme, që quhet lokucion numëror. Lokucionet numërore fillojnë që me lokucionin *njëzet e një* e vijojnë me *tridhjetë e një...*, *dyzet e një...*, *njëqind e një... nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë* etj. Po ashtu, lokucione numërore formohen edhe me fjalët mijë, milion, miliard, bilion, biliard etj., kur këto shoqërohen me numra. Sh.Demiraj te lokucionet e ngurosura të formuara prej numërorësh themelorë përfshin edhe disa grupe fjalësh që i quan numërorë ndasorë (nga një, nga dy, nga tre etj.), të cilët tregojnë një sasi gjërash që ndahen në mënyrë të barabartë mes një grupi

¹⁸³ Shënim: Këta mbiemra në Fjalor jepen edhe në formë të përbërë, pra dalin me dy variante, që do të thotë se procesi i kalimit nga lokucioni në përbërje nuk ka përfunduar ende.

¹⁸⁴ Sh. Demiraj, Morfologji e gjuhës së sotme shqipe, Prishtinë 1971 : 87.

individësh¹⁸⁵.

VI.1.4. Lokucione përemërore

Grupet e fjalëve që mund të trajtohen si lokucione përemërore, janë përmendur pak, madje në shumë raste nuk përmenden as si togje fjalësh e as si shprehje. Në studimin e tij, prof.M. Domi flet edhe për lokucione përemërore të tipit *përemër i pacaktuar + përemër lidhor*. Ai vëren se bashkimi i tyre ka shpënë ose po shpie në formimin e një përemri të vetëm që mund të merret fare mirë si lokucion përemëror. Në Gramatikën e gjuhës shqipe 1 flitet për lokucionin përemëror *gjë që*.¹⁸⁶ Në Fjalorin e 2006-ës kemi dalluar këto lokucione përemërore: *cilido që, çdo gjë*¹⁸⁷, *çfarëdo që, gjë që, gjithë ç'* (ishin), *kushdo që*. Numri i lokucioneve përemërore është i paktë. Ata dalin më shumë në formë të përngjitur. Kur janë lokucione, përgjithësisht, si kokë (si bazë) e lokucionit shërben një përemër i pacaktuar. Gjithashtu, numrin më të madh të përemrave të përngjitur e përbëjnë përemrat e pacaktuar. Kjo përforcon mendimin se dikur këta kanë ekzistur në formën e lokucioneve (meqë lokucionet janë parashkalla e përngjitjes) dhe pastaj pjesët përbërëse të tyre janë shkrirë, kanë humbur ose kanë zbehur kuptimin, duke kryer kështu të plotë procesin e kalimit nga lokucioni në përngjitje¹⁸⁸.

¹⁸⁵ Sh. Demiraj, po aty.

¹⁸⁶ Gramatika e gjuhës shqipe 1, 2002 : 248.

¹⁸⁷ Grupi i fjalëve *çdo gjë* del edhe si zë më vete në Fjalor në formë të përngjitur, *çdogjë*. Kjo dëshmon se, para se të arrinte në fazën e përngjitjes (megjithëse procesi duket ende i papërfunduar për shkak të përdorimit të dy varianteve), ky grup fjalësh ka ekzistuar në formën e lokucionit. Prandaj mund të themi se *çdo gjë* (=gjithçka) është lokucion përemëror.

¹⁸⁸ Për lokucione përemërore flet edhe L.Buxheli. Ajo mendon se përemrat e pacaktuar të përngjitur ndonjëherë luajnë rol fjalëformues. Kështu, përemrat *çfarëdo, kushdo, cilido*, duke u bashkuar me përemrin lidhor *që*, kanë formuar lokucionet përemërore *çfarëdo që, cilido që, kushdo që*. (L. Buxheli, Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe, 2009 : 180).

VI.1.5. Lokucione foljore

Po të zbatojmë tri kriteret e përcaktimit të lokucioneve, atëherë identifikimi i lokucioneve foljore mund të jetë më i qartë. Ashtu si gjithë lokucionet që u përkasin pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës, edhe lokucionet foljore janë trajtuar pak në gjuhësinë shqiptare, sidomos në gramatika¹⁸⁹. Duket se çështja e mostrajtitimit të tyre lidhet edhe me problemin e dallimit të kufijve që i ndan ato prej njësive frazeologjike. Shpesh disa lokucione foljore trajtohen si njësi frazeologjike dhe kufiri mes tyre nuk përcaktohet qartë. Kjo ndodh ngaqë të dyja këto njësi gjuhësore kanë afri të mëdha si nga struktura ashtu edhe nga ana semantike. Si lokucionet foljore edhe njësitë frazeologjike foljore kanë strukturë të hapur dhe nga funksioni janë të barasvlershme me një folje të vetme. Gjithashtu, elementet përbërëse të strukturës së tyre përgjithësisht janë të qëndrueshëm e të ngurosur, por shkalla e qëndrueshmërisë së tyre është e ndryshme. Por ajo çka i dallon më shumë këto dy njësi gjuhësore është ana semantike. Njësitë frazeologjike në përgjithësi (ku përfshihen edhe njësitë frazeologjike foljore) karakterizohen nga kuptimi i figurshëm me ngjyrim të theksuar emocionues shprehës¹⁹⁰. Edhe lokucionet foljore mund të jenë të figurshme, por u mungon shprehësia ose është shumë e dobët. Ky tipar mund të na ndihmojë për të përcaktuar kufirin mes tyre, ndonëse jo të prerë. Edhe në gjuhësinë italiane, franceze, spanjolle etj., ku çështja e lokucioneve foljore është trajtuar gjerësisht¹⁹¹, problemi shtrohet gjithmonë në aspektin e dallimit mes këtyre njësive gjuhësore dhe atyre që i quajnë shprehje.

Lokucione foljore në Fjalorin e 2006-ës:

Bëj *aluzion*, marr *arratinë*, zë *besë*, bëj *ballë*, bëj *be*, bëj *çudi*, bëj *durim*, bëj *fjalë*, bëj *fotografi*, bëj *gati*, bëj *gjimnastikë*, bëj *kursim*, bëj *lajka*, bëj *marrëzi*, bëj *mënjane*, bëj

¹⁸⁹ Një studim të gjerë për lokucionet foljore ka kryer Z. Daci në SF 1985 /3 me titull: “*Vështrim rreth një tipi të lokucioneve foljore*”.

¹⁹⁰ Shih më gjerë: J.Thomai, Frazeologjia e gjuhës shqipe, në Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, Tiranë 2010 : XI – XIII.

¹⁹¹ Në këto gjuhë ka një numër të konsiderueshëm lokucioneve foljore, që për nga struktura e kuptimi përkojnë me lokucionet foljore të shqipes.

nder, *běj* not, *běj* përpjekje, *běj* pyetje, *běj* shaka, *běj* shëtitje, *běj* shtëpi (mur), *běj* tërkuzë, *běj* timen (= përvetësoj), *běj* thirrje, *běj* zë, *bën* dredha, *bën* kthesë (rruga), *bën* rrudha, *bën* shtrenjtë, (ma) ka *ënda*, zë në (me) *gojë*, (e) *gjen* zbatim, *gjen* shpëtim, *gjen* përhapje, *gjen* përkrahje, *gjen* vdekjen, zë *gjumi*, *hedh* lumin, *hedh* sëmundjen, i doli nga *hundët* (për hundësh), fut *hundët*, jap *jetën*, erdhi në *jetë*, u nda nga *jeta*, ndërroi *jetë*, *kam* dëshirë, *kam* durim, *kam* dhembje, *kam* etje, *kam* gjumë, *kam* kundërshtim, *kam shpresë* *kam* uri, ngul *këmbë*, ngre *krye*, derdh *lot*, *marr* frymë, *marr* hov, *marr* me mend, *marr* pjesë, *marr* në pyetje, *marr* në qafë, *marr* në shqyrtim, *marr* zjarr, *marr* hak, *marr* nën mbrojtje, *marr* inat, *merr* fund, *merr* valë, *mban* erë, *mbaj* fjalën, *kam* ndër *mend*, *sjell* ndër *mend*, *vjen* ndër *mend*, *mbaj* *mend*, më doli nga *mendtë*, e ruaj në *mendje*, e fshiu nga *mendja*, nuk më hiqet nga *mendja*, *kam* për *mënge*, *mbaj* *mëri*, *kam* *mëshirë*, *běj* *pushim*, (e) nxori birërie, nxori zë, nxori në shitje, i nxori gjumin, nxori mallin, i nxori pijen, *bën* *qejf*, *kam* *qejf*, e zë turpi, luaj *vendit*, *marr* *vesh*, (i) tha në *vesh*, (e) zuri nga (për) *veshi*, vë në rrezik, vë në shfrytëzim, vë themelet, vë në veprim, vë theksin, u bë *xhind*, *běj* *xhiro*, nxjerr yçkla, *kam* për *zemër*, fal *zemrën*, zë në gushë, zë për dore, zë deti, zë frika, (më) zë syri, zë shiu (bora), zë brumin, zë shok (mik), zë vend, i bie vrugu.

VI.1.6. Lokucione ndajfoljore

Përgjithësisht, kur flitet për formimin e ndajfoljeve në shqipe, trajtohen si mënyë më vete formimi edhe lokucionet ndajfoljore. Prof. A.Xhuvani në një studim të posaçëm për origjinën dhe formimin e ndajfoljeve, i trajton lokucionet ndajfoljore si një kategori ndajfoljesh, që formohen prej dy a më shumë fjalësh të lakueshme a të palakueshme dhe të bashkuara ose jo me parafjalë¹⁹². Pak a shumë i njëjti përkufizim u është bërë edhe më vonë në gramatikat tona, duke mbajtuar parasysh tiparet që i karakterizojnë lokucionet në përgjithësi në gjuhën shqipe. Lokucionet ndajfoljore që përbëhen nga një grup fjalësh me lidhje të qëndrueshme midis tyre dhe që, si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht, janë të

¹⁹² A. Xhuvani, *Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqipe*, në *Vepra I*, 1980 : 243-244.

barasvlershme, por jo identike, me një ndajfolje¹⁹³, dallohen qartë në shqipe. Ato kanë struktura të ndryshme. Disa lokucione ndajfoljore e kanë kapërcyer fazën e kalimit nga lokucioni në përngjitje dhe tashmë shihen si fjalë të përngjitura. Ka raste kur përdoren në të dy variantet, gjë që tregon se procesi i kalimit nga lokucioni në përngjitje nuk ka përfunduar (*anë e kënd* dhe *anekënd*, *drejt për drejt* dhe *drejtpërdrejt*). Megjithatë, në Fjalorin e 2006-ës vihet re qartë prirja e gjuhës drejt sintetizimit, sepse në krahasim me fjalorët e mëparshëm është shtuar numri i ndajfoljeve të përngjitura që kanë dalë prej lokucioneve.

Lokucione ndajfoljore në Fjalorin e 2006-ës:

Me acari, afër e afër, së afërmi, për analogji, andej e këtej, andej-këtej, në anë të anës, nga ana e anës, në të katër anët, anë e kënd, anës e anës, ashtu-ashtu, ashtu-kështu, aty për aty, aty-aty, aty-këtu, ballë për ballë, breg më breg, brez pas brezi, nga brezi në brez, me të *butë*, ca nga ca, copë e çikë, copë e kothere, copë e thërrime, copë e grimë, copa-copa, copë-copë, në çast, atë çast, këtë çast, orë e *çast*, çikë e thërrime, një çikë, darkë për darkë, degë më degë, dimër e verë, ditë e natë, me ditë, nga dita në ditë, një ditë, një ditë prej ditësh, dora-dorës, dorë më dorë, duar-duar, dhëmb për dhëmb, fije për fije, fije-fije, në fjalë e sipër, pa fjalë, fjalë për fjalë, fjolla-fjolla, flokë-flokë, pa fund, pa anë e pa fund, në fund të fundit, fund e krye, fundja-fundjes, goja-gojës, gojë më gojë, gojë pas goje, gropa-gropa, grupe-grupe, për së gjalli, gjatë e gjerë (sa gjatë gjerë), gjerë e gjatë (sa gjerë gjatë), gju më gju, hap pas hapi, herë më herë, herë pas here, në krye të herës, herë-herë, hollë-hollë, hope-hope, me një hov, hove-hove, javë për javë, për *jetë* e mot, këmba-këmbës, këmbë e krye, këmbë-këmbë, para kohe, me kohë, në kohë, kokë e këmbë, kokë më kokë, kot më kot, krah për krah, kur e kur, kurrën e kurrës, me çdo *kusht*, për së largu, lart e më lart, lart e poshtë, lehtë-lehtë, mbarë e mbrapsht, mëngjes për mëngjes, nga mëngjesi deri në mbrëmje, me radhë, me nxit, mot e jetë, me çdo *mënyrë*, nata-natës, në përgjithësi, në veçanti, nga dera në derë, nga koha në kohë, nga vera, me *ngut*, me një zë, një për një, deri më një, orë për orë, orë pas ore, një orë e më parë, orë e pa kohë, orë-orë, palë-palë, pikë për pikë, pikë-pikë, nga poshtë lart, poshtë e më poshtë,

¹⁹³ M.Domi, *Disa çështje të lokucioneve*, SF 1985 /1 : 214. e cit.

qoshe më qoshe, radhë-radhë, rëndë-rëndë, rreth e rrotull, rreth e qark, rreth e rreth, sot e mot, sot për sot, me shpirt, shtëpi për shtëpi, shumë-shumë, tufa-tufa (tufë-tufë), tutje-tëhu, në tym, thikë më thikë, thela-thela, varg e varg, varg e vistër, vende-vende, vija-vija, nga viti në vit, vit për vit, vrima-vrima.

VI.1.7. Lokucione parafjalore

Edhe lokucionet parafjalore janë trajtuar në gramatikat tona e në studime të ndryshme, ndonëse nuk u është dhënë vendi i duhur¹⁹⁴. Pas K.Cipos (më 1949) e Sh.Demirajt (më 1961), të cilët kanë përmendur pak lokucione parafjalore (*në vend, në mes, me anë të*) por pa dhënë ndonjë shpjegim të saktë, A.Xhuvani në studimin mbi parafjalët jep një numër të madh lokucionesh parafjalore, duke i quajtur fillimisht si lokucione a shprehje parafjalore e pastaj duke përdorur vetëm termin shprehje parafjalore. *Ai i përkufizon si grupe fjalësh, që kanë kuptimin e një njësie dhe bëjnë po atë funksion të parafjalëve*¹⁹⁵. Gjithashtu, për nga struktura, Xhuvani shpjegon se elementet përbërëse të tyre janë një parafjalë dhe një emër, të cilit i prin parafjala dhe i vjen pas një nyjë ose një parafjalë. Por Xhuvani nuk shpjegon në këtë punim se me cilën rasë përdoren këto parafjalë, pavarësisht se përmend praninë e nyjës. Një paraqitje më të plotë e më të saktë për lokucionet parafjalore jep E.Lafe në Gramatikën e gjuhës së sotme shqipe (1971), ku i interpreton ato nga ana e përbërjes strukturore dhe semantike¹⁹⁶.

Përgjithësisht, lokucionet parafjalore në shqipe kanë në bazë një emër dhe përdoren kryesisht me rasën gjinore. Pak prej tyre përdoren me kallëzoren dhe vetëm katër përdoren, përveç gjinores, edhe me rrjedhoren. Formimi i lokucioneve parafjalore prej emrash është rruga kryesore për pasurimin e klasës së parafjalëve në shqipe¹⁹⁷. Në Fjalorin e 2006-ës është përfshirë një numër i madh lokucionesh parafjalore, por ky

¹⁹⁴ Studimi më i plotë për lokucionet parafjalore në gjuhën shqipe është bërë nga M.Çeliku "Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe", në Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II, 1975.

¹⁹⁵ A.Xhuvani, *Parafjalët*, në *Vepra I*, 1980 : 267 dhe 330.

¹⁹⁶ E. Lafe, *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe, Morfologjia, IV*, 1971 : 29-48.

¹⁹⁷ Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 387.

numër nuk ka pësuar ndonjë rritje të dukshme, krahasur me listën e lokucioneve që jepet në studimin e M.Çelikut apo në Gramatikën e Akademisë.

Lokucione parafjalore në Fjalorin e 2006-ës:

Në *ag*, në *ah*, në *anë*, me *anën*, për *arsye*, në *bashkëpunim* me, në *dëm*, në *dobi*, për *faj*, në *fushën*, me *gjithë*, në *harmoni* me, për *hir* (të), në *krahasim* me, në *kurriz*, në *lëmin*, në *lidhje* me, *lidhur* me, në *marrëveshje* me, në *mes*, në drejtim, në *bazë*, në *këmbë*, në *vend*, në *palcë* (të), për *punë*, në *përputhje* me, në *pikë*, në *prag*, në *saje*, në *sy*, nga *shkaku* (i), për *shkak* (të), në *varësi*. (34)

VI.1.8. Lokucione lidhëzore

Pjesa më e madhe e lokucioneve lidhëzore në shqipe janë formime relativisht të reja, por ka prej tyre që i gjejmë qysh në shkrimet e vjetra¹⁹⁸. Karakteristikë e lokucioneve është mënyra e vendosjes: një pjesë i kanë elementet përbërëse pranë njëra tjetrës, ashtu si shumica e lokucioneve, kurse ka të tjera që janë të ndara në dy pjesë para secilës nga të dyja fjalët a fjalitë që lidhin (*daç...daç, qoftë...qoftë, jo vetëm...por edhe* etj.). Lokucionet lidhëzore janë trajtuar në të gjitha gramatikat e shqipes, që nga Sheperi, Cipo, Prifti, Floqi etj., ndonëse jo plotësisht. Trajtimi i tyre më i plotë, ndryshe nga ç'ka ndodhur me pjesët e tjera të ligjëratës ku bëjnë pjesë lokucionet, shpjegohet ndoshta me identifikimin e tyre. Duket më e lehtë të identifikosh lokucionet lidhëzore, për shkak se një pjesë e mirë e tyre kanë në përbërjen strukturore vetëm fjalë shërbyese (dy lidhëza, një lidhëz dhe një pjesëz etj.). Edhe kur njëri prej elementeve të strukturës së lokucionit lidhëzor është fjalë emërtuese (folje, ndajfolje, përemër), përgjithësisht, ai është gramatikalizuar në atë shkallë sa me gjithë elementet e tjera ka formuar një unitet të madh kuptimor e shqiptimor¹⁹⁹.

¹⁹⁸ Shih: E. Lafe, *Lidhëzat te libri i parë shqip*, në: Studime filologjike, 1971/4 : 104.

¹⁹⁹ Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 401.

Janë të shumta lokucionet lidhëzore në Fjalorin e 2006-ës. Por, elementet përbërëse të disa prej tyre, duke u ndodhur për një kohë të gjatë pranë njëri-tjetrit, janë shkrirë, duke kapërcyer kështu fazën e kalimit nga lokucioni në përngjitje (*sadoqë, sidoqë, sikundërqë, tekdoqë* etj.). Këto lidhëza e të tjera që në Fjalorin e 2006-ës dalin si zë më vete në formën e tyre të përngjitur, në Gramatikën e gjuhës shqipe I²⁰⁰ dhe në Fjalorin e '80-ës²⁰¹ dalin në formë lokucioni.

Lokucione lidhëzore në Fjalorin e 2006-ës:

Aq sa, për arsye se, në çastin kur, që prej çastit, në çdo kohë që, nga çdo anë që, për çdo rast që, daç... daç, edhe...edhe, edhe në qoftë se, edhe po qe se, edhe në, edhe sikur, edhe pse, edhe sepse, hem...hem, ja...ja, sido që të jetë, kështu që, në kohën që, në kohën kur, sa kohë që, për sa kohë që, kudo që, në mënyrë që, ndo...ndo, në...apo, ngado që, ose..ose, paçka se, pavarësisht se, që ku, që kur, kurdo që, mjaft që, posa që, sido që, le që...por (edhe), jo që...por (edhe), jo vetëm që...por (edhe), qoftë... qoftë, në qoftë se, në rast se, sa kohë që, sado që, si... (ashtu) edhe, nga frika se, nga shkak se, duke qenë se, në është se, po qe se, po të jetë se, përpara se, qysh se, vetëm se, si... si, sido që, për shkak se, tekdo që, në vend që, jo vetëm që...porse, vërtet që.

VI.1.9. Lokucione pjesëzore

Edhe pse nuk janë përmendur ose është folur pak për lokucionet pjesëzore në gjuhën shqipe, ato janë pjesë e klasifikimit strukturor të pjesëzave. Në të vërtetë, edhe për trajtimin e pjesëzave si pjesë ligjërata ka pasur qëndrime të ndryshme dhe shpesh nuk u është kushtuar vëmendja e duhur. Përderisa në klasën e pjesëzave ka disa njësi që përbëhen nga dy ose tri fjalë që formojnë një tërësi të vetme për nga kuptimi, midis të cilave nuk mund të ndërhyjë ndonjë fjalë tjetër (qoftë edhe shërbyese) dhe që ka vlerën e

²⁰⁰ Po aty.

²⁰¹ Fjalori i gjuhës shqipe, 1980 : 1604. Këto lidhëza në Fjalor jepen si lokucione lidhëzore nën zërin e lidhëzës *që*.

një pjesëze të vetme, atëherë pse të mos quhen lokucione pjesëzore? Njësi të tilla që dalin në formën e lokucioneve pjesëzore janë: *as që, ja që, po e po, se mos* etj.

Sh. Demiraj kur trajton pjesëzat si pjesë ligjërata, nuk u bën ndonjë klasifikim të qartë nga ana strukturore. Nuk flet as për pjesëza të thjeshta, as për të përngjitura e as për lokucione. Nga pikëpamja e fjalëformimit trajton vetëm pjesëzat e prejardhura prej pjesësh të tjera ligjërata²⁰². Edhe prof.M.Domi në studimin e tij të gjerë mbi lokucionet, ku i trajton këto si mënyrë fjalëformimi që vepron në të gjitha pjesët e ligjërates, nuk përmend lokucione pjesëzore. Po kështu, në Drejtshkrimin e gjuhës shqipe flitet për lokucione që u përkasin të gjitha pjesëve të pandryshueshme të ligjërates (lokucione ndajfoljore, parafjalore, lidhëzore e pasthirrmore) përveç pjesëzave. Ato nuk përmenden as nën termin e togut apo togfjalëshit të lirë dhe as të shprehjeve.

E.Angoni, në një studim të zgjeruar mbi pjesëzat, i klasifikon ato edhe sipas kriterit morfologjik, ku, mes pjesëzave të thjeshta që janë më të shumta në numër dhe pjesëzave të përngjitura, dallon edhe lokucionet pjesëzore²⁰³. Po ashtu, J.Kole përsëri në një studim të plotë për pjesëzat bën fjalë për pjesëza që dalin në formën e lokucioneve e bashkimeve të qëndrueshme²⁰⁴ Edhe në Gramatikën e gjuhës shqipe I, në klasifikimin që u bëhet pjesëzave *sipas strukturës*, zënë vend edhe lokucionet pjesëzore.

Lokucione pjesëzore në Fjalorin e 2006-ës:

As që, ja që, jo që jo, ku e ku, le që, pa *le*, po se po, po e po, poshtë-lart, se mos, si urdhëron, vetëm se, vetëm që, vetëm e vetëm.

VI.1.10. Lokucione pasthirrmore

Në gramatikat e shqipes e në ndonjë studim, autorët kanë mbajtur qëndrime të

²⁰² Sh.Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë 1971 : 274.

²⁰³ E. Angoni, *Pjesëzat*, në Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, 1972 : 313-314.

²⁰⁴ Shih: J.Kole, *Pjesëzat si kategori leksiko-semantike në shqipen e sotme*, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, 1972 : 322.

ndryshme lidhur me klasifikimin strukturor të pasthirmave. Xanoni flet për pasthirmat të thjeshta e të përngjitura²⁰⁵, kurse Cipo i ndan në pasthirmat të thjeshta dhe shprehje epifonematike²⁰⁶. Sh.Demiraj i klasifikon pasthirmat në të mirfillta e të pamirfillta sipas prejardhjes²⁰⁷, por nuk bën ndonjë klasifikim sipas strukturës. Edhe në Gramatikën e gjuhës shqipe 1 bëhet një klasifikim nga pikëpamja e formimit në të parme dhe jo të parme, ku te pasthirmat jo të parme përveç atyre që janë formuar prej pjesësh të tjera të ligjëratës dhe pasthirmave të përngjitura bëjnë pjesë edhe disa bashkime të qëndrueshme frazeologjike²⁰⁸. As këtu nuk sqarohet vendi që zënë pasthirmat që kanë formën e një grupi fjalësh, por që nuk funksionojnë si njësi frazeologjike. Por E.Angoni bën një klasifikim të drejtë e të hollësishëm për pasthirmat duke u nisur nga përbërja e tyre strukturore dhe duke i vështruar ato si të gjitha fjalët e tjera të gjuhës shqipe, të ndryshueshme e të pandryshueshme. Kështu, ai i ndan ato në tri grupe, ku, krahas pasthirmave të thjeshta e të përbëra, dallon edhe lokucionet pasthirmore²⁰⁹. Përkufizimi që u bën Angoni lokucioneve pasthirmore përputhet përgjithësisht me përkufizimin që u bëjmë lokucioneve në tërësi²¹⁰. Edhe në Drejtshkrimin e gjuhës shqipe përmenden lokucionet pasthirmore dhe jepet një listë e tyre jo shteruese. Nga shembujt që jepen aty, duket se ato plotësojnë kriteret për t'u quajtur *lokucione*.

Lokucione pasthirmore në Fjalorin e 2006-ës:

Të *ardhsha* për të mirë!, qofsh i *gëzuar*!, e kalofsh i *gëzuar*!, qofsh (**jam**) me jetë, rrofsh e qofsh!, qofsh shëndoshë, gëzuar qofsh!, i qofsha falë, shëndet pastë! (**kam**), punë e

²⁰⁵ Te pasthirmat e përngjitura Xanoni përfshin ato që janë të përbëra nga më shumë se një fjalë, por ai nuk dallon në këtë grup pasthirmat që janë të përngjitura, pra që nga ana drejtshkrimore pjesët përbërëse të tyre shkruhen si një njësi e vetme, nga pasthirmat me strukturë të hapur. (A.Xanoni, *Gramatika shqyp*, Shkodër 1909 : 166).

²⁰⁶ Sipas Cipo pasthirmat epifonematike janë formuar nga bashkimi i dy ose më shumë fjalëve në një të vetme ose nga bashkime të qëndrueshme frazeologjike. Kështu, as Cipo nuk bën një ndarje të qartë mes pasthirmave të përngjitura dhe atyre që kanë formën e një grupi fjalësh. (K.Cipo, *Gramatika shqipe*, 1949 : 186-187).

²⁰⁷ Te pasthirmat e pamirfillta Demiraj përfshin ato që janë formuar nga ndonjë pjesë tjetër e ligjëratës ose nga ndonjë fjali. (Sh.Demiraj, *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë 1971 : 280).

²⁰⁸ Gramatika e gjuhës shqipe I, 2002 : 430-431.

²⁰⁹ E. Angoni, *Pasthirmat në gjuhën e sotme shqipe*, në: Studime filologjike 1973/4 : 49.

²¹⁰ Sipas Angonit, *lokucionet pasthirmore përbëhen prej dy a më shumë fjalësh, të cilat kanë një kuptim të vetëm dhe kryejnë funksionin e një pasthirrme*. (Po aty). Si lokucione pasthirmore ai përmend: *të lumtë, t'u bëfsha, djall o punë* etj.

mbarë!, *udhë e mbarë!*, të shkoftë *mbarë!*, *mbetsh* me shëndet!, mirë *mbetsh*, ditën *e mirë!*, të vajttë *mbarë!*, të gjettë (të priftë) *e mira*, ju ardhshim për *të mirë*, të gjitha *të mirat!*, *mirë* se erdhe!, qofsh me *nder!*, me *shëndet!*, *shëndet* e të mira!, qofsh (të paça) me *shëndet!*, vafsh (ardhsh) *shëndoshë!*, vetë *shëndoshë!*

VI.2 Përbërësit e lokucioneve²¹¹

Analiza tërësore dhe e hollësishme e lokucioneve sipas pjesëve të ligjëratës nënkupton dallimin konkret të tyre, klasifikimin strukturor (format e ndryshme me të cilat dalin) sipas elementeve përbërëse, klasifikimin sipas përbërjes semantike, caqet e shtrirjes së tyre nga njëra pjesë e ligjëratës te tjetra dhe njohjen e proceseve në shkallë të ndryshme të kalimit nga një tog i lirë fjalësh në një grup fjalësh (në një tërësi) të pazbërthyeshme dhe nga ky grup fjalësh në një fjalë të vetme (drejtshkrimore, morfologjike, sintaksore e leksikore).

Njohja e çdo aspekti që përbën secili një anë të analizës së lokucioneve, është e vlefshme, sepse duke analizuar një aspekt mund të lindë nevoja për ndërhyrjen analizuese të aspektit tjetër, gjë që tregon se asnjë element nuk mund të vështrohet e të analizohet i shkëputur plotësisht nga një tjetër.

Nga pikëpamja strukturore lokucionet kanë formën e një grupi fjalësh, i cili ka në përbërje të tij dy ose më shumë fjalë. Këto fjalë, ndryshe nga ç'ishin në gjendje të lirë, kur bëhen pjesë e strukturës së lokucionit, pësojnë ndryshime kuptimore e gramatikore. Përgjithësisht, vijnë duke e zbehur e duke e humbur mëvetësinë e tyre kuptimore e

²¹¹ Shënim: Në këtë punim do të trajtojmë vetëm tipat strukturorë të lokucioneve që kemi nxjerrë nga Fjalori i gjuhës shqipe 2006.

gramatikore²¹². Këto elemente përbërëse të strukturës së lokucionit mund t'u përkasin të gjitha pjesëve të ligjëratës, të ndryshueshme e të pandryshueshme dhe mund të jenë:

- a) vetëm fjalë kuptimplota (*bar blete, bëj ballë, lule dielli, marr vesh etj.*)
- b) fjalë kuptimplota dhe fjalë jokuptimplota (*afër e afër, me radhë, në vend, në qoftë se etj.*)
- c) vetëm fjalë jokuptimplota. (*jo se jo, le që...por, se mos etj.*)

Përbërësit strukturorë të lokucioneve dhe lidhjet sintaksore mes tyre janë të ndryshme edhe në varësi të pjesës së ligjëratës së cilës i përket lokucioni. Kështu, përbërësit strukturorë të lokucioneve emërore janë vetëm fjalë kuptimplota, përbërësit strukturorë të lokucioneve ndajfoljeve mund të jenë vetëm fjalë kuptimplota, por edhe kuptimplota dhe jokuptimplota, kurse përbërësit strukturorë të lokucioneve pjesëzore mund të jenë vetëm fjalë jokuptimplota etj. Prandaj, për një analizë më të plotë e më të saktë strukturore, përbërësit e lokucioneve duhen vështruar e vlerësuar fillimisht sipas pjesës së ligjëratës ku bën pjesë lokucioni e pastaj në tërësi. Kështu, sipas llojit të lokucioneve, dallojmë këto struktura me këta përbërës strukturorë:

VI.2.1 Përbërësit e lokucioneve emërore

Lokucionet emërore kanë në strukturën e tyre përbërës që dallohen qartë. Ata janë dy fjalë kuptimplota. Pjesa më e madhe e lokucioneve emërore bëjë pjesë në tipin strukturor

- emër + emër

Në këtë tip strukturor dallohen këta *nëntipa*:

- emër i pashquar + emër në rrjedhore të pashquar njëjës

²¹² Ka disa lokucione që e ruajnë mëvetësinë e tyre morfologjike, siç janë lokucionet pasthirmore *mirë se erdhe, shëndet paç* etj. apo disa lokucione foljore *vë re, marr pjesë* etj. Në këto lokucione folja ndryshon sipas përdorimit, pra ruan mëvetësinë morfologjike.

Këtu lidhja strukturore është mjaft e dukshme. Në këtë nëntip hyjnë lokucionet që kanë si përbërës të parë emrin:

- a) bar (*bar breshke, bar miu, bar pate etj.*)
- b) lule (*lule deleje, lule dielli, lule gjarpri, lule zogu etj.*)
- c) gur (*gur gjaku, gur liri, gur mëndafshi etj.*)
- d) rrush (*rrush gjarpri, rrush pule, rrush qeni, rrushi i qyqes, rrush toke, rrush frëngu etj.s*)
- e) zog (*zog blete, zog drite, zog nuseje etj.*)

Përbërësi i parë strukturor i lokucioneve emërore të këtij nëntipi mund të jetë edhe emëri *mollë, nuse, peshk* e ndonjë tjetër, por janë më të paktë në numër.

Disa prej këtyre lokucioneve në Fjalorin e 2006-ës i gjejmë njëherësh edhe në formë të përbërë ose të përngjitur. Kështu, në Fjalor dalin si zë më vete (e jo nën zërin e emrit lule, siç dalin lokucionet), pra në formë përfaqësuese, emrat *lulebletë, luleborë, luledele, luledimër* etj. Duket se te këta emra është zhdukur mbaresa e ngurosur e rrjedhore që del te përbërësi i dytë i lokucionit (*lule blet-e, lule bor-e* etj.), duke u zëvendësuar me një -ë, gjë që tregon se këto fjalë kanë kapërcyer fazën e kalimit nga lokucioni në përbërje. Në disa fjalorë, si tek ai i P.Tases, këta emra dalin në formë të përngjitur (*lulebore, luledimri etj.*), gjë që tregon se edhe kjo fazë është kapërcyer tashmë me bjerren e mbaresës së rrjedhore dhe emra janë prirur drejt kompozimit. Megjithatë, mendojmë se, përderisa këto fjalë dalin në të njëjtin vend (në Fjalorin e 2006-ës) edhe si lokucione edhe si emra të përbërë, domethënë që procesi i kalimit nga lokucioni në përbërje nuk është konsoliduar ende. Prandaj, mund të përdoren të dy variantet dhe shkrimi i tyre si njësh si ndaras të mos quhet gabim ose shmangie nga norma.

Krahas këtyre lokucioneve ekzistojnë edhe disa grupe fjalësh që kanë strukturë të njëjtë me to, si: *bukë gruri, tokë buke, zog pule, vezë pate, vaj arre, vaj ulliri* etj. Këto togje, edhe pse nga pikëpamja strukturore janë e njëjta gjë me lokucionet, nuk mund të quhen lokucione, sepse mes elementeve përbërëse të tyre mund të hyjë edhe ndonjë

element tjetër dhe kuptimi i togut të mos priset. Po kështu, mund të themi se elementet përbërëse të tyre nuk janë të ngurosura si te lokucionet: mund të themi *zog pule*, por edhe *zog i pulës* dhe kuptimi të mbetet i njëjtë. Por, kur kemi të bëjmë me lokucion, si *zog blete* (*gargull*), nëse emri *bletë* nuk do të ishte i ngrosur në formën e rrjedhore së pashquar njëjës, por mund të dilte edhe në trajta të tjera, si *zog i bletës*, atëherë kuptimi do të ndryshonte.

Një nëntip tjetër strukturor është:

- emër i pashquar njëjës + emër në rrjedhore të pashquar shumës (*bar ethesh, bar rresh, lule ethesh, lule dhensh* etj.) Këto lokucione janë të pakta.

Nëntipa të tjerë strukturë që i përkasin tipit *emër+emër* janë edhe ata të formuar nga:

- emër i shquar njëjës + emër në gjinore të shquar njëjës (*bari i jetës, hiri i hardhisë, shoku i jetës, Kashta e Kumtrit, molla e Adamit, nusja e lalës, nusja e syrit, qafa e Buallit, rrushi i qyqes* etj.).

Te këto lokucione përbërësit e kanë humbur mëvetësinë kuptimore e gramatikore, që mund të kishin nëse do të dilnin në formën e togjeve të lira.

Edhe në këtë nëntip strukturor në Fjalorin e 2006-ës disa lokucione paraqiten në formën e tyre të përbërë (*nuselalë, rrushqyqe* etj.). Shihet se edhe këta emra dalin në formën e tyre përfaqësuese, pra ka rënë mbaresa *-e* e ngrosur e rrjedhore së pashquar. Edhe këtu, edhe pse prirja po shkon drejt përbërjes, përderisa këto fjalë përdoren në të dy variantet, mund të shkruhen e të përdoren të dyja.

- emër i pashquar njëjës + emër prejfoljor asnjans në rrjedhore njëjës (*bar të preri*).

Tipin e dytë strukturor e përbëjnë strukturat:

- emër + mbiemër (i nyjshëm ose i panyjshëm)

Me këtë strukturë janë formuar pak lokucione. Përbërësi i parë, *emri*, mund të jetë:

- në të pashquarën (*bar ngjitës, bar i trashë, gur shkrepës, lule mosmëharro, lule mosmëprek etj.*)
- në të shquarën (*Arusha e Madhe, Arusha e Vogël, Guri i Bardhë etj.*). Përgjithësisht, në këtë nëntip përfshihen emra të përveçëm që emërtojnë njësi, toponime etj.

Edhe pse lokucionet emërorë janë të shumta në numër, duket se tipat strukturorë janë të kufizuar.

VI.2.2 Përbërësit e lokucioneve mbiemërore

Përbërësit strukturorë të lokucioneve mbiemërore ngjajnë me përbërësit e disa lokucioneve emërore. Kështu, në strukturën e lokucioneve mbiemërore dallojmë këta përbërës:

- emër i pashquar + emër në rrjedhore të pashquar njëjës

Si përbërës i parë i këtij tipi strukturor mund të jetë emri:

- ngjyrë (*ngjyrë argjendi, ngjyrë dheu, ngjyrë hiri, ngjyrë portokalli, ngjyrë tjegulle, ngjyrë tulle*); ose emri
- bojë (*bojë argjendi, bojë dheu, bojë kafe, bojë qielli*).

Shumica e këtyre lokucioneve në Fjalorin e 2006-ës paraqiten edhe në formën e tyre të përbërë (*ngjyrëportokall, ngjyrëtjegull, ngjyrëtullë, bojëkafe, bojëqiell etj.*). Kjo dëshmon sërish se lokucioni ka kaluar në përbërje, duke humbur mbaresën e rrjedhores. Kështu, struktura e tyre si fjalë e përbërë mund të interpretohet si strukturë e tipit *emër + mbiemër*²¹³. Gjithashtu, në Fjalorin e 2006-ës hasim shumë fjalë të përbëra me temë të parë fjalëformuese emrat *ngjyrë dhe bojë (ngjyrëgështenjë, ngjyrëmanushaqe, ngjyrëmjaliti, ngjyrëvjollcë, bojëgështenjë, bojëmanushaqe, bojëshegë etj.)*, të cilat janë

²¹³ Shih: L.Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, 2009 : 158.

formuar prej lokucioneve përkatëse, por nuk gjejmë paralelisht edhe lokucionet. Sipas kësaj kuptohet se lokucionet kanë ikur nga përdorimi pas bashkimit të pjesëve përbërëse të tyre në një fjalë të vetme. Por, në të vertetë, në ligjërimin e përditshëm, në të shkruar e në të folur, këto fjalë përdoren më shumë në formë lokucioni, ku dallohet qartë mbaresa e rrjedhore së pashquar. Prandaj, as në këto raste procesi i kalimit nga lokucioni në përbërje nuk është konsoliduar ende. Edhe pse njihet tashmë prirja për realizimin e këtij procesi, mendojmë se në këtë pikë duket disi i sforcuar përdorimi i këtyre fjalëve vetëm në formë të përbërë.

- Tipin e dytë strukturor të ndërtimit të lokucioneve mbiemërore e përbëjnë mbiemrat e formuar prej *përsëritjes së drejtpërdrejtë të të njëjtit emër në formën e numrit shumës ose në formën e numrit shumës*. Të tilla në Fjalor janë dhënë lokucionet mbiemërore *lara-lara, lule-lule, thekë-thekë, zhele-zhele*²¹⁴ etj., të cilat motivohen prej ndajfoljeve të të njëjtit tip, prandaj quhen edhe formime me konversion prej ndajfoljeve. Këto lokucione në Fjalor paraqiten si zë më vete. Ndërsa formimet e të njëjtit tip, si: *pika-pika, vija-vija* etj. dalin vetëm si ndajfolje.

VI.2.3 Përbërësit e lokucioneve numërore

Lokucionet numërore kanë në strukturën e tyre dy ose më shumë elemente. Ato mund të jetën të lidhura ose jo me lidhëzën *e*.

Kur nuk lidhen me lidhëzën *e*, lokucionet numërore kanë strukturë:

- numëror + numëror (*një mijë, katër mijë, dy milion, një miliard* etj.).

Këto lokucione formohen me pjesëmarrjen e fjalëve *mijë, milion, miliard, bilion* etj. Ashtu si te numërorët e përngjitur, edhe në këto raste numërori më i vogël ndiqet nga numërorë më të mëdhenj. Kur këto lokucione përbëhen nga më shumë se dy elemente,

²¹⁴ Këto lloje ndërtimesh përdoren edhe si ndajfolje.

atëherë në strukturën e tyre shtohet lidhëza *e* (*një mijë e katërqind, dy milion e treqind e njëzet e shtatë* etj.)

Kur lidhen me lidhëzën *e* struktura e lokucioneve është:

- numëror + lidhëza *e* + numëror... (*njëzet e një, tridhjet e dy, njëqind e një* etj.).

Kur këto struktura përbëhen nga më shumë se dy elemente, ato përsëri lidhen me anë të lidhëzës *e* (*njëqind e tridhjetë e nëntë, një milion e katërqind e njëzet e tre* etj.).

Ndryshe nga fjalët e përngjitura dhe nga tipi i parë strukturor, në këto raste numri më i madh ndiqet nga një numër më i vogël (*njëzet e një, njëqind e dyzet e dy* etj.).

Rendi i përbërësve strukturorë të lokucioneve numërore është i ngulitur. Kështu, në rastin e strukturave kur numri më i madh ndiqet nga një numër më i vogël, nuk mund të ndodhë e kundërta (të themi p.sh., *një e njëzet* në vend të *njëzet e një* etj.), sepse lokucioni do të humbiste kuptimin dhe funksionin.

Në shkrimin e lokucioneve numërore vihet re ndonjë problem, sidomos në përdorimin e *-së* fundore. Kështu, shpesh numërori i përbërë *tridhjetë*, kur përdoret si element i parë i një lokucioni numëror del pa *-në* fundore: *tridhjet e dy*²¹⁵ etj. Ndërkohë që të gjitha lokucionet e tjera numërore që kanë të njëjtën strukturë, elementi i parë shkruhet me *-ë* fundore (*shtatëdhjetë e tre, dyqind e nëntëdhjetë e nëntë* etj.²¹⁶).

Gjithashtu, edhe për shkrimin e fjalëve *milion, miliard, trilion* etj., kur paraprihen nga numra më të mëdhenj se *një*, nuk mbahet një qëndrim. Kështu, në Drejtshkrimin e gjuhës shqipe dhe në Gramatikën e gjuhës shqipe I, këto fjalë të paraprija nga numra më të mëdhenjë se një shkruhen pa *-ë* fundore²¹⁷. Në Fjalorin e 2006-ës, kur shpjegohet kuptimi i fjalëve *miliard e trilion* thuhet përkatësisht: *miliard, -i,* numër i barabartë me

²¹⁵ Shih shembujt në: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, 1973 : 131 dhe në: *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, 2002 : 207. E.Likaj në: *Morfologji e shqipes standarde* (2010 : 70) jep një shembuj ku lokucioni *tridhjetë e pesë* shkruhet me *-ë* fundore. Në Fjalorin e 2006-ës nuk gjejmë ndonjë shembul ku numërori *tridhjetë* të përdoret si element i ndonjë lokucioni.

²¹⁶ Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, po aty; Gramatika e gjuhës shqipe I, po aty.

²¹⁷ Po aty.

një mijë milionë; *trilion*, -i,... numër i barabartë me *një mijë miliardë*²¹⁸. Pra, këtu, fjalët *miliard* e *trilion* janë të shkruara me -ë fundore.

Për të dhënë nga ana gramatikore kuptimin e shumësit dhe ndoshta për analogji me fjalën *mijë*, këto fjalë kur paraprihen nga numra më të mëdhenj se një, mund të shkruhen me -ë fundore.

VI.2.4 Përbërësit e lokucioneve përemërore

Duke qenë se janë të pakta, edhe tipat strukturorë të lokucioneve përemërore janë mjaft të kufizuar. Lokucionet përemërore kanë në përbërje të tyre gjithmonë një përemër të pacaktuar. Kështu tipat strukturorë të tyre janë:

- përemër i pacaktuar + përemër i pacaktuar (*çdo gjë, gjithë ç'*)
- përemër i pacaktuar + përemër lidhor (*cilido që, çfarëdo që, gjë që*²¹⁹, *kushdo që*).

Disa prej përemrave të pacaktuar që marrin pjesë në ndërtimin e këtyre lokucioneve janë përemra të përngjitur, të cilët në këtë rast kanë luajtur rol fjalëformues.

Përemrat e pacaktuar që janë edhe elementi i parë i lokucioneve përemërore, duke u ndjekur nga përemri lidhor *që* ose nga ndonjë përemër tjetër i pacaktuar funksionojnë si një përemër më vete. Mes tyre nuk mund të ndërhyjë ndonjë element tjetër qoftë i ndryshueshëm qoftë i pandryshueshëm, ashtu siç ndodh në të gjitha rastet e formimit të lokucioneve.

²¹⁸ Fjalor i gjuhës shqipe, 2006 : 629, 1106.

²¹⁹ Në lokucionin përemëror *gjë që*, fjala *gjë* del si përemër i pacaktuar i cili është formuar me konversion nga emri *gjë* në formë të ngurosur, prandaj disa studiues struktura të tilla i quajnë të formuara prej emrit *gjë* në formë të ngurosur + përemër lidhor. Nuk duhen ngatërruar rastet kur kemi të bëjmë me emrin *gjë* në formë të lirë (*gjë, gjë-ja*). Atëherë nuk kemi të bëjmë me lokucion, por me një grup të lirë fjalësh (*P.sh.: Pashë një gjë që më pëlqen*).

VI.2.5 Përbërësit e lokucioneve foljore

Lokucionet foljore kanë në strukturën e tyre dy ose tri elemente, një prej të cilëve përgjithësisht është folje²²⁰. Edhe në italishte, lokucionet foljore kanë po ashtu në strukturë një folje (kallëzues), kurse pjesa tjetër e lokucionit mund të jetë një fjalë tjetër dhe përgjithësisht një emër²²¹.

Kështu, lokucionet foljore në shqipe përfaqësohen nga këta tipa strukturorë:

- folje + emër

Duket se në këtë tip strukturor bën pjesë shumica e lokucioneve foljore të shqipes. Në këtë rast, emri mund të jetë:

- në të pashquarën njëjës (*bëj aluzion, bëj ballë, bëj çudi, bëj fjalë, kam dëshirë, kam durim, kam shpresë, ngul këmbë, marr hov, marrë pjesë, mbaj mend etj.*)²²²
- në të pashquarën shumës (*bëj marrëzi, bën rrudha etj.*)
- në të shquarën njëjës (*marr arratinë, mbaj fjalën etj.*)
- në të shquarën shumës (*fut hundët, vë themelet etj.*)

Ka edhe ndonjë rast kur emri në formë të ngurosor del në rrjedhore të shquar, si: *luaj vendit*. Ky lokucion për nga kuptimi është i barabartë me lokucionin *luaj nga vendi*, por në Fjalor jepet vetëm modeli i parë.

²²⁰ Këtu bëhet fjalë vetëm për lokucione foljore që janë përfshirë në Fjalorin e 2006-ës, por M. Domi përmend edhe lokucione foljore që kanë si kokë një emër (emër prejfoljor asnjans). Ai mendon se krahas lokucioneve foljore mund të ekzistojnë edhe emrat përkatës (*bëj ballë > të bërët ballë, ngre krye > të ngriturit krye etj.*) dhe, s'ka asnjë arsye që kur fjala bosht e togut është folje, ta quajmë folje ta quajmë togun "lokucion" dhe kur është emër jo (M. Domi, *Disa çështje të lokucioneve*, SF, 1985/1 : 216).

²²¹ Shih: Bianco F, *Locuzioni*, në: Enciclopedia dell'italiano I, Romë 2010 : 837. Sipas Bianco-s në italishte te lokucionet foljore dallojmë më shumë tipa strukturorë, ku elementi i dytë, përveçse një emër mund të jetë një ndajfolje (si edhe në shqipe), një mbiemër dhe infinitivi i një foljeje tjetër.

²²² Në Fjalorin e 2006-ës folja në këto lokucione del në formë përfaqësuese, por ka raste që del edhe në veten e tretë njëjës (*bën rrudha, merr valë etj.*), sipas kontekstit në të cilin përdoret.

Në të gjithë nëntipat strukturorë të tipit *folje + emër*, emri del në formë ngurosur, ai nuk mund të ndryshojë formë, sepse struktura e lokucionit do të prishej, togu do të merrte kuptim tjetër dhe vlera e tij nuk do të ishte e barabartë as kuptimisht dhe as gramatikisht me një folje të vetme.

Një tip tjetër strukturor, por mjaft i kufizuar, është edhe ai që përbëhet nga:

- folje + ndajfolje (*bëj mënjanzë, bën shtrenjtë* etj.)

Për ndërtimin e lokucioneve foljore të tipit folje + emër, marrin pjesë kryesisht foljet: *bëj, kam, marr, mbaj, vë, zë* e ndonjë tjetër.

Kur lokucionet përbëhen nga tri elemente, një prej të cilëve është gjithmonë një parafjalë, struktura e tyre e përgjithshme do të ishte:

- folje + parafjalë + emër

Parafjalët që marrin pjesë në këto ndërtime, janë: *nga, në, me, nën, ndër, për* etj. Në varësi të tyre, elementi i tretë i lokucionit, emri, përdoret në rase të ndryshme. Kështu, nëntipat strukturorë që formojnë këto struktura janë:

- folje + parafjala *nga* + emër në emërore [(i) *doli nga hundët, (më) doli nga mendtë, u nda nga jeta, (e) fshiu nga mendja* etj.].

Parafjala *nga*, përgjithësisht, kërkon një emër në të shquarën. Prandaj elementi i tretë i strukturës së këtyre lokucioneve përemërore, emri, është në trajtë të shquar. Ai mund të përdoret në formën e numrit njëjës, por edhe në formën e shumës.

- folje + parafjala *në* + emër në kallëzore [*marr në pyetje, marr në qafë, marr në shqyrtim, zë në gojë, (e) ruaj në mendje, vë në rrezik, vë në shfrytëzim, vë në veprim* etj.]

Në këto struktura emri del në trajtë të pashquar dhe në numrin njëjës. Kjo vjen ngaqë format gramatikore të emrit janë të kufizuara, edhe sepse ato nuk luajnë rol kuptimdalues, kur është fjala për vlerën semantike të të gjithë lokucionit²²³.

- folje + parafjala *me* + emër në kallëzore (*bëj me dorë, zë me gojë, marr me mend* etj.)

Edhë në këtë nëntip strukturor emri është në trajtë të pashquar njëjës, rrallë del në shumës.

- folje + parafjala *nën* + emër në kallëzore (*marr nën mbrojtje*)

Këtu dallojmë një numër mjaft të kufizuar lokucioneesh foljore.

- folje + parafjala *me* + emër në kallëzore (*zë me gojë, marr me mend* etj.)
- folje + parafjala *ndër* + emër në kallëzore (*kam ndër mend, sjell ndër mend, vjen ndër mend* etj.)

Në këto raste parafjala *ndër* ndiqet, përgjithësisht, nga emri *mend*, i cili është në të pashquarën shumës.

- folje + parafjala *për* + emër në kallëzore (*kam për zemër* etj.)
- folje + parafjala *për* + emër në rrjedhore [*kap për mënge, (e) zuri për veshi, zë për dore* etj.]

Në këtë nëntip strukturor vendin e parafjalës *prej* të rrjedhores e zë parafjala *për*, e cila përdoret vetëm me emra në rrjedhore të pashquar.

Shihet se pjesa më e madhe e lokucioneve foljore kanë strukturë folje + emër. Por edhe lokucionet me tre përbërës strukturorë zënë vend të konsiderueshëm mes tyre. Këtu mund të ketë edhe ndonjë lokucion të formuar me ndonjë parafjalë tjetër, veç

²²³ Z.Daci, *Vështrim rreth një tipi të lokucioneve foljore*, në: *Gjuha jonë* 1985/3 : 59.

atyre që kemi analizuar, por rastet në Fjalor janë të kufizuara. Ato mund të jenë më të përdorura në gjuhën e folur, në letërsinë artistike e në publicistikë²²⁴.

VI.2.6 Përbërësit e lokucioneve ndajfoljore

Strukturat e lokucioneve ndajfoljore janë të ndryshme dhe më të larmishmet, krahasuar me pjesët e tjera të ligjëratës. Pjesa më e madhe e lokucioneve ndajfoljore ka në strukturën e vet një emër, i cili, duke u bërë pjesë përbërëse e lokucionit, ka pësuar ndryshime kuptimore dhe është ngurosur. Kjo ka sjellë edhe ndryshime të karakterit gramatikor: humbjen e të gjitha kategorive gramatikore të emrit dhe humbjen e aftësisë për t'u lidhur nga ana sintaksore me njësitë gjuhësore që mund të lidhet një emër. Kështu, emri ndajfoljëzohet dhe, si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht, funksionon, së bashku me pjesët e tjera të lokucionit, si një ndajfolje. Shpesh lokucionet ndajfoljore formohen edhe prej dy emrash, të cilët, të dy bashkë, kanë kaluar në procesin e ndajfoljëzimit. Kur lokucionet ndajfoljore përbëhen prej dy emrash, struktura e tyre mund të ndërtohet nga *përsëritja*, që mund të jetë e tipave të ndryshëm²²⁵. Këta tipa strukturorë përbëhen:

- nga përsëritja e të njëjtit emër në formën e njëjësit (*copë-copë, këmbë-këmbë, palë-palë, pikë-pikë, tufë-tufë etj.*).
- nga përsëritja e të njëjtit emër në formën e shumësit (*duar-duar, fije-fije, fjolla-fjolla, flokë-flokë, gropa-gropa, grupe-grupe, hope-hope, hove-hove, tufa-tufa, thela-thela, vende-vende, vija-vija etj.*).

²²⁴ Studiuesja Z.Daci në studimin e saj të gjerë "Vështrim rreth një tipi të lokucioneve foljore" (Gjuha jonë, 1985/3, ku trajton me hollësi lokucionet me strukturë *folje + parafjalë + emër*, jep edhe raste të tjera lokucioneesh të ndërtuara me parafjalët *pa, mbi, pas etj.*, por shembujt janë kryesisht nga letërsia artistike. Gjithashtu, ndër to ka grupe fjalësh të cilat janë trajtuar si lokucione, por ne mendojmë se u përkasin më shumë njësisë frazeologjike, si: *nxjerr nga hundët, vete pas avazit etj.*

²²⁵ Shih: E.Hysa, *Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe*, në: Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, 1972 : 296.

Formimet e tipit të parë dhe të dytë mund të përbëjnë edhe një model të gjallë fjalëformimi.

- nga përsëritja e të njëjtit emër të lidhur me lidhëzën *e* (*anës e anës, rreth e rreth, varg e varg*).

Në këto raste emri mund të dalë në trajta të ndryshme, si në shembullin e parë që del në formën e rrjedhores së shquar ose si në shembujt e tjerë që del në formën e emërores së pashquar²²⁶.

- Një tip tjetër strukturor është ai që përbëhet prej dy emrash me kuptim të përafërt që lidhen me lidhëzën *e* (*anë e kënd*²²⁷, *copë e çikë, copë e kothere, copë e grimë, çikë e thërrime, rreth e rrotull, rreth e qark* etj.).

Me të njëjtën strukturë ndërtohen edhe lokucionet ndajfoljore që përbëhen prej dy emrash me kuptim antonimik (*dimër e verë, ditë e natë, fund e krye, këmbë e krye, mot e jetë, orë e çast* etj.).

Në këto ndërtime emrat që përbëjnë lokucionin, janë në emërore të pashquar.

- Në këtë tip strukturor, që përbëhet prej emrash me kuptim të përafërt a të kundërt të lidhur me lidhëzën *e*, hyjnë edhe disa lokucione, emrat përbërës të të cilëve kanë përpara parafjalët *pa* ose *për*. Këto parafjalë mund të ndodhen përpara të dy emrave ose përpara vetëm njërit prej tyre, kurse tjetri e ka të nënkuptuar (*pa anë e pa fund, për jetë e mot, orë e pa kohë* etj.).

²²⁶ Në këta tipa, të formimit të lokucioneve ndajfoljore prej përsëritjes së të njëjtit emër, E.Hysa dallon edhe një tip strukturor të formuar prej përsëritjes së të njëjtit emër të gjinisë femërore në trajtën e emërores së shquar (radha-radha, koha-koha, reja-reja, kamba-kamba etj.). Sipas Hysës, këto formime i gjejmë pothuajse vetëm tek autorët gegë dhe kryesisht vetëm nëpër poezi, me sa duket për arsye të rimës (E.Hysa, *Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe*, në: Çështje të fonetikës..., 1972 : 297). Në Fjalorin e 2006 nuk kemi hasur formime të tilla.

²²⁷ Në Fjalor, lokucionin *anë e kënd* e gjejmë si zë më vete në formë të përngjitur, gjë që tregon gjithnjë e më shumë prirjen drejt leksikalizimit.

- nga përsëritja e të njëjtit emër, ku përbërësi i parë është në emërore të shquar, kurse i dyti në rrjedhore të shquar (*dora-dorës, fundja-fundjes, goja-gojës, këmba-këmbës, nata-natës* etj.)

- nga përsëritja e të njëjtit emër, të lidhur me parafjalë të ndryshme:

- me parafjalën *për* (*ballë për ballë, darkë për darkë, dhëmb për dhëmb, fije për fije, fjalë për fjalë, javë për javë, krah për krah, mëngjes për mëngjes, vit për vit* etj.).

Në këto ndërtime, emrat që përbëjnë lokucionin janë në të pashquarën njëjës, përbërësi i parë është në emërore, kurse i dyti që vihet re edhe nga prania e parafjalës *për*, është në kallëzore.

- me parafjalën *më* (*breg më breg, degë më degë, dorë më dorë, gojë më gojë, herë më herë, kokë më kokë, qoshe më qoshe, thikë më thikë* etj.).

Edhë në këto raste, emrat janë në të pashquarën njëjës, përbërësi i parë është në emërore, kurse i dyti, nisur edhe nga natyra e parafjalës është në kallëzore.

- me parafjalën *pas* (*brez pas brezi, hap pas hapi, herë pas here, orë pas ore* etj.).

Në këtë nëntip strukturor emrat që përbëjnë lokucionin janë sërish në të pashquarën njëjës, përbërësi i parë është në emërore, kurse i dyti, nisur edhe nga parafjala që e prin, është në rrjedhore²²⁸.

Këtu mund të përfshihet edhe lokucioni ndajfoljor *një ditë prej ditësh*, i përbërë nga përsëritja e emrit ditë, të lidhur me parafjalën *prej*, ku përbërësi i parë është në të pashquarën njëjës, gjë që e tregon edhe nyja joshquese një, kurse përbërësi i dytë, ndryshe nga rastet e mësipërme, është në rrjedhore të pashquar *shumës*.

²²⁸ E.Hysa, në ndërtimin e strukturave të tilla (përsëritja e të njëjtit emër që lidhen me parafjalë të ndryshme) përmend ndërmjetësinë edhe të parafjalëve: *me* (*flakë me flakë, gojë me gojë* etj.), *mbi* (*det mbi det, gurë mbi gurë* etj.), *në e ndër* (*breg në breg, curr në curr, sy ndër sy* etj.), *nga* (*mot nga mot, ditë nga ditë* etj.). Në Fjalor kemi gjetur vetëm ndonjë lokucion të formuar me ndërmjetësinë e këtyre parafjalëve (*trup me trup, sy ndër sy, këmbë mbi këmbë*), ndoshta ngaqë, përgjithësisht, këto lloje lokucioneesh, të ndërtuara në këtë mënyrë, janë krahinore e më të kufizuara.

- nga përsëritja e të njëjtit emër, formohen edhe lokucione të një tipi të veçantë, që përbëhen nga: *parafjala nga + emër në emërore të shquar + parafjala në + emër në kallëzore të pashquar (nga brezi në brez, nga dita në ditë, nga viti në vit etj.)*.

Një tip i veçantë strukturor e mjaft i përhapur në shqipe i lokucioneve ndajfoljore që kanë në përbërje të tyre një emër, është ai që përbëhet nga një:

- parafjalë + emër²²⁹

Parafjalët që marrin pjesë në këto struktura janë:

- parafjala *në* (*në çast, në kohë, në përgjithësi, në veçanti, në tym etj.*)
- parafjala *me*. Kjo parafjalë mund të ndiqet:
 - a) nga një emër në të pashquarën (*me acari, me ditë, me një hov, me kohë, me radhë, me nxit*);
 - b) nga një mbiemër i emëruar i gjinisë asnjënjë (*me të butë, me të shpejtë etj.*)
- parafjala *pa* (*pa fjalë, pa fund etj.*)²³⁰.

Në këtë tip strukturor hyn edhe ndonjë lokucion i formuar:

- me parafjalë të *gjinores* (*nga ana e anës, në anë të anës, në fund të fundit etj.*).

²²⁹ Ky tip lokucioneesh është trajtuar nga E.Hysa dhe Sh.Demiraj, i cili bën një analizë të plotë se pse disa togje të tipit parafjalë + emër duhet të quhen lokucione (E. Hysa, i cit., dhe Sh.Demiraj, *Rreth ndajfoljësimit (adverbializimit) të disa formave gramatikore dhe të disa togjeve të tipit parafjalë + emër*, në: SF 1970/1.

²³⁰ Sh.Demiraj përmend si lokucione ndajfoljore të këtij tipi edhe ato të formuara me parafjalët *nga* e *për* (nga herë, nga hera, nga ditë, nga dita, për dita, për hera, nga mot etj.). Në Fjalor një pjesë e këtyre ndërtimeve na paraqiten në formë të përngjitur (*ngaherë, përherë etj.*), që tregon se të tilla struktura kanë ardhur duke iu afruar gjithnjë e më shumë kuptimit të ndajfoljeve *kurdoherë*.

Në Fjalorin e 2006-ës, të formuar prej parafjalës *për* dhe një emri kemi gjetur lokucionin *për analogji*, që duket se është kalkim, pra nuk është ndërtuar sipas modeleve të tipit: *për herë, për ditë etj.*). Megjithatë, ky grup fjalësh mund të quhet lokucion përderisa plotëson kriteret për të qenë i tillë: pjesët përbërëse të tij nuk mund të përdoren më vete si fjalë të veçanta (emri është ngurosor), sidomos nga ana gramatikore. Edhe parafjala e ka humbur aftësinë e saj lidhëse duke qenë se përdoret vetëm para një emri në formë të ngurosor. Gjithashtu, ky grup fjalësh është i barasvlershëm me një ndajfolje.

Duket se tipi strukturor *parafjalë + emër* në formimin e lokucioneve ndajfoljore është mjaft prodhimtar dhe i gjallë në gjuhën shqipe. Ai përbën kështu një model dhe është *burim për zgjerimin e kategorisë së ndajfoljeve*²³¹.

Përgjithësisht, pjesët përbërëse të këtyre togjeve, kur kanë kaluar në klasën e ë ndajfoljeve, si gramatikisht ashtu edhe kuptimisht kanë humbur diku më shumë e diku më pak mëvetësinë si fjalë të veçanta dhe janë shndërruar në njësi të pandashme me vlerë dhe tipare ndajfoljore. Në këto raste emri është ngurosur duke humbur kategoritë gramatikore dhe aftësinë e lidhjeve sintaksore. Nga ana kuptimore, ai përdoret në një kuptim mjaft të përgjithshëm dhe kryesisht abstrakt, që tregon kohë ose gjendje shpirtërore, prandaj i humbet më shpejt veçoritë kuptimore.²³² Po ashtu, parafjala, duke u përdorur para një emri të ngurosur, humbet aftësinë për t'u përdorur para të njëjtit emër në një formë tjetër. E njëjta gjë vlen të thuhet edhe për rastet e lokucioneve të formuara me anë të përsëritjes me ndërmjetësinë e parafjalëve.

Lokucionet ndajfoljore mund të kenë në strukturën e tyre një ose dy ndajfolje. Kur lokucionet ndajfoljore përbëhet prej dy ndajfoljesh, ashtu si te lokucionet ndajfoljore që përbëheshin prej dy emrash, si mjet i veçantë për formimin e tyre shërben *përsëritja*. Kështu, veçojmë tipat strukturorë të formuar nga:

- përsëritja e së njëjtës ndajfolje (*ashtu-ashtu, aty-aty, hollë-hollë, kur e kur, lehtë-lehtë, rëndë-rëndë, shumë-shumë etj.*).
- përsëritja e së njëjtës ndajfolje me lidhëzën *e* (*afër e afër etj.*).

Këtu mund të përmendim edhe rastin kur përbërësi i dytë përdoret në shkallën krahasore, si: *lart e më lart etj.*²³³ Ndajfolja e përdorur në shkallën krahasore nuk mund të përdoret

²³¹ E.Hysa, e cit. fq.304.

²³² E.Hysa, po aty.

²³³ Në këtë tip strukturor përgjithësisht në të gjitha rastet përbërësi i dytë mund të përdoret në shkallën krahasore (*afër e më afër, shpejt e më shpejt*). Në Fjalor kemi hasur vetëm lokucionin *lart e më lart*.

më vete në të njëjtin kontekst. Duke qenë pjesë e lokucionit ajo është ngurosur dhe nuk mund të përdoret në shkallë të tjera, ndryshe kuptimi i lokucionit do të prishej.

- përsëritja e së njëjtës ndajfolje me parafjalë. Më e përdorshme në këtë rast është parafjala *për* (*aty për aty, sot për sot, vetëm për vetëm etj.*)²³⁴ Por mund të ketë edhe ndonjë parafjalë tjetër, si në rastin e emrave, si parafjala *më* e *nga* (*kot më kot, pak nga pak etj.*)

Tipa të tjerë strukturorë të lokucioneve ndajfoljore janë ata të formuar nga:

- bashkimi i dy ndajfoljeve me kuptim antonimik (*andej-këtej, ashtu-kështu, aty-këtu, tutje-tëhu etj.*)
- bashkimi i dy ndajfoljeve me kuptim antonim të lidhura me lidhëzën *e* (*andej e këtej, lart e poshtë, gjatë e gjerë, gjerë e gjatë, mbarë e mbrapsht*) etj.
- bashkimi i një emri me një ndajfolje ose anasjelltas me lidhëzën *e* (*në fjalë e sipër, sot e mot etj.*).

Një tip strukturor më vete i lokucioneve ndajfoljore është ai i formuar me:

- parafjalën *për* + një mbiemër të emërzuar të gjinisë asnjënjëse në rrjedhore (për së gjalli, për së gjati).

Në këtë mënyrë në gjuhën shqipe krijohen një sërë lokucioneve ndajfoljore mbi bazën e modelit të dhënë²³⁵.

²³⁴ Në Gramatikën e gjuhës shqipe 1 (fq. 380) në këtë tip përfshihen edhe lokucionet ndajfoljore *brenda për brenda* dhe *drejt për drejt*. Në Fjalorin e 2006-ës këto grupe fjalësh dalin vetëm në formë të përngjitur si zë më vete, që tregon përsëri prirjen që kanë lokucionet për t'u bashkuar në një fjalë të vetme.

²³⁵ Në studime e gramatika përmenden si lokucione ndajfoljore edhe disa grupe fjalësh të përbëra prej dy foljesh të lidhura me lidhëzën *e*, të tipit: *çel e mbyll, shkel e shko* etj. Në Fjalor këto na paraqiten në formë të përngjitur. Edhe në ndjenjën gjuhësore të folësve këto po trajtohen si fjalë të përngjitura, që tregon prirjen drejt sintentizimit të mjeteve të shprehjes dhe mënjanimit e strukturave analitike.

VI.2.7 Përbërësit e lokucioneve parafjalore²³⁶

Përgjithësisht, në strukturën e lokucioneve parafjalore marrin pjesë dy ose tre përbërës, ku një prej tyre mund të jetë një emër, ndërsa përbërësit e tjerë mund të jenë një ose dy parafjalë. Parafjalët që marrin pjesë në ndërtimin e këtyre lokucioneve janë: *në, për, me, nga*. Këto janë elementi i parë i strukturës së lokucionit, pra vendosen para emrit, përveç parafjalës *me*, e cila mund të vendoset edhe pas emrit si elementi i tretë i strukturës së një lokucioni me tre përbërës. Lokucionet parafjalore, përgjithësisht, përdoren me rasën gjinore²³⁷, por mund të përdoren edhe me rrjedhoren e pashquar (*me anë miqsh, në bazë strukturash* etj.) ose me kallëzoren. Tipi strukturor më i përhapur te lokucionet parafjalor është:

- parafjalë + emër

Parafjalët që marrin pjesë në ndërtimin e këtyre strukturave janë:

- parafjala *në* (*në ag, në anë, në dëm, në fushën, në kurriz, në emër, në drejtim, në bazë, në këmbë, në vend, në pikë, në prag, në saje* etj.).
- parafjala *për* (*për arsye, për faj, për hir, për punë, për shkak*)
- parafjala *me* (*me anën, me përjashtim*)
- parafjala *nga* (*nga shkaku*)²³⁸

Në të gjitha këto ndërtime emri që është elementi i dytë i strukturës së lokucionit parafjalor, mund të jetë në kallëzore *të pashquar* njëjës ose në kallëzore *të shquar*

²³⁶ Te lokucionet parafjalore nuk do të përfshijmë ato që janë formuar me konversion prej lokucioneve ndajfoljore.

²³⁷ Sh.Demiraj i trajton këto togje si lokucione të ngurosura parafjalore, të formuara nga *një parafjalë, një emër dhe një njëjës e përparme* (*Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë 1971 : 261). Kështu, njëjës gjinor ai nuk e trajton si të tillë, por e sheh si pjesë përbërëse të lokucionit dhe ndoshta emrin që është pjesë përbërëse e lokucionit e trajton si emër të gjinorës. Pra, nuk flet për parafjalë që përdoren me rasën gjinore, por vetëm sa i përmend si lokucione.

²³⁸ Lokucionet parafjalore që ndërtohen me parafjalën *nga* janë të rralla. Në Fjalor kemi hasur vetëm lokucionin *nga shkaku*.

njëjës. Kur lokucioni përbëhet prej parafjalës *nga*, emri del në emërore të shquar njëjës, ashtu siç e kërkon kjo parafjalë.

Tipi i dytë strukturor është ai që përbëhet nga:

- parafjalë + emër + parafjalë (*në bashkëpunim me, në marrëveshje me, në përputhje me etj.*)

Këto lokucione janë më të pakta, krahasuar me lokucionet e tipit të parë. Në këto struktura parafjala e parë që është edhe elementi i parë përbërës i lokucionit, është parafjala *në*, kurse parafjala e dytë ose elementi i tretë përbërës i lokucionit është parafjala *me*. Këto lokucione parafjalore përdoren me rasën kallëzore.

Në të gjitha lokucionet parafjalore emri që merr pjesë në strukturën e lokucionit del në formë të ngurosur. Ai e humb kuptimin e sendësisë dhe *merr një kuptim të përgjithshëm abstrakt ose të fytuar*²³⁹. Gjithashtu, kur kalon në klasën e parafjalëve emri humbet edhe kategoritë gramatikore. Duke u bërë pjesë e një lokucioni parafjalor, emri humbet pavarësinë e tij funksionale dhe hyn në marrëdhënie sintaksore varësie me fjalë të tjera. Pra, ai *humbet një nga tiparet e tij sintaksore bazë, e pikërisht aftësinë për të pasur pranë vetes fjalë përcaktuese*²⁴⁰. Në të gjitha rastet e ndërtimit të lokucioneve parafjalore, kur emri humbet mëvetësinë dhe nuk funksionon më si gjymtyrë fjalie, ka ndodhur procesi i morfologjizimit të grupeve të fjalëve.

Disa lokucione parafjalore i përkasin gjuhës së folur të popullit, si: *për punë, në këmbë, në mes etj.* Duket se këto kanë krijuar një model për formimin e lokucioneve të tjera të këtyre tipave, që i përkasin kryesisht stilit shkencor, publicistik e zyrtar. Prandaj, *formimi i lokucioneve parafjalore që kanë në strukturën e tyre një emër është rruga kryesore e pasurimit të klasës së parafjalëve në gjuhën shqipe*²⁴¹.

²³⁹ Gramatika e gjuhës shqipe 1, 2002 : 385.

²⁴⁰ M.Çeliku, *Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe*, në: Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II, 1975 : 214.

²⁴¹ Gramatika e gjuhës shqipe 1, 2002 : 387.

Përveç emrave, për ndërtimin e lokucioneve parafjalore mund të përdoret edhe ndonjë pjesë tjetër e ligjëratës, por këto raste janë shumë të kufizuara. I tillë është përemri i pacaktuar *gjithë* dhe pjesorja *lidhur*, që krijojnë këto struktura:

- parafjala *me* + përemri *gjithë* (*me gjithë*)
- pjesorja *lidhur* + parafjala *me* (*lidhur me*)

VI.2.8 Përbërësit e lokucioneve lidhëzore

Tipat strukturorë të lokucioneve lidhëzore janë mjaft të larmishëm. Lokucionet lidhëzore mund të kenë dy, tre ose katër përbërës, ndonjëherë edhe pesë (*jo vetëm që...por edhe etj.*). Këta përbërës mund të rrinë pranë njëri-tjetrit, por mund të përdoren edhe të ndarë. Një prej tyre është gjithmonë një lidhëz ose një fjalë lidhëse. Lidhëzat që bëjnë pjesë më shumë në strukturën e lokucioneve janë *që* dhe *se*. Përbërësit e tjerë mund të jenë emra, forma foljore, ndajfolje, përemra, lidhëza, pjesëza. Kështu, kur në strukturën e lokucionit është një *emër* dallojmë këta tipa strukturorë:

- emër + lidhëz (*për arsye se, për shkak se, me kusht që, në çastin kur, në kohën që, në kohën kur, në mënyrë që, në rast se, në vend që, nga shkak se etj.*)

Emri në këto raste shoqërohet me parafjalët *për, me, në, nga* dhe mund të jetë në emërore ose në kallëzore të shquar ose të pashquar, në varësi të parafjalës me të cilën përdoret, kurse përbërësi tjetër, lidhëzat, janë *se* dhe *që*, ndonjëherë edhe lidhëza me prajardhje ndajfoljore *kur*.

Në këto ndërtime mundet që midis emrit dhe parafjalës të jetë edhe përemri i pacaktuar *çdo* (*në çdo kohë që, nga çdo anë që, për çdo rast që*), i cili i jep lidhëzës një kuptim tjetër, kryesisht vendor e kohor.

Të gjitha këto lokucione lidhëzore janë formuar nga leksikalizimi i togjeve të përbëra prej një emri të paraprirë nga një parafjalë dhe të ndjekur nga lidhëzat *se, që e kur*. Edhe këtu, ashtu si në çdo rast tjetër kur bëhet pjesë e strukturës së lokucioneve, emri nguroset, humbet pavarësinë, duke u përdorur kështu në formë të pandryshueshme. Lokucionet lidhëzore që njërin prej përbërsve e kanë emër, janë relativisht të reja, prandaj edhe shkalla e gramatikalizimit të tyre është më e dobët. Emrat, në këto ndërtime, ruajnë njëfarë mëvetësie kuptimore.

- përemër + emër + lidhëz (*sa herë që, sa kohë që* etj). Përemri *sa* në këto raste përdoret si fjalë lidhëse.

Këto lokucione mund të përdoren edhe pa lidhëzën *që*. Për emrin që bën pjesë në strukturën e këtyre lokucioneve vlen të thuhet e njëjta gjë si emrat që marrin pjesë në strukturat e mësipërme.

Një tip tjetër strukturor është ai që përbëhet prej një *forme foljore* dhe që ndërtohet nga:

- lidhëz + formë foljore + lidhëz (*në qoftë se, po qe se, në është se, po të jetë se*)

Vetëm lidhëza *duke qenë se* është e formuar prej dy elementesh (*formë foljore + lidhëz*).

Edhe në këto lokucione lidhëzore, forma foljore është ngurosur dhe, duke qenë se janë më të vjetra e më të përdorura, janë edhe më të gramatikalizuara.

Ndonjëherë përpara këtyre lokucioneve përdoret edhe pjesëza *edhe* (*edhe në qoftë se, edhe po qe se*).

Kur lokucioni ka në përbërjen e vet një ndajfolje, ndërtohet struktura e tipit:

- ndajfolje + lidhëz (*kështu që, kurdo që, kudo që, mjaft që, përpara se, sado që, sido që, vetëm se* etj.).

Një pjesë të lokucioneve të këtij tipi në Fjalor i gjejmë edhe në formë të përngjitur (*sado që, sido që, tekdo që > sadoqë, sidoqë, tekdoqë*), gjë që tregon shkallën e lartë të gramatikalizimit të këtyre togjeve dhe prirjen e mëtejshme drejt sintetizimit.

Kur lokucioni ka në përbërje një *pjesëz*, ndërtohen këta tipa strukturorë:

- pjesëz + lidhëz (*edhe në, edhe sikur, edhe pse, edhe sepse, që ku, që kur, qysh se etj.*)
- Prej lidhëzash e pjesëzash (që mund të jenë më shumë se një) formohet një tip tjetër strukturor i lokucioneve lidhëzore: *jo që...por (edhe), jo vetëm që...por edhe, jo vetëm që...porse, le që...por (edhe), si...(ashtu) edhe etj.*

Kur në strukturën e lokucionit marrin pjesë lidhëza, lokucionet përbëhen nga:

- e njëjta lidhëz që përsëritet (*daç...daç, ja...ja, hem...hem, ndo...ndo, qoftë...qoftë, si...si*).

Këto lidhëza nuk mund të përdoren më vete, duke ruajtur të njëjtin kuptim. Lidhëzat *ja* e *ndo* nuk mund të përdoren pa u përsëritur; fjalët *qoftë* e *daç*, nëse nuk përsëriten, mbeten forma foljore.

- prej dy lidhëzash të ndryshme (*si...ashtu edhe, në...apo*).

Të gjitha fjalët që përbëjnë strukturën e një lokucioni lidhëzor shprehin një kuptim të vetëm, i cili shpesh buron nga vetë kuptimi i fjalës emërtuese që është pjesë e lokucionit. Gjithashtu, ato funksionojnë si një lidhëz e vetme, pra si një pjesë e ligjëratës. Shumica e lokucioneve lidhëzore janë formime relativisht të reja dhe përdoren më shumë në gjuhën e publicistikës e të shkencës për të shprehur lloje të ndryshme marrëdhëniesh semantiko-sintaksore²⁴².

²⁴² Shih: Gramatika e gjuhës shqipe 1, 2002 : 404.

VI.2.9 Përbërësit e lokucioneve pjesëzore

Nga pikëpamja strukturore, lokucionet pjesëzore nuk zënë vendin kryesor në klasën e pjesëzave. Shumica e pjesëzave në gjuhën shqipe janë fjalë të thjeshta. Prandaj, edhe tipat strukturorë të lokucioneve lidhëzore janë më të kufizuar. Kështu, lokucionet lidhëzore formohen kryesisht në dy mënyra:

- nga përsëritja e së njëjtës pjesëz që lidhet me një lidhëz bashkërenditëse ose nënrenditëse (*jo që jo, ku e ku*²⁴³, *po se po, po e po, vetëm e vetëm*²⁴⁴).
- pjesëz + lidhëz (*as që, ja që, le që, se mos, vetëm se, vetëm që*)

Në klasën e pjesëzave hyn edhe lokucioni *si urdhëron*²⁴⁵, i cili është formuar nga ndajfolja *si* dhe trajta e ngurosur *urdhëron* e foljes *urdhëroj*.

Kur kalojnë në klasën e pjesëzave, pjesët e tjera të ligjëratës (fjalët: *le, urdhëron, vetëm, si, ku, kur etj.*) e humbasin ose e dobësojnë ndjeshëm kuptimin leksikor. Gjithashtu humbasin kategoritë gramatikore [kështu, pjesëza e ngurosur foljore *le* (trajtë e gjymtë e urdhërores së foljes *le* në vetën e dytë njëjës²⁴⁶) nuk mund të qëndrojnë më vete, sepse ka dobësuar thuajse plotësisht kuptimin leksikor, ka humbur kategoritë gramatikore të foljes, si edhe lidhjet sintaksore] dhe funksionin sintaksor, pra nuk funksionojnë më si gjymtyrë e veçantë e fjalisë. Po kështu, edhe folja *urdhëron* e ka zbehur kuptimin leksikor dhe i ka humbur të gjitha kategoritë gramatikore të foljes.

²⁴³ Fjala *ku* trajtohet fillimisht si ndajfolje, pastaj me konversion kalon në klasën e pjesëzave dhe trajtohet si pjesëz e thjeshta. Kështu ajo përdoret për të formuar lokucione lidhëzore, prandaj themi se struktura e këtij lokucioni është e ndërtuar nga përsëritja e së njëjtës pjesëz dhe *jo* e së njëjtës ndajfolje.

²⁴⁴ Të njëjtën gjë si për lokucionin *ku e ku* mund të themi edhe për lokucionin *vetëm e vetëm*.

²⁴⁵ Pothuaj në të gjitha rastet grupi i fjalëve *si urdhëron* është trajtuar si lokucion ose si shprehje pasthirmore, pra bënte pjesë në klasën e pasthirmave. Në Fjalorin e 2006-ës ky grup fjalësh trajtohet si pjesëz.

²⁴⁶ E. Angoni, *Pjesëzat*, në: Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, 1972 : 314

VI.2.10 Përbërësit e lokucioneve pasthirmore

Lokucionet pasthirmore janë fjali dëshirore jo të zgjeruara, që përdoren si formula stereotipe urimi, qortimi, mallkimi, përshëndetjeje, me një kuptim të vetëm dhe me një intonacion të posaçëm dëshiror.

Struktura e këtyre lokucioneve përbëhet nga dy ose më shumë elemente, të cilat së bashku kryejnë funksionin e një pasthirrme të vetme. Përbërësit e lokucioneve pasthirmore janë fjalë kuptimplota. Një prej tyre përgjithësisht është një folje në dëshirore. Vendin kryesor në këto ndërtime e zënë foljet *kam* dhe *jam* në mënyrën dëshirore.

Kur në strukturën e lokucioneve pasthirmore bën pjesë një *folje*, dallojmë këta tipa strukturorë:

- folje në dëshirore + emër dhe anasjelltas [*të ardhsha për të mirë!*, *qofsh me jetë!*, *të gjettë (të priftë) e mira!*, *ju ardhshim për të mirë!*, *qofsh me nder!*, *qofsh me shëndet!*, *shëndet pastë!* etj.]

Në këtë nëntip strukturor, folja në dëshirore ndiqet përgjithësisht nga një emër i pashquar me parafjalë. Në disa raste kemi të bëjmë me një mbiemër të emëruar (*të gjettë e mira!* etj.)

- folje në dëshirore + ndajfolje dhe anasjelltas (*qofsh shëndoshë!* *mirë mbetsh!* *të vajttë mbarë!*, *vafsh (ardhsh) shëndoshë!*, etj.).

- folje në dëshirore + mbiemër (*qofsh i gëzuar!*, *e kalofsh i gëzuar!* etj.)

Ka raste kur kallëzuesi (folja në dëshirore e konkretisht folja *qoftë*) nuk del në pah, por nënkuptohet, si te: *punë e mbarë!*, *udhë e mbarë!*, *me shëndet!* etj.

- folje në dëshirore + lidhëza *e* + folje në dëshirore (*rrofsh e qofsh!*)

Çdo fjali-formulë, që ka formën e një lokucioni, shpreh një kuptim të vetëm të përgjithshëm që, përgjithësisht është kuptim dëshiror, dhe kryen funksionin e një

pasthirrme të vetme. Nga pikëpamja sintaksore, ashtu si të gjitha pasthirrmat e tjera, ato nuk lidhen me pjesë të tjera të fjalisë, kështu që nuk janë gjymtyrë të saj, prandaj mund të qëndrojnë më vete. Gjithashtu, mes elementeve përbërëse të lokucioneve pasthirrmore nuk mund të ndërhyjë ndonjë element tjetër, përndryshe, struktura e lokucionit do të prishej e nuk do të kishte kuptim. Edhe pse përbëhen prej fjalësh emërtuese që mund të ndryshojnë formë, vetë lokucionet pasthirrmore si një e tërë nuk ndryshojnë. Ato nuk mund të marrin elemente fjalëformuese, si sufikse apo prefikse.

Një pjesë e lokucioneve pasthirrmore kanë kaluar në përngjitje, sepse pjesët përbërëse të tyre e kanë humbur mëvetësinë kuptimore e gramatikore. Kështu, në Drejtshkrimin e gjuhës shqipe njësitë mirë se vjen!, falem nderit!, kryet shëndoshë!²⁴⁷ etj., shkruhen veç, kurse në Fjalorin e 2006-ës këto dalin në formë të përngjitur. Madje, fjala *kryeshëndoshë* del si emër, që do të thotë se është fjalë e ndryshueshme dhe ka marrë të gjitha karakteristikat leksiko-gramatikore të emrit. Për sa u përket fjalëve *mirësevjen* dhe *mirë se erdhe*, që kanë të njëjtin kuptim dhe të njëjtën strukturë, por shkruhen ndryshe, mund të themi se e para (*mirësevjen*) është përngjitur ndoshta ngaqë elementi i dytë është i ndryshueshëm, kurse në rastin tjetër (*mirë se erdhe*) folja mbetet në formë të ngurosur. Megjithatë, përderisa këto njësi edhe në ndjenjën gjuhësore të folësve herë shkruhen veç e herë shkruhen bashkë, mund të themi se ndodhen ende në fazën e kalimit nga lokucioni në përngjitje dhe procesi ndihet i papërfunduar.

Lokucionet pasthirrmore, duke qenë se nuk formohen aty për aty në procesin e të folurit, por riprodhohen si njësi të gatshme të sistemit gjuhësor, të ardhura kryesisht nga gjuha e folur e popullit, nuk përbëjnë modele prodhimtare e aktive fjalëformimi në gjuhën e sotme shqipe.

²⁴⁷ Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973 : 132.

VI. 3 Statistika

Përgjithësisht, të gjithë fjalorët normativë të gjuhëve letrare kombëtare, përveç funksionit të tyre kryesor që është ai shpjegues, duhet të kenë edhe funksion informues, në mënyrë që të jepen të dhëna për kuptimin e fjalëve a shprehjeve që nuk kuptohen ose kuptohen me vështirësi. Në këto fjalë e shprehje hyjnë ato që janë përdorur dikur në gjuhën letrare e që tani mund të kenë ndryshuar edhe strukturën edhe kuptimin, por edhe të reja, që kanë hyrë në gjuhën e shkrimit duke iu përshtatur zhvillimeve dhe ndryshimeve ekonomike, shoqërore, kulturore e politike të kohës sonë.

Fjalori i vitit 2006, duke qenë fjalori i fundit normativ deri më sot i gjuhës shqipe, i cili ka ardhur duke e shtuar dhe përmirësuar përbërjen e vet, i kryen edhe më mirë funksionet e tij se sa fjalorët e mëparshëm. Ky Fjalor përmban 48 000 fjalë. Krahasuar me Fjalorin e '80-ës ka një shtim të fjalësit prej rreth 7 000 fjalësh. Por këtë rritje të numrit të fjalëve nuk mund ta shohim në përpjesëtim të drejtë me numrin e lokucioneve që janë përfshirë në Fjalor (numri i lokucioneve të përfshira në Fjalor në raport me këtë rritje mund të jetë më i madh ose më i vogël), sepse në shumicën e rasteve ato nuk dalin si zë më vete, por përfshihen nën një zë të caktuar për të dhënë ngjyime të ndryshme kuptimore. Megjithatë, kur shtohet numri i fjalëve në të tillë fjalorë, përgjithësisht, rriten edhe të gjitha ato njësi gjuhësore që konsiderohen të vlefshme për pasurimin e korpusit të tij dhe të gjuhës në tërësi. Kështu që në Fjalorin e 2006-ës duket se kemi një shtim të numrit të lokucioneve. Kjo lidhet edhe me kriteret që kemi vendosur për të përcaktuar lokucionet. Në bazë të këtyre kriterëve kemi trajtuar si lokucion edhe ndonjë grup fjalësh që në Fjalor është dhënë pas yllshit (*), ku renditen zakonisht frazeologjizmat. Përgjithësisht, kur lokucionet kanë pasur në strukturën e tyre një fjalë emërtuese, ato i kemi dalluar nën zërin që shprehet me këtë fjalë, që, nga pikëpamja semantike, është edhe përbërësi kryesor i strukturës së lokucionit. Ka pasur raste kur një sërë lokucioneve kanë qenë pasqyruar te përbërësi jokryesor, ndoshta sepse janë renditur sipas tipit semantikostrukturor (lokucionet *në bazë, në drejtim, në këmbë* etj. janë pasqyruar te parafjala *në*). Gjithashtu ndonjë lokucioni është pasqyruar dy herë, edhe te përbërësi

kryesor edhe te përbërësi tjetër. Kjo ka ndodhur edhe në rastet kur lokucionet përbëhen prej dy fjalësh emërtuese.

Megjithatë, në përpjekje për t'i dalluar sipas kritereve të përcaktuara, në Fjalorin e 2006-ës kemi gjetur rreth 590 lokucione, nga të cilat numrin më të madh e përbëjnë lokucionet emërore²⁴⁸, foljore dhe ndajfoljore, përkatësisht me rreth 160, 117 dhe 150 njësi²⁴⁹. Numri i madh i lokucioneve në këto pjesë ligjërata mund të shpjegohet me përbërjen e tyre semantikostrukurore. Këto lokucione përbëhen përgjithësisht prej fjalësh emërtuese, të cilat kur bëhen pjesë e strukturës së lokucionit, edhe pse ngurosen, e ruajnë pjesërisht kuptimin leksikor. Kjo do të thotë se shkalla e gramatikalizimit të këto njësi është më e ulët dhe ato janë më pak të qëndrueshme, si rrjedhim edhe më pak të prirura për të kaluar në procesin e përngjitjes apo të përbërjes. Ndryshe ndodh me lokucionet përemërore. Në Fjalor kemi gjetur 6 të tilla. Tashmë pjesa më e madhe e lokucioneve përemërore, disa më herët e disa më vonë, duke qenë më të gramatikalizuara, e kanë kaluar fazën e kapërcimit nga lokucioni në përngjitje dhe tani dalin si fjalë të përngjitura. Edhe lokucione mbiemërore kemi dalluar pak, rreth 20. Nga pikëpamja e fjalëformimit, në klasën e mbiemrave lokucionet dhe përngjitja nuk përbëjnë ndonjë mënyrë prodhimtare për pasurimin e kësaj klase.

Te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, numërohen rreth 34 lokucione parafjalore, rreth 62 lokucione lidhëzore, rreth 15 lokucione pjesëzore dhe rreth 28 lokucione pasthirmore. Përgjithësisht, numri i këtyre lokucioneve, me disa lëvizje të vogla, me kalimin nga një klasë te një tjetër apo me përfundimin e procesit të kalimit nga lokucioni në përngjitje, nuk ka ndryshuar ndjeshëm.

²⁴⁸ Lokucionet emërore vërtet janë të shumta, por shumica e tyre i përkasin një tipi semantikostrukturor, atij që ka si element të parë të strukturës së tij fjalët *lule* ose *bar* në emërore të pashquar njëjës.

²⁴⁹ Këtu nuk është përfshirë asnjë lokucion numëror, edhe pse numri i tyre është shumë i madh, sepse në Fjalor nuk janë pasqyruar, ngaqë nga përbërja semantikostrukurore janë mjaft të kufizuar.

VI. 4 Semantika e lokucioneve

Për të përcaktuar më qartë tiparet e lokucioneve në gjuhën shqipe, për t'i njohur ata si njësi më vete gjuhësore e si mënyrë e veçantë fjalëformimi është e nevojshme që krahas analizës strukturore, të analizohen edhe nga pikëpamja semantike. Analiza strukturore dhe semantike së bashku do të bëjë që të dallohen më mirë kufijtë që i ndajnë lokucionet nga fjala, togfjalëshat, frazeologjizmat dhe fjalët e përbëra e të përngjitura.

Lokucionet janë grupe fjalësh të lidhura shumë ngushtë nga ana semantike, që shprehin një nocion të vetëm, pra janë *njësi semantike*, mund të thuash edhe njësi leksikore²⁵⁰. Për të njohur dhe për të interpretuar nocionin që shprehin, që përbën edhe thelbin kuptimor të lokucioneve, është e rëndësishme analiza e tyre në përbërës semantikë, sipas njësive leksiko-gramatikore.

VI.4.1 Lloji semantik i lokucioneve emërore

Edhe pse lokucionet emërore janë të shumta dhe përbëhen prej fjalësh kuptimplota, tipat strukturorë të tyre nuk janë aq të larmishëm, kështu që edhe nga ana semantike nuk dallohen për ndonjë larmi të madhe. Ashtu si gjithë emrat në përgjithësi, edhe lokucionet emërore emërtojnë qenie e sende konkrete, lëndë e nocione abstrakte etj. Kështu, nga pikëpamja semantike tipin më të madh të lokucioneve emërore e përbëjnë:

- lokucionet emërore që emërtojnë *bimë* (*bar balsami, bar beronje, bar pezmi, bar qumështi, lule dielli, lule dimri, lule mbrëmjeje gështenjë kali > gështenjë e egër, rrush gjarpri > lloj shkurreje, rrush pule > mana toke etj.*)

Semantika e këtyre lokucioneve e ka burimin në gjuhën e folur të popullit. Është vështirë që prej marrëdhënieve të drejtpërdrejta që shprehin përbërësit e tyre semantikë të

²⁵⁰ Shih: M.Domi, *Disa çështje të lokucioneve*, në: SF 1985/1 : 215.

dallohet kuptimi konkret i tyre. Semantika e këtyre lokucioneve, ashtu si e njëjta semantikë e disa fjalëve të përngjitura, mund të zbulohet duke studiuar historinë, lidhjen semantikostrukurore të përbërësve, si dhe tipare të veçanta të tyre, që mund të përçohen në mënyrë të figurshme te lokucioni.

Tipa të tjerë semantikë janë:

- lokucionet emërore nga fusha e zoologjisë, që emërtojnë shpendë e kafshë (*dallëndyshe deti* > *lloj peshku*, *gështenjë deti* > *iriq deti*, *nusja e lalës*, *nuse pashke*, *zog nuseje* > *rrëfeshku*, *zog mizë* > *kolibri*, *zogu i dhenve* > *bishtatundës* etj.).

Duket se edhe semantika e këtyre emrave e ka burimin në gjuhën e folur të popullit.

- lokucionet emërore që emërtojnë lëndë (*gur gjaku* > *lëndë minerale*, *gur kali*, *gur leshi*, *gur mëndafshi*, *gur pambuku*, *gur shkrepës* > *strall* etj.)

Edhe një pjesë e këtyre lokucioneve emërore kanë semantikë të vështirë për t'u zbërthyer, sepse i përkasin gjuhës së folur të popullit, kurse pjesa tjetër përdoret më shpesh në ligjërimin e përditshmëm dhe kuptimi i tyre është i njohur, kështu që nuk është e nevojshme të studiohen në rrethanat e krijimit.

- lokucionet emërore që emërtojnë *vjësi* të ndryshme (*Arusha e Madhe*, *Arusha e Vogël*, *Kashta e Kumtrit* etj.)

- lokucionet emërore që emërtojnë *pjesë të trupit të njeriut* (*molla e Adamit* > *fikthi*)

- lokucionet emërore që shënojnë *emërtime gjeografike* (*Guri i Bardhë*, *qafa e Buallit*, *qafa e Thanës* etj.).

Këto emërtime gjeografike janë të figurshme, prandaj dalin në formën e lokucionit dhe jo në formën e një togu të lirë.

VI.4.2 Lloji semantik i lokucioneve mbiemërore

Semantika e lokucioneve mbiemërore zbërthehet qartë. Te këto lokucione, në varësi të llojit të tiparit që emërtojnë, dallohet vetëm një tip semantik:

- lokucione mbiemërore që tregojnë cilësi (*ngjyrë argjendi, bojë dheu, ngjyrë dheu, ngjyrë hiri, bojë kafe, ngjyrë limon, ngjyrë tulle, lara-lara, lule-lule, zhele-zhele* etj.)

Përgjithësisht lokucionet mbiemërore shënojnë ngjyrë dhe kanë si përbërës të parë semantik emrat *ngjyrë* ose *bojë*.

VI.4.3 Lloji semantik i lokucioneve numërore

Ashtu si gjithë numërorët, edhe lokucionet numërore shënojnë *sasi të caktuar* sendesh a frymorësh, pra shërbejnë për të përcaktuar me saktësi kuptimin e numrit shumë të fjalëve të cilat mund të numërohen. Kjo ndodh kur këto lokucione vendosen para këtyre fjalëve dhe ky është përdorimi më i shpeshtë i tyre. Kur qëndrojnë më vete tregojnë numra abstraktë.

VI.4.4 Lloji semantik i lokucioneve përemërore

Edhe pse në klasën e përemrave në Fjalorin e 2006-ës kemi dalluar vetëm gjashtë lokucione përemërore, semantika e tyre është e ndryshme. Ajo lidhet me semantikën e përemrave të pacaktuar që janë elementi i parë strukturor i lokucioneve përemërore.

Përveç një lokucioni (*gjë që*), të tjerët tregojnë në mënyrë të pacaktuar frymorë ose sende, por nga ana tjetër secili ka edhe karakteristikat e veta semantike.

Kështu, lokucionet përemërore *cilido që* e *kushdo që* tregojnë frymorë a sende të veçuar të një grupi.

Lokucioni përemëror *çdo gjë* tregon vetëm sende, secilën prej tyre në mënyrë të pacaktuar.

Lokucioni *çfarëdo që* tregon secilin frymor a send pa dallim, pavarësisht nga natyra, lloji, tiparet a veçoritë që ka.

Lokucioni përemëror *gjë që* funksionon si përemër lidhor. Përdoret kryesisht në stilin publicistik e shkencor. Në këtë lokucion emri *gjë*, pasi ka kaluar në klasën e përemrave, është ngurosur duke humbur kështu veçoritë kuptimore e gramatikore. Në këtë rast ai nuk ka ndonjë semantikë të veçantë, por përdoret si përforcues duke rimarrë gjithë fjalinë drejtuese me tërë brendinë e saj për ta vënë në lidhje kuptimore me fjalinë përcaktore.

VI.4.5 Lloji semantik i lokucioneve foljore

Nga ana semantike lokucionet foljore mund të zbërthehen lehtë kur kuptimi i tyre del drejtpërdrejt prej kuptimit të përbërësve strukturorë (*bëj gjimnastikë, kam dëshirë* etj.). Kështu, ato zbërthehen sipas kuptimit të tyre të parë. Në shumë raste lokucionet foljore janë të figurshme dhe atëherë ka më shumë vështirësi për të dalluar semantikën e tyre. Megjithatë, nëse kemi një lokucion të dhënë që ka të njëjtën strukturë me një lokucion tjetër, të cilit ia njohim kuptimin, duke ndjekur modelin mund të zbërthejmë edhe kuptimin e tij. Por, përgjithësisht, ne e njohim kuptimin e pjesës më të madhe të lokucioneve foljore në shqipe, mjafton që t'i dallojmë si të tilla. Edhe pse janë të figurshme, lokucioneve foljore u mungon shprehësia ose është shumë e dobët. Kjo na ndihmon që t'i dallojmë e të vendosim njëfarë kufiri me njësitë frazeologjike.

Përgjithësisht, lokucionet foljore përbëhen prej dy fjalësh emërtuese. Ndonjëherë njëra prej tyre ka kuptim të mëvetësishëm, kurse tjetra e ka dobësuar kuptimin dhe shërben për të plotësuar e për të sqaruar kuptimin e së parës (*bëj durim, marr hov, vë në rrezik* etj.). Të tilla janë foljet *bëj, kam, marr, vë* etj., që ndiqen nga një emër me ose pa parafjalë.

Duke u nisur nga kuptimi i pjesëve përbërëse, te lokucionet foljore dallojmë disa tipa semantikë.

- lokucione foljore që emërtojnë procese (*marr arratinë, bëj gjimnastikë, bëj shëtitje, vë re, bëj zë, merr valë, mban erë, zë vend* etj.)
- lokucione foljore me kuptim të figurshëm vendi (*vë në zbatim, vë në shfrytëzim, vë në dukje, marr në qafë* etj.). Këto lokucione shprehin marrëdhënie abstrakte, sepse edhe emrat që marrin pjesë në to (përgjithësisht emra të formuar me sufikset *-im* dhe *-je*) janë emra abstraktë.²⁵¹
- lokucione foljore ku emri që është pjesë përbërëse e lokucionit, shënon kryesisht pjesë të trupit të njeriut (*zë në gojë, e ruaj në mendje, e fshiu nga mendja, më doli nga mendtë, e zuri (për) nga veshi, kam për zemër, zë për dore* etj.)

Emrat që marrin pjesë në strukturrën e këtyre lokucioneve janë: *mendje, gojë, vesh, dorë* etj.

- Në ndonjë rast lokucionet foljore, nëpërmjet emrit që merr pjesë në strukturën e tyre, mund të shprehin edhe marrëdhënie kuptimore mënyre (*zë me gojë, marr me mend* etj.).

Nga përbërja semantike duket se një pjesë e lokucioneve foljore janë më të vjetra (*bëj zë, vë re, zë në gojë, kam gjumë* etj.) dhe i përkasin kryesisht stilit bisedor. Këto lloje lokucionesh janë më të gramatikalizuara, pra elementet e tyre përbërëse karakterizohen nga një shkallë më e lartë ngurtësie, kështu që janë më të prirura për t'u bashkuar dhe për të formuar fjalë të përngjitura. Një pjesë tjetër e lokucioneve foljore janë më të reja dhe i përkasin stilit publistik e shkencor (*bën përpjekje, vë në shfrytëzim, gjen zbatim, marr*

²⁵¹ Në studimin mbi parafjalët, prof. Xhuvani përmend shpesh edhe termat *shprehje foljore* a *lokucione verbale*. Konkretisht, kur trajton parafjalën *në* ai thekson se me këtë parafjalë me kuptim të figurtë vendi në gjuhën popullore formohen disa grupe fjalësh, të cilat i quan shprehje foljor a lokucione foljore. Por shembujt që merr, kanë karakteristikat e njëjësive frazeologjike. Megjithatë më pas përmend disa ndërtime me foljen *vë* (*vë në dyshim, vë në lëvizje, vë në jetë, vë në shërbim, vë në zbatim, vë në veprim* etj.) të krijuara në gjuhë të shkrimit. Këto i quan shprehje që kanë kuptim hapësinore metaforik.

pjesë etj.). Këto lokucione janë më pak të qëndrueshme dhe mjafton një ndryshim në përbërjen gramatikore të emrit, që lokucioni të kthehet në një grup të lirë fjalësh.

VI.4.6 Lloji semantik i lokucioneve ndajfoljore

Ashtu si gjithë klasa e ndajfoljore, edhe lokucionet ndajfoljore nga ana semantike janë të ndryshme, sepse tiparet dhe rrethanat që emërtojnë janë të shumta. Përgjithësisht, semantika e lokucioneve ndajfoljore zërthehet lehtë prej kuptimit të përbërësve strukturorë të tyre. Kuptimisht, ato janë të barasvlershme me një ndajfoljore. Përgjithësisht, lokucionet ndajfoljore kanë kuptim kohor, kuptim vendor ose tregojnë mënyrën e kryerjes së një veprimi. Kështu, dallojmë këta tipa semantikë:

- lokucione ndajfoljore me kuptim kohor (*brez pas brezi, ditë për ditë, dimër e verë, ditë e natë, me ditë, herë-herë, herë pas here, javë për javë, mëngjes për mëngjes, nga mëngjesi deri në mbrëmje, mot e jetë, orë e çast, orë-orë, orë e pa kohë, sot e mot, nga viti në vit etj.*)

Kuptimi i këtyre lokucioneve lidhet me kuptimin e emrit që përbën strukturën e lokucionit, i cili, gjithashtu, ka kuptim kohor.

- lokucione ndajfoljore me kuptim vendor (*afër e afër, andej e këtej, nga ana e anës, aty-këtu, ballë për ballë, breg më breg, vende-vende etj.*)

- lokucione ndajfoljore që tregojnë mënyrën e kryerjes së një veprimi (*anës e anës, me të butë, copë-copë, copë e thërrime, dora-dorës, dhëmb për dhëmb, fije-fije, fjalë për fjalë, fjolla-fjolla, goja-gojës, gojë më gojë, gju më gju, hap pas hapi, kokë më kokë, pikë-pikë, tufa-tufa, në tym, varg e varg etj.*)

Ka ndonjë lokucion ndajfoljor që i përdorur në kontekste të ndryshme mund të tregojë herë vendin e herë mënyrën e kryerjes së veprimit. Këto janë lokucionet që formohen nga përsëritja e të njëjtit emër të lidhur me parafjalën *më* (*degë më degë, rrugë më rrugë etj.*).

Tipin më të përdorur semantik të lokucioneve ndajfoljore e përbëjnë ato që tregojnë mënyrën e kryerjes së veprimit.

VI.4.7 Lloji semantik i lokucioneve parafjalore

Semantika e lokucioneve parafjalore lidhet me kuptimin e emrave që përbëjnë strukturën e tyre, por edhe me marrëdhëniet e caktuara që shprehin parafjalët, që janë pjesë përbërëse e lokucionit. Përgjithësisht, këto parafjalë, kur hyjnë në përbërje të lokucionit, shprehin marrëdhënie abstrakte të diferencuara. Edhe vetë emrat që bëjnë pjesë në këto lokucione, pasi kanë humbur kuptimin e sendësisë dhe aftësinë për ta shprehur këtë kuptim në mënyrë të mëvetësishme, përgjithësisht, shfaqen me kuptim abstrakt ose të fytyruar. Pra, emri e ruan pjesërisht kuptimin e tij leksikor, duke dhënë kuptimin e vendit, të shkakut, të mjetit etj. Kështu, në kuptimin e përgjithshëm të lokucioneve parafjalore kontribuojnë të gjitha elementet strukturore përbërëse të tyre²⁵². Prej marrëdhënieve të ndryshme që krijojnë emrat dhe parafjalët që përbëjnë lokucionet parafjalore, kuptimi i të cilave përputhet me kuptimin e lokucionit në tërësi, tipat semantikë të tyre janë të larmishëm. kështu, lokucionet parafjalore mund të tregojnë:

- mjet (*me anë, me anën*)
- shkak (*për arsye, për shkak, nga shkak i, për hir, për punë, në saje*)
- marrëdhënie vendore e hapësinore, por ndonjëherë edhe kohore (*në ag, në ah, në drejtim*²⁵³, *në mes, në palcë, në prag, në pikë, në sy*)
- zëvendësim, këmbim (*në vend, në këmbë*)
- marrëdhënie objektore (*në dëm, në dobi*)

²⁵² Shih: M. Çeliku, Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe, në: Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II, 1975 : 213.

²⁵³ Parafjala *në drejtim* ka përdorim shumë të gjerë. Përveç kuptimit vendor (drejtim të lëvizjes), ajo mund të përdoret edhe me kuptim synimi e kufizimi.

- marrëdhënie kufizimi (*në fushën*)
- marrëdhënie përjashtimi (*me përjashtim*)
- marrëdhënie mënyrore-objektore (*në bashkëpunim me, në harmoni me, në krahasim me, në marrëveshje me, në përputhje me*).

Lokucionet parafjalore kanë lindur nga nevoja për të shprehur marrëdhënie të caktuara, të diferencuara, prandaj me këtë rrugë formimi krijohen vazhdimisht parafjalë të reja²⁵⁴, të cilat ndjekin modelin e ndërtimit të disa lokucioneve të gjuhës popullore (*në mes, në këmbë, për punë etj.*).

VI.4.8 Lloji semantik i lokucioneve lidhëzore

Duke qenë se janë fjalë shërbyese, lidhëzat, ku përfshihen edhe lokucionet lidhëzore, nuk kanë kuptim leksikor të pavarur. Lokucionet lidhëzore shprehin marrëdhënie të ndryshme semantikosintaksore, prandaj hyjnë në grupin e *lidhëzave semantike*, të cilat, ndryshe nga lidhëzat josesantike që shprehin vetëm marrëdhënie sintaksore pa semantikë, shprehin edhe marrëdhënie të ndryshme kuptimore. Kështu, lokucionet lidhëzore mund të shprehin marrëdhënie vendore, kohore, mënyrore etj. Pra, ashtu si lidhëzat e përngjitura, edhe lokucionet lidhëzore janë thjesht fjalë marrëdhënieje.

VI.4.9 Lloji semantik i lokucioneve pjesëzore

Ashtu si e gjithë klasa e pjesëzave, edhe lokucionet lidhëzore kanë kuptim të kushtëzuar që varet nga konteksti. Ato shprehin thjesht ngjyrimë kuptimore plotësuese të një fjale, të një togfjalëshi etj. Nisur nga ky kuptim i kushtëzuar që shprehin, lokucionet

²⁵⁴ Këto formime të reja i përkasin kryesisht stilit shkencor, publicistik e zyrtar.

lidhëzore mund të klasifikohen në disa tipa semantikë, të cilët janë të larmishëm edhe pse numri i lokucioneve pjesëzore është i paktë.

- lokucione lidhëzore që përdoren për të shprehur pohim të përforcuar (*po se po, po e po*).

- lokucione lidhëzore që përdoren për të shprehur mohim të përforcuar (*jo që jo, as që*).

Lokucionet pjesëzore që përfshihen në këta dy tipa semantikë përdoren, përgjithësisht, kur folësi pohon (tipi i parë semantik) ose mohon (tipi i dytë semantik) diçka që vihet në dyshim.

- lokucioni pjesëzor *se mos* duke pasur si element përbërës të strukturës së tij pjesëzën *mos* me vlerë dyshimi, përdoret kryesisht për të shprehur dyshim, por edhe ndonjë ngjyrim emocional (ironi, përbuzje, mospranim etj.).

- lokucione pjesëzore që përdoren për të theksuar më shumë kuptimin e fjalës, të togfjalëshit a të fjalisë (*vetëm e vetëm, vetëm se, vetëm që*).

Si përbërës strukturorë të lokucioneve pjesëzore mund të jenë edhe disa fjalë kuptimplota. Kështu, një nga përbërësit e këtij tipi semantik është ndajfolja *vetëm*, e cila, kur përdoret me vlerën e një pjesëze humbet karakteristika leksiko-gramatikore të klasës së ndajfoljeve dhe nuk mund të qëndrojë më vete në fjali

- lokucione pjesëzore me vlerë emocionuese-shprehëse (*ja që, le që*).

Edhe në këtë tip semantik është përdorur një fjalë kuptimplotë, forma foljore e urdhërores *le*, e cila, kur hyn në përbërje të lokucionit lidhëzor *le që*, nguroset duke humbur kështu kuptimin leksikor dhe kategoritë gramatikore të foljes.

- me vlerën e një lokucioni pjesëzor përdoret edhe togu *ku e ku* që tregon shkallën e lartë të dallimit ndërmjet sendeve, ndërmjet vetive të tyre etj.

- lokucioni pjesëztor *si urdhëron* përdoret për të pohuar me mirësjellje diçka, për të shprehur pëlqimin e plotë ose gatishmërinë për ato që na thonë²⁵⁵.

VI.4.10 Lloji semantik i lokucioneve pasthirmore

Nga ana semantike, lokucionet pasthirmore shprehin përshëndetje të ndryshme, urime, ngushëllime etj. Edhe pse pjesët përbërëse të këtyre lokucioneve nuk e kanë humbur krejt kuptimin leksikor, përsëri ato përdoren me një ngjyrim të fortë emocionues dhe, në njëfarë mënyre, duke qenë thjesht përshëndetje ose urime etj., shprehin dëshirën a vullnetin e folësit.

VI.5 Përgjithësim modelesh

Në pjesën më të madhe të tipave strukturorë të lokucioneve në tërësi marrin pjesë një ose dy fjalë emërtuese. Edhe te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, si te ndajfolja, por edhe tek ato që nuk kanë kuptim leksikor të pavarur, si te parafjala, lidhëzat etj., dallohen disa tipa strukturorë me një prej përbërësve fjalë emërtuese. Nga pikëpamja gramatikore e leksikore kjo fjalë emërtuese mund të jetë e ngurosur. Shkalla e ngurtësisë lidhet me llojin e lokucionit në të cilin është përfshirë. Në shumë raste fjala emërtuese që merr pjesë në strukturën e lokucioneve është një *emër*, por mund të jetë edhe *folje* ose *ndajfolje* etj., mund të jenë edhe dy të tilla.

Një numër të konsiderueshëm (më shumë se gjysma) përbëjnë lokucionet që kanë në strukturë *dy emra* (këto mund të jenë *lokucione emërore, mbiemërore e ndajfoljore*). të cilët mund të emërtojnë bimë, mund të jenë nga fusha e zoologjisë apo e astronomisë etj., mund të tregojnë cilësi apo mënyrën e kryerjes së veprimit, mund të kenë kuptim kohor

²⁵⁵ Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë 2006 : 1143.

ose vendor. Përsëritja është jetë një mjet që shërben për ndërtimin e këtyre strukturave [te lokucionet mbiemërore (*lule-lule* etj.), te lokucionet ndajfoljore (*dallgë-dallgë, duar-duar, dorë më dorë, hera-herës* etj.)]. Këta tipa semantikostrukturorë mund të shërbejnë edhe si modele për krijimin e lokucioneve të reja.

Folja është një tjetër fjalë emërtuese që, pas emrit, është pjesë përbërëse e strukturave të një sërë lokucionesh. Ajo përfshihet te të gjitha lokucionet foljore, ku ka edhe peshën më të madhe, te ndonjë lokucion lidhëzor (*në qoftë se*) dhe te lokucionet pasthirmore. Në disa raste tipat strukturorë ku bën pjesë një folje nuk mund të përdoren si modele për krijimin e njësive të reja, sepse ato kanë hyrë në gjuhë si njësi të gatshme (*vë re, bëj zë etj. dhe lokucionet pasthirmore*). Por kur këto lokucione janë krijime më të reja (*vë në zbatim, marr në shqyrtim* etj.) strukturat e tyre mund të shërbejnë si modele për krijime të reja.

Tipat e tjerë semantikostrukturorë të lokucioneve janë më të kufizuar.

VI.6 Prirje

Në varësi të shkallës së ngurtësisë apo të qëndrueshmërisë së elementeve përbërëse, pra në varësi të shkallës së gramatikalizimit dhe të leksikalizimit një pjesë e lokucioneve kanë prirje për të kaluar në përngjitje. Kur pjesët përbërëse të lokucionit e humbin gjithnjë e më shumë mëvetësinë kuptimore e gramatikore, pra kur arrijnë në një shkallë të lartë gramatikalizimi, duke qëndruar gjatë dhe dendur pranë njëra-tjerës përngjiten në një fjalë të vetme. Megjithatë, edhe për lokucionet që e kanë arritur këtë shkallë, duhet kohë që të kryhet ky proces. Mundet që, nga ana shkencore, procesi të ketë përfunduar, por zbatimi i tij kërkon kohë. Kështu, disa njësi në Fjalorin e 2006-ës tashmë dalin në formë të përngjitur (në fjalorë të tjerë dalin në formë lokucionesh: *sado që, sido që, anë e kënd* etj.), e megjithatë vazhdojnë të përdoren si lokucione.

Te lokucionet që kanë shkallë të ulët të qëndrueshmërisë së elementeve përbërëse, prirja për të kaluar në përngjitje nuk ekziston.

VII. PËRNGJITJET DHE LOKUCIONET

VII.1 Raportet

Nga statistikat që kemi nxjerrë nga Fjalori i 2006-ës për përngjitjet dhe lokucionet në tërësi dallojmë se raporti mes tyre është pothuaj i barabartë: rreth 600 fjalë të përngjitura dhe po kaq lokucione²⁵⁶. Përgjithësisht, duket se numri i lokucioneve në Fjalor është rritur sepse janë shtuar njësi të tjera (formime të hershme, por edhe më të reja) që janë konsideruar të vlefshme për pasurimin e fjalësisë të këtij fjalori dhe të gjuhës në tërësi dhe që nuk janë pasqyruar më parë. Ndërkohë, kemi gjithashtu një rritje të numrit të fjalëve të përngjitura, por këtu nuk mund të përcaktojmë dot me saktësi se sa prej tyre janë shtuar në Fjalor për të njëjtën arsye si lokucionet dhe sa prej tyre janë rezultat i procesit të përfunduar të kalimit nga lokucioni në përngjitje. Gjithsesi, raporti tashmë i barabartë mes tyre dëshmon se përngjitja dhe lokucionet janë dy mënyra aktive formimi fjalësh në shqipe që veprojnë në gjuhë secila më vete duke ruajtur tiparet që i karakterizojnë, të përcaktuara përmes kriterëve të posaçme dhe që njëkohësisht bashkëveprojnë natyrshëm, duke ndjekur prirjen e gjuhës drejt mënyrave sintetike të formimit të fjalëve. Këto marrëdhënie mund të bëhen më qartë, po t'i vështrojmë sipas pjesëve të ligjëratës.

Raporti mes *emrave të përngjitur dhe lokucioneve emërore* është pak a shumë i njëjtë, përkatësisht 140 : 160.

²⁵⁶ Në këto statistika janë përfshirë të gjitha fjalët, edhe kur dalin në dy variante: herë si fjalë të përngjitura dhe herë si lokucione. Ato janë vendosur në mënyrën e formimit së cilës i përkasin, bazuar në tipin semantikostrukturor dhe sipas kriterëve të përcaktuara për çdo mënyrë fjalëformimi.

Në gramatika e në studime të ndryshme këto dy mënyra fjalëformimi nuk janë quajtur aktive në formimin e emrave. Por statistikat dëshmojnë se ato kanë vepruar edhe tek emri. Rritja e ndjeshme e numrit të lokucioneve emërore lidhet me kriteret e përcaktimit të lokucioneve në përgjithësi. Në këtë klasë kemi përfshirë shumë grupe fjalësh (p.sh. tipi semantikostrukturor që ka si element të parë strukturor fjalën *lule* ose *bar*) që më parë janë trajtuar thjesht si togfjalësha. Nga ana tjetër, rritja e numrit të emrave të përngjitur, përgjithësisht, shpjegohet me shtimin në Fjalor të formimeve të hershme të cilat nuk janë pasqyruar në fjalorë të tjerë dhe me trajtimin që u kemi bërë në bazë të kritereve disa formimeve që, në dukje, dalin si formime me parashtesë.

Në *klasën e mbiemrave* këto dy mënyra fjalëformimi nuk janë prodhimtare. Raporti mes mbiemrave të përngjitur dhe lokucioneve mbiemërore është 9 : 20. Te lokucionet mbiemërore janë përfshirë disa grupe fjalësh të cilat kanë ardhur me konversion prej ndajfoljeve (*lara-lara, thekë-thekë* etj.). Përgjithësisht, mbiemrat që kanë si element të parë të strukturës së tyre emrat *ngjyrë* dhe *bojë* tani quhen formime të përbëra. Duke u larguar prej lokucioneve ato e kanë ngushtuar këtë mënyrë formimi të mbiemrave, por duke mos qenë më as formime të përngjitura tashmë nuk kanë më ndikim te sasia e mbiemrave të përngjitur.

Raporti lëkundet në *klasën e përemrave*, rreth 85 përemra të përngjitur dhe 6 lokucione përemërore. Një pjesë e madhe e përemrave të përngjitur janë formuar prej leksikalizimit të njërive përbërëse të grupit të fjalëve , për shkak të përdorimit për një kohë të gjatë pranë njëri-tjetrit, pra kanë dalë prej lokucioneve përkatëse.

Te *foljet* raporti është rreth 40 folje të përngjitura me rreth 117 lokucione foljore. Numri i madh i lokucioneve në këtë kategori shpjegohet me vendosjen e kritereve përcaktuese që na kanë shërbyer për dallimin e lokucioneve dhe me interpretimin e tyre. Nga ana tjetër, një pjesë e foljeve të përngjitura (jo të gjitha) kanë dalë prej lokucioneve përkatëse (*vërej, bëzaj, ngush, mbuz* etj.). Kështu, edhe në këtë kategori përngjitja ka marrë prej lokucioneve.

Këto dy mënyra fjalëformimi, përngjitja dhe lokucionet, veprojnë më shumë në *klasën e ndajfoljeve* ku raporti është 2 : 1 (rreth 300 fjalë të përngjitura dhe rreth 150

lokucione ndajfoljore). Së fundi, një pjesë e mirë e tyre ka kaluar në përngjitje për shkak të leksikalizimit dhe të shkrirjes në një fjalë të vetme të lokucioneve ndajfoljore.

Te *parafjalët* dallojmë 10 të përngjitura dhe 34 lokucione parafjalore. Numri i madh i lokucioneve parafjalore, krahasur me parafjalët e përngjitura, shpjegohet me trajtimin që u kemi bërë disa grupeve fjalësh.

Te *lidhëzat*, raporti nuk ka ndonjë lëkundje të dukshme. Kemi rreth 50 të përngjitura dhe rreth 62 lokucione lidhëzore.

Po e njëjta gjë vihet re te pasthirrmat, rreth 20 të përngjitura dhe rreth 28 lokucione pasthirrmore.

Në klasën e pjesëzave, numërohen më shumë lokucione pjesëzore 15, kurse pjesëza të përngjitura janë vetëm 6.

Përgjithësisht, te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës numri i fjalëve të përngjitura është rritur për shkak të leksikalizimit të pjesëve përbërëse dhe të shkrirjes në një fjalë të vetme të lokucioneve.

VII.2 Vërejtje

Përngjitja dhe lokucionet, duke qenë dy mënyra formimi fjalësh që bashkëveprojnë me njëra-tjetrën dhe që shpesh është vështirë t'u dallosh kufijtë (përveç paraqitjes grafike, ku fjalët e përngjitura shkruhen njësh, kurse lokucionet ndaras) paraqesin edhe probleme të karaktereve të ndryshme, sidomos të karakterit drejtshkrimor. Këto probleme vihen re edhe në fjalorë. Kur fjala e përngjitur ka arritur atë shkallë gramatikalizimi dhe leksikalizimi sa ta quajë të përfunduar procesin e kalimit nga lokucioni në përngjitje, çështja është e zgjidhur: ajo funksionon dhe vepron si fjalë e përngjitur. Edhe kur elementet përbërëse të një lokucioni e ruajnë pjesërisht mëvetësinë kuptimore e gramatikore, pra kur në ta shkalla e gramatikalizimit është e ulët e më pak e qëndrueshme përsëri çështja është e zgjidhur: te këto njësi prirja për të kaluar në

përngjitje është pothuaj e vakët dhe ato mund të vazhdojnë të funksionojnë si lokucione. Por kur një njësi gjuhësore që funksionon njësoj në sistemin gjuhësor, herë sillet si fjalë e përngjitur dhe herë si lokucion, çështja vështirësohet. Edhe në Fjalorin e 2006-ës vëmë re shpesh se një fjalë është përdorur në dy variante, në formë të përngjitur dhe në formë lokucioni dhe kjo ndodh me të gjitha pjesët e ligjëratës, sidomos me përemrat dhe ndajfoljen ku këto mënyra fjalëformimi veprojnë më shumë, por edhe te lidhëzat. Përgjithësisht, këto fjalë, kur paraqiten si zë më vete në fjalor, dalin në formë të përngjitur (*anekënd, bëzaj, brendapërbrenda, drejtpërdrejt, qyshse, sadoqë, vërej* etj.), që do të thotë se, nga ana shkencore, ato kanë shkruar drejt prirjes për të shmangur formimet analitike dhe për t'u sintetizuar. Por kur paraqiten nën njërin prej elementeve të tyre përbërëse, ato dalin në formë lokucioni (*anë e kënd, bëj zë, brenda për brenda, drejt për drejt, qysh se, sado që, vë re* etj.), që do të thotë se u duhet ende kohë për të përfunduar procesin drejt përngjitjes së plotë. Për rastet kur ka dyzime të tilla, që shfaqen dukshëm edhe te përdoruesit e gjuhës, mund të trajtohen të dy variantet, pavarësisht nga prirja.

VIII. PËRCAKTIME DHE PËRGJITHËSIME

Duke u parë si mënyra fjalëformimi, edhe pse jo aq prodhimtare dhe aktive në gjuhën shqipe, por që e pasurojnë fjalësin me vlera të reja (duke risjellë njësi gjuhësore, të krijuara nga gjuha e folur e popullit dhe njësi të tjera të krijuara në bazë analogjish apo modelesh), përngjitja dhe lokucionet janë rivlerësuar dhe janë pasqyruar më mirë në fjalorë, në gramatika e në studime të ndryshme.

Fjalët e përngjitura dhe lokucionet janë njësi gjuhësore që në sistemin gjuhësor veprojnë njësoj si të tilla. Ato funksionojnë si një fjalë e vetme dhe brenda tyre nuk mund të ndërhyjë asnjë njësi tjetër gjuhësore. Megjithatë në gjuhë ato sillen si dy njësi gjuhësore të ndryshme, madje në këtë punim i kemi vështuar edhe si dy mënyra të ndryshme fjalëformimi, prandaj mes tyre ka edhe dallime, që lidhen së pari *me strukturën*:

- Fjalët e përngjitura kanë strukturë të mbyllur, binare, ashtu siç është në përgjithësi struktura e fjalëve jo të parme, kurse lokucionet kanë strukturë të hapur, që do të thotë se nga struktura ato përbëhen prej një grupi fjalësh, por nga funksioni kanë vlerën e një fjalë të vetme.

Gjithashtu dallohen *nga kuptimi*:

- Kuptimi leksikor i një fjale të përngjitur është i barabartë me shumën e kuptimeve të elementeve përbërëse të grupit të fjalëve nga ka dalë, kurse lokucionet, si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht, janë të barsvlershme me një fjalë të vetme, por jo të njëjta me të. Pra, elementet përbërëse të një lokucioni nuk e ruajnë mëvetësinë e tyre kuptimore e gramatikore.

Këto dy dallime thelbësore mes fjalëve të përngjitura dhe lokucioneve bëjnë që t'i studiojmë më vete, duke përcaktuar kritere të posaçme për identifikimin dhe analizën e

secilës prej tyre. Nga ana tjetër, duke i studiuar së bashku në një punim, mund të themi se këto dy mënyra fjalëformimi kanë ngjashmëri që lidhen së pari me strukturën e tyre. Në strukturën e fjalëve të përngjitura dhe të lokucioneve mund të marrin pjesë elemente që u përkasin të gjitha pjesëve të ligjëratës. Si të fjalët e përngjitura ashtu edhe të lokucionet vihet re prirja për të ruajtur në formë të ngurosur strukturën. Lokucionet që janë parashkalla e fjalëve të përngjitura, ashtu si këto, funksionojnë si një fjalë e vetme me vlerën e një pjese të ligjëratës.

Gjatë shqyrtimit të materialit dhe analizës hap pas hapi të rasteve të përgjithshme dhe të veçanta u vu re se dallimi i fjalëve të përngjitura dhe sidomos i lokucioneve, si dhe studimi i tyre kërkonte përcaktimin e kritereve për një analizë strukturore e semantike të hollësishme të këtij leksiku. Pas përcaktimit të këtyre kritereve për secilën mënyrë fjalëformimi, që ndihmuan në studimin dhe analizën e çdo tipi semantikostrukturor sipas pjesëve të ligjëratës, u arritën këto përfundime:

1. Fjalët e përngjitura dhe lokucionet *shtrihen në të gjitha pjesët e ligjëratës*. Kjo dëshmon se mënyrat e formimit të tyre janë aktive dhe veprojnë kudo në gjuhën shqipe. Kështu, në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006, që deri më sot është fjalori më i pasur i shqipes, gjenden rreth 600 fjalë të përngjitura dhe po kaq lokucione. Shpërndarja e tyre në pjesë ligjëratare është e ndryshme. Ato veprojnë më shumë në pjesët e pandryshueshme të ligjëratës. Ndajfolja, si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës dhe e vetmja ndër to me kuptim të mëvetësishëm, ka edhe numrin më të madh të fjalëve të përngjitura dhe lokucioneve, përkatësisht rreth 300 dhe 150²⁵⁷. Edhe në pjesët e tjera të ligjëratës, sidomos të pjesët e ndryshueshme (emri e folja kryesisht) ku pothuaj nuk flitej për veprimin e këtyre dy mënyrave formimi fjalësh, tashmë numërohen jo pak fjalë të përngjitura e lokucione.

²⁵⁷ Edhe lokucionet emërore, po ashtu si lokucionet ndajfoljore, zënë një vend të konsiderueshëm mes pjesëve të ligjëratës, por nga pikëpamja e tipave semantikostrukturorë janë më të kufizuar, kurse lokucionet ndajfoljore janë mjaft të larmishme.

2. **Strukturat morfologjike** të fjalëve të përngjitura dhe lokucioneve kanë veçoritë e tyre.
- a) *Struktura e fjalëve të përngjitura* është e mbyllur. Ajo ka karakter binar, që do të thotë se të gjitha lidhjet semiotike dhe gramatikore janë binare, madje edhe lidhjet terciare zakonisht zbërthehen në dy lidhje binare. Kështu, edhe kur fjala e përngjitur përbëhet nga tri ose më shumë elemente, sërish struktura e saj është binare²⁵⁸.
 - b) *Struktura e lokucioneve* është e hapur. Ajo përbëhet prej një grupi fjalësh, që kanë lidhje të qëndrueshme mes tyre, që si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht, funksionojnë si një fjalë e vetme. Në këtë grup fjalësh nuk mund të ndërfiten elemente të tjera, ndryshe lokucionit do t'i prishej kuptimi. Gjithashtu, struktura e lokucionit është e përcaktuar, elementet përbërëse që e formojnë atë, nuk mund të ndryshojnë rendin.
3. Analiza e **përbërësve strukturorë** që marrin pjesë në ndërtimin e fjalëve të përngjitura e të lokucioneve ndihmon në analizën e përgjithshme të tyre dhe në nxjerrjen më në pah të veçorive semantikostruktorore.
- a) Nga pikëpamja strukturore *fjalët e përngjitura* përbëhen nga dy ose më shumë morfema rrënjore. Por përveç tyre, disa fjalë të përngjitura përbëhen edhe nga morfema ndajshesore formëformuese, siç mund të jetë mbaresa e rrjedhores së pashquar (para+dite+e). Në strukturën e fjalëve të përngjitura marrin pjesë elemente që u përkasin të gjitha pjesëve të ligjëratës. Pra, nga pikëpamja leksikore, një fjalë e përngjitur mund të ketë në përbërje të saj:

²⁵⁸ Fjala e përngjitur *përveçse* është e përbërë nga tri elemente: *për + veç + se*, por struktura është binare: lidhëzës *përveç* që është edhe baza e fjalës, i shtohet elementi *-se*. Ndërkohë, vetë lidhëza *përveç* ka strukturë binare, e përbërë nga elementet *për + veç*.

- vetëm fjalë kuptimplota
- vetëm fjalë jokuptimplota
- fjalë kuptimplota dhe fjalë jokuptimplota.

Përbërësit strukturorë të fjalëve të përngjitura e ruajnë rendin që kanë pasur kur ishin në gjendje të lirë, pra kur kishin formën e një grupi fjalësh. Gjithashtu, si përbërës të fjalës së përngjitur, e humbasin kuptimin e tyre fillestar si fjalë të pavarura, pra ngurosen duke i dhënë fjalës së re të përngjitur kuptim të ri leksikor e morfologjik. Në varësi të pjesës së ligjëratës që krijohet prej përngjitjes, përbërësit strukturorë të fjalëve të përngjitura janë të ndryshëm. Edhe brenda së njëjtës pjesë ligjërata dallohen përbërës të ndryshëm strukturorë. Këta përbërës strukturorë formojnë edhe tipat strukturorë të fjalëve të përngjitura.

Tipat strukturorë të ndajfoljeve të përngjitura, janë më të larmishmit. Dallojmë rreth 42 të tillë²⁵⁹. Edhe tek emrat e përngjitur, të cilat janë trajtuar fare pak më parë, kemi dalluar mjaft tipa strukturorë, 27. Numërorët e përngjitur përbëjnë vetëm një tip strukturor. Ka raste kur në ndërtimin e fjalëve të përngjitura vepron edhe analogjia, pra ato nuk janë krijuar vetëm nga përdorimi i pjesëve të tyre përbërëse për një kohë të gjatë pranë njëra-tjetrës, por edhe sipas ndonjë modeli të caktuar.

b) *Lokucionet* kanë në strukturën e tyre dy ose më shumë elemente përbërëse që kanë lidhje të qëndrueshme mes tyre. Ato nuk e ruajnë mëvetësinë e tyre kuptimore e gramatikore. Zakonisht, në përbërje të lokucionit mund të marrin pjesë një ose dy fjalë emërtuese të cilat mund të jenë të ngurosura. Kjo fjalë emërtuese i jep kuptimin gjithë lokucionit dhe përbën atë që e quajmë kokë e lokucionit. Mund të ndodhë, si në rastin e disa lokucioneve lidhëzore, kur në përbërje të lokucionit nuk ka asnjë fjalë emërtuese, por

²⁵⁹ Përgjithësisht, kemi bërë një analizë të hollësishme strukturore, sipas përbërësve, të fjalëve të përngjitura dhe të lokucioneve. Kështu, një fjalë e përngjitur mund të përfaqësojë edhe një tip strukturor më vete.

vetëm fjalë shërbyese. Kështu, nga pikëpamja leksikore, ashtu si fjalët e përngjitura lokucionet mund të kenë në përbërje të tyre:

- vetëm fjalë kuptimplota

- vetëm fjalë jokuptimplota

- fjalë kuptimplota dhe fjalë jokuptimplota.

Përbërësit strukturorë të lokucioneve dhe lidhjet sintaksore mes tyre janë të ndryshme edhe në varësi të pjesës së ligjëratës së cilës i përket lokucioni. Tipat strukturorë që ndërtojnë këta përbërës të lokucioneve janë më të kufizuar se të fjalët e përngjitura. Lokucionet ndajfoljore kanë larminë më të madhe në tipa strukturorë: rreth 14. Lokucionet emërore e foljore, edhe pse përbëjnë një sasi të konsiderueshme të të gjitha lokucioneve në tërësi, nga pikëpamja e tipave strukturorë janë më të varfra, gjë që tregon se një pjesë e mirë e tyre janë krijuar sipas një modeli ose sipas analogjisë.

4. Veçoritë e fjalëve të përngjitura e të lokucioneve përcaktohen më qartë kur krahas analizës strukturorë bëhet edhe *analiza semantike* e tyre. Këto analiza mund të kryhen të shkëputura, por ndonjëherë për analizën e njërit aspekt mund të duhet ndihma e aspektit tjetër.

a) Nga pikëpamja semantike, kuptimi i *fjalës së përngjitur* është i barabartë me shumën e kuptimeve të përbërësve të grupit të fjalëve prej nga ka dalë. Ka raste kur përbërësit e disa fjalëve të përngjitura janë çsemantizuar më shumë, kurse te disa të tjerë prirja për çsemantizim është më e zbehtë. Kështu, kur përbërësit e kanë zbehur më shumë kuptimin, është vështirë të nxjerrësh kuptimin e fjalës së re (p.sh. te fjala *theribujkë*). Pavarësisht nga numri i elementeve që bëjnë pjesë në strukturën e fjalëve të përngjitura, ato shprehin një nocion të vetëm dhe jo marrëdhënie nocionesh.

Emrat e përngjitur, që përbëhen kryesisht prej fjalëve kuptimplota kanë larminë më të madhe të tipave semantikë, 7 të tillë.

b) Nga ana semantike *lokucionet* janë grupe fjalësh që shprehin një nocion të vetëm, pra janë *njësi semantike*, mund të thuash edhe njësi leksikore.

Nocionin që ato shprehin, përbën edhe thelbin kuptimor të lokucioneve.

5. Në këtë punim vumë re se në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006, kishte raste kur fjala e përngjitur dhe lokucioni prej të cilit ka dalë kjo fjalë e përngjitur dhe që kanë të njëjtin kuptim leksikor, janë përdorur njëkohësisht. Përgjithësisht, fjala e përngjitur ka dalë si zë më vete, kurse lokucioni është trajtuar nën zërin që përbën një prej elementeve të lokucionit. Kjo dukuri është vërejtur kryesisht te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, ku mungojnë treguesit gramatikorë (mbaresat), të cilët janë shenjë e mbylljes së strukturës dhe njëfjalësimit. Kjo do të thotë se është vështirë të dallosh dhe të zbatosh kufirin që ndan fjalët e përngjitura nga lokucionet, sepse, në shumë raste, lokucionet ndodhen në procesin e leksikalizimit. Megjithatë, në Fjalor shumë njësi gjuhësore që më parë dilnin në formë lokucioni, janë trajtuar në formën e tyre të përngjitur, gjë që flet për prirjen për kalimin nga lokucionet, që janë parashkalla e fjalëve të përngjitura, në përngjitje. Kjo prirje lidhet me prirjen e përgjithshme të shqipes për sintetizimin e mjeteve të shprehjes dhe për mënjanimin e strukturave analitike.

IX. REKOMANDIME

Studimet e vazhdueshme që janë ndërmarrë deri më sot, lidhur me fjalët e përngjitura dhe lokucionet, kanë vendosur statusin dhe rolin e këtyre kategorive gjuhësore në sistemin e gjuhës shqipe.

Në këtë punim jemi përpjekur të bëjmë një përshkrim tërësor e të imtë, sidomos të strukturës morfologjike të këtyre fjalëve për çdo pjesë ligjërata, por edhe të përbërësve semantikë, duke dalluar kështu edhe caqet e shtrirjes së tyre, kufijtë që i ndajnë me njësitë më të afërta.

Duke qenë se çështjet problemore kanë qenë të shumta e të ndryshme, mundet që në studimet në vijim të mbahen qëndrime më të qarta e më të përcaktuara.

Kështu, pas përcaktimit të kriterëve, që i njeh këto kategori gjuhësore dhe i ndan nga kategoritë e tjera, duhet të mbahet një qëndrim për ndërtimin e strukturave të tyre dhe për mënyrën e formimit. Ka raste kur në të njëjtën gramatikë apo brenda një studimi disa fjalë herë trajtohen si të përngjitura e herë si të përbëra, herë si lokucione e herë si njësi frazeologjike, pa sqaruar se ndoshta ato mund të ndodhen në kapërcyell të kalimit nga një mënyrë formimi në një tjetër.

Gjithashtu, mund të mbahet një qëndrim i njësuar lidhur me terminologjinë. Struktura fjalësh të ngjashme që i përkasin së njëjtës mënyrë formimi trajtohen me emra të ndryshëm (herë quhen shprehje e herë lokucione).

Në gramatika ku do të trajtohet gjerësisht edhe fjalëformimi apo në studime të veçanta, këto kategori fjalësh duhet të trajtohen në të gjitha pjesët e ligjërates.

Lokucionet, si kategori leksiko-gramatikore, që tashmë njihen si njësi më vete gjuhësore, mund të trajtohen si mënyrë e veçantë fjalëformimi dhe të zënë vend të kapitullin e fjalëformimit.

Ka një mungesë konsekuence që vihet re në shkrimin e fjalëve të përngjitura dhe të lokucioneve. E njëjta njësi gjuhësore herë shkruhet bashkë e herë ndaras, pra herë del si fjalë e përngjitur e herë si lokucion. Te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës ku ndodh më shpesh kjo dukuri, është më e lehtë të mbahet një qëndrim i caktuar. Rekomandojmë që, meqenëse këto njësi gjuhësore kanë në përbërje të tyre elemente të pandryshueshme, pra që nuk marrin tregues eptimorë dhe që nuk ndryshojnë në kontekste, të shkruhen si një fjalë e vetme, pra të dalin në formën e një fjale të përngjitur. Kështu, fjalët *sadoqë, tekdoqë, sikundërqë* etj., në Fjalorin e 2006-ës dalin në formë të përngjitur, kurse ndërtime të tjera të ngjashme, si: *kurdo që, kudo që* etj., dalin në formë lokucioni, ndërkohë që nuk kemi asnjë argument që të mendojmë se në rastin e parë grupet e fjalëve e kanë përfunduar procesin e kalimit nga lokucioni në përngjitje, ndërsa në rastin e dytë ky proces është i papërfunduar ende. Nisur nga kjo, mundet që disa fjalë që tashmë dalin në formë të përngjitur, të shërbejnë si *model* për grupet e fjalëve që kanë të njëjtën përbërje strukturore me to dhe që i përkasin të njëjtës pjesë ligjërate, por që shkruhen ndaras, në formë lokucioni.

Kështu, lidhëzat e përngjitura me strukturë: *ndajfolje + lidhëza që*, të tipit *sadoqë, tekdoqë* etj., mund të shërbejnë si model që edhe lokucionet me të njëjtën strukturë të shkruhen njësh: *kështu që, kudo që, kurdo që, mjaft që, ngado që, posa që, sido që* (*kështuqë, kudoqë, kurdoqë, mjaftqë, ngadoqë, posaqë, sidoqë*) etj. Në këto grupe fjalësh përngjitja është edhe më e thjeshtë, sepse në strukturën e tyre ka vetëm pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.

Si modele për shkrimin njësh të lokucioneve, pra për kalimin e tyre në fjalë të përngjitura, mund të shërbejnë disa njësi në klasën e ndajfoljeve, pavarësisht se në përbërje të tyre mund të ketë pjesë të ndryshueshme të ligjëratës.

Strukturat:

ndajfolje + lidhëza e + ndajfolje ose emër + lidhëza e + emër (këtu mund të jetë edhe i njëjti emër që përsëritet),

që kanë formuar ndajfoljet e përngjitura, si: *tejetej, tejndanë, tejembanë, anekënd, fundekrye* etj., mund të shihen si model për përngjitjen e strukturave të ngjashme, që dalin në formë lokucionesh, si: *lart e poshtë, mbarë e mbrapsht, sot e mot, rreth e qark, rreth e rrotull, rreth e rreth, jetë e mot (larteposhtë, mbarembropsht, sotemot, rretheqark, rretherrotull, rretherreth, jetemot* etj.

Po kështu, strukturat e përngjitura të tipit:

ndajfolje + parafjala për + ndajfolje ose emër + parafjala për + emër

që kanë formuar ndajfoljet e përngjitura, si: *brendapërbrenda, plotpërplot, drejtpërdrejt, anëpëranë, mespërmes* etj., mund të shërbejnë si model për përngjitjen e lokucioneve, si: *sot për sot, krah për krah, vit për vit* etj.

Edhe pse një pjesë e këtyre strukturave kanë në përbërje të tyre një pjesë të ndryshueshme të ligjëratës, konkretisht një emër, ai del në formë të ngurosur, duke pësuar edhe ndryshime kuptimore. Kjo ka sjellë edhe ndryshime të karakterit gramatikor: humbjen e të gjitha kategorive gramatikore të emrit dhe humbjen e aftësisë për t'u lidhur nga ana sintaksore me njësitë gjuhësore që mund të lidhet një emër. Kështu, emri ndajfoljëzohet dhe, si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht, funksionon së bashku me pjesët e tjera të lokucionit, si një ndajfolje.

Edhe në ndjenjën gjuhësore të folësit duket se këto grupe fjalësh kanë më shumë prirje për t'u përdorur në formë të përngjitur, gjë që përforcon edhe më tej prirjen e gjuhës për shmangien e mjeteve analitike të shprehjes.

BIBLIOGRAFI e cituar dhe e shfrytëzuar

Agalliu F., Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1988

Akademia e Shkencave, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë 1972

Akademia e Shkencave, Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë 2002

Akademia e Shkencave, Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II, Tiranë 1975

Akademia e Shkencave, Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës I, Tiranë 1973

Akademia e Shkencave, Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë 1954

Akademia e Shkencave, Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980

Akademia e Shkencave, Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë 2006

Agalliu F. dhe të tjerë, Hyrje në gjuhësi, 1970

Anderson Stephen R., *The morpheme: Its nature and use* for the Oxford handbook of inflection, 2013

Angoni E., Pjesëzat, në: *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme I*, Tiranë, 1972

- Angoni E.**, *Pasthirrmat nw gjuhwn e sotme shqipe*, në: Studime filologjike 1973/4
- Angoni E.**, *Onomatopetë dhe mundësitë e tyre fjalëformuese*, në: Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II, Tiranë 1975.
- Aronoff M., Fudeman K.**, What is morphology?, 2005
- Bianco F.**, *Locuzioni*, nw: Enciclopedia dell'italiano, Romë 2010
- Booij G.**, The grammar of words, 2010
- Buxheli L.**, Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe, Tiranë 2009
- Carstairs-Mccarthy A.**, *Basic terminology*, në: Handbook of word-fomation 2005
- Cipo K.**, Gramatika shqipe, 1949
- Çabej E.**, Studime gjuhësore I, II, Prishtinë 1976
- Çabej E.**, Studime etimologjike në fushë të shqipes, bleu II, A-B, Tiranë 1976.
- Çabej E.**, *Gjendja e sotme dhe detyrat e etimologjisë së gjuhës shqipe*, në: Studime gjuhësore, Prishtinë 1976
- Çeliku M.**, *Lokucionet parafrjalore emërore në gjuhën letrare shqipe*, në: Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II, Tiranë 1975
- Daci Z.**, *Vështrim rreth një tipi të lokucioneve foljore*, në: Gjuha jonë, 1985/3

Demiraj Sh., Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, Prishtinë 1971

Dodi A., *Fjala lamtumirë, përdorimi dhe formimi i saj*, në: Gjuha jonë, 1985/3

Domi M., *Disa çështje të lokucioneve*, në: Studime filologjike 1985/1

Dressler W., *Word-formation in natural morphology* (Preference for binarity), në Handbook of word-formation, 2005

Gazulli N., Fjalorth i ri, Tiranë 2005

Geci P., *Pasuria e leksikut të shqipes dhe fjalori i gjuhës shqipe*, në: Studime mbi leksikun... II, 1972

Hornby, A.S., Oxford advanced learner's dictionary of current english, 1974

Hysa E., *Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe*, në: Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, 1972.

Hysa E., *Dukuri e prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare*, në: Gjuha jonë, Tiranë 1985/1

Islamaj Sh., *Fjalëformi në gjuhësinë shqiptare*, në: Përmbledhjen e akteve të Seminarit XXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Prishtinë 2010

Kastovsky D., *Hans Marchand and the Marchandians*, në Handbook of word-formation, 2005

Kole J., *Pjesëzat si kategori leksiko-semantike në shqipen e sotme*, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë, 1972

Kostallari A., *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë, 1972

Kostallari A., *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë, 1972

Kostallari A., *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*, në Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, 1972.

Lafe E., *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe*, Morfologjia, IV, Tiranë 1971

Lafe E., *Lidhëzat të libri i parë shqip*, në: Studime filologjike, 1971/4.

Lieber Rochelle, *English word-formation process*, në Handbook of word-formation, 2005

Likaj E., Çabej M., *Morfologji e shqipes standarde*, Tiranë 2010

Lyons, J., *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë 2001

Lloshi Xh., *Mbi rezultatet kryesore në studimin e leksikut dhe të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe pas çlirimit*, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, 1972.

Lloshi, Xh., *Shqipja, gjuhë e hapur dhe dinamike*, Tiranë 2011

Matthews P.H., *Morphology, an introduction to the theory of word-structure*, 1974

Meyer G., *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë 2007

Nida Eugen A., Morphology, 1974 (botim i dymbëdhjetë)

Petit Larousse, 1979

Qesku P., Fjalor Anglisht-Shqip, Tiranë 2002

Samara M., *Mbi trajtimin leksikografik të lokucioneve në gjuhën e sotme shqipe*, në Studime filologjike 1992/1-4

Sinani Sh., Ndajfoljet përemërore në gjuhën shqipe, Tiranë 2013

Studime filologjike 1987/2

Tase P., Fjalor dialektor, Tiranë 2006

Tournier J., *Precis de lexicologie anglaise*, Paris 1988

Thomai J., Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, Tiranë 2010

Thomai J., Leksikologjia e gjuhës shqipe

Scalise, S., Morfologia, 1994

Sepir E., Hyrje në studimin e ligjërimit

Spencer Andrew, *Word-formation and syntax*, në: Handbook of word-formation, 2005

Štekauer Pavol, *Onomasiological approach to word-formation*, në Handbook of word-formation, 2005.

Sheperi, I.D., Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, Vlorë 1927

Williams E., On the notions lexically related and head of word, në Linguistic inquiry 12-2, 1981

Xanoni A., *Gramatika shqyp*, Shkodër 1909

Xhuvani A., *Çështja e “Fjalorit të gjuhës shqipe”*, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, 1972.

Xhuvani A., *Mbi thjeshtësinë e gjuhës*, në: Vepra I, Tiranë 1980

Xhuvani A., **Çabej** E., *Parashtesat e gjuhës shqipe.*, në: Vepra I, Tiranë 1980

Xhuvani A., *Paraafjalët*, në: Vepra I, Tiranë, 1980

Xhuvani A., *Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në gjuhën shqipe*, në: Vepra I, Tiranë 1980

SHTOJCË - FJALORTH

Fjalë të përngjitura në Fjalorin e gjuhës shqipe 2006

A

Afërmendsh

Akëcili

Akëku

Akëkush

Akëqysh

Akësecili

Akëseku

Akësekush

Anamend (anamendas)

Anapraptas

Anaprapthi

Andaj

Andej

Andejpari

Anekënd

Anembanë

Anepërqark

Anëpëranë

Anipse

Apo

Asajane

Asfare

Asfarëgjë

Asgjetiu

Asgjë

Asgjëkafshë

Asgjëkund(i)

Asgjëmangut

Asgjësend

Asisoj

Askund(i)

Askurrë

Askurrfarë

Askurrgjë

Askurrkah

Askurrkund

Askurrkush

Askush

Asndonjë

Asndonjëherë

Asndonjë*r/i*-a

Asnjanës

Asnjeri

Asnjë

Asnjëfarë

Asnjëfarëlloj

Asnjëherë

Asnjë*r/i*-a

Asodore

Asohere

Asokohe

Aspak

Assesi

Atëbotë

Atëherë

Atëkohë

Atillë (i,e)

Atje

Atypari

B

Babaplak

Babazot

Barabar

Bardhezi

Bardhëditë

Bardhëkuqe

Bashkalesh

Batbat

Belbëzot

Besëtytë

Besëtytni

Bërbëlit

Bëzaj

Bëzbëze

Brendapërbrenda

Brezëmbrek

Bukagjellë ndajf

Bukëvale

Buzagaz

Bythakrej

Bythëqyqe

C

Caherë

Capak

Cekapreka

Cilido

Cinglapjekthi

Ç

Çakaçuke

Çakaçukthi

Çapejak

Çdo

Çdofarë

Çdogjë

Çdoherë

Çdokush

Çdolloy

Çdonjëri

Çdota

Çelembyll

Çfarë

Çfarëdo

Çfarëdolloy

Çfarëmos

Çka

Çkado

Çkamos

Çmos pacak

Çne

Çnuk

Çoç

Çoku

Çokush

Çosa

D

Daç

Dalëngadalë

Deleduk

Denbabaden

Derisa

Dërdëllit

Diç

Diçka

Digjepiq

Diku

Dikur

Dikush

Diqysh

Disa

Disi

Doemos

Dokudo

Dokurdo

Dokushdo

Domethënë

Domosdo

Donkishot

Donzhuan

Dorëmenjë

Dosido

Drejtpërsëdrejti

Drekëherë

Dymbëdhjetë

Dymëzaj

E

Ecejak

F

Faleminderit

Falëmeshëndet

Faqemender

Farefis

Farëgjëje

Farësendi

Fërfëllij

Fëshfërin

Foleqesh

G

Gatitu

Gërgëre

Guguftu

Guraçokthi

Gurangrehas

Gurapec

Gurashenjash

Gurkali

Gurmacash

Gurmacthi

Gurtopthi

Gurthimurthi

GJ

Gjashtëmbëdhjetë

Gjersa

Gjëegjëzë

Gjëkafshë

Gjëkund

Gjësend(i)

Gjithandej

Gjithaq

Gjithashtu

Gjithçka

Gjithçmos

Gjithfarë

Gjithfarëlloj

Gjithfarësoj

Gjithfarësh

Gjithherë

Gjithkah

Gjithkund

Gjithkush

Gjithmbarë

Gjithmonë

Gjithnduer

Gjithnduersh

Gjithnjë

Gjithqysh

Gjithsaherë

Gjithsecili

Gjithsej

Gjithsekush

Gjithsesi

Gjithunji

H

Hajekeq

Hajmedet

Hajujk

Hamendje

Hapaçel

Hapadollapa

Hapagojas

Hapakrah

Hapashalas

Hapashalthi

Herëdokur

Hë nabrenda

Hë najashtë

Hë nakeq

Hë naprapë

Hë për hë

Hiç asgjë

Hiç gjë

Hiç gjë kafshë

Hiç gjë kund(i)

Hiç gjë send(i)

Hiç mosgjë

Hiqepiq

Hopakalas

Hopangop

I

Imzot

J

Jashtënesh

Jomë

Josemë

K

Kacafyt

Kacafytas

Kacagjelthi

Kacambyt

Kaherë

Kahmos

Kaladibrançe

Kaladredhas

Kalagjunjas

Kalakiç

Kalakryq

Kalamend

Kalangërç

Kalavarem

Kalavesh

Kalavigjas

Kalehtas

Kalehtë

Kalëshalë

Kaliqafë

Kamot

Kashelashë

Katërbëdhjetë

Këmbëcingthi

Këmbëdele

Këmbëkithi

Këqyr

Kësisoj

Këso

Kësodore

Këtejdetas

Këtejlumas

Këtejpari

Këtupari

Kryekëput

Kryekreje

Kryepari

Kryepicingul

Kryeshëndoshë

Kudo

Kukafshehtas

Kukafshehthi

Kukamë

Kuku

Kukumjaçkë

Kukuris

Kukuvajkë

Kumos

Kuqezi

Kurdo

Kurdoherë

Kurse

Kurrfarë

Kurrgjë

Kurrikah

Kurrikund

Kurrikush

Kurrijëherë

Kurriqysh

Kurrsesi

Kushdo

Kushedi

L

Lamtumirë

Largkëtej-i

Largnesh-i

Largqoft/ë-i

Lesheli

M

Majakrethi

Majëkrahut

Marrakot

Marramendth

Matanë

Matanëlumas

Matanëmalas

Mbanë

Mbasandaj

Mbasbjeshkas

Mbibisht

Mbifushë

Mbikrah

Mbipetk

Mbisup

Mbivetull

Mbudh

Mbuz

Mbyllasyzash

Megjithatë

Megjithëkëtë

Megjithëqë

Megjithëse

Melekuqe

Menatë

Menjëherë

Meqenëqë

Meqenëse

Meqë

Mespërmes

Mëditje

Mëditës

Mëdyshas

Mëdyshje

Mëdyzaj

Mëgojëz

Mëgjunjas (mëgjunjazi)

Mëkeq

Mëkëmb

Mëkresë

Mëngojë

Mënjane

Mënjëzaj

Mërkëmb

Mërmërit

Mësa

Mësysh

Mëvetësi

Mëzëmër

Mirëdita

Mirëfilli

Mirëmbërëma

Mirëmëngjes(i)

Mirëpo

Mirëseardhje

Mirësevjen

Mirupafshim

Mirupjekshim

Mishmash

Molladardhë

Mollaftua

Mollatartë

Moskurrë

Moskush

Mosmëharro

Mosmëprek

Mosnjeri

Mosnjëherë

Mostjetër

Motmot

Murmërij

Murmurit

Murmuroj

N

Ndajgjethëz

Ndajnatë

Ndajnatëherë

Ndanë

Ndeshtrashë

Ndërdysh

Ndërdyash

Ndërhundsh

Ndërkaq

Ndërkohë

Ndërmjet

Ndërsa

Ndërsjelltas

Ndërsyj

Ndjesëpast/ë-i

Ndo

Ndoca

Ndokund

Ndokush

Ndonëse

Ndonjë

Ndonjëherë

Ndonjëri

Ndopak

Ndore

Ndorem

Ndoresh

Nëdorës

Nënbarkëz

Nënçati

Nëndore

Nënlëkurë

Nëntëmbëdhjetë

Nëntokë

Nëpër

Nëpërkëmb

Nëpërmes

Nëpunës

Nëse

Ngaditë

Ngado

Ngaherë

Ngandonjëherë

Nganjëherë

Ngaqë

Ngarend

Ngase

Ngrykë

Ngush

Ngjyrëvishnje

Ninananë

Nisesos

Nusebukur

Nuselalë

NJ

Njaçkadië

Njëditëzaj

Njëenjzë

Njëfarë

Njëfarëlloj

Njëfarësoj

Njëherë

Njëherësh

Njëlloj

Njëmbëdhjetë

Njëmend

Njëmendthi

Njëmenjë

Njëmëzaj

Njënatëzaj

Njënjë

Njëpërnjë

Njësoj

Njëtash

Njëzëri

O

Obobo

Oburrani

P

Paçka

Padashka

Padije

Padjallëzi

Padurim

Pafuqi

Pakkush

Pakmos

Paksa

Paksëpaku

Pakujdesi

Pakujdesje

Pakujtimas

Pale

PamiradijE

Paprerë

Papritmas (papritmazi)

Paradite

Paradreke

Parasysh

Pardje

Parmbrëmë

Parvjet

Pasdarke

Pasдите

Pasdreke

Pasi

Paskëtaj

Pasmesnatë

Pasnesër

Pasqafe

Patjetër

Pavetëdiqe

Pasagurithi

Pesëmbëdhjetë

Përballë

Përbrenda

Përbri

Përbuj

Përbuz

Përderës

Përderisa

Përditë

Përdyt

Përdhe

Përdhunë

Përfaqe

Përfund
Përfytem
Përgojë
Përgjatë
Përgjithmonë
Përgjithnjë
Përgjumësh
Përhedh
Përherë
Përjashta
Përjetë
Përkarshi
Përkëmb
Përkëtej
Përkrah
Përkundër
Përmatanë
Përmbas
Përmbi
Përmbipardje
Përmbipasnesër

Përmbropa

Përmendsh

Përmes

Përmjet

Përnatë

Përndryshe

Përngaherë

Përngut

Përnjëherë

Përnjëmend

Përposhtë

Përqark

Përqurr

Përreth

Përse

Përsëdyt

Përsëri

Përsipër

Përskaj

Përsysh

Përhëndosh

Përshitës

Përrëshqit

Përshtat

Përtej

Përtejbotë

Përtokë

Përtop

Përtym

Përudh

Përveç

Përveçqë

Përveçse

Pëshpërit

Picimajthi

Picingul

Picingulthi

Pikëgjallë

Pikëpesë

Pikësëpari

Plotfuqi

Plotgojas

Plotpërplot

Porsa

Porse

Porsi

Posa

Posaqë

Posi

Posikur

Pothuaj

Pothuajse

Prandaj

Pranë

Prapakthehu

Prapamalas

Prapëseprapë

Prore

Pulaqorrthi

Punëdore

Pupu

Q

Qepëdosë

Qëherthi

Qëkur(i)

Qëkurse

Qëlashti

Qëmoti

Qënatje

Qëparë

Qëparthi

Qiteprit

Qoftëlarg-u

R

Ruajnazot-i

Rr

Rraketake

Rrallëherë

Rrallëkund

Rrallëkush

Rrasëpetë

Rrëshqanë

Rruazapalcas

Rrushqyqe

S

Sado

Sadokudo

Sadomos

Sadoqë

Sakaq

Sakaqherë

Sanataditë

Saora

Sapo

Sapunqyqe

Saqë

Secili

Secilido

Sedo

Sekush

Sepse

Sesa

Sesi

Siç

Sido

Sidokudo

Sidomos

Sidoqoftë

Sidozot

Sikundër

Sikundërqë

Sikundërse

Sikur

Sikurse

Sikush

Sipas

Sipër

Sivjet

Sonte

Symbyllas (symbyllazi)

Syplasar

Sytokas

Sh

Shëmëhill

Shëmitër

Shënëndre

Shpeshherë

Shtatëmbëdhjetë

Shtatëpëllëmbëmjekër

Shtojzorreshta

Shtojzovalle

Shtozoj

Shtrojerë

Shumçka

Shumëkund

Shumëkush

Shushurin

T

Taketuke

Tambël

Tamtam

Tejefund

Tejembanë

Tejendanë

Tejetej

Tejmatanë

Tejnesër

Tejpardje

Tejparvjet

Tejpasnesër

Tejpërtej

Tekandej

Tekdo

Tekefundit

Tekembramja

Tekëndej

Tekqë
Teksa
Teposhtë
Tetëmbëdhjetë
Tëlyen
Tëmbël
Tëmotje
Tiktak
Tjetërkah
Tjetërkund
Tjetërkush
Tjetërmendas
Tjetërpardje
Tjetërpasnesër
Tjetërparvjet
Tjetërqysh
Togfjalësh
Topahipas (topahipthi)
Topgropthi
Trembëdhjetë
Tukeq

Tumirëmbeç

Tundubishtje

Tungjatjeta

Th

Thashetheme

Theqafas (theqafazi)

Theribujkë

Therimi

Therpelë

Thithëlopë

Thuajse

Thuthuq

U

Ububu

Udhembarë

V

Vajmedet

Valëbuke

Vapëherë

Veçan

Veçmas

Veçse

Vetvetiu

Vëmendje

Vërej

Xh

Xhuxhmaxhuxh

Z

Zemërherë

Zigzag

Zomotër

Lokucione në Fjalorin e gjuhës shqipe 2006

A

A... apo

Me acari

Afër e afër

Së afërmi

Në ag

Në ah

Bëj aluzion

Për analogji

Andej e këtej

Andej-këtej

Në anë të anës

Nga ana e anës

Në të katër anët

Anë e kënd

Në anë

Me anën

Anën e anës

Aq sa

Të *ardhsha* për të mirë!

Mirë *ardhsh!*

Ngjyrë *argjendi*

Për arsye

Për arsye se

Arusha e Madhe

Arusha e Vogël

Marr *arratinë*

As që

Ashtu-ashtu

Ashtu-kështu

Aty për aty

Aty-aty

Aty-këty

B

Ballë për ballë

Bar argjendi

Bar balsami

Bar beronje

Bar blete

Bar brengje

Bar breshke

Bar delli

Bar djathi

Bar dhëmballe

Bar ethesh

Bar guri

Bar gjaku

Bar hënëze

Bar hikrraqi

Bar hirre

Bar hudhre

Bari i jetës

Bar jodi

Bar lepuri

Bar lunge

Bar i lotzonjës

Bar miu

Bar mjalti
Bar nepërke
Bar ngjitës
Bar pate
Bar peshku
Bar pezmi
Bar përdhes
Bar plasjeje
Bar të preri
Bar pushi
Bar qelbës
Bar qeni
Bar qumështi
Bar rresh
Bar sahati
Bar shëllire
Bar shpirre
Bar shpretke
Bar tambli
Bar i trashë
Bar thëllëze

Bar thiu

Bar uji

Bar urithi

Bar verdhëze

Bar vese

Bar veshi

Bar zemre

Bar zgjebeje

Në *bashkëpunim me*

Zë besë

Bëj ballë

Bëj be

Bëj çudi

Bëj durim

Bëj fjalë

Bëj fotografi

Bëj gati

Bëj gjimnastikë

Bëj kursim

Bëj lajka

Bëj marrëzi

Bëj mënjatë

Bëj nder

Bëj not

Bëj përpjekje

Bëj pyetje

Bëj shaka

Bëj shëtitje

Bëj tërkuzë

Bëj thirrje

Bëj zë

Bën dredha,

Bën kthesë (rruga)

Bën rrudha

Bën shtrenjtë

Bojë argjendi

Breg më breg

Brez pas brezi

Nga brezi në brez

Me të butë

C

Ca nga ca

Cilido që

Copë e çikë

Copë e kothere

Copë e thërrime

Copë e grimë

Copa – copa

Copë – copë

Ç

Në çast

Atë çast

Këtë çast

Në çastin kur

Që prej çastit

Orë e *çast*

Çdo gjë

Në *çdo* kohë (që)

Nga *çdo* anë (që)

Për *çdo* rast (që)

Çfarëdo që

Çikë e thërrime

Një çikë

D

Daç...daç

Dallëndyshe deti

Darkë për darkë

Degë më degë

Në *dëm*

Dimër e verë

Ditë e natë

Me ditë

Nga dita në ditë

Një ditë

Një ditë prej ditësh

Në dobi

Dora-dorës

Dorë më dorë

Duar-duar

Dh

Bojë *dheu*

Ngjyrë *dheu*

Dhëmb për dhëmb

E

Edhe...edhe

edhe në qoftë se

edhe po qe se

Edhe në

Edhe sikur

Edhe pse

Edhe sepse

Ë

(ma) Ka *ënda*

F

Për *faj*

Fije për fije

Fije-fije

Në fjalë e sipër

Pa fjalë

Fjalë për fjalë

Fjolla-fjolla

Flokë-flokë

Pa fund

Pa anë e pa *fund*

Në fund të fundit

Fund e krye

Fundja-fundjes

Në *fushën*

G

Gështenjë kali

Gështenjë deti iriq

Qofsh *i gëzuar!*

E kalofsh *i gëzuar!*

Zë në (me) *gojë*

Goja-gojës

Gojë më *gojë*

Gojë pas *goje*

Gropa-gropa

Grupe-grupe

Gruri i thneglave

Gryka e Këlcyrës

Gur gjaku (lëndë minerale)

Gur kali

Guri liri

Gur leshi

Gur mëndafshi

Gur pambuku

Gur mulliri

Gur shkrepës

Guri i Bardhë

Gj

Për së *gjalli*

Gjatë e gjerë (sa gjatë gjerë)

Gjen zbatim

Gjen shpëtim

Gjen përhapje

Gjen përkrahje

Gjen vdekjen

Gjerë e gjatë (sa gjerë gjatë)

Gjë që

Me gjithë

Gjithë ç'

Gju më gju

(e) Zë *gjumi*

H

Hap pas hapi

Në *harmoni* me

Hedh sëmundjen

Hem...hem

Herë më herë

Herë pas here

Në krye të herës

Herë-herë

Për *hir* (të)

Ngjyrë *hiri*

Hiri i hardhisë

Hollë-hollë

Hope-hope

Me një hov

Hove-hove

(i) Doli nga *hundët* (për hundësh)

Fut *hundët*

J

Ja...ja

Javë për javë

Sido që *të jetë*

Për *jetë* e mot

Shoku i *jetës*

Jap *jetën*

Erdhi në *jetë*

U nda nga *jetas*

Ndërroi *jetë*

K

Kam dëshirë

Kam durim

Kam dhembje

Kam etje

Kam gjumë

Kam kundërshtim

Kam shpresë

Kam uri

Bojë *kafë*

Kashta e Kumtrit

Këmba-këmbës

Këmbë e krye

Ngul *këmbë*

Këmbë-këmbë

Kështu që

Para kohe

Me kohë

Në kohë

Në kohën që

Në kohën kur

Sa kohë që

Për sa kohë që

Kokë e këmbë

Kokë më kokë

Kot më kot

Krah për krah

Në krahasim me

Ngre *krye*

Ku e ku

Kur e kur

Në *kurriz*

Kurrën e kurrës

Kushdo që

Me çdo *kusht*

L

Lara-lara

Për së largu

Lart e më lart

Lart e poshtë

Lehtë-lehtë

Le që

Pa *le*

Leskra-leskra

Në *lëmin*

Në lidhje me

Lidhur me

Ngjyrë *limon*

Derdh *lot*

Lule akshami

Lule akulli

Lule alle

Lule argjendi

Lule balsami

Lule blete

Lule bore

Lule breshke

Lule bretku

Lule bualli

Lule deleje

Lule dielli

Lule dimri

Lule djathi

Lule dushku

Lule dylli

Lule dhensh

Lule ethesh

Lule fieri

Lule floriri

Lule fshese

Lule gishti

Lule gomari

Lule gjarpri

Lule gjize

Lule kashte

Lule këmbore

Lule krehri

Lule kungulli

Lule lakre

Lule lepuri

Lule maji

Lule mbrëmjeje

Lule mëllage

Lule mëngjesi

Lule misri

Lule mize

Lule mosmëharro

Lule mosmëprek

Lule peshku

Lule plepi

Lule pranvere

Lule preshi

Lule qeni

Lule qengji

Lule qyqeje

Lule rezhde

Lule rruaze

Lule sahati

Lule sapuni

Lule syri

Lule sharre

Lule shigjete

Lule shpate

Lule shqerre

Lule shqiponje

Lule thoi

Lule vathi

Lule vere

Lule vizhe

Lule vjeshte

Lule ylli

Lule zjarri

Lule zogu

Lule zonje

Lule-lule

M

Marr frymë

Marr hov

Marr me mend

Marr pjesë

Marr në pyetje

Marr në qafë

Marr në shqyrtim

Marr hak

Marr nën mbrojtje

Marr inat

Merr fund

Merr valë

Në *marrëveshje* me

Mban erë

Mbaj fjalën

Punë e mbarë!

Udhë e mbarë!

Të shkoftë mbarë!

Mbarë e mbrapsht

Mbetsh me shëndet!

Mirë *mbetsh!*

Me kujdes

Me radhë

Me nxit

Kam ndër *mend*

Sjell ndër *mend*

Vjen ndër *mend*

Mbaj *mend*

(më) Doli nga *mentë*,

(e) Ruaj në *mendje*

(e) Fshiu nga *mendja*

Nuk më hiqet nga *mendja*

Kam për mënge

Mëngjes për mëngjes

Nga mëngjesi deri në mbrëmje

Me çdo *mënyrë*

Në *mënyrë* që

Mbaj *mëri*

Kam *mëshirë*

Ditën *e mirë!*

Të vajttë mbarë!

Të gjettë (të priftë) *e mira!*

Ju ardhshim për *të mirë!*

Të gjitha *të mirat!*

Mirë se erdhe!

Mish i huaj

Mollë dheu

Molla e Adamit

Mot e jetë

N

Nata-natës

Qofsh me *nder!*

Ndo...ndo

Në bazë

Në drejtim

Në këmbë

Në përgjithësi

Në veçanti

Në tym

Në vend

Nga dera në derë

Nga koha në kohë

Nga vera

Ngado që

Me ngut

Nuse deti

Nusja e lalës

Nuse pashke

Nusja e syrit

(e) Nxori birërie

Nxori zë

Nxori në shitje

I nxori gjumin

Nxori mallin

I nxori pijen

Nj

Me një zë

Një për një

Deri më një

Pa një pa dy

Njolla-njolla

O

Orë për orë

Orë pas ore

Një orë e më parë

Orë e pa kohë

Orë-orë

P

Paçka

Paçka se

Në *palcë* (të)

Palë-palë

Shëndet *pastë!*

Pavarësisht se

Peshku i kurrizit

Peshk guri

Për punë (të)

Në *përputhje* me

Në pikë (të vapës)

Pikë për pikë

Pikë-pikë

Ngjyrë *plumbi*

Ngjyrë *portokalli*

Nga *poshtë* lart

Poshtë e më poshtë

Në *prag*

Ngjyrë *preshti*

Presh gjarpri

Bëj *pushim*

Q

Qafa e Thanës

Qafa e Buallit

Bën *qeif*

Kam *qejf*

Që ku

Që kur

Kurdo *që*

Mjaft *që*

Posa *që*

Sido *që*

Le *që*...por (edhe)

Jo *që*...por (edhe)

Qofsh me jetë!

Rrofsh e *qofsh*!

Qofsh shëndoshë!

Gëzuar *qofsh*!

I qofsha falë!

Qoftë... qoftë

Në qoftë se

Qoshe më qoshe

R

Radhë-radhë

Ka raste

Në rast se

Në rast të kundërt

Rëndë-rëndë

Rr

Rreth e rrotull

Rreth e qark

Rreth e rreth

Rrush arushe

Rrush gjarpri

Rrush mali

Rrush pule

Rrush qeni

Rrushi i qyqes

Rrush toke

Rrush frëngu

Rrush thëllëze

S

Sa kohë që

Sado që (është edhe sadoqë si zë më vete)

Në saje

Nga frika se

Nga shkakun se

Duke qenë se

Në është se

Po qe se

Po të jetë se

Përpara se

Qysh se

Vetëm se

Si... (ashtu) edhe

Si... si

Sido që

Sot e mot

Sot për sot

Në sy (të)

Sh

Me shëndet!

Shëndet e të mira!

Qofsh (të paça) me shëndet!

Me shëndet e zemër të mirë!

Vafsh (ardhsh) shëndoshë!

Vetë shëndoshë!

Nga shkaku i

Për shkak të

Për shkak se

Shkalla e Tujanit

Shkallë-shkallë

Shkolla e jetës

Me shpirt

Shtëpi për shtëpi

Shumë-shumë

T

Tekdo që

Ngjyrë *tjegulle*

Ngjyrë *tulle*

Tufa-tufa (tufë-tufë)

Zë turpi

Tutje-tëhu

Th

Thekë-thekë

Vë *theksin*

Thela-thela

Thikë më thikë

U

Si urdhëron

V

Në *varësi*

Varg e varg

Varg e vistër

Vende-vende

Në vend

Në vend që

Luaj *vendit*

Marr *vesh*

Mbaj vesh

(i) Tha në *vesh*

(e) Zuri nga (për) *veshi*

Vetëm për vetëm

Vetëm e vetëm

Jo *vetëm* (që)... por edhe

Jo vetëm... porse

Vë në rrezik

Vë në shfrytëzim

Vë themelet

Vë në veprim

Vërtet që

Vija-vija

Nga viti në vit

Vit për vit

Vrima-vrима

I bie vrugu

X

Xanë lepuri

Xixa-xixa

Xh

U bë xhind

Bëj xhiro

Y

Nxjerr yçkla

Z

Kam për zemër

Fal zemrën

Zë në gushë

Zë për dore

(më) Zë deti

(më) Zë frika

(më) Zë syri

Zë shiu (bora)

Zë brumin

Zë vend

Me zemër të mirë!

Zog bari

Zog blete

Zog drite

Zogu i dhenve

Zog miu

Zogu i natës

Zog nuseje

Zoti i shtëpisë

ZH

Zhele-zhele

